

**ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**35**



**PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË  
SHQIPËRISE



ENVER HOXHA



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

VËLLIMI

35

SHKURT 1967 – QERSHOR 1967

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1982

## *PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 35-TË*

*Materialet e vëllimit të 35-të-të Veprave të shokut Enver Hoxha i përkasin periudhës shkurt-qershori të vitit 1967. Një pjesë e mirë e tyre botahej për herë të parë.*

Vëllimi hapet me fjalën historike të 6 shkurtit 1967, mbajtur përpara disa organizatave-bazë të Partisë të Tiranës «Për revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë e të pushtetit», i cili i dha një orientim të mëtejshëm luftës së masave punonjëse e të komunistëve për të vënë në jetë vendimet e Kongresit të 5-të. Ky fjalim, që pati reperkusione të thella në jetën e vendit, e nxiti më tej shpërthimin e lëvizjeve të mëdha për revolucionarizimin e Partisë, të pushtetit dhe të të gjithë jetës së vendit.

Në materialet që botahej në këtë vëllim duket preokupimi i madh i udhëheqjes së Partisë që ky vrull e kjo lëvizje e gjerë dhe e thellë të orientoheshin, të udhëhiqeshin e të organizoheshin në shkallën e duhor, që Partia dhe pushteti t'u përgjigjeshin me masa të drejta ekonomike, politike e organizative, me një punë edukuese të ngritur në një nivel më të lartë. Në një sërë diskutimesh, fjalimesh e bisedash në forumet e Partisë e në popull, shoku Enver Hoxha thekson do-

mosdoshmërinë e revolucionarizimit të metodës e të stilit në punë të kuadrove të Partisë, të pushtetit, të ekonomisë, gjetjen e formave të reja edukuese e organizuese, që arti i drejtimit t'u përgjigjet vrullit dhe gatishmërisë së masave punonjëse.

Përballë këtyre detyrave një rëndësi të veçantë merrte rritja e mëtejshme e rolit udhëheqës të Partisë në të gjitha fushat, revolucionarizimi i mëtejshëm i saj, i çdo komunisti. Këto kërkesa, aktuale dhe të perspektivës, trajtohen në shumë materiale të vëllimit. Kështu, ndërsa në diskutimin në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH më 21 prill 1967, shoku Enver Hoxha, përmes një analize konkrete të punës së deriatëhershme të Partisë, shtron detyra për kalitjen ideologjike dhe forcimin organizativ të Partisë, për përmirësimin e punës së forumeve drejtuese të saj, në fjalën e mbajtur në një organizatë-bazë të uzinës «Enver», ai vë theksin në rolin pararojë e udhëheqës të të gjithë komunistëve, të cilët «...duhet të udhëheqin me shembullin, me sakrificat dhe me punën e tyre vetëmohuese». Forcimi i Partisë kërkonte, gjithashtu, gjallërimin e saj të vazhdueshëm me gjak të ri nga radhët e punëtorëve, kooperativistëve, intelektualëve e, në mënyrë të veçantë, nga radhët e grave. Kritika që u bën shoku Enver Hoxha shfaqjeve të sektarizmit, të skepticizmit e të mefshtësisë në këtë drejtim dhe detyrat që shtron ai, kanë vlerën e tyre aktuale për sot dhe për të ardhmen.

Partia luftën e saj për thellimin e revolucionit do ta bënte me masat, në krye të tyre. Për këtë qëllim në materialet e këtij vëllimi i jepet një rëndësi e dorës së

parë zbatimit të drejtë dhe konsekuent të vijës së masave, pjesëmarrjes së tyre praktike në jetën e vendit, sepse «Partia asgjë nuk mund të zgjidhë drejt dhe me bazë jashtë masave dhe pa ndihmën e tyre». Prandaj, forcimi i mëtejshëm i punës së organizatave të masave, sidomos i Frontit Demokratik, forcimi i rolit udhëheqës të Partisë në këto organizata, konsiderohet si një detyrë tepër e rëndësishme.

Në disa fjalime, diskutime e biseda të shokut Enver Hoxha, mbajtur drejtpërdrejt para masave punonjëse, duket qartë synimi që komunistët dhe masat punonjëse të vendit tonë të kuptojnë drejt vijën e Partisë dhe detyrat që u shtronte zhvillimi e thellimi i pandërrerë i revolucionit. Trajtimi i problemeve kyç të Partisë e të shoqërisë sonë me komunistët dhe me masat është një shprehje tjetër e zbatimit të vijës së masave nga Partia jonë. Një vend i rëndësishëm u kushtohet në këto takime, sidomos, luftës kundër fesë e zakoneve prapanike.

Në një sërë materialesh të këtij vëllimi pasqyrohet politika e Partisë për zhvillimin e zonave malore të vendit, të cilat, për shkaqe objektive, kishin ngelur më prapa zonave fushore dhe tanj hynin në rrugën e një përparimi më të shpejtë. Zhvillimi i gjithanshëm i vendit tonë kishte krijuar kushte materiale për një kthesë edhe në zhvillimin e malësive. Nga ana tjetër, ndryshimet e mëdha që ishin bërë edhe në këto zona, kishin rrënjosur e rritur më tej te banorët punëtorë e patriotë të tyre besimin te vija e Partisë. Ky besim, së bashku me punën e madhe ideologjike, zhvillimin e arsimit e të kulturës etj., i kishte hedhur ata në lëvizjen

e madhe kundër fesë e Kanunit. Këtij vrulli revolucionar e besimit te Partia, kjo do t'i përgjigjej me masa të rëndësishme ekonomike, politike, ideologjike e organizative. Në mjaft materiale shoku Enver tërheq vëmendjen që në drejtim të zhvillimit të zonave malore të bëhej një kthesë vendimtare në botëkuptim, në ekonomi, në kulturë. Baza e këtij zhvillimi do të ishte forcimi i ekonomisë popullore e, në veçanti, zhvillimi i bujqësisë, e cila, në këto zona, vetëm para pak kohësh kishte hyrë në mënyrë masive në rrugën e kolektivizimit. Forcimi i kooperativave malore, një problem i madh për Partinë në këtë periudhë, trajtohet në diskutimin në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH më 24 shkurt; në fjalën e mbajtur në aktivin e Partisë të rrethit të Krujës etj.

Në përgjithësi, problemet e zhvillimit të bujqësisë në materialet e këtij vëllimi zënë një vend të dukshëm. Kjo lidhet me detyrat që kishte përcaktuar Kongresi i 5-të i Partisë për zhvillimin, modernizimin e intensifikimin e bujqësisë sonë, duke u bazuar në prodhimin e madh shoqëror. Këtu vihej theksi edhe në këtë periudhë, ndërsa masat e marra për zvogëlimin e oborrit kooperativist, për të cilin flitet në materialet e vëllimit, dëshmojnë, edhe një herë, për vazhdimësinë e politikës revolucionare të Partisë, lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve socialiste në prodhim në fshat.

Problemët e luftës kundër imperializmit e revolucionit modern gjejnë një pasqyrim të gjërë në materialet e këtij vëllimi. Në to shprehet politika e drejtë e PPSH në probleme të zhvillimit botëror, vija konsekutive e saj në mbrojtje të marksizëm-leninizmit, të

revolucionit e të socializmit, lufta e vendosur kundër revizionizmit sovjetik, jugosllav etj., nxirren në shesh tiparet e politikës së jashtme të revizionistëve sovjetikë, të cilët, për qëllimet e tyre imperialiste, vinin në ankand interesat e proletariatit e të popujve. Në artikujt e shkruar pas agresionit izraelit të qershorit 1967, demaskohet komploti i kurdisur nga Bashkimi Sovjetik e SHBA kundër popujve arabë. Siç argumentohet edhe në artikullin, «Agjent i amerikanëve dhe mik i rremë i popujve arabë», në këtë komplot kishin rolin e tyre edhe revizionistët jugosllavë, që, ndërsa liqeshin si kampionë të «mosangazhimit» dhe të mbrojtjes së të drejtave të popujve, u shërbenin interesave të imperialistëve, kurse në Jugosllavi ruanin e nxitnin pabarazinë ekonomike e politike, shtypjen e popullsisë shqiptare në Kosovë e gjetkë.

Vëllimi i 35-të i Veprave të shokut Enver Hoxha, ku gjendet e materializuar politika konkrete e Partisë në një periudhë të caktuar, është një ndihmë tjetër për komunistët dhe masat punonjëse të vendit tonë, për realizimin e detyrave aktuale të ndërtimit socialist dhe të thellimit të revolucionit në të gjitha fushat.



## REVOLUCIONARIZIMI I MËTEJSHËM I PARTISË DHE I PUSHTETIT

*Fjalim i mbajtur në mbledhjen e përbashkët të organizatave-bazë të Partisë të Minierës së Qymyrgurit të Kërrabës, uzinës «Enver», kooperativës bujqësore «Vilhelm Pik», Repartit Ushtarak nr. 5009 dhe Universitetit të Tiranës*

**6 shkurt 1967**

Shokë dhe shoqe komunistë,

Organizatat e Partisë gjenden përpara një evenimenti të rëndësishëm. Gjatë dy muajve të ardhshëni, kudo, në organizatat-bazë të qytetit e të fshatit, në institucionet e ndryshme dhe në forcat e armatosura, do të zhvillohen mbledhjet për dhënie llogari dhe përzgjedhjen e udhëheqjeve të organizatave-bazë dhe të komiteteve të Partisë në rajone e në zona të thella.

Dhënia llogari dhe zgjedhjet janë një ngjarje me rëndësi të madhe për forcimin e mëtejshëm të Partisë. Në mbledhjet për këtë qëllim çdo komunist duhet të bëjë bilancin e punës së tij dhe të organizatës, të peshojë me frymën e kritikës dhe të autokritikës suksesset e të metat, të caktojë objektivat, për arritjen e të

cilëve do të luftojë në të ardhmen, të zgjedhë sekretarin, byronë apo komitetin nga gjiri i shokëve e i shqeve që kanë punuar më mirë, që janë treguar organizatorë të aftë, luftëtarë të vendosur për zbatimin e vijës së Partisë.

Mbledhjet e organizatave-bazë për dhënie llogari e zgjedhje medoemrës duhet të justifikojnë mbajtjen e tyre. Me këtë dua të them që të kërkohet e të jepet llogari nga të gjithë një për një, dhe jo vetëm si e kemi kryer detyrën në përgjithësi, por si e kam kryer atë unë si komunist në veçanti, dhe jo vetëm në arë, në fabrikë ose në zyrë, por si e kam kryer detyrën në shoqëri, si jam mobilizuar dhe si kam luftuar për problemet shoqërore, politike, familjare dhe, kur them familjare, nuk e kam aspak për çështjet e brendshme të familjes, po për problemet shoqërore-politike që preku pojnë familjen shqiptare.

Në organizatën-bazë komunistët revolucionarë u kërkojnë llogari shokëve të tyre revolucionarë, pasi çështjet për të cilat kërkohet llogari s'janë private, personale, por janë probleme politike-organizative të Partisë, probleme të kolektivit, të masës, prandaj ne, si komunistë, kemi përgjegjësi të madhe si kolektiv partie dhe si komunistë, pjesëtarë të këtij kolektivi.

Ne po bëjmë një luftë të madhe, të vazhdueshme dhe me rezultate shumë të mira për revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë. Revolucionarizim i Partisë do të thotë revolucionarizim i komunistëve. Këta duhet të jenë ushtarë të çeliktë, të qartë politikisht, të guximshëm, të dashur, të hapët, të sinqertë e, kur duhet, edhe të rrëptë. Këta duhet të shkatërrojnë çdo gjë të

keqë, të mbështetin, të organizojnë dhe të luftojnë në ballë për të renë përparimtare. Në qoftë se këto që them duken si parime të përgjithshme, atëherë po i bëj më konkrete.

Ta filloj nga më e thjeshta. Si mund të quhet revolucionar ai komunist që kalon gjashtë herë në ditë mbi bajgat që kanë mbushur shkallët e apartamentit të tij dhe nuk merr mundimin ta zhdukë një situatë të tillë dhe të edukojë gjithë banorët e pallatit?

Si mund të quhet revolucionar ai komunist që merr pjesë në mbledhjet e lagjes, të Frontit ose të bashkimeve profesionale vetëm kur e thërresin, bile edhe këtë herë përpinqet t'i bëjë bisht, ose vete sa të duket që vajti, atje lidh duart dhe e quan veten se s'ka asnje përgjegjësi të flasë, pale të luftojë për të vënë në zbatim ato që flasin të tjerët?

Si mund të quhet në pozita pararojë ajo organizatë-bazë partie e Portit në Durrës dhe si mund të quhet në pozita revolucionare ai punëtor i këtij porti që ditën punon mirë, dallohet, bile edhe lavdërohet, kurse në mbrëmje në shtëpi bën ikona kishe dhe i shet në mëngjes në besimtarë privatë?

Po shkoj edhe më tej. Si mund të jetë në pozita revolucionare organizata-bazë e Partisë në fshatin malor Zgjan të lokalitetit të Hysgjokajt, në rrëthin e Lushnjës, ku gati të gjitha vajzat që nga 13-14 vjeç e poshtë janë të fejuara dhe disa të martuara të vogla nga prindët, jashtë ligjit?

Po shkoj akoma edhe më tej. Si mund të jetë në pozita revolucionare e gjithë organizata e Partisë e rrëthit të Lezhës, ku në mënyrë të heshtur është bërë

ligj zakoni i poshtër i shitjes së vajzave për martesë? Gjithë Partia dhe vendi duhet të ngrihen në këmbë, të djegin me zjarr zakonet prapanike e t'i këputin kokën cilid do që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të Partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave. Këto janë probleme moralo-politike me rëndësi të madhe.

Kërkimi i llogarisë nga komunistët është i domosdoshëm, por ky duhet të bëhet me fryshtë revolucionare dhe jo meskine, për çështje të vogla, apolitike, jo në formë inkvizicioni, jo të shpifet dhe të krijohen gjëra të paqena, jo sulme personale hakmarrëse. Të gjitha këto lloj kërkese llogarish janë të huaja e të dënueshme nga Partia jonë, pasi janë të fryshtëzuara të gjitha nga pikëpamja mikroborgjeze.

Prandaj mendoj se duhet të largohemi nga ato forma kërkese llogarie të përgjithshme pa rezultat, ose të bërjes së një kritike o autokritike bajate, që as ndez, as shuan, që nuk i edukon politikisht shokët dhe nuk i ndihmon ata në zgjidhjen drejt të problemeve.

Që ta bëjmë Partinë revolucionare në kulm, të gjithë komunistët duhet të marrin dhe të mbajnë përgjegjësitë, duke i kryer detyrat deri në një dhe duke dhënë llogari deri në një. Llogaria shumë herë nuk jepet si duhet, nuk kërkohet si duhet pasi nuk kuptohen si duhet detyrat e gjithsecilit, dhe në radhë të parë detyrat politike.

Të marrim, për shembull, anëtarët e komiteteve të Partisë ose anëtarët e byrove të organizatave-bazë dhe deri te komunistët e organizatës-bazë. Thuhet zakonisht se nuk mobilizohen të tërë si duhet në punët e ndryshme të Partisë, bëhet zakonisht kritikë se by-

roja e komitetit të Partisë, sekretarët e tij, ose sekretari i organizatës-bazë, nuk e organizojnë mirë punën me ta etj., etj. Këto janë me vend dhe të drejta, bille duhet të kritikohen akoma më fort, pasi nga komitetet e Partisë dhe nga sekretarët e tyre punë, pak a shumë të organizuar dhe të planifikuar, ka vetëm me instruktörët e komitetit, me njerëzit e aparatit dhe herë pas here në ndonjë mbledhje me sekretarët e organizatave-bazë. E shikuar dhe e bërë kështu, kjo punë ka një frymë burokratike, zyrtare.

Por fajin nuk e kanë vetëm këta shokë, faj kanë edhe disa shokë të tjerë që kritikohen lehtas, ose s'kritikohen fare, dhe, kur vjen koha e dhëties llogari dhe e zgjedhjeve, as llogari japidh dhe përsëri zgjidhen. Fjalën e kam, në radhë të parë, për anëtarët e plenumeve të komiteteve të Partisë dhe të byrove të organizatave-bazë. Ata janë zgjedhur nga Partia të drejtajnjë, të organizojnë, të mobilizojnë dhe të luftojnë si revolucionarë dhe jo të presin vetëm dy ose tri mbledhjet në vit të komitetit të Partisë dhe të kujtojnë se me këtë mbaroi puna e tyre. Në këto mbledhje puna vetëm sa ka filluar.

Ata mund të thonë: «Po ja, nuk na mbledhin sekretarët, nuk na mobilizojnë» etj. Mirë, po nuk kemi parë asnjëherë që këta shokë t'ua vënë sekretarëve këmbët në një këpucë për këtë punë dhe, më në fund, t'u ngrenë edhe këmbët, në rast se ata nuk e kryejnë si duhet detyrën. Ta zëmë se fajtorë janë byrotë dhe sekretarët; por ne shumë rrallë shohim anëtarët e komiteteve të Partisë që të përdorin si revolucionarë të drejtat që atyre u ka dhënë Partia. Rrallë mund

të jetë ndonjë, për të mos thënë asnijë, që, pa e caktuar komiteti, shkon të kontrollojë, të ndihmojë, të udhëzojë, të marrë masat në vend në organizata të tjera bazë jashtë asaj të vetës, ose të shohim të vejë të vizitorjë dhe të ndihmojë organizata ekonomike jashtë asaj ku punon vetë zakonisht. As qimen nga qulli, si të thuash, nuk e ngre pa pyetur dhe pa marrë lejen e sekretarëve. Anëtari i komitetit të Partisë duhet t'i koordinojë këto punë me sekretarët, të kërkojë të dhëna nga aparatet e Partisë, ai duhet të diskutojë me sekretarët mbi ç'ka parë, ç'ka bërë dhe çfarë propozon. Të mos marrë ai asnijë mundim dhe asnijë iniciativë vetë, brenda kompetencave, kësaj nuk i thonë punë revolucionare, por një interesim thjesht për punët që janë nën drejtimin e organizatës-bazë të tij. Ky është një interesim i thjeshtë lokal.

Zbatimi si duhet i të drejtave dhe i detyrave nga çdo komunist i bazës, ose i zgjedhur në forumet udhëheqëse të Partisë, nuk do të thotë që ai të shkelë normat e Partisë, për të cilat do të flas më poshtë, përkundrazi, ai lufton që t'i çelikosë ato. Po nuk i përdori këto të drejta, ai lejon kështu një metodë pune të tillë që forcon fryshtës burokratike të punës së aparatave të Partisë. dhe arrihet në atë që njerëzit e emëruar të aparatave të Partisë bëhen të plotfuqishëm, dalin në skenë si «specialistë, punëtorë partie të pagabueshëm» dhe thuhet për ta se «e njojin organizatën në majë të gishtërinjve». Kështu është edhe për disa anëtarë të thjeshtë të Partisë.

S'ka asnijë dyshim se në organizatën-bazë duhet të ketë organizim të detyrave, ndarje pune në komunistët.

Kjo bëhet ku mirë, ku jo mirë; këtë ne duhet ta perfekcionojmë, por asnjë komunisti nuk i lejohet të lidhë duart në rast se nuk i caktohet ndonjë detyrë në mënyrë të veçantë. Sa shumë detyra ka në shesh për t'i kryer. Atëherë, çfarë revolucionari i thonë atij komunisti, që vetëm pret t'i caktojë dikush një detyrë për ta kryer?

Jo, një komunist i tillë nuk mund të quhet revolucionar, energjik, me iniciativë, i hedhur. Partia nuk i do t'i ketë të tillë anëtarët e saj, të cilët duhet të kuptojnë se vetëm në një luftë revolucionare krijohen dhe kaliten komunistët heroikë.

Prandaj një shkollë e madhe për revolucionarizimin e kuadrove të Partisë janë të gjitha mbledhjet e Partisë, dhe veçanërisht ato për dhënie llogari e zgjedhje.

Dhënia llogari dhe zgjedhjet duhet të vënë në lëvizje edhe gjithë punonjësit e paorganizuar në Parti, të cilët nuk janë e nuk mund të janë indiferentë as për sukseset ose të metat e punës, as për detyrat që do të caktojë organizata e Partisë për të ardhmen, as përfaktin se kush do të zgjidhet në udhëheqje të organiza-tës së Partisë. Prandaj komunistët, duke u përgatitur për mbledhjet për dhënie llogari e zgjedhje, duhet të bisedojnë me punonjësit, të dëgjojnë mendimet, vë-rejtjet, kritikat e propozimet e tyre dhe këto t'i studiojnë me kujdes, në mënyrë që në mbledhjen e Partisë të pasqyrohen jo vetëm mendimet e komunistëve, por edhe ato të masave. Një përgatitje e tillë do të ndihmojë që mbledhjet e Partisë për zgjedhjet të zhvillohen me një frysë luftarake, revolucionare.

Partia jonë në mbledhjet për dhënie llogari e zgjedhje shkon e fortë e monolite, e armatosur me vendimet historike të Kongresit të saj të 5-të. Ajo shkon, në krahasim me zgjedhjet e viti të kaluar, me një bilanc më të pasur suksesesh të arritura nga punonjësit tanë me luftë e përpjekje, nën udhëheqjen e komunistëve. Plani i shtetit për vitin 1966 u realizua me sukses dhe më mirë se çdo vit tjetër. Plani i prodhimit të përgjithshëm industrial u plotësua 104 për qind, ose 12 për qind më shumë se më 1965. Për disa prodhime të veçanta, në krahasim me vitin 1965, më 1966 industria e naftës prodhoi 9 për qind më tepër, ajo e qymyrgurit 17 për qind, e bakrit 56 për qind, e hekur-nikelit 43 për qind, e energjisë elektrike 24 për qind, industria mekanike 40 për qind, industria e lehtë 10 për qind, ajo ushqimore 5 për qind etj. Në bujqësi, gjithashtu, u arriten rezultate të mira. Sipërfaqja e mbjellë me drithëra buke u rrit 7 për qind në krahasim me vitin 1965, kurse ajo me patate afro 4 herë. U hapën 18 600 hektarë toka të reja, ose 70 për qind më shumë se më 1965 etj. Plani i grumbullimeve për drithërat e bukës u plotësua 112 për qind, për patatet 106 për qind, për pambukun 103 për qind, për panxharsheqerin 123 për qind, për lulëdiellin 115 për qind etj. Suksese të rëndësishme janë arritur edhe në sektorët e tjerë, në ndërtim, në transport, në lëmin e tregtisë, të arsimit, të kulturës e të shëndetësisë.

Viti 1966 ishte viti i iniciativave të mëdha krijuese të klasës punëtore, si rrjedhim i të cilave u ngritën shumë reparte e fabrika të reja; ishte viti gjatë të cilit gjithë fshatarësia e zonave malore u fut në rrugën e

kolektivizimit të bujqësisë; ishte viti i forcimit të mëtejshëm të fuqisë mbrojtëse të atdheut dhe i një mobilizimi revolucionar të çdo qytetari të Republikës sonë Popullore.

Këto suksese janë një nxitje, një inkurajim i madh për çdo komunist e për çdo punonjës të vendit tonë. Ato na forcojnë bindjen dhe besimin se, ashtu siç plotësuam detyrat e vitit të parë të pesëvjeçarit, ne do t'i plotësojmë me sukses, bile akoma më mirë, edhe detyrat për vitin 1967 e për vitet e tjera të planit të katërt pesëvjeçar që aprovoi Kongresi i 5-të i Partisë sonë të lavdishme.

Ne, komunistët, na mëson Partia, sukseset nuk duhet të na dehin kurrë. Prapa sukseseve nuk duhet të fshehim kurrë të metat që ka në punën tonë. Dhe ne e dimë se në punën e madhe që kanë zhvilluar organizatat e Partisë për të mobilizuar masat, me gjithë sukseset e arritura, ka pasur dhe ka edhe të meta, për zhdukjen e të cilave Partia duhet të luftojë me vendosmëri,

Komiteti Qendror i Partisë ka theksuar yazhdhimisht se në punën e tyre organizatat-bazë të Partisë duhet të kenë më shumë iniciativë. Por kjo çështje disa herë nuk kuptohet drejt. Kështu, ekziston një mendim sipas të cilët punimi i vendimeve të komiteteve të Partisë në organizatat-bazë i rëndon këto dhe u pret iniciativën. Punimi i vendimeve që dërgohen nga lart nuk duhet konsideruar si një çështje e tepërt, e panevojshme. Një mendim i tillë do të ishte i gabuar, pasi atëherë, sipas tij, Partinë në tërësi as nuk duhet ta informojmë, as ta mësojmë si të punojë e të mendojë

dhe as t'i japim orientime e përgjithësime të eksperiencës.

Ne nuk duhet të harrojmë për asnjë çast se Partia jonë ka në bazën e saj centralizmin demokratik, që do të thotë se jeta demokratike, veprimet demokratike të Partisë sonë bëhen nën një udhëheqje të centralizuar, udhëheqje të zgjedhur me format më demokratike nga e gjithë Partia. Në bazë, pra, të këtij centralizmi demokratik, vendimet me rëndësi të organeve më të larta të Partisë jo vetëm duhet të njihen nga të gjithë, nga organet më të ulëta dhe nga e tërë Partia, por organet e ulëta duhet t'i thellojnë më tej ato dhe të gjejnë mënyrat e metodat më të mira për t'i vënë në zbatim, për t'i realizuar në jetë.

Zbatimi i këtyre vendimeve jetike të Partisë nuk mund të kryhet kur ekziston në Parti një fryshtë librale, mikroborgjeze, kur ekziston pikëpamja e dëmshme «s'na bëhet vonë». Jo, në Partinë tonë marksiste-leniniste, në një parti luftarake proletare, nuk ka vend shthurja politike dhe organizative liberale, demokracia false.

Partia jonë udhëheq luftën e madhe proletare të popullit dhe, për të fituar në çdo betejë, ajo zbaton një disiplinë të hekurt, e cila në Parti është e tillë pasi është e ndërgjegjshme. Këto norma dhe normat e tjera të Partisë, për të cilat do të flas më poshtë, ne duhet t'i ruajmë dhe t'i kalitim më tej dhe për asnjë moment nuk duhet të mendohet se, meqë Partia është në fuqi, ineqë ne ndërtojmë socializmin me sukses, na lejohet të bëjmë lëshime në zbatimin me rreptësi të normave të Partisë. Në asnjë mënyrë jo! Ato e konsolidojnë Partinë, e bëjnë atë pararojë dhe të pamposhtur.

Punimi i vendimeve ose sugjerimet për punë, për forma pune dhe detyra nga lart, janë të domosdoshme. Një gjë e tillë nuk u mbyll asnje horizont organizatave-bazë, nuk u pret asnjë iniciativë. Po çështja qëndron në atë se çfarë ndihme e diferençuar u jepet atyre për t'i kuptuar vendimet dhe për t'i zbatuar ato në gjendjen reale ku rron dhe udhëheq organizata-bazë. Këtu kemi një të metë të madhe.

Terreni i çdo organizate duket i njëllojtë, por nuk është plotësisht kështu. Prandaj nuk mund të rekombinohet që punimi i një vendimi të bëhet njëlloj, si në qytet, ashtu edhe në fshat, si në uzinë, ashtu dhe në brigadën e një kooperative, apo në një shkollë. Nuk duhet të insistohet që çdo organizatë të punojë në mënyrë uniforme të gjitha problemet që mund të përbajë një vendim.

Një organizatë duhet të orientohet, të informohet dhe të kuptojë në përgjithësi mirë të tërë vendimin dhe t'u futet thellë atyre pjesëve që përbëjnë probleme akute dhe aktuale për të. Por ç'ndodh te ne disa herë? Instruksionet për këto punë ndonjëherë jepen të çala, seminaret bëhen të përgjithshme dhe rezulton që disa sekretarë organizatash-bazë nuk i shtrojnë fare në organizatë as ato që marrin në aktive, as ato që marrin në seminare.

Përse ngjet kjo? Ose ato që u thonë janë gjëra të përgjithshme dhe sekretarët e organizatave-bazë mendojnë se s'kanë ç't'u thonë shokëve në organizatë, ose ato që u thonë janë gjëra të mira, të reja, por sekretarët e organizatave-bazë nuk janë në gjendje të marrin shënimë të sakta, t'i kuptojnë këto thellë, por ato

shënimë të pakta që marrin janë aq të shpëlara saqë kur arrijnë në organizatën-bazë, katandisen në formula bajate, stereotipe, të dëgjuara një mijë herë.

Prandaj komitetet e Partisë dhe sekretarët e organizatave-bazë duhet t'i kushtojnë një kujdes të madh parapërgatitjes së kësaj pune. Komitetet e Partisë duhet të kuptojnë se puna në organizatat e Partisë në fshat ka specifikën dhe karakteristikat e saj, që shumë herë, dhe sidomos në situatat tona konkrete, janë shumë të ndryshme nga puna e organizatave të Partisë të qytetit.

Të harrosh ose të injorosh ndryshimet e qytetit me fshatin tonë, të jetës dhe zakoneve të qytetit me ato të fshatit dhe të zbatosh në mënyrë automatike e shabllon atë metodë pune, ato forma, si në njërin dhe në tjetrin, atëherë rezultatet nuk do të janë të kënaqshme. Sekretarët dhe instruktorët e komiteteve të Partisë nuk bëjnë shumë kujdes në këtë drejtim. Ata, për shembull, nuk llogaritin sa duhet që shtypi për shumë arsyesh nuk shkon ku duhet dhe shpejt në fshat ashtu si në qytet, që vatra e kulturës në një kooperativë nuk funksionon dhe nuk frekuentohej si ajo e një fabrike në qytet, që mbeturinat në ndërgjegjen e fshatarit ruhen më me këmbëngulje sesa në atë të punëtorit, që ngritja kulturore e fshatarit është akoma më e ulët se ajo e qytetarit. Atëherë ç'duhet të bëjnë sekretarët dhe instruktorët? Dy rrugë ka: ose të ecin si kuajt e karrocës, ose të vrashin mendjen më shumë për të gjetur rrugëdaljet më të përshtatshme. Receta do të jetë vështirë të japid, pasi, siç thashë, për çdo fshat ose grup fshatash mund të ketë rrugë të veçanta, si-

pas gjendjes e rrethanave. Por një recetë është e pagabuar dhe ilaci kryesor, që e shëron dhe e shëndosh punën, është njohja mirë, thellë e me baza e gjendjes në fshat, njohja e njerëzve, e kuadrove të fshatit një nga një, e aftësive të tyre, prirjeve, vullnetit, zemrës së tyre. Kjo duhet edhe për organizatat e qytetit. Vetëm mbi këto baza mund të ketë iniciativë dhe vetëveprim në organizatat-bazë, vetëm mbi këto baza mund të jepet edhe ndihma e kualifikuar nga komitetet e instruktorët e Partisë. Përmirësimi i kësaj të mete në metodën e punës së komiteteve dhe të organizatave-bazë do të ndihmojë që organizatat e Partisë të bëhen më luftarake dhe të udhëheqin më mirë punën, për plotësimin e detyrave të mëdha që kanë përpara.

Organizatat e Partisë, tani që përgatiten për mbledhjet për dhënie llogari e zgjedhje, duhet të kenë mirë parasysh karakteristikat e tyre të veganta, si dhe dobësitë që kanë, në mënyrë që veçanërisht mbi këto të insistohet me rastin e zgjedhjeve.

Duhet thënë se komitetet e Partisë lidhur me zgjedhjet në Parti kanë krijuar një traditë, e cila duhet të pastrohet nga gjërat që nuk japid fryt ose nga format e vjetruara. Një nga këto çështje është edhe zakoni që, me rastin e zgjedhjeve e dhënies llogari, fliitet për të gjitha problemet. Më duket se shokët duhet ta shohin më nga afër këtë çështje. Mund të adoptojmë praktikën që në mbledhjet për dhënie llogari e zgjedhje raportet të kufizohen në një ose në dy çështje kryesore, të themi të prodhimit ose vetëm për çështje të kulturës dhe të arsimit, në ato çështje ku ka më

shumë dobësi e të meta, dhe rreth tyre çdo komunist të japë llogari, të bëjë kritikë dhe autokritikë. Përcaktimi i këtyre problemeve lidhet ngushtë me karakteristikat e organizatës-bazë, me specifikën, me të metat e dobësitë e saj.

Detyra jonë është ta kalitim vazhdimisht Partinë, në mënyrë që ajo të jetë gjithnjë luftarake, dinamike, e gjallë, e papajtueshme me të metat e dobësitë. Për këtë rëndësi të dorës së parë ka sjellja e gjakut të ri në radhët e Partisë, pranimi i anëtarëve të rinj nga radhët e klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste, të elementeve më të shquar e revolucionarë të intligjencies. Statuti i aprovuar në Kongresin e 5-të të Partisë përcakton qartë kushtet që nevojiten për pranimet në Parti dhe masat që duhen zbatuar për përgatitjen e kandidatëve. Detyra e organizatave-bazë është që këto kërkesa dhe qëllimi i tyre të shpjegohen dhe të kuptohen mirë. Në qoftë se direktivat e Partisë për pranimet do të shpjegohen mirë dhe do të kuptohen drejt, atëherë do të bëhet e qartë se kërkesat e reja të Statutit nuk i mbyllin dyert e Partisë, përkundrazi, i hapin ato. Po për cilët? Për të mirët, për revolucionarët dhe i mbyllin dyert për ata që nuk e meritojnë.

Përse tani ndonjë shok mendon se kushtet e reja mund të pengojnë ardhjen e gjakut të ri në Parti? Sepse anëtarët dhe organizatat e Partisë deri tani disa herë propozonin pa kriterë të shëndosha dhe i pranonin njerëzit në Parti pa i provuar mirë. Tani kriteret janë të shëndosha dhe provat të diferencuara. Njerëzit duhet të mësohen me këto forma të reja, kështu nuk ka pse të mendohet se do të mbyllen dyert e Partisë.

Po t'u mbylleshin dyert njerëzve, kjo do të ishte një punë shumë e keqe, ashtu sikurse do të ishte, gjithashtu, shumë e keqe, po të mbaheshin kanatet krejt të hapura dhe të hynte në Parti kush të donte dhe kur të donte. Por disa direktivën e Partisë e marrin kallëp. Kurse ajo është e diferencuar, me njanca — për punëtorët, për kooperativistët, për intelektualët dhe për nëpunësit. Në qoftë se nuk do të shikohen këto nuanca dhe kërkesa të caktuara për njérën ose për tjetrën shtresë dhe do të degdisheshin andej-këtej për të bërë stazhin e kandidatit si minatori, si kooperativisti, ashtu edhe intelektuali apo njeriu i zyrës, kjo do të thotë se direktiva nuk është kuptuar dhe atëherë ka edhe rreziqe.

Të marrim çështjen e atyre që rekomandojnë një kandidat për anëtar partie. Në instruksionin e Komitetit Qendror thuhet që kundër rekomanduesit jose-rioz «**të mbahet qëndrim**». Kjo duhet të interpretohet drejt, rekomanduesi duhet të rekomandojë dhe ka përgjegjësi përpara Partisë, por të mos kuptohet sikur medoemos duhet të merren masa ndëshkimore kundër tij për gabime o faje që kandidati mund të bëjë gjatë jetës së tij në Parti, sepse pastaj nuk rekomandon më njeri. Çështja duhet të kuptohet në dialektikën e zhvillimit.

Ose të marrim kërkesën e Statutit që kandidati mund të ndërrojë profesionin kur bën stazhin. Në parim kjo mund të bëhet, por të mos bëhet rregull, pasi as punës, as kandidatit nuk i intereson një gjë e tillë.

Largimi i kandidatit nga rrathi i tij mund të bë-

het, por edhe kjo nuk duhet të bëhet si rregull. Kur kandidati është beqar, çështja është më e lehtë. Pastaj tani në çdo rrëth kemi sektorë të shumtë, të ndryshëm e të vështirë pune, ku ne mund ta drejtojmë kandidatin. Çështja është edukimit me vështirësitë në punë të shikohet edhe për punëtorët, edhe për kooperativistët; me kujdes duhet të ecet për gratë, e sidomos kur këto janë të martuara e me fëmijë, por më shumë, dhe sidomos ne, duhet të kërkojmë për nëpunësit dhe intelektualët. Pra, duhet të kuptohen drejt direktivat e Partisë dhe të ndiqet me kujdesin më të madh e në mënyrë të pandërprerë problemi i pranimeve në baza të reja, problemi i forcimit të Partisë me gjak të ri, sepse kjo është një çështje jetike për Partinë.

Çështjet e sipërme janë të rëndësishme për përmirësimin e punës së Partisë. Por nuk janë këto të vetmet që duhet të kemi parasysh lidhur me fushatën e dhënies llogari e të zgjedhjeve në Parti. Revolucionarizimi i mëtejshëm i Partisë dhe i organeve të pushtetit tonë, çelikosja e Partisë dhe e pushtetit, varren nga një kompleks problemesh. Unë dua t'ju flas juve për dy probleme parimore:

E para, për zbatinin dhe respektimin me rreptësi të parimeve dhe të normave revolucionare të Partisë.

E dyta, për luftën konsekutive dhe të vendosur që duhet t'i bëhet burokratizmit.

## Mbi zbatimin e normave të Partisë

Partia jonë marksiste-leniniste, që në themelimin e saj, u ka vënë rëndësi të dorës së parë centralizmit demokratik, kritikës dhe autokritikës, demokracisë proletare, analizave kritike të problemeve e të fenomeneve, konspiracionit të shëndoshë, disiplinës së hekurt e të vetëdijshme, vijës së masave, luftës së klasave etj., etj. Rezultatet e mira në këtë drejtim i vërteton gjendja moralo-politike në Parti, ngritja ideologjike, fryma revolucionare në Parti dhe në popull, realizimi i vijës së Partisë pa gabime shqetësuese, realizimi i planeve.

Natyrisht, do të ishte gabim vetëkënaqësie dhe miopizmi në rast se do të thoshim që çdo gjë te ne ka arritur kulmin, se çdo gjë kryhet në mënyrë të përsosur. Vetëkënaqësia, dehja nga sukseset e arritura krijon atë gjendje të fjetur që zvogëlon gabimet, i lë ato të trashen dhe i mbulon me mendimin se «ne kemi suksese», «tani çdo gjë ecën mirë», «s'kemi përse të shqetësohem nga disa shfaqje të dënueshme», të cilat i quajmë të rastit.

Vetëkënaqësia përvendimet e drejta të marra, dhe që këtej ideja se ata që i kanë formuluar ato, në bazë të eksperiencës së Partisë dhe të shtetit, janë të pagabueshëm, të pakritikuveshëm, duke mbajtur ndaj tyre një qëndrim idealist, mistik, jorevolucionar, jodialektik marksist-leninist, është një ide e gabuar, një mendim i gabuar. Duhet të shkohet kurdohëri nga parami beso dhe kontrollo, duaj dhe respekto çdo njeri

që punon dhe lufton drejt pa u lodhur, me konsekuençë, me drejtësi, në rrugën e Partisë, por mos lër pa kritikuar dhe pa ndrequr asnjeri, cilido qoftë, kur gabon, mos hezito të demaskosh e të goditësh ash-për e pa miëshirë cilindo që hyn në rrugën armiqësore, kundër Partisë, kundër popullit, kundër socializmit.

Të vazhdojmë ta revolucionarizojmë Partinë me një këmbëngulje të madhe — ky duhet të jetë preokupacioni ynë më i madh. Revolucionarizimi i Partisë nuk mund të bëhet veçse nëpërmjet rrugës së njohjes si duhet të kuptimit të thellë filozofik dhe të zbatimit me rreptësi e në mënyrë revolucionare të parimeve marksiste-leniniste që udhëheqin Partinë dhe të normave leniniste që rregullojnë jetën e saj dhe të komunistëve.

Kjo çështje e madhe jetike nuk mund të kuptohet formalisht dhe këto parime nuk mund të lejojmë të zbatohen mekanikisht, të mësohen si formula pa shpirt dhe pa jetë. Detyra jonë nga më kryesoret është që, duke i mësuar e duke i zbatuar si duhet në jetë këto parime dhe norma, të zbulojmë dhe njëkohësisht të kuptojmë arsyet e vërteta, të thella, përsë nuk kuptohen dhe nuk zbatohen si duhet këto norma në përgjithësi, ose te disa në veçanti, në këtë ose në atë organizatë-bazë, te ky komunist ose tek ai tjetri.

Punonjësit e Partisë janë tani në gjendje ta bëjnë vazhdimisht këtë diagozë të domosdoshme të punës dhe duhet të dalin me mjete shëruese, qoftë në një shkallë të përgjithshme për të gjithë Partinë, qoftë për komunistë të vecantë. Ilaçi për komunistë të vecantë

që nuk kuptojnë, nuk zbatojnë si duhet ose i shkelin normat, është studimi i teorisë marksiste-leniniste, është lufta revolucionare dhe kjo është pjesë e edukimit të përgjithshëm të Partisë në këto drejtime.

Le të shikojmë disa çështje që na mëson eksperiencia e Partisë.

Në organizatat-bazë të Partisë sonë, me gjithë përparimet e mëdha, nuk ka një jetë shumë intensive, nuk ka debate e diskutime të gjalla si duhet, nuk ka sa duhet rrahje mendimesh dhe të të kundërtave, nga të cilat të mësojnë shokët dhe të dalin vendime dhe masa të drejta, që do të bëjnë të ngrihet e të afirmohet personaliteti i çdo komunisti, do të mprehet vigjilanca, do të zbatohet drejt dhe më me lehtësi direktiva, vija, detyra. Kjo është një çështje kapitale pér jetën dhe luftën e Partisë.

A duhet t'i kushtojmë ne vëmendjen e veçantë këtij problemi pér të gjetur arsyet e vërteta që e pengojnë organizatën-bazë të jetë në kulm revolucionare? Patjetër! Medoemos! A duhet të kënaqemi me këto rezultate që kemi arritur dhe të mos na tërheqë vëmendjen fakti që një numër komunistësh nuk diskutojnë, nuk marrin pjesë aktive në debatet, të kënaqemi vetëm duke thënë se «janë të pangritur», ose fajet e një komunisti që kritikojmë t'i quajmë kryesisht subjektive dhe të mos mendojmë e të thellohem se ky ose ai komunist ka gabuar pér fajin e tij, por përgjëgjësi kemi edhe ne, organizata-bazë, që nuk e kemi ndihmuar? Ose kur një komunist apo një grup komunistësh nuk realizojnë detyrat e planet, a duhet të mjaftohemi të themi se e kanë vetë fajin, kurse ne,

organizata-bazë, nuk kemi asnje faj ndaj tyre dhe të desolidarizohemi në përgjegjësi kur ngjet diçka e pa-pëlqyer dhe të solidarizohemi vetëm kur çdo gjë shkon mirë? Në asnje mënyrë jo!

Po përse ngjasin këto gjëra në organizatat-bazë, përse ngjasin këto gjëra me komunistët? Nuk është hera e parë që ne i kemi analizuar këto, qoftë dobët, qoftë thellë; s'është hera e parë që i konstatojmë, por prapë na ngjasin, me gjithë masat organizative dhe edukative që kemi marrë dhe vazhdimisht po marrim.

Në asnje çështje mendoj të mos bëjmë iluzion, të mos e lëmë veten të na mbulojë vetëkënaqësia, ose ta quajmë se detyrën e kemi plotësuar duke marrë këto masa, ose, më në fund, të themi se rezultate ne-kemi (dhe në fakt kemi), por «është e paevitueshme që gjëra të tillë të mos na ngjasin. Kjo është dialektika e jetës, e luftës». Këto mendime nuk duhet të na kënaqin, prandaj të thellojmë kurdoherë e më shumë analizën e problemeve dhe të forcojmë e të organizojmë më mirë masat që marrim. Këtu më duket mua se duhet të insistojmë.

E kam theksuar edhe herë të tjera se mbledhja e organizatës-bazë duhet të jetë për komunistët një ngjarje me shumë rëndësi dhe, që të jetë e tillë, lyp një përgatitje të madhe, e jo vetëm nga sekretari, jo vetëm nga përcaktimi i drejtë i rendit të ditës, por nga të gjithë komunistët, deri në zbërthimin e fundit të skajeve më të thjeshta të problemit që merr në studim dhe diskuton organizata-bazë. Në qoftë se bëhet kështu, nuk mund të mos ketë diskutime në organizatën-bazë, nuk mund të mos ketë debate e kundërshtime,

nuk mund të mos ketë mendime të reja, të drejta ose të gabuara, nuk mund të mos ketë kritika dhe auto-kritika. Të tillë organizatë-bazë duam ne. Për një organizatë-bazë të tillë ne duhet të luftojmë. Këtu është baza e çdo fillimi dhe e çdo edukimi të drejtë, këtu është kalitja e komunistëve me normat e drejta të Partisë, këtu bëhet ngritja e tyre politike, ideologjike, por edhe tekniko-organizative, pasi nga debatet revolucionare në organizatë varen shumë organizimi i punës dhe realizimi në jetë i detyrës, varen përpjekjet individuale e kolektive për ngritjen tekniqe të komunistëve dhe të masave.

Në qoftë se kërkesa e llogarisë nga cilido, në qoftë se kërkesa e disiplinës nga cilido nuk bëhen me këmbëngulje në organizatën-bazë, atëherë ku do të bëhen? Në qoftë se kritika dhe autokritika nuk zhvillohen në organizatën-bazë si duhet, në bazë të normave të Partisë, atëherë ku do të zhvillohen si duhet? Në rast se komunisti nuk merr kurajën të shfaqë mendimet e tij në organizatën-bazë, atëherë do të jetë vallë ai në gjendje t'i shfaqë ato si duhet në mbledhjet me masat? Në qoftë se komunisti nuk edukohet t'i kuptojë e t'i zbatojë diktaturën e proletariatit dhe të gjitha normat që rrjedhin prej saj në jetë, në ndërgjegjen e në punën e tij, atëherë vihet pyetja: Si do të bëjë ai që masat ta kuptojnë ç'është diktatura e proletariatit, ç'janë normat e saj politike, ideologjike, etike, organizative dhe represive?

Në mësojmë dhe kërkojmë që masat e gjera të flasin lirisht, të kritikojnë të metat dhe njerëzit, me qëllim që këta të edukohen dhe të ndreqen. Natyrisht,

një gjë e tillë nuk mund të zbatohet si duhet nga masat, kur atë nuk e kuption dhe nuk e zbaton si duhet Partia në tërësi dhe komunisti në veçanti.

Çështja nuk është se Partia dhe komunistët tanë nuk i njohin këto norma dhe nuk i zbatojnë në jetë. Jo, por këtu bie mjaft erë formalizëm, automatizëm e mosthellim si duhet në to, mosshikim si duhet i së mirës ose i rrezikshmërisë, që mund të rezultojë nga një thellim e zbatim i drejtë i tyre, ose e kundërtë.

**Mendoj se normat themelore që rregullojnë jetën dhe luftën e Partisë, pra të organizatës-bazë, të çdo komunisti, duhet të njihen mirë, thellë, të njihen ana ideologjike dhe politike e tyre. Këtu ne nuk kemi insistuar sa duhet dhe si duhet.**

Për ta ilustruar këtë konkluzion të marrim si shembull Statutin e Partisë. Statuti është udhërrëfyesi i komunistit, është dokumenti bazë që rregullon jetën e Partisë. Tek ai janë të sintetizuara orientimet kryesore të Partisë, të drejtat dhe detyrat e komunistit, të cilat pa i ditur, pa i kuptuar thellë dhe pa i zbatuar në jetë, ai nuk mund të jetë një komunist i mirë.

Kur ky i shkel këto norma të Statutit, ndëshkohet deri në përjashtim nga Partia. Por ngjet një gjë shumë e quditshme: Statuti nuk mësohet, nuk përdoret si material bazë për komunistët, anëtarë të thjeshtë dhe udhëheqës. Shumë nga këta as nuk e kanë lexuar fare. Disa e lexojnë dhe thonë: «Dakord. Gjëra të njohura, këto i dimë mirë. Mbi këto ne mbështetemi». Është e vërtetë se shumë gjëra i dimë, por atëherë përsë gajmë, përsë i shkelim nenet e Statutit? Kjo tregon se këto nene nuk i dimë mirë, nganjëherë nuk i njohim

fare dhe nuk na janë bërë si duhet pengesa në ndërgjegjen tonë për gjërat e gabuara dhe frysëzim i plotë për të ecur kurdoherë drejt e në mënyrë revolucionare.

Që kur lindi Partia dhe çdo vit ne bëjmë leksione mbi Statutin. Kjo punë ka dhënë dhe jep rezultate, por ne duhet të vazhdojmë të gjejmë edhe arsyet, edhe metodat më të mira që çdo komunist ta ketë Statutin parasysh brenda në mendje e në zemër, në çdo hap që bën.

Po t'i pyesësh punonjësit për rrogën e tyre, për të drejtat e punës, për pushimet, ata të përgjigjen deri në santim. Ata i dinë mirë rrjetdhimet e realizimit ose jo të normës ose të tjera gjëra lidhur me të dhe me interesin material të tyre, dinë ligjet dhe rregulloret, por nenet e Statutit të Partisë nuk i dinë si duhet. Një praktikë të tillë ne nuk duhet ta lejojmë më, sepse sjell konsekuenca jo të mira për revolucionarizimin e Partisë.

**Të marrim çështjen e mosdiskutimit si duhet dha nga të gjithë në organizatë për problemet e ndryshme. Këtu çështjen e kam në përgjithësi për fenomenin dhe nuk e kam në anën mekanike se të gjithë anëtarët e organizatës-bazë duhet të diskutojnë medoemos. Po pse nuk diskutojnë? Kjo duhet të na preokupojë në radhë të parë.**

Nuk ka diskutime, ose diskutimet janë të zbehta kur problemi nuk njihet, kur nuk studiohet dhe nuk shtronhet drejt e i argumentuar.

Nuk ka diskutime kur problemi i komunikohet i thatë dhe në minutën e fundit organizatës, të cilën e gjen në befasi dhe e vë në pozita ose të mos diskut-

tojë dot, ose të diskutojë dobët. Pra, problemi shtronhet për të kaluar radhën, shtronhet si një problem angari; organizatës, në një mënyrë të tèrthortë i imponohen mendimet e atij që e shtron problemin dhe dallohen në organizatë ata që e kanë lehtë të flasin, por që disa herë nuk kanë mendime, veçse fraza.

Kuptohet ç'rrjedhime negative ka një gjë e tillë për punën, për edukimin dhe ç'raporte vendosen në mes udhëheqjes dhe bazës.

Përgatitja për problemin që shtronhet është i vemi mjet i gjallërimit të organizatës. Kush zoteron problemin është në gjendje të diskutojë, të bëjë vërejtje, të kritikojë, të parashikojë dhe të propozojë. Në qoftë se të gjithë bëjnë kështu, atëherë s'ka asnjë dyshim që mendime të mira dhe të këqija do të përplasen, do të shoshiten, do të gjenden dhe do të zgjidhen më të mirët, do të parashikohen edhe masat për të kapërcyer vështirësitë. Por gjatë këtij debati do të njihet edhe vlera e njerëzve, sa i vlen lëkura njërit dhe tjetrit. Kësaj i thonë luftë revolucionare në organizatë.

Rregullat e mbledhjes janë vënë pikërisht jo ta pengojnë një luftë të tillë, por ta zhvillojnë më tej. Në këto rregulla duhet të tregojmë kujdes të madh, duke luftuar fryshtës burokratike në zbatimin e tyre. Sekretari, duke respektuar rregullat, për qëllimet që thashë më lart, nuk duhet ta ndiejë veten mbi të tjetrët, të mendojë se atij i takon e drejta të konkludojë si dëshiron ai, se fjala e tij e fundit është fjala e «zotit», se mendimi i tij është më i miri, pasi ai të bën «gjëmën», sepse mban lidhjet me komitetin, se ai formulon, dhe formulon shumë keq procesverbalet që

janë shumë të nevojshme për të njojur dhe për të ndjekur luftën në organizatë.

I gjithë ky kompleks gjërash bën që, shumë vetave u pritet hovi të diskutojnë, shumë diskutojnë e propozojnë, por mendimet e propozimet e tyre i merr era dhe ndonjëri, me dashje ose pa dashje, detyrohet të diskutojë rrallë. Ka të tjerë që bëjnë përpjekje të kritikojnë punën ose njerëzit, por priten me këmbët e para dhe kështu, me dashje ose pa dashje, krijohet një gjendje e rëndë në organizatë ose një situatë e përgjumshme. Disa nuk diskutojnë, nuk kritikojnë fare, pasi nuk shohin ç'të kritikojnë. Disa të tjerë shohin, por bëjnë një kritikë të butë, për të mos lënduar njeri. Të tjerë shohin, po nuk guxojnë të kritikojnë se kanë frikë.

Të gjithë ne e dimë rëndësinë e kritikës dhe të autokritikës dhe është lehtë të themi «ç'komunistë janë këta që kanë frikë të kritikojnë drejt? Partia këtë kërkon çdo ditë nga anëtarët e saj». Kështu është. Por faktet, ndodhitë janë të tillë dhe neve na duhet të luftojmë kurdoherë për të gjetur arsyet përse komunisti që nuk ka dhe nuk duhet të ketë frikë, në disa raste e rrethana, ndien drujtje dhe s'ka guxim të shprehet lirisht. Mund të jenë arsyet subjektive, por ka edhe arsyet objektive që e shtyjnë komunistin në këto situata. Që të dyja kanë ilaç. Komunistin ne duhet ta shërojmë me një edukim të thellë ideologjik dhe anët subjektive dhe objektive jo të mira që shfaqen, me punën dhe me luftën e organizatës-bazë, me një luftë këmbëngulëse për kuptimin, për mësimin dhe për zbatimin deri në fund në mënyrë revolucionare të

rregullave dhe të normave të Partisë. E tërë kjo punë duhet të konsiderohet një edukim i gjerë ideologjik, edhe organizativ njëkohësisht, për të gjithë dhe jo vetëm një specialitet për kuadrot që merren me organizimin, po për çdo anëtar të Partisë pa përjashtim.

As ai komunist që ka frikë të kritikojë dhe të thotë hapur për çdo gjë atë që mendon dhe as ai që shtyp kritikën dhe mendimet e shokëve nuk janë komunistë të formuar dhe të mirë, për të mos thënë të këqij, sepse pastaj s'duhet të qëndrojnë më në Parti. Në qoftë se ata nuk edukohen, nuk korrigohen, duhet medoemos të largohen nga Partia, pasi brenda saj njerëzit nuk mund të qëndrojnë për numër dhe me vese të tilla të pakorrigjueshme.

Kur një person kërkon të futet në Parti dhe pranohet, ai ka të drejta dhe detyra që absolutisht duhet t'i nlohë dhe t'i zbatojë me guxim. Nuk mund të quhen anëtar i Partisë sonë dhe, nga ana tjetër, të jesh i frikshëm. Një anëtar partie mund të mos dijë shumë gjëra, ose disa gjëra ai mund t'i nlohë përgjysmë. Partia këto do t'ia mësojë kurdoherë nëpërmjet shumë formave, por ato që ai i di dhe ashtu si i di, ato që ka mësuar dhe aq sa i ka mësuar, anëtari i Partisë duhet t'i shprehë, t'i hedhë në diskutim dhe, si komunist që është, të presë edhe gjykimet kritike revolucionare të shokëve, domethënë me gjakftohtësi të presë kritikën bolshevike, të luftojë me guxim kritikën jobolshevike, të nlohë ndershmërisht ku i ka gabimet dhe të ecë përpara.

Të gjithë thonë: «Kjo është e drejtë, por hë, ja që ka edhe nga ata që s'guxojnë» etj. Por kush ua

ka fajin këtyre, Partia, normat e saj, apo pse ajo u thotë vazhdimisht sulmoni përpara si revolucionarë? Në qoftë se të tillë njerëz Partinë e shohin te një person që u shtyp mendimet e tyre të drejta, ose u mbyt kritikën, fajin e kanë ata vetë dhe jo Partia, as normat e saj. Në qoftë se të tillë komunistë forcën e kolektivit të Partisë e errësojnë përpara një personi që vetë e kanë veshur me funksione, atëherë ata janë larg kuptimit të normave të Partisë. Por ka edhe nga ata që nga ana formale i kanë kuptuar mirë normat e Partisë, por në kokën e tyre ziejnë norma të tjera, mikroborgjeze, atëherë kolektivi i Partisë duhet t'ua zbulojë këtyre këto norma të huaja, t'ua luftojë dhe t'i edukojë ata.

Këtë çështje kaq të madhe ne duhet ta shikojmë nga të gjitha anët, pasi ka drejtorë, shefa ose sekretarë që gabojnë, por ka edhe nga ata që s'janë as shefa, as drejtorë, por nuk e durojnë as kritikën, as disiplinën, as dhënien llogari dhe çdo kërkesë e rregull që u kërkohet, e marrin sikur kundër atyre po bëhet një veprim me frymë personale etj. Ne njohim nga këta llafazanë (ashtu siç njohim edhe drejtorë arrogantë), që shipin kundër drejtorit, po, kur çështja shkon në organizatë, kur gjykohet drejt nga kolektivi, e vërteta del në shesh.

I vetmi gjykim i drejtë dhe i plotë është kontrolli i kolektivit, i cili e verifikon dhe duhet ta verifikojë çështjen. Kjo do të thotë «kontrolli i masës» dhe «politika e masës». Të gjithë, pa përjashtim, duhet t'i nënshtrohen gjykimit të masave mbi punën dhe sjelljet e tyre në shoqëri. Komunistët duhet t'i nënshtrohen një kontrolli të dyfishtë, atij të Partisë dhe atij të masave. Kurrkush nuk mund të thotë se kjo është

çështje personale, private, kur ajo është e lidhur me shoqërinë, me normat socialiste dhe të Partisë. Askush nuk duhet të përzihet në çështjet personale të tjetrit, po kur ky shtyp gruan, për shembull, ose bën një jetë luksoze, jashtë mundësive të të ardhurave të tij etj., atëherë kolektivi ka plotësish të drejtë ta kritikojë, dhe po të vërtetohen se shkelen normat dhe ligjet, atëherë veprohet ndryshe. Një veprim i tillë e shëndosh dhe nuk e dobëson shoqërinë tonë, ai përkundrazi dobëson pikëpamjet mikroborgjeze mbi jetën, mbi normat e jetës së vjetër që e bënин njeriun skllav, pa personalitet, pa liri, pa iniciativë.

Momenti i dhënies llogari dhe i zgjedhjeve në Parti është me rëndësi të madhe për kalitjen e Partisë dhe të kuadrove, për revolucionarizimin e mëtejshëm të tyre. Duhet flakur tej çdo formalizëm në këto mbledhje të rëndësishme, duhet flakur tej çdo ngurrim për zbatimin e normave që rregullojnë jetën e Partisë. Udhëheqja duhet të japë llogari në këto mbledhje, të vërtetojë me fakte nëse c'ka kryer apo jo si duhet detyrën e saj dhe jo të parashtrojë vetëm vërejtje të përgjithshme ose kritika vetëm për të tjerët. Kështu duhet të bëjë edhe çdo komunist.

Zgjedhja e udhëheqjes duhet të bëhet me kriterë të shëndosha, brenda normave të caktuara, pa i imponuar askush organizatës-bazë ose organizatës së Partisë udhëheqësin ose udhëheqësit. Ato duhet t'i propozojnë vetë kandidaturat, vetë t'i shoshitin, vetë t'i zgjedhin udhëheqësit dhe vetë t'i rrëzojnë në rrugën më demokratike, kur s'punojnë mirë.

Në paraqitjen e kandidatëve sikur jemi larguar ca

nga normat revolucionare që zbatonim më parë. Tani, nën pretekstin se kuadrot njihen, biografitë e tyre gati nuk kërkohen fare, ose bëhen formalisht. Kjo duhet rivendosur drejt, pavarësisht nëse njihet ose jo i propozuari, i cili duhet të dalë vetë përpara shokëve të organizatës për të bërë biografinë e vet, ku të evitojë mburrjen me të kaluarën, për të cilën masa ia njeh meritat, por të flasë më konkretisht për dobësitë e shfaqura prej tij në punë, ose për pikëpamjet e gabuara që mund të ketë dhe të zotohet se do t'i ndreqë.

Këto norma duhet të ruhen e të zhvillohen drejt në Parti, por përpara masës, edhe për ata që emërohen në funksione shtetërore, mendoj unë, duhet të zbatojmë disa norma pak a shumë të ngjashme, sidomos për kuadrot kryesorë, të tillë si drejtorë, nëndrejtorë, shefa plani, llogaritarë, kryellogaritarë etj. Këta kuadro emërohen dhe mund të mos ndryshojmë shumë gjëra në parimin dhe në rregullat si veprohet tani, por organizata ekonomike ose çdo entitet tjetër duhet ta njohe medoemos kush është personi i ri që i vjen ta udhëheqë. Nëpunësin e emëruar jo vetëm që duhet t'ia bëjmë të njojur masës, dhe jo në mënyrë formale, por të praktikojmë që vetë ky të dalë përpara masës dhe të bëjë sinqerisht autobiografinë e tij, në mënyrë që masa të gjykojë mbi të dhe t'i thotë: «Shiko, vëlla, puno mirë, sillu mirë, zbato drejt normat e ligjet, na kérko llogari deri në santim, pasi edhe ne ashtu do të bëjmë ndaj teje. Na dëgjo, se edhe ne do të të ndihmojmë po të punosh mirë. Por, ki mendjen, po gabove, do të të heqim veshin, kurse, po të vazhdosh në gabime, do të të ngremë këmbët dhe dije se

s'ka kush të mbron; Partia është jona, pushteti është yni, jemi ne në fuqi, diktatura e proletariatit është në fuqi, prandaj ne do të ta thyejmë kokën në rast se do të bësh të këqija; përkundrazi, do të të duam e do të të respektojmë pa masë në rast se do të punosh mirë».

Po t'i zbatojmë me vendosmëri këto norma, do të shohim sa drejt do të na venë punët dhe sa shpejt do të korrigohen ata njerëz që tani livadhisin pa fre.

Përse kanë kaq rëndësi njohja dhe zbatimi si duhet i normave të Partisë dhe përse duhet të insishtojmë ne kaq shumë për t'i njohur dhe për t'i bërë këto norma jetën tonë?

Ne e dimë se Partia jonë e Punës është, si çdo parti marksiste-leniniste e vërtetë, repart i organizuar i klasës punëtore. Kjo do të thotë që në Parti janë vetëm njerëz të pararojës, nga më të mirët, më revolucionarët, më të pathyeshmit. Këta njerëz nuk bien nga qiejt, ata dalin nga gjiri i popullit, dallohen në punë e në luftë nga virtytet dhe qëndrimet e tyre. Njerëzit që pranohen në Parti vijnë nga klasa e shtresa të ndryshme të shoqërisë sonë, nga klasa punëtore, nga kooperativistët, nga nëpunësit, nga intelektualët etj. Por, megjithëkëtë, Partia jonë nuk është një arenë klasash, ku çdo klasë në numër proporcional ka përfaqësuesit e saj që mbrojnë interesat e veçanta të secilës klasë etj. Jo. Në Partinë tonë hegjemone është klasa punëtore me ideologjinë e saj, marksizëm-leninizmin, pavarësisht se përqindjet me origjinë ose me gjendje punëtore tek ajo, tani për tani, për arsyet që dimë, mund të jenë më të vogla nga ato me origjinë fshatare.

Detashmenti i organizuar i klasës punëtore në vendin tonë, që është Partia e Punës, nuk është gjithashtu një arenë në gjirin e së cilës zhvillohet një luftë klasash në kuptimin klasik të fjalës, por është ajo që e udhëheq luftën e klasave. Kjo do të thotë se Partia jonë është një parti monolite, me unitet të çeliktë marksist-leninist mendimi e veprimi, ajo nuk lejon në gjirin e saj fraksione dhe opozita antimarksiste, revisioniste, trockiste, liberale, socialdemokrate etj. Ajo ka caktuar strategjinë dhe taktikën e saj, të mbështetura kurdoherë në teorinë marksiste-leniniste dhe në rrethanat objektive të vendit tonë, lidhur me vëçantinë dhe me kohën, të analizuara në dritën e materializmit dialektik dhe historik. Kështu që edhe taktikat e Partisë nuk mund t'u bëjnë as bisht, as, dredhi këtyre parimeve. Në bazë të kësaj Partia ka përcaktuar normat e veta për t'ia arritur qëllimit, që është programi i saj, ndërtimi i plotë i socializmit dhe i shoqërisë pa klasa, komunizmit. Ky arrihet vetëm nën hegemoninë e klasës punëtore, që udhëhiqet nga detashmenti i organizuar marksist-leninist i kësaj klase, partia komuniste, te ne Partia e Punës.

Përse duhen organizimi i përsosur, disiplina e hekurt, normat bolshevike në Parti? Këto duhen pasi janë, si të thuash, çimentoja e Partisë. Partia nuk është një grumbull njerëzish pa ideologji, pa kritere e pa qëllime, ose me kritere e qëllime të kundërtë e të hallakatura që janë ngritur për të vajtur në dasmë. Jo.

Partia e Punës e Shqipërisë u formua dhe u hodh në një luftë të tmerrshme kundër fashizmit që nuk

e kishte parë ndonjëherë njerezimi. Ishin në balancë fatet e popullit tonë dhe vetëm një parti marksiste-lininiste, si Partia jonë, mund t'i shpëtonte ato, siç i shpëtoi. Pra, Partia jonë ishte shpata e mprehtë, e ndritur, e pathyeshme dhe e papërkulur në dorën e klasës punëtore, dhe të popullit shqiptar. Dhe kjo shpatë u bë e tillë pasi u mbrujt me marksizëm-léninizmin dhe u kalit në luftë dhe me normat e saj që ajo i kishte vënë vetes. Kështu, nën udhëheqjen e Partisë, u fitua Lufta Nacionalçirimitare, u krye Revolucioni ynë Popullor, po ndërtohet sot me sukses socializmi. Partia do ta mbarojë detyrën e saj të lartë kur të jetë ndërtuar shoqëria komuniste në vendin tonë, kur të ketë triumfuar kudo në botë revolucioni proletar.

Sa luftëra i janë dashur Partisë të bëjë për të arritur në ditët e sotme! Ajo luftoi me fashistët italjanë e gjermanë, me ballistët dhe me koalicionin feudo-borgjez të vendit; ajo luftoi kundër titistëve dhe agjenturave të tyre të panumërt brenda dhe jashtë radhëve të saj; ajo luftoi kundër komploteve dhe agjenturave të imperialistëve të bashkuar; ajo luftoi kundër tradhtarëve hrushovianë, agjenturave të tyre brenda e jashtë saj; ajo luftoi kundër koalicionit të egër fashist të revizionizmit modern, me atë hrushovian në krye.

Partia jonë u doli mbanë të gjitha këtyre rreziqueve dhe i mposhti me sukses, për arsyet që thashë më lart, dhe jo se populli ynë numëronte me dhjetëra milionë njerez, apo se Partia jonë numëronte me miliona anëtarë. Në parti nuk ka vlerë sasia, po cilësia

e çelikut, dhe komunistët shqiptarë, në sajë të mbrojtjes së parimeve marksiste-leniniste, janë bërë me të vërtetë një çelik i pathyeshëm.

Armiqtë s'mungojnë të thonë se Shqipëria qëndron në këmbë dhe rron në sajë të tjerëve. Këto, natyrisht, janë gjepura. Nuk do të ishim marksistë në rast se do të mohonim solidaritetin ndërkombëtar të proletariatit botëror, por veç duhet të luftosh, të mbrohesh më parë vetë, të punosh drejt, pastaj të të ndihmojë edhe tjetri.

Shumë gjëra ndodhën në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e demokracisë popullore që çuan në përbysjen e regjimit socialist dhe në degjenerimin e partive të tyre. Përse nuk ndodhën këto edhe te ne? Për arsyet që thashë më lart dhe përsëri pikërisht pér ato arsyet që ka pér të ndodhur asgjë edhe në të ardhmen. A nuk ekziston vallë koalicion i vazhdueshëm imperialisto-revisionist kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Shqipërisë socialiste? Në këmbështë ky koalicion, por në këmbë kemi qenë e jemi edhe ne. Jemi matur me ta dhe kemi fituar, përsëri po matemi me ta dhe fitojmë. Kështu do të ndodhë edhe paskëtaj. Prandaj deri në fund fitorja do të jetë jona, e popullit dhe e Partisë sonë.

Të gjithë duhet t'i studiojmë materialet e Partisë sonë, duke filluar që nga formimi i saj, pasi në tonë do të gjejmë një eksperiencë kolosale. Mundet që këto materiale të mos kenë format e përshtatshme të paraqitjes filozofike që i kanë aq qejf intelektualët ose stilistët, mund të ketë në to edhe gjëra të vogla, të panevojshme, të ripërsëritura, por ato janë të atilla

që kalitën një Parti dhe që frymëzuan një popull të vogël e të pamposhtur që asnjëherë nuk u përkul, nuk u mposht, sepse u qëndroi besnik marksizëm-le-ninizmit dhe normave të tij.

Revisionistët modernë dhe reaksiioni ne na quajnë stalinistë, duke menduar se me këtë na shajnë dhe në fakt atje e kanë qëllimin. Por ata, përkundrazi, na lavdërojnë me këtë epitet: ne e kemi për nder të jemi stalinistë, pasi duke qenë dhe duke qëndruar të tillë, armiku s'na mposhti e nuk do të na mposhtë dot kurrë.

Në dokumentet e Partisë sonë, me një vlerë të madhe historike, ka dhe dëshiroj të përmend disa momente, gjatë të cilave, po të mos kishim vepruar ashtu sikurse vepruam, popullit do t'i kishim nxjerrë tela-she, në mos do të humbiste pavarësinë e fituar me gjak.

Partia jonë nuk lejoi të ndante pushtetin me elementët e borgjezisë, qoftë kjo edhe liberale; ajo nuk lejoi krijimin e partive borgjeze as jashtë Frontit, as brenda në Front, jo vetëm pse kështu ishte eksperienca e Bashkimit Sovjetik, po pér arsyen se Partia jonë dhe populli i njihnin që më parë, i njo-hën gjatë luftës dhe i provuan edhe pas luftës cilët ishin ballistët, «demokratët», «demokratë-indipendentë» e të tjera, si Riza Dani e Shefqet Beja me shokë. Partia, në kohën e tyre e në momentet e përshtatshme, të gjithëve u bëri thirrje, u nderi dorën, bile disa i mbështeti e dolën edhe deputetë. Këto ishin veprime taktyke të drejta, të nevojshme, por Partia nuk i ktheu në strategji dhe nuk i bëri një vijë politike e ideologjike të saj.

Armiqtë mund të na akuzojnë për sektarë e terroristë, por ne syleshë nuk ishim; armiqtë, që na kthyen pushkën, Partia dhe populli i zhdukën pa nishan. Ne nuk ishim terroristë, por revolucionarë, dhe revolucioni proletar, i udhëhequr nga partia marksiste-leniniste, nuk lejon që armikun ta futësh në vathë, nuk lejon të mbash gjarprin në gjë, me pretekst dhe arsyen që mund të përpinqesh t'u veshësh çdo petk, por që prapë nuk bien erë marksizëm-leninizëm. Këto u kryen me sukses pasi Partia ishte maja e mprehtë e shpatës së popullit.

Partia i mbajti kurdoherë të pastra radhët e saj, ashtu siç duhet të jenë radhët e një partie proletare, së cilës i duhet të kalojë nëpër një mijë rreziqe për t'ia arritur qëllimit përfundimtar. Asnjëherë nuk e humbi toruan Partia në këtë çështje jetike, ajo kurdoherë kishte parasysh se armiqtë, që të mposhtnin popullin, duhej të mposhtnin më parë Partinë, prandaj ata zhvilluan vazhdimisht një luftë të koordinuar brenda dhe jashtë saj.

Partia jonë i dërrmoi armiqtë e saj të brendshëm, duke filluar që nga Anastas Lula e deri te Liri Belishova. Kjo ishte një luftë sistematike, revolucionare. Asnjëherë Partia nuk ka lejuar të trasheshin punët armiqësore në Parti, asnjëherë ajo nuk la pa përdorur me durim mjetet sqaruese, bindëse ndaj gjithë atyre që tradhtuan dhe u hodhën në rrugën antiparti dhe antipopull, po, kur u mbush kupa dhe faktet ishin të dukshme, ajo i flaku jashtë radhëve të saj pa hezitim dhe ata që kishin komplotuar ia dha gjyqit, i cili disave u preu edhe kokën. Armiqtë qanë

për ta, kurse populli u gjëzua që u qëruan këta tradhtarë.

Një parti marksiste-leniniste që respektohet si e tillë, nuk mund të lejojë ekzistencën e dy vijave në parti; nuk mund të lejojë, pra, ekzistencën e fraksionit ose të shumë fraksioneve. Edhe në qoftë se shfaqet një gjë e tillë, partia nuk mund dhe nuk duhet ta lejojë, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, ekzistencën e tyre. Frakzioni në parti është në kundërshtim me unitetin e mendimit dhe të veprimit marksist-leninist dhe përpinqet ta kthejë partinë marksiste-leniniste në një parti socialdemokrate dhe vendin socialist në një vend kapitalist.

Të gjitha këto momente janë historike për Partinë, prandaj të gjithë duhet t'i lexojnë materialet dhe vendimet mbi to, t'i studiojnë dhe të mbështeten në to, pasi janë mësime jetëdhënëse dhe udhërrëfyese për veprimet tonë, në çdo kohë.

Lufta e Partisë sonë është një shkollë e madhe revolucionare, e cila e bën atë që t'i mbajë radhët e saj kurdoherë të pastra, pasi, megjithëse Partia nuk është një arenë lufte klasash, anëtarët e saj, që janë në pararojë, sjellin disa herë me vete mbeturina joproletare, të cilat duhet të spastrohen dhe të luftohen, dhe kjo është ajo formë lufte klasash që ne insistojmë vazhdimisht se duhet të zhvillohet kundër mbeturinave brenda në Parti. Në këtë luftë të madhe disa komunistë lodhen, disa herë thyhen. Janë, pra, këto arsyë që mund të bëhen të rrezikshme, prandaj Partia vazhdimisht e vazhdimisht duhet t'i edukojë kuadrot e saj ideologjikisht, politikisht, në luftë dhe

në punë, që të mos mposhten, që të jenë kurdoherë revolucionarë. Duke e shikuar çështjen në këtë prizëm, i vetmi prizëm marksist-leninist, kuptohet atëherë ç'rëndësi të madhe kanë normat marksiste-leniniste që rregullojnë jetën, punën dhe luftën e Partisë, të popullit, të komunistit dhe të patriotit pa parti.

Sa më thellë të kuptohet vija e drejtë e Partisë sonë, sa më thellë të kuptohen parimet dhe normat e jetës së saj, sa më drejt, thellë e me guxim revolucionar të zbatohen ato, aq më e fortë dhe e papërkulshme do të jetë Partia jonë dhe socializmi do të ecë me sukses përpara.

Për këto gjëra, pra, ne kemi luftuar e do të luftojmë deri në fund, me Partinë tonë heroike në krye, për popullin tonë të lavdishëm, për socializmin dhe komunizmin.

### **Prapë mbi burokratizmin**

Duke u mbështetur në vendimet historike të Kongresit të 5-të që na udhëheqin në punën tonë, duke u mbështetur në Letrën e Hapur të Komitetit Qendror të Partisë dhe në Thirrjen e Komitetit Qendror dhe të Qeverisë<sup>1</sup>, që janë dokumente mjaft të rëndësishme për punën e komunistëve dhe të ma-

---

1 Thirrja e KQ të PPSH dhe e Këshillit të Ministrave të RPSH mbi pjesëmarrjen e masave popullore për diskutimin dhe hartimin e planit të katërt pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës për periudhën 1966-1970, 23 tetor 1965. Shih: «Dokumente kryesore të PPSH», v. IV, f. 539.

save të gjera dhe që dhanë kaq rezultate të mëdha pozitive në revolucionarizmin e të gjitha punëve, më lejoni të shfaq disa mendime të mëtejshme lidhur me luftën e pandërprerë që ne duhet të zhvillojmë kundër burokratizmit dhe bartësve të tij.

Do të ishte gabim ta flinim mendjen se lufta kundër burokratizmit mori fund, ose se duhet t'i ngadalësojmë përpjekjet pas fushatës që zhvilluam dhe pas rezultateve të para që u arritën në këtë drejtim. Duhet kuptuar se kjo luftë nuk do të mbarojë kurrë, përderisa do të ekzistojnë klasat dhe lufta e klasave, ajo do të jetë e vazhdueshme.

Përse do të jetë e vazhdueshme? Sepse ajo nuk konsiston, siç e kuptojnë disa, në marrjen thjesht të disa masave teknike, të tilla siç janë shkurtimi i kuadrove të tepërt, zhdukja e hallkave të panevojshme në organikat e organeve shtetërore, të pushtetit, të ekonomisë, të kulturës, ose në aparatet e Partisë, apo shkurtimi i letrave dhe i shkresave dhe deri te përcaktimi më i drejtë i kompetencave dhe i përgjegjësive individuale e kolektive. Këto masa kanë luajtur dhe do të vazhdojnë të luajnë një rol pozitiv e luftarak kundër burokratizmit, por nuk janë e tëra. Kjo është një anë e vogël dhe mbetet një anë teknike e problemit, e cila mund të kthehet «në një masë prapë burokratike», në qoftë se nuk kuptohet politikisht dhe ideologjikisht përbajtja e saj, domethënë në qoftë se nuk kuptohet ideologjikisht dhe politikisht ç'është e si formohet burokratizmi, si i krijon ai konceptet e veta, ku i ka burimet, ç'gjë subjektive dhe objektive e ushqen atë.

Ne mund t'i kemi reduktuar njerëzit në ndonjë institucion nga 100 veta në 50, por kjo nuk na shpëton nga burokratizmi, në rast se këta 50 veta që mbetën nuk e kanë kuptuar thellë ç'është burokratizmi dhe të luftojnë si revolucionarë. Ashtu është edhe me shkresat. Ato mund të janë më të pakta, por përsëri mund të ruajnë fryshten burokratike. Formave duhet t'u vëmë rëndësinë e tyre, ato luajnë rol dhe ndihmojnë kur janë të mira, dëmtojnë kur janë të këqija, por të mos harrojmë kurrë se rëndësi ka esenca, bren-dia e çështjes, kuptimi ideopolitik i saj.

Burokratizmi, që zhvillohet në forma konkrete dhe merr tipare të shëmtuara, fryshtohet nga koncepte idealiste, që zhvillohen dhe marrin forma të ndryshme, për t'i shërbyer feudalizmit, borgjezisë dhe kapitalistëve, për të sunduar mbi masat, për t'i shtypur ato, për t'i shfrytëzuar deri në fund. Pra, burokratizmi është një formë të menduari dhe të vepruar në kundërshtim të hapët me popullin, me interesat e tij jetike.

Burokratizmi dhe burokratët janë, pra, antipopullorë dhe armiq të popullit. Konceptet që formojnë burokratizmin dhe burokratin janë idealiste, reaksionare, antirevolucionare, antimarksiste. Pra, burokratizmi dhe burokratët janë armiq të më të këqij e më dinakë të partisë marksiste-leniniste dhe, si të tillë, ajo duhet t'i luftojë vazhdimisht, me këmbëngulje, pa pushim, në të gjitha shfaqjet dhe, në radhë të parë, të shpartallojë konceptet politiko-ideologjike të tyre, të shpartallojë njëkohësisht edhe sistemin organizativ ose strukturor që ata vendosin, ose që orvaten

të mbajnë gjallë në forma dhe në mënyra të ndryshme.

Populli, masat edukohen dhe drejtohen në dy mënyra në botë. Atje ku ka fituar revolucioni, edukohen në mënyrë revolucionare, kurse atje ku sundon kapitali, në mënyrë burokratike. Në shoqërinë e parë, që është shoqëri socialiste, populli është në fuqi, është vendosur diktatura e proletariatit dhe partia marksiste-leniniste është në fuqi, vija e partisë, vija e masave është në fuqi. Këtu ekziston demokraci e gjerë dhe e vërtetë për masat e gjera dhe nuk ekziston demokraci për pakicën reaksionare, shtypëse, armike të masave, që ka humbur çdo fuqi, kundër së cilës, nëpërmjet luftës së klasave dhe diktaturës së proletariatit, duhet të ushtrohet një presion, një vigjilencë e madhe, e cila kurrë nuk duhet dobësuar.

Kurse në vendet ku sundon kapitali ekziston demokraci për kapitalistët, për shtypësit e për shfrytëzuesit, ekziston shtypje për shumicën, për masat, për popullin. Këtu ekziston diktatura e borgjezisë, diktatura fashiste, sundon rendi burokratik.

Pra, ekzistojnë dy koncepte për të drejtuar: koncepti burokratik antipopullor dhe koncepti revolucionar popullor. Njëri lufton tjetrin për jetë ose për vdekje. Atje ku fiton revolucioni, burokracia e ka humbur betejën e parë, por armët ajo nuk i ka hedhur dhe lufton në forma të tjera, që e kanë burimin në traditat e regjimeve të kaluara, gjynahet e vjetra të të cilave i paguajmë ne akoma, e kanë burimin sidomos në mentalitetin, në paragjykimet, në botëkuptimin e njerëzve.

Konceptet burokratike të të menduarit, domethënë

botëkuptimet ideologjike idealiste të burokracisë janë njëkohësisht koncepte të pakicës, koncepte subjektiviste që zhvillohen tek individët dhe që formojnë ideologjinë e klasës sunduese të pakicës që kërkon të sundoje mbi shumicën, së cilës pakica nuk mungon t'ia ngulë në mendje dhe në ndërgjegje me anën e kulturës, të arsimit, të politikës, të degjenerimit moralo-politik, për t'ia bërë një jetë të dytë, një mënyrë jetese të menduari dhe të vepruar.

Pra, kur fiton revolucioni, ne nuk duhet të mendojmë se të gjithë njerëzit i zhdukin menjëherë këto mendime e paragjykime idealiste, subjektiviste, individualiste dhe se këto nuk influencojnë, nuk frenojnë ecjen përpara, nuk pengojnë revolucionarizimin e njerëzve, të koncepteve e të botëkuptimit të tyre, nuk pengojnë konsolidimin me hapa të shpejtë të socializmit. Jo. Këtë ne nuk duhet ta mendojmë kështu, pasi atëherë nuk do të ishim realistë, nuk do të ishim objektivë, nuk do të ishim dhe nuk do të vepronim si revolucionarë.

Ne e shkatërruam nga themeli pushtetin e vjetër burokratik të feudo-borgjezisë dhe të fashizmit, vendosëm diktaturën e proletariatit, pushtetin e këshillave popullorë. Në pushtetin tonë të ri popullor nuk mund të themi se s'mbetën në një formë ose në një tjetër disa shfaqje të mënyrës së vjetër të drejtimit të punëve. Është fakt se gjatë këtyre dy dhjetëvjeçarëve e ca ne e kemi modernizuar, demokratizuar dhe afruar vazhdimisht shumë pushtetin tonë me masat e popullit. Por prapë duhet të bëjmë një luftë të vazhdueshme në drejtimin që pushteti ynë të mos

jetë demokratik vetëm nga forma, nga struktura, por, sidomos nga brendia. Duhet të luftojmë që esenca demokratike e pushtetit të predominojë, karakteri i tij thellësisht popullor të dominojë, pasi ky karakter do të zhdukë nga rrënjet elementët burokratikë të mbetur nga e kaluara ose të lindur rishtas në forma të reja, dhe ky karakter demokratik është i vetmi në gjendje të perfeksionojë dhe të përsosë strukturat, format dhe të krijojë ligjet që formojnë organizimin dhe orientimet e pushtetit.

Që të luftohen me sukses burokratizmi dhe burokratët, duhet të kuptohen thellë e të zbatohen me vendosmëri direktivat e Partisë sidomos, në lidhje me atë që «pushteti është i masave», «sa më afër masave», «demokracia e gjerë e masave» etj.

Disa shokë mendojnë se i kuptojnë dhe i zbatojnë mirë këto parime, por në praktikën e tyre vërtetohet e kundërtat. Ata mendojnë se pushteti është demokratik vetëm sepse bëhen zgjedhjet dhe për ta kjo është e mjaftueshme. Zgjedhje bëhen edhe në demokracitë borgjeze, debate bëhen edhe gjatë zgjedhjeve në demokracitë borgjeze. Por deputetët atje jo vetëm nuk janë njerëz të popullit, megjithëse formalisht zgjidhen prej tij nëpërmjet një mijë mënyrash mashtruese, ata janë njerëz të borgjezisë, në shërbim të saj, për të mbrojtur e për të mbushur kasat e kapitalistëve me gjakun dhe djersën e popullit. Të tillë deputetë ligjerojnë mjetet represive për të mbajtur në këmbë dhe për të fuqizuar një pushtet antipopullor, antidemokratik, burokratik. Ky është regjimi i hurit dhe i litarit, i korruptionit moralo-politik.

Zgjedhjet, pra, te ne dhe tek ata janë diametralisht të kundërtë në parim, në përmbajtje, në qëllime e në veprime. Te ne ato në esencë janë popullore, revolucionare. Deputetët e këshillave dhe të Kuvendit Popullor janë njerëz të popullit, të lidhur me popullin, të zgjedhur e të revokueshmë prej popullit. Ata bëjnë ligje revolucionare në interes të popullit dhe i zbatojnë së bashku me popullin këto ligje, urdhëresa dhe norma socialiste, revolucionare. Vullneti i masave të gjera të popullit është sovran t'i prishë këto ligje dhe urdhëresa, t'i korrigjojë dhe t'i ndryshojë në qoftë se i gjen të papërshtatshme, të vjetruara e të gabuara.

Roli dhe detyrat e deputetit tonë në demokracinë popullore nuk konsistonë vetëm në atë që të vejë formalisht të marrë kontakt një herë ose dy herë në vit me zgjedhësit e tij dhe të zbatojë në mënyrë burokratike urdhrat e vendimet në vendin ku punon, por ai është njëkohësisht deputet dhe pjesëtar i një mase të madhe të popullit, e cila jo vetëm zbaton, por krijon, vendos, diskuton, kritikon, propozon dhe ndryshon. Në kuptimin e thellë dhe në zbatimin si duhet në jetë të këtyre gjërave qëndron lufta e vërtetë kundër koncepteve burokratike. Këtu qëndron fusha e madhe e betejës në mes revolucionarëve e burokratëve, në mes masovikëve e burokratëve, në mes trimave e frikacakëve, në mes atyre që luftojnë ta lidhin fort Partinë me masat e popullit dhe atyre që përpilen ta largojnë Partinë nga populli.

Burokratët kanë frikë nga masat, revolucionarët jo. Ndjenja e frikës është një produkt individual dhe

jo masovik. Ajo mund t'i komunikohet masës për një moment e të krijojë për një kohë edhe panik, por masat janë të pafrikësueshme.

Po t'i hedhim një sy eksperiencës së madhe të Luftës Nacionalçlirimtare, do të gjejmë shembuj individësh që kishin frikë të merrnin pjesë në luftë, që hezitonin, por më në fund dolën, u bashkuan me popullin trim, u doli frika dhe u bënë trima. Nga ana tjetër, kur masat luftonin me heroizëm, ka pasur individë që u frikësoan dhe dezertuan nga radhët e masave. Kjo, pra, ngjiste nga arsyen subjektive të individit. Një njeri i tillë frikësohej, sepse në këtë rrugë e shtyin konceptet e tij jorevolucionare, borgjeze, mikroborgjeze, individualiste e frikamane.

Burokrati është frikacak, sepse botëkuptimi i tij është idealist, mistik, individualist. Këtej rrjedhin të gjitha të këqijat, si mendjemadhësia, servilizmi, gjenneshtra, mashtrimi etj., të gjitha këto për të ruajtur pozitën individuale të fituar, për t'u ngjitur në pozitë, për të fituar në mënyrë të jashtëligjshme, për të bërë një mijë e një dallavere. Natyrisht, një bagazh i tillë nuk mund t'u rezistojë syrit të masave, luftës së masave, hovit revolucionar të masave, prandaj burokrati do të bëjë çmos për t'i bërë bisht qëdo norme revolucionare, do të përpinqet t'i bëjë jovepruese ligjet dhe urdhëresat revolucionare, për t'i mërzitur masat, për t'i bërë ato të pakënaqura dhe, më në fund, indiferente. Ai do të përpinqet që aparatin e shtetit ta kthejë në një armë të mbyllur dhe administrativo-repressive, ta kthejë atë në një administratë që të jetë në shërbim të burokratizmit për t'i trembur dhe për

t'i shtypur masat dhe të mos jetë në shërbim të popullit dhe kundër burokratizmit.

Burokratët e rrezikshëm, që luftojnë për ta ngri-tur burokratizmin në sistem ose për ta mbajtur fry-mën e tij të gjallë, duhet t'i kërkojmë dhe t'i luftojmë, sidomos në aparatet e pushtetit dhe të Partisë, në pos-tet drejtuese të ndërmarrjeve ekonomike, të industrisë dhe të kooperativave, në drejtimin e institucio-neve arsimore-kulturore.

Burokrati e ka frikë masën, punën në masë dhe kur është i detyruar të vejë në masë, ai dëshiron dhe vishet me pushtet, përpinqet t'i imponohet masës me pushtetin, me funksionet që mban. Kështu ai defor-mon esencën demokratike revolucionare të pushtetit, të ligjeve. Ai shkel demokracinë, shtyp kritikën, mbron gjoja «drejtësinë e direktivës» ose të ligjit, autoritetin e Partisë dhe të shtetit. Në fakt ai bën të kundërtën, poshtëron autoritetin e Partisë e të pushtetit dhe, me qëllimet e tij të mbrapshta, të fshehta dhe disa herë të hapura, ai i ftoh, i largon masat nga Partia.

Ne kemi shembullin e disa drejtorëve ndërmarr-jesh apo ministrish, kryetarëve kooperativash etj., që veprojnë në mënyrë antiparti, antidemokratike, si pa-dronë kundër masave, kundër vartësve, kundër pu-nëtorëve. Ne u kemi lënë ministrive kompetenca dhe fonde të nevojshme e të domosdoshme të destinuara, natyrisht, për zgjerimin e domosdoshëm të prodhimit, dhe dihet se prodhimi krijohet në ndërmarrjet. Ndodh që disa drejtorë ndërmarrjesh kërkojnë dhe sigurojnë dyfishin e lëndës së parë që u nevojitet për prodhimin vjetor, disa të tjerë ruajnë në depot e ndërmarrjeve

të tyre materiale të shumta mbi normativën dhe nuk mjaftohen me kaq, por kërkojnë edhe të tjera. E keqja është se këta mburren me titullin e drejtorit të një ndërmarrjeje socialiste, kurse në fakt ata nuk do të meritonin të ishin as drejtorë të një ndërmarrjeje private në kohën e feudo-borgjezisë, pasi privati nuk do të lejonte kurrë t'i prishej malli, ose të futej në borxh, duke krijuar rezerva të panevojshme. Por drejtorit tonë burokrat s'i bëhet vonë të dëmtojë shtetin proletar, të pengojë ekonominë, ta drejtojë ndërmarrjen me kokën e tij, sipas pikëpamjeve të tij subjektive, dhe me një mijë mënyra përpinqet t'i shtypë kritikën, vigjilencën dhe kontrollin e masës së punëtorëve. Masa e punëtorëve duhet medoemos t'i shtypë kokën pa asnjë hezitim një drejtori të tillë, ose ndonjë funksionari tjetër të tillë, kushdo qoftë ai, i Partisë ose i pushtetit, dhe i çdo grade që të jetë.

Njerëz të tillë shtypin kritikuesit dhe hakmerren kundër tyre. Ata i kanë në gojë parimet «vija e masave», «kritika dhe autokritika bolshevike», «zëri i masave» etj. Por në realitet ata bëjnë çdo gjë që masat të mos veprojnë. Ç'vlerë kanë të tillë njerëz për Partinë dhe për shoqërinë tonë socialiste? Asnjë vlerë, vetëm një vlerë negative.

Atëherë vihet pyetja: Kujt i shërbejnë këta njerëz, revolucionarizimit të Partisë, socializmit, apo burokracisë dhe lakkive të tyre personale?

Vihet pyetja: Sa u vlen lëkura këtyre njerëzve përpara masës së madhe revolucionare të punonjësve, ku ata ushtrojnë këto sjellje antipopullore? Asnjë grosh. Përse masa nuk i përlan këta njerëz të këqij

dhe pa skrupull? Kush i mbron këta, përse zbulohen me vonesë dhe përse kundër tyre merren masa me vonesë, kurse të këqijat që bëjnë njihen me kohë nga masat, shumë herë këto të këqija janë vënë në dukje e, megjithatë, ata lejohen të vazhdojnë? S'ka dyshim, këta i mbron burokratizmi, rutina, formalizmi dhe disa njerëz të aparateve. Askush tjetër.

Këta zyrtarë burokratë që mendojnë se janë mbrojtësit e vërtetë të parimeve, të ligjeve, kanë frikë nga zëri i masave, nga kritikat e tyre. Në mbledhjet që zhvillohen krijohet disa herë një situatë jo tepër revolucionare. Atje nuk dëgjohen shumë zëra kambanash, duhet të bjerë medoemos «një kambanë» dhe, kur dëgjohet diçka që nuk tingëllon ashtu «siç kemi vendosur», atëherë bëhet alarm dhe përpinqemi që ta futim çdo gjë në «normën e vendosur», që nuk është norma e vërtetë. Atëherë ku janë debatet e zjarrita, rrahja e mendimeve të të kundërtave që kërkojmë, ku janë kritikat konstruktive kur ka mendime jo të pjekura ose jo të drejta që t'i ndreqim? Në mbledhje të tillë nuk mund të ketë. Pra, këtu nuk dëgjohet zëri i masës dhe, me dashje ose pa dashje, masa nuk lejohet të mendojë, të kritikojë, të vendosë, të propozojë. Nën flamurin e parullave të Partisë, nën flamurin e zbatimit të normave revolucionare të Partisë dhe të pushtetit popullor, vendoset, pra, një frenim, një regjim restriksioni<sup>1</sup>, formalizmi e burokratizmi.

Disa njerëz që e kuptojnë në mënyrë burokratike direktivën ose ligjin, s'ka si ta zbatojnë atë në mënyrë

---

<sup>1</sup> Nga frëngjishtja – shtrëngimi, kufizimi.

revolucionare. Direktiva ose ligji për ta është urdhër nga lart që duhet zbatuar verbërisht. Ata nuk marrin mundimin të thellohen ku e ka origjinën ligji ose direktiva, ç'situata kanë qenë ato që e kanë detyruar udhëheqjen t'i bëjë këto. Një shikim i tillë i cekët dhe burokratik i këtij problemi i bën ata që edhe t'i zbatojnë këto në mënyrë burokratike.

Nuk mjafton që ligji dhe direktiva vetëm të shpjegohen një herë, qoftë edhe dy herë, por ato nga përbërja dhe zbërthimi i tyre politik, ideologjik dhe organizativ duhet të bëhen një forcë madhështore, mobilizuese. Mendimi për zbatimin e direktivës pa umbështetur te masat, pa menduar dhe pa parë në praktikë nëse u pëlqen masave, është pa asnje fryt. Por që të mendosh drejt duhet të pranosh dhe të nxitësh që masat të shfaqin mendimet e tyre mbarë e mbrapsht. Kjo ka telashe dhe burokратi ua ka frikën telasheve. Ai duhet të ruajë «famën e mirë» që kanë krijuar eprorët për të, ai duhet t'u bëjë qejfin eprorëve e forumeve dhe t'u thotë atyre që «direktiva që keni pjellë ju është gjeniale, pa asnje gabim, e përshtatshme, popullore».

Si mund të ketë frikë partia marksiste-leniniste nga masat, nga zëri i tyre, nga kritikat e tyre? Ajo parti që ka frikë s'mund të quhet një parti marksiste-leniniste. Por nuk është kurrë partia ajo që ka frikë, po janë disa individë, disa anëtarë partie, disa funksionarë shtetërorë, janë burokratët që kanë frikë nga masat, janë këta që fshihen nën autoritetin e partisë e të pushtetit për të shtypur zërin e masave. Këta njerëz ne duhet t'i shtypim dhe shtypja e tyre duhet

të bëhet në mënyrë revolucionare nga Partia dhe nga masat njëkohësisht.

A do të lejojmë ne, shokë komunistë, shokë punëtorë, që disa njerëz të tillë të maskuar me emrin e Partisë ose me funksionet shtetërore, të na shkelin me këmbë ligjet e revolucionit tonë proletar, të na deformojnë normat jetëdhënëse revolucionare të Partisë, të na ndryshkin diktaturën e proletariatit me fjalë bombastike që fshehin vepra të këqija? Në asnjë mënyrë jo, sepse atëherë do të vulosnim vdekjen e popullit tonë.

A do të lejojmë ne, shokë punëtorë, që t'u bëjmë qejfin disa njerëzve të tillë dhe të dëmtojmë çështjen e madhe të popullit? Në asnjë mënyrë jo.

A mund të imagjinohet që nga disa njerëz të tillë të krimbur të ketë frikë masa e popullit, e udhëhequr nga Partia, të ketë frikë klasa jonë punëtore dhe Partia e saj e lavdishme e Punës? Kurrë, për asnjë sekondë, nuk mund të imagjinohet një gjë e tillë.

Por as edhe nuk duhet menduar se këta, meqë janë të paktë, s'kanë ç'na bëjnë, prandaj nuk duhet t'i vëmë në darën e hekurt të diktaturës, ku ose të ndreqen, ose të zhduken. Të mos harrojmë kurrë tragjedinë e Bashkimit Sovjetik. Nën udhëheqjen e Partisë dhe të klasës punëtore, masat e popullit duhet të jenë kurdoherë dhe për çdo gjë në këmbë për të mbrojtur diktaturën e proletariatit, ligjet, ideologjinë, politikën dhe realizimet e saj. Kjo është e vëtmja rrugë e drejtë e shëndetshme, shpëtimtare, që na mëson Partia jonë, e cila na këshillon ta zbatojmë deri në fund, të gjithë, pa përjashtim.

Dy rrugë ka: ose me Partinë dhe popullin, ose kundër tyre. Prandaj asgjë s'duhet lejuar jashtë ligjeve dhe normave të Partisë dhe të popullit, asgjë s'duhet t'i shpëtojë syrit vigjilent të Partisë dhe të popullit, askush nuk duhet lejuar që të mos u japë llogari për punën e tij Partisë dhe popullit dhe të marrë atë që meriton nga Partia dhe nga populli.

Kritika shumë e myllur, shumë e cekët dhe formale në organizatat-bazë, që arsyetohet me gjëra që s'qëndrojnë në këmbë, duhet të marrë fund.

Themi se në organizatën-bazë nuk kritikojnë se kanë frikë. Atëherë, në qoftë se është kështu, do të thotë se kolektivi i organizatës-bazë nuk është në gjendje ta mundë ndjenjën e frikës individuale. Atëherë, në këtë rast, këtë luftë le t'ia kalojmë kolektivit, jashtë organizatës, për të luftuar me sukses frikën individuale, por edhe kolektive, të organizatës-bazë ku ka zënë rrënje një e keqe e tillë.

Të zhduken gazetat e murit aktuale dhe shumë qesharake dhe të kthehen ato në gazeta muri revolucionare, që të shërbijnë për edukim revolucionar. Të zhduken nga këto gazeta redaksitë e tyre prej kalem-xhinjsh oportunistë që «ruajnë nderin dhe autoritetin e drejtorit» e të tyren njëkohësisht dhe cilido pa frikë dhe me shkronja të mëdha të shkruajë çfarë mendon ai për punën dhe për njerëzit.

Ose thuhet: «Duhet të ruajmë autoritetin e kuadrove, se po t'i kritikojmë hapur, atëherë na diskreditohen kuadrot». Domethënë ata që mendojnë kështu, pranojnë që më parë se kuadrot janë të pagabueshëm dhe masat gabojnë në gjykimet e tyre. Të mendosh

kështu është një gabim shumë i rëndë, është të mendosh jo si marksist, jo si revolucionar. Kuadrin që punon mirë s'ka kush e diskrediton, përkundrazi, atë e duan dhe e mbrojnë. Por ç'të keqe ka dhe ç'normë shkëlet, kur masa e kritikon hapur kuadrin që gabon? Asgjë të keqe, veçse të mirë. Përse ne, nën pretekstin e «ruajtjes së prestigjit të kuadrit», duhet të shtypim ose të dobësojmë kritikën nga poshtë? Ç'e keqe i vjen Partisë nga një gjë e tillë? Shumë të këqija vijnë në qoftë se veprojmë gabim. Autoriteti i Partisë në masa bie, ne kështu krimbim Partinë, mbajmë dhe mbrojmë në Parti njerëz të padenjë, Partinë e edukojmë keq.

Disa herë ngurrohet të merren masa kundër kuadrove me stazh dhe me eksperiencë, kur këta kuadro gabojnë një herë e dy herë. Ky është një gabim i madh. Në këto raste ne duhet të shohim se metoda e mirë e punës dhe sjelljet revolucionare nuk janë lidhur kur doherë me zotësinë e kuadrit, por sidomos me botëkuptimin e tij politiko-ideologjik.

Pra, edukimi i kuadrit dhe i njerëzve me fryshtëzues revolucionare është një detyrë e madhe, e përhershme, pasi nga një punë e mirë ose e keqe në këtë drejtim varet lufta me sukses ose jo kundër burokratizmit dhe burokratëve, varet shërimi i tyre.

Po t'i këqyrim me kujdes burokratët, do të dallojmë se ata nuk studiojnë sa duhet teorinë marksiste-leniniste dhe se në punën e tyre mbizotëron subjektivizmi. Ata janë shumë të prekshëm në mendimet e tyre, janë njëkohësisht megalomanë dhe servilë, — megalomanë karshi masës, servilë ndaj eprorëve.

Burokratët fshehin injorancën me fjalët dhe fratzat bombastike. Ata e përdorin si kapital vetjak, personal, qenien për një kohë të gjatë pa lëvizur në poste drejtuese dhe arrijnë në mendimin se janë bërë të paprekshëm, të pazëvendësueshëm, mendojnë se kanë përpunuar në mënyrë të mjafthueshme opinionin rreth e qark vetes për «zotësinë e tyre» dhe nuk parashikojnë asnjë rrezik se do të ulen në pozitë, se do të transferohen etj. Ata mendojnë vetëm se do të ngjiten dhe vetëm të ngjiten dhe punojnë në këtë drejtim.

I gjithë ky mentalitet jorevolucionar krijon tek ata një ndjenjë stabiliteti në kolktukun që kanë zënë, një siguri në pagabueshmërinë e tyre në punë dhe në përsosmërinë e metodës dhe të stilit të punës së tyre, dhe arrijnë kështu që të krijojnë një mënyrë të menduari e të jetuari në familje dhe në shoqëri, të një borgjezi të ri brenda në demokracinë tonë popullore. Kjo është shumë e rrezikshme. Këto pikëpamje të burokratit, në rast se nuk ia djegim me zjarr, ai, i mbuluar me autoritet, do të na i përhapë dhe do të na infektojë edhe të tjerët.

Pra, përveç edukimit ideopolitik të kuadrove dhe të masave në përgjithësi dhe formave të shumta të luftës kundër shfaqjeve të burokratizmit, mendoj se ne duhet ta studiojmë më seriozisht problemin dhe të zbatojmë një qarkullim të mëtejshëm të drejtë të kuadrit, pasi kemi kuadro që kanë nga më shumë se 10-15 vjet që janë mykur në një vend dhe që, me dashje ose pa dashje, kanë marrë disa tipare të njerëzve që thashë më lart. Zëvendësimi i tyre me nje-

rëz të bazës do t'u bëjë mirë Partisë dhe pushtetit lart dhe bazës e njerëzve që venë nga lart-poshtë do t'u sjellë të mira. Natyrisht, me zjarr e dëshirë të gjithë këta nuk do të venë, por ne duhet të jemi të bindur se veprojmë drejt, sepse këtyre njerëzve në këtë mënyrë u luftojmë pikëpamjet jorevolucionare që janë shfaqur në ta. Ne do t'i shërojmë.

Nuk i bën përshtypje të madhe një punëtori ose një kooperativisti kur ndërron vend. Ai kurdoherë nuk i trembet punës dhe jetës në përgjithësi. Ai është mësuar me vështirësi, bukën ai e fiton kudo me djersë. Kurse intelektuali dhe zyrtari e kanë vështirë të lëvizin për shumë arsyе pasi: e para, tek ata është krijuar një pikëpamje e epërsisë së «intelektit» dhe e «zyrtarizmit»; dhe e dyta, çështja e rrogës, çështja e trajtimit financiar. Këto dy pikëpamje, që nuk shfaqen te punëtorët dhe te fshatarët, duhen luftuar tek intelektualët dhe zyrtarët.

Dituria, shkenca, mençuria nuk janë pronë vetëm e disave që kanë tru «specialë» ose «virtute të veçanta» dhe që mendojnë se vetëm ata janë në gjendje t'i mësojnë dhe të urdhërojnë të tjerët t'i zbatojnë. Janë masat e gjera ato që krijojnë, që ndërtojnë dhe transformojnë botën e shoqërinë dhe kur i bëjnë këto, do të thotë se çdo meritë, pa nën-vleftësuar meritën e gjithsecilit, e vënë në shërbimin e përgjithshëm të shoqërisë. Pra, merita u përket masave që punojnë, mendojnë, krijojnë, zbatojnë, mendojnë dhe krijojnë përsëri.

Prandaj mendimin e atyre që kanë njëfarë diturie, por të cilën e shfrytëzojnë për të imponuar mbi

masat «unin», duhet ta luftojmë pasi ky është një mendim borgjez, reaksionar, ashtu siç është borgjez, reaksionar edhe mendimi i «zyrtarizmit», kur kuptohet që me anën e tij të fshihen e keqja e personit, botëkuptimi dhe veprimi i tij antimarksist, antirevolucionar, burokratik.

Punëtori dhe fshatari e kanë të qartë se të ardhurat e tyre janë të lidhura me punën, me djersën, kurse funksionari e lidh rrogën e tij edhe me punën, por edhe me postin. Prandaj shkuarja e tij poshtë me qejf ose jo, varet se a ulet ose jo nga posti, i ulet ose jo rroga tok me «rytbenë».

Natyrisht, nuk do të ishte e drejtë t'u jepnim rroga personale atyre që shkojnë nga lart-poshtë për arsy pune. Por, në interesin e përgjithshëm, ne duhet të shkojmë akoma më me guxim drejt ngushtimit të diferencës në mes rrogave të punëtorëve dhe në-punësve dhe në mes kategorive të ndryshme të në-punësve. Kjo është një rrugë e drejtë marksiste-leniniste. Marksiste-leniniste është gjithashtu që kjo masë të shoqërohet me krijimin e bollëkut ekonomik.

Nga të gjitha këto Partisë i dalin detyra të mëdha për të revolucionarizuar më tej punën e saj. Sukseset e mëdha që kemi ne në punën tonë të Partisë nuk duhet të na dehin dhe të mbyllim sytë për të metat dhe dobësitë që ekzistojnë dhe që nuk duhen nënvleftësuar. Do të ishte një dëm i madh në rast se ne nuk do të thellonim më tej dhe nuk do të zbatonim pa frikë vijën e masave, demokracinë e vërtetë të masave, në rast se nuk do të thellonim dhe nuk do të zbatonim deri në fund, drejt e në mënyrë revolucion-

nare, normat e Partisë, centralizmin demokratik dhe jo atë burokratik, kritikën dhe autokritikën bolshevikë, disiplinën proletare, moralin proletar.

Ne do ta forcojmë Partinë, kështu ne duhet të ecim në këtë rrugë të drejtë, që Partisë, socializmit dhe popullit tonë të mos u dhembë kurrë as koka, as zemra, as trupi.

Ne i kemi të gjitha mundësitë, pasi Partinë e kemi të fortë, të kalitur, me eksperiencë të madhe revolucionare, pasi ne i kemi anëtarët e Partisë të guximshëm, heroikë dhe një popull të mrekullueshëm, të lidhur shumë ngushtë me Partinë.

*Botuar për herë të parë në  
gazeten «Zëri i popullit»,  
nr. 32 (5757), 7 shkurt 1967*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha «Raporte e fjalime  
1967-1968», f. 5 ~*

**VETËM KËSHTU MBROHEN REPUBLIKA  
DEMOKRATIKE GJERMANE DHE KUFIJTE  
ODER-NAJSE**

*Artikull i botuar në gazetën „Zëri i popullit“*

**8 shkurt 1967**

Agjencitë e ndryshme të lajmeve paralajmërojnë mbledhjen e ministrave të jashtëm të vendeve pjesë-marrëse të Traktatit të Varshavës për të diskutuar marrëdhëniet e tyre me Republikën Federale Gjermane.

Duket qartë se në konjunkturat aktuale qeveria e Valter Ulbrihtit po izolohet nga vetë aleatët e saj, qeveritë revizioniste, që janë turrur të vendosin marrëdhënie diplomatike dhe të marrin nga Boni kredi-lëmoshë. Bashkimi Sovjetik i ka pasë lidhur qysh më parë të tilla marrëdhënie, Rumania i lidhi tani, Hungaria do t'i lidhë nesër, Bullgaria me Çekoslovakianë pasnesër. Rëndësi ka fakti që shtetet revizioniste po i sakrifikojnë interesat e Republikës Demokratike Gjermane dhe, duke u lidhur me një mijë mënyra me Bonin, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Fran-

cën dhe me Anglinë, sot ose nesër do t'i imponojnë Republikës Demokratike Gjermane kompromise të tjera në dëm të saj.

Mbledhja dhe deklaratat e revizionistëve janë sa për të kaluar radhën. Ato janë të fryshtuara nga interesa socialshoviniste, nacionaliste dhe do ta bëjnë Ulbrihtin e grupin e tij që një mëngjes ose të pranojnë plotësisht diktatin e tyre, ose të lidhen drejtpërsëdrejti me Bonin, ose t'i qërojnë nga mesi. Aleanca e tyre false nuk është veçse një fasadë për veprimet e tyre të shkëputura. Imperialistët e dinë fare mirë se llo-motitjet mbi veprimet «e përbashkëta» të shteteve revizioniste nuk kanë më asnjë efekt, ato janë inopervese, çdo gjë bëhet në prapaskenë dhe sovjeto-amerikanët dominojnë në këto prapaskena. Veprimet e «fasadës» të revizionistëve sovjetikë nuk i shërbejnë tjetërkujt veçse interesave të shtetit të madh shovinist sovjetik. Të gjithë partnerët e revizionistëve sovjetikë e dinë këtë gjë, por edhe ata të gjithë përpiken që veprimet e veta t'i matin vetëm me metrin e interesave të tyre të ngushta nationale. Për ta çështja e Republikës Demokratike Gjermane është bërë një pengesë e mërzitshme në rrugën e tyre tradhtare të krijimit «të marrëdhënieve normale» me imperialistët e ndryshëm. Ulbrihti dhe shokët e tij e shohin këtë situatë, por ata janë vetë revizionistë dhe nuk janë në gjendje ta shkatërrojnë në mënyrë revolucionare këtë plan të ndyrë, duke u revoltuar dhe duke hedhur poshtë zgjedhën imperialisto-revizioniste. Ulbrihti dhe shokët e tij janë të zhytur në këto kontradikta dhe koniunktura, prandaj më kot përpiken t'i

shpëtojnë darës me metoda revizioniste. Të gjitha këto veprime «të përbashkëta» të revizionistëve nuk kanë për qëllim të shpëtojnë as popullin gjerman, as Republikën Demokratike Gjermane dhe as botën nga një kthim i revanshistëve gjermanë dhe i veprimeve të tyre militariste, revanshiste dhe zjarrndezëse.

Republika Demokratike Gjermane është e indinjuar dhe e revoltuar nga Republika Popullore e Rumanisë, e cila lidhi marrëdhënie diplomatike me Republikën Federale Gjermane, dhe ajo ka të drejtë, por Republika Popullore e Rumanisë ecën në një rrugë të hapur qysh më parë nga dikush tjetër, kundër të cilit në kohën e duhur nuk u shpreh asnjë indinjatë dhe revoltë nga udhëheqja e Republikës Demokratike Gjermane, me Valter Ulbrihtin në krye. Këta të tjerë që e hapën më parë këtë rrugë janë Hrushovi dhe pasardhësit e tij — Brezhnjevi, Kosigini e të tjerë.

Udhëheqja revizioniste e Republikës Demokratike Gjermane, që cirret dhe indinjohet kaq shumë, i ka tradhtuar vetë që më parë interesat e popullit gjerman, të komunistëve dhe të demokratëve gjermanë. Kjo udhëheqje mendoi se, duke u bërë ortake në tradhtinë ideologjike të Hrushovit, do të fitonte edhe në politikën e kompromiseve, të lëshimeve e të aleancave që projektonte dhe kryente me një zhurmë shurdhuese antimarksiste, antishqiptare, antikinezë klouni tragjik Nikita Hrushovi.

Nikita Hrushovi shkeli vendimet e përbashkëta që kishin marrë për Gjermaninë vendet anëtare të Traktatit të Varshavës. Me këtë veprim tradhtar të Hrushovit ishin dakord që të gjithë, me përjashtim të

Republikës Popullore të Shqipërisë, Qeveria e së cilës e kundërshtoi energjikisht dhe publikisht këtë shkelje arbitrale të vendimit të përbashkët dhe bëri thirrje që të firmosej traktati i paqes me të dyja shtetet gjermane dhe, në rast se nuk arrihej kjo, të firmosej medoemos vetëm me Republikën Demokratike Gjermane. Po të plotësohej një vendim i tillë, i cili qe marrë së toku dhe njëzëri, mbrojtja e Republikës Demokratike Gjermane do të ishte e garantuar me traktat. Por, zotëria e tij, Valter Ulbrihti, jo vetëm që u bashkua me revolucionarin Nikita Hrushov dhe shokët e tij, të tjera, po, njëlloj si ata, sulmoi Partinë e Punës të Shqipërisë dhe Qeverinë Shqiptare, të vetmet që mbronin interesat e popullit dhe të Republikës Demokratike Gjermane.

Ne shqiptarët do të vazhdojmë ta mbrojmë gjérnë fund Republikën Demokratike Gjermane dhe popullin e saj, në çdo rast dhe kundër kujtdo qoftë, edhe kundër tradhtarëve dhe revolucionistëve gjermanë që kanë hyrë në shërbim të revolucionistëve sovjetikë, që i shërbejnë politikës hegemoniste të të dyja shteteve të mëdha imperialiste dhe revolucioniste, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, dhe që kanë rënë në çarqet e ngritura nga revolucionistët e Moskës dhe revanshistët e Bonit.

Është e qartë se revolucionistët sovjetikë dhe të gjitha klikat revolucioniste që janë në pushtet në Evropë, nën flamurin e rreckosur të bashkekzistencës paqësore hrushoviane, që i shërben aleancës sovjeto-amerikane, duan ta likuidojnë sa më parë çështjen gjermane. Ata kanë vendosur që kjo të bëhet në dëm

të Republikës Demokratike Gjermane, pasi kjo është bërë për ta një ferrë nëpër këmbë.

«Traktati i Varshavës», «solidariteti i Varshavës», «veprime të përbashkëta të vendeve të Traktatit të Varshavës» — të gjitha këto janë blofe e demagogji për të gënjer dhe për të fshehur veprimet e veçuara të gjithsecilit. Çdo gjë zhvillohet në prapaskenë dhe në prapaskenë qentë po grihen me njëri-tjetrin mbi një kockë. Mbi këtë kockë cilido llogarit, për interesat e veta nacionale, shoviniste, të përfitojë, të lidhë kontrata e marrëveshje të fshehta me imperialistët, të sigurojë koncesione, të marrë premtimë të veçuara e të pavlefshme për të ruajtur gjoja statukuonë e marrëveshjes ndërkombëtare pas Luftës së Dytë Botërore. Kudo, në çdo hap të tyre, s'ka gjë tjetër veç veprimeve me frymë dhe ideologji borgjeze, kudo tek ata vepron ligji kapitalist i xhunglës, i maskuar me fraza socialiste; në veprimet e tyre s'ka asnë fije internacionizmi proletar,asnë fije solidariteti socialist.

Revisionistët e Evropës janë të alarmuar e të indinjuar që Rumania lidhi marrëveshje e që bën tregti me Bonin dhe merr kredi nga ai. Por Rumania nuk bën gjë tjetër përveç asaj që ka bërë dhe bën me të madhe Bashkimi Sovjetik. Revisionistët ngrenë zërin kundër Rumanisë për të zvogëluar tradhtinë e madhe të revisionistëve sovjetikë, për aleancën e madhe sovjeto-amerikane që i frymëzon të gjitha këto veprime. Vihet pyetja: Ç'bëjnë Kosigini dhe Podgorni që shkojnë në Francë, në Angli, në Itali, në Vatikan e gjekë? Ata i bëjnë varrin socializmit, i bëjnë varrin Repu-

blikës Demokratike Gjermane, ata marrin kredi nga kapitalistët dhe jo vetëm zhvillojnë «bashkekzistencën paqësore», por përsosin integrimin ekonomik dhe politik të socializmit në kapitalizëm.

Po revisionistët çekë çfarë po bëjnë nga ana e tyre? Atë që bëri Rumania më parë, se ishte larg kufijve të Bonit, çekët do ta bëjnë së afërmi, bullgarët do ta bëjnë pas tyre, pasi hëpërhi nuk i lënë revolucionistët sovjetikë, kurse hungarezët, të cilët kanë hyrë gjer në grykë në kundërrevolucion, do të bëjnë çdo gjë që i intereson reaksionit.

Ulbrihti vetë dhe shokët e tij që qajnë, kanë firmosur kushedi sa marrëveshje me qeverinë e Bonit dhe me reaksionarët e Berlinit Perëndimor.

Sa për revisionistët polakë, këta janë gati në çdo moment ta lënë në baltë Republikën Demokratike Gjermane, në rast se u njihet kufiri Oder-Najse nga ata që e rivendikojnë.

Përse revisionistët e tjerë, bashkë me ata gjermanë, janë kundër lidhjeve diplomatike të qeverisë rumune me Bonin? Lidhjen e marrëdhënieve diplomatike në mes Bukureshtit dhe Bonit ata nuk e lutojnë drejtpërdrejt, sepse revisionistët sovjetikë janë të përlyer me kohë vetë dhe sepse revisionistët çekë, hungarezë, bullgarë e të tjerë do t'i lidhin medoemos nesër. Por ata kërkojnë, gjoja, nga Rumania dhe nga qeveritarët e Bonit të njihet publikisht si shtet sovran Republika Demokratike Gjermane, kufiri Oder-Najse dhe që Republika Federale Gjermane të mos armatoset me armë bërthamore.

Tradhtarët revisionistë nuk janë konsekuentë.

Prandaj këto pretendime janë blofe për të kaluar radhën dhe për të kurdisur tradhti të tjera, pasi vendimi i përbashkët për të nënshkruar traktatin e paqes edhe vetëm me Republikën Demokratike Gjermane pikërisht këto kërkesa do të realizonte. Këtë vendim ata e shkelën përfundimisht dhe paturpësisht.

Ne u themi: zotérinj revizionistë, ju mbronni gjoja paqen, kurse përgatitni luftën. Me fjalë jeni gjoja kundër Bonit, por në të vërtetë jeni me Bonin, jeni me Frankon.

Ju tani po kurdisi aleanca të reja në Evropë dhe në botë për një ndarje tjetër të re të botës, të cilën përpinqeni ta realizoni me anë të një lufte të re botërore. Këtë luftë të re botërore po e përgatitin imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë. E astuquajtura qetësi në Evropë që kënaq Titon me shokë, do të shndërrohet dhe duhet të kthehet në një zjarr të madh që të likuidojë kapitalistët, revizionistët dhe gjithë tradhtarët.

A mendoni ju, revizionistë modernë, se do të vazhdoni për shumë kohë të gënjeni popujt tuaj dhe komunistët e vërtetë me këto veprime tradhtie? A mendoni ju se do t'i shpëtoni revolucionit që po zien në partitë tuaja dhe në gjirin e popujve tuaj? Jo. Dita e shembjes suaj ka arritur. Komunistët e vërtetë, popujt revolucionarë do të përballojnë çdo vështirësi, do të hedhin tej çdo ndjenjë frike, do të hidhen në greva, në demonstrata, në përlleshje, në revolucion, sepse udhëheqësit revizionistë tradhtarë po përgatitin një shtypje të re, të egër, të llahtarshme, që do të çojë në luftën imperialiste.

Të mos harrojmë luftën që kaloi dhe barbarizmat e saj. Ata që i provokuan dhe i bënë ato gjëra janë të ngjashëm me këta të sotmit. Rruga nöpër të cilën ecin tradhtarët e marksizëm-lininizmit është rruga e robërisë së popujve. Nuk mjafton më të jemi vijllentë, por duhet të sulmojmë me heroizëm gjithë armiqjtë kapitalistë, revisionistë, reaksionarët. Komunistët e vërtetë gjermanë, demokratët revolucionarë gjermanë, i gjithë populli gjerman i Republikës Demokratike Gjermane, për të shpëtuar republikën e tyre, duhet të thyejnë me guxim darën revisioniste sovjetike, të mposhtin intrigën e madhe që luhet në kurriz të tyre. Në këtë rrugë ata do të kenë përkrahjen e plotë të të gjithë popujve, të të gjithë marksistë-lininistëve të vörtetë. Vetëm kështu mbrohen Republika Demokratike Gjermane dhe kufijtë Oder-Najse.

*Botuar për herë të parë në  
gazeten «Zëri i popullit»,  
nr. 33 (5758), 8 shkurt 1967*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## **POPULLI I KA ZGJEDHUR UDHËHEQËSIT PËR TË REALIZUAR VIJËN E PARTISË**

*Nga takimi me punonjës dhe kooperativistë  
të Shijakut<sup>1</sup>*

**18 shkurt 1967**

Duke udhëtuar sot për këtu, në Shijak, po mendoja për ditët e bucura që i solli Partia popullit tonë heroik, i cili meriton të jetojë i lumtur. Në të kaluarën ai ka vuajtur shumë nga shtypja e feudalëve, e kapitalistëve dhe e imperialistëve të huaj, por asnjëherë nuk është përkultur dhe ka luftuar vazhdimisht për lirinë e për të drejtat e tij. Populli ynë është një popull revolucionar, ai nuk ka lejuar asnjëherë «t'ia hajë qeni shkopin». Sukseset dhe lumturinë që gjëzon sot ai ua detyron udhëheqjes largpamëse të Partisë dhe gjakut, djersës, sakrificave të tij të panumërta gjatë Luftës Nacionalçirimitare. Prandaj

---

1 Ky takim u bë në mënyrë krejt spontane, kur shoku Enver Hoxha ishte duke vizituar Fabrikën e Niseshtesë, furrën e bukës dhe stallat e lopëve të kooperativës bujqësore në Shijak.

ne themi kurdoherë se fitorja mbi pushtuesit fashistë dhe tradhtarët e vendit, si dhe çdo përparim që është realizuar pas Çlirimit në Shqipëri i detyrohen heroizmit të popullit dhe udhëheqjes së drejtë e të ndritur të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Populli dhe Partia, ashtu siç ishin gjatë luftës faktorët kryesorë që siguruan lirinë dhe pavarësinë e atdheut, edhe sot janë faktorët kryesorë që jeta e njerëzve në vendin tonë bëhet çdo ditë më e mirë dhe më e bukur. Partia ka punuar vazhdimesh për forcimin dhe çimentimin e unitetit të saj me popullin, për edukimin e tij me një ndërgjegje të lartë revolucionare, për pajisjen e tij me mjete të fuqishme pune e mbrojtjeje, me qëllim që armiqqtë tanë, cilëtdo qofshin ata, të jashtëm ose të brendshëm, të mos guxojnë ta prekin Shqipërinë. Dhe e vërteta është se sot ata duhet të mendohen mirë pa të guxojnë të prekin atdheun tonë. Për të gjitha këto arsyе Shqipëria socialiste, duke ecur në rrugën marksiste-leniniste, është bërë sot një forcë përparimtare që jo vetëm forcohet e lulëzon vetë, por ndihmon njëkohësisht edhe të tjerët me shembullin e saj në ndërtimin e socializmit dhe në mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë.

Ndihma që i jepet mikut apo shokut nuk kuptohet vetëm me dhënen e mjeteve materiale. Duke pasur parasysh se populli ynë është i vogël, merret me mend se ndihma materiale që ai mund t'u japë miqve të vet në botë është modeste. Vlera e kësaj ndihme matet në drejtime të tjera, në radhë të parë në fushën politike dhe ideologjike. Në mënyrë internacionliste, në kohën e Stalinit, neve na ka dhënë një

ndihmë të konsiderueshme materiale Bashkimi Sovjetik. Megjithatë, ndihmat që na jasin miqtë nuk mund të barazohen me krijimtarinë dhe me punën e madhe të vetë popullit shqiptar. Rëndësi vendimtare për ndërtimin e socializmit në vendin tonë kanë puna, zotësia e popullit dhe e Partisë sonë. Jo më pak rëndësi ka ndihma e madhe, e gjithanshme dhe e pakufishme, politike dhe ideologjike, që u jasin Partia dhe populli ynë popujve të tjerë të botës, duke filluar që nga ai i Bashkimit Sovjetik e gjer tek atatë Afrikës dhe të Amerikës Latine. Këtë ndihmë, veç të tjerave, ne e jashim me shembullin tonë, nëpërmjet të cilit popujt shohin si mund të ecë një vend në rrugën e socializmit. Të gjithë ndjekin me simpati qëndrimet e Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë në mbledhjet e ndryshme ndërkombëtare, ku të deleguarit e vendit tonë shfaqin pa druatje mendimet e tyre për çdo problem, dhe armiqtë, duan ose s'duan, detyrohen t'i thonë pikëpamjet tona në radiot e tyre.

Askush nuk mundi t'i mbyllë dot gojën përfaqësuesit të Republikës Popullore të Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, kur ai sulmoi imperializmin amerikan. Një jehonë të madhe pati kjo ngjarje jo vetëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po në të gjithë botën. Një javë të tërë radiot dhe gazetat e mbarë botës folën për ato që kishte thënë përfaqësuesi i popullit shqiptar. Kjo jo vetëm e rriti prestigjin ndërkombëtar të vendit tonë, por u dha kurajë edhe përfaqësuesve të vendevë të ndryshme demokratike borgjeze, si atyre të Egjiptit, të Sudanit etj.

Qeveritë e këtyre vendeve vërtet janë përfaqësuese të kapitalizmit, por përpiken të shpëtojnë nga goja e peshkut më të madh, imperializmit amerikan, që mundohet t'i gllabërojë. Përfaqësuesit e vendeve të tillë nuk flasin dot si ne, mbasi imperialistët u kanë lidhur duar e këmbë, por edhe sepse qeveritë e tyre s'e ndiejnë veten të fortë, pasi nuk kanë baza në popull. Prandaj, qëndrimi ynë është një shembull përtat se si duhet t'i rezistojnë me guxim imperializmit. Kjo është një ndihmë përtat dhe neve na intereson, se rezistenca e tyre dobëson armiqëtanë të mëdhenj.

Radioja jonë flet vazhdimisht përt çdo gjë që ngjet dhe bëhet në Shqipëri, si lulëzon e forcohet vendi ynë, si punon klasa punëtore, si është ngritur dhe është bashkuar fshatarësia në jetë e në punë kolektive, si ngrihen fabrika të reja, si hapen shkolla, ku shkojnë pa përjashtim të gjithë djemtë dhe vajzat e reja, si punojnë, luftojnë e mendojnë njëlloj si burrat grata e vendit tonë etj. Kjo prek thellë ndjenjat e njerëzve. Sot në botë është krijuar një situatë e tillë simpatie për Shqipërinë sa nuk mund të merret me mend dhe të krahasohet me të kaluarën. Përpara, kur të huajt pushtonin Shqipërinë, në favor të saj flisnin vetëm disa elementë demokratë e përparimtarë, kurse sot, po të guxojë ta prekë atë ndonjë agresor, ky jo vetëm do të hajë grushte të rënda vdekjeprurëse nga vetë ne dhe nuk do të arrijë t'i kapërcejë dot kufijtë ose brigjet e Adriatikut, por kundër tij do të ngrihet në këmbë edhe opinioni publik botëror.

Revisionistët sovjetikë dhe gjithë revisionistët

e tjerë, kudo që janë, dridhen, sepse, pavarësisht që në disa vende janë në fuqi, ata e shohin se nuk i kanë me vete masat e popullit. Ata kanë degjeneruar me kohë dhe tani nuk mendojnë, nuk luftojnë dhe nuk rrojnë tok me popullin, përkundrazi, përpinqen ta shtypin dhe ta shfrytëzojnë, prandaj ai nuk i do. Populli nuk ka si t'i dojë kusarët, njerëzit e pandershëm e hipokritë që para syve flasin sikur janë miq, kurse prapa krahëve bëjnë të kundërtën. Populli nuk i do as ata drejtues që kërkojnë t'u bindesh verbërisht, përndryshe të kërcënojnë. Njerëzit e mirë, që mendojnë e punojnë për popullin dhe rrojnë pranë tij, ai i do, i respekton, i nderon dhe i mbron.

Po përse popujt e këtyre vendeve nuk ngrihen t'i rrëzojnë klikat e përbëra nga njerëz të tillë që veprojnë kundër interesave të masave? Do të ngrihen patjetër, në mos sot, nesër, ashtu sikurse u ngrit populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë, gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe me luftë përbëysi armiqtë e mori fuqinë në dorë.

Shqiptarët kanë luftuar vazhdimisht edhe më përpara. Edhe këtu, në Shijak, gjyshërit tuaj kanë luftuar në çdo kohë. Ata që u ngritën më 1914-1915 kundër bejlerëve e që i quanin «rebelë», ishin këtej, nga Shijaku, nga Kavaja etj. Por «rebelët» ishin kryengritës, revolucionarë, që ngrinin krye për një çështje të drejtë, prandaj populli i ndoqi pas njerëz të tillë, si Haxhi Qamilin me shokë, që u ngritën kundër tiranëve, bejlerëve, feudalëve e borgjezisë. Fshatarët e Shqipërisë së Mesme, fshatarët e Shijakut, të Kavjës e të tjerë, që u bashkuan me Haxhi Qamilin,

ishin «rebelë», të tillë, siç jemi edhe ne, që rrëzuam botën e vjetër dhe tani po ngremë një botë të re, botën e ndershmërisë, të lirisë dhe të përparimit, botën pa gjakpirës e pa shfrytëzues, kundër të cilëve populli ka luftuar vazhdimisht në shekuj.

Kur themi që po ndërtojmë botën e re, nuk dua të them me këtë se jemi kundër pleqve. Ne i duam dhe i nderojmë shumë pleqtë dhe punojmë që edhe atyre t'u krijojmë kushte që të kalojnë pleqëri të bardhë, pse shumë kanë vuajtur në jetë në të kaluarën. Por disa pleq kanë edhe mendime të vjetra në kokë që të rinjtë nuk ua pranojnë. Prandaj ata duhet të mendojnë drejt, të mos e pengojnë rininë duke i vënë përpara zakonet e pushtuesve anadollakë që populli ynë i ka shporrur me kohë nga trualli i atdheut, përkundrazi, të rinjve e të reja ve t'u japim mundësi për të mësuar, për të punuar dhe për të ecur përpara. Të jeni të sigurt se të rinjtë këshillat e mira të pleqve i pranojnë me dëshirë, kurse mendimet e disa prapanikëve, qofshin këta pleq apo të rinj, nuk kanë si t'i pranojnë dhe unë mendoj se bëjnë mirë. Bile, Partia i mëson të rinjtë, që, kur janë në rrugë të drejtë dhe ndonjë i vjetër nga mendimet i pengon në ecjen e tyre përpara, të mos prapsen. Kur një i ri ose e re i thotë një plaku se nuk e ka mirë një mendim, ky i fundit të mos mendojë se me këtë i riu e poshtëron, përkundrazi, e ndihmon që edhe ai të mendojë njëlloj si të tjerët.

Nënët, gratë dhe vajzat tona, shoqe dhe shokë, kanë vuajtur shumë në të kaluarën, për shkak të prapambetjes ku e kishin lënë popullin armiqtë e tij.

Se mos donin burrat t'i trajtonin keq, se mos donin që ato të vuanin kaq shumë! Jo, kurrë! Me shpirt e me zemër ata i donin shumë, sepse gratë ishin njerëzit e tyre më të afërt, por zakonet e ulëta që kishin rrënjosur në popullin tonë pushtuesit, bejlerët dhe agallarët, kishin helmuar ndërgjegjen e njerëzve tanë.

Ne burrat duhet të përpinqemi që gratë t'i gjirojmë nga shumë punë, t'i ndihmojmë ato, sidomos në shtëpi. Fajet në këtë çështje më shumë i kanë disa burra, që janë kapadainj dhe s'u jepet të bëjnë asgjë në shtëpi. Zakonet e këqija, të trashëguara nga feudalët, kanë hyrë në ndërgjegjen tonë pa u kup-tuar, por tani, siç na mëson Partia, të përpinqemi t'i zhdukim. Kjo punë, natyrisht, nuk bëhet as me dekret, as se po ju them unë. Të gjithë jemi njerëz me kokë, që mendojmë dhe reflektojmë, dhe e kemi të qartë se nuk ka njeri që të mos dojë nënën, gruan, vajzën, motrën. Por të mos mjaftohemi me kaq, të punojmë që ato të janë aktive, t'i bëjmë të afta që vetë të luftojnë, të mbrohen në jetë, të punojnë dhe të krijojnë. Po të lejojmë që edhe tani gratë e vajzat të vazhdojnë të ndrydhen e të shtypjen nga zakonet e këqija, ato nuk mund të ecin dot përpara. Kur është nevoja për t'i këshilluar, këtë do ta bëjmë si për të gjithë, sepse nevojë për këshilla kemi të tërë. Dhe gratë i dëgjojnë me kujdes këshillat tona kur janë të drejta dhe të mira, por kur nuk janë të tillë, nuk duhen dëgjuar.

Edhë feja ka ndihmuar shumë në prapambetjen dhe në shtypjen e popullit. Feja porosit që, kur të falesh, të kthesht ftyrën nga Qabeja, nga vendi ku

lindi Muhameti, në Arabi. Ai, pra, ishte arab, kurse ne jemi shqiptarë. Atëherë përse t'i kthejmë sytë nga Arabia? Përkundrazi, sytë ne duhet t'i kemi kurdoherë nga atdheu ynë, nga Shqipëria, nga Partia. Politika grabitqare e Muhametit bëri që të krijohej një perandori e madhe arabe. Për ta mbajtur në këmbë dhe të lidhur këtë perandori të madhe ai kishte nevojë për një ideologji të tillë që do ta ndihmonte të mbante popujt e robëruar. Dhe një ideologji e tillë u bë feja islame që porosiste myslimanët, midis së tjerash, të faleshin pesë herë në ditë. Mirëpo tani, shumë shekuj pas vdekjes së Muhametit, a na lejohet neve të drejtojmë shikimin, mendjen e zemrën tonë nga Arabia dhe të rrimë e të mbajmë kot ramazan? Përse? Feja i ka nxjerrë këto norma të vetat që popujt e robëruar t'i nënshtroheshin pushtuesit arab ose, më vonë, atij otoman, që të ishin të bindur ndaj pushtuesve dhe qëllimet e të cilëve feja i zbuste e i mbulonte gjoja me një perëndi që na qenkësh e të gjithëve. Feja kërkonte që falja të bëhej në rregull, në kohën e duhur, ndryshe nuk mund të qëndronte në këmbë kjo perandori e madhe, së cilës ajo i shërbente ideologjikisht. Kjo është njëloj me «këshillën» që jepte Musolini, që shqiptarët duhej të vepronin sipas ligjeve fashiste, pse këto na ishin gjoja për të mirën e Shqipërisë. Por një «këshillë» të tillë shqiptarët nuk e pranuan kurrë. Besoj se pleqtë e Shijakut nuk do të m'i marrin për keq fjalët që thashë përfenë.

Njerëzit tanë duhet të mendojnë ca më thellë për këto çështje, të punojnë dhe të rrojnë me ndër, të mos gabojnë, të rrojnë të lirë dhe ta gëzojnë jetën,

sepse jeta është këtu mbi tokë dhe jo në qiel, siç thotë feja. Tani edhe të moshuarit e kuptojnë se të gjitha ato që thuhen për «jetën tjetër» janë vetëm gjepura.

Në të kaluarën, me dashje ose pa dashje, populli, duke qenë i paditur dhe i lënë në errësirë, i besonte këto përralla. Tani që Partia i hapi sytë, ai e kupton se feja është një pengesë e madhe në rrugën e tij të përparimit. Prandaj ne po bëjmë një kërcim të fortë përpara. Gjithë populli ynë, në punën dhe në luftën ku e udhëheq Partia, ka bërë dhe po bën hope të mëdha, prandaj ka arritur përparime të jashtëzakonshme.

Këtë që po them e shikojmë edhe këtu, te ju. Në Shijak janë ndërtuar shtëpi të reja, pallate e fabrika, është ngritur kooperativa bujqësore e, mbi të gjitha, në sajë të punës dhe të përpjekjeve tuaja dhe të udhëheqjes së drejtë të Partisë, keni ndryshuar shumë, në radhë të parë ju, njerëzit. Kjo është edhe arsyesa që keni arritur gjithë këto suksese.

Kooperativa juaj është bërë një shembull i mirë për kooperativat e tjera të rrethit të Durrësit, bile edhe për ato të të gjithë vendit tonë, sepse ju, me punën tuaj, nën udhëheqjen e organizatës-bazë të Partisë, keni ecur përpara në bujqësi, i keni bërë fushat e kopshtet tuaja çdo vit e më pjellorë, keni zhvilluar e keni arritur suksese mjaft të mira edhe në blektori, sidomos në zhvillimin e lopës. Shembulli juaj ka rëndësi të madhe për ecjen përpara të kollektivizimit në tërë vendin tonë.

Mësuesit e mëdhenj të marksizëm-leninizmit na

mësojnë se çështjet ekonomike kanë rëndësi të madhe, prandaj ato duhet t'i çojmë gjithnjë përpara, me një qartësi të madhe politike dhe ideologjike. Këtë qartësi Partia e ka rrënjosur dhe po e fut gjithnjë e më shumë në popull, prandaj ditë-ditës kemi arritur dhe po korrim suksese të reja. Pikërisht te këto qëndron siguria e sukseseve tona të ardhshme. Unë jam i bindur se duke ecur në këtë rrugë dhe duke zbatuar mirë mësimet e Partisë, do të korrni suksese të reja në bujqësi e në blektori. Këto përparime do të realizohen vetëm me punën, me mendjen dhe me zotësinë tuaj, duke qëndruar fort të bashkuar, sepse «bashkimi bën fuqinë». Bujqësia ka rezerva të mëdha, mjafton të mobilizohesh dhe t'i nxjerrësh ato.

Kooperativa juaj parashikon të marrë këtë vit 18 kuintalë grurë për hektar, por jam i bindur se pas pak kohe, ajo mund dhe do të marrë 24 kuintalë për hektar. Ju, shijakasit, keni cilësi të mira. Këtë nuk jua them për t'ju bërë qejfin. Gabojnë ata që thonë se në Shijak ka fanatizëm. Mund të ketë ndonjë fanatik aty-këtu, por është fakt se gjersa ju po bëni hapa të mëdhenj përpara në çdo drejtim, kjo do të thotë se këtu sundon fryma përparimtare. Ne shohim se ju ndiqni me kujdes mënyrat e përparuara të punës e të jetës shoqërore të përbashkët dhe e keni bërë ekonominë tuaj një nga kooperativat më të mira e më të mëdha të rrëthit të Durrësit dhe të të gjithë vendit tonë.

Kongresi i 5-të na mëson që cilido nga ne ta kryejë mirë detyrën, nën kontrollin e popullit, i cili të ketë guxim e ta thotë fjalën e vet, kur sheh se

dikush gabon, të kritikojë pa u druajtur cilindo. Është një gjë shumë e mirë që secili të thotë mendimin e vet që kjo ose ajo punë të bëhet kështu ose ashtu, ndryshe njerëzit do të ndryshken. Ka njerëz që e kanë vështirë të flasin, pse ka ndodhur që disa drejtues hakmerren, por dijeni se ata që hakmerren nuk janë njerëz të mirë. Kritika, edhe sikur të mos jetë qind për qind e drejtë, përsëri sjell fitime, por kur del se ndonjëri hakmerret ndaj atij që e kritikoi, me këtë ai shfaq mbeturinat që ka në ndërgjegjen e vet, ndaj duhet edukuar që t'i zhdukë ato. Kurse populli, kur sheh se ai që flet ka qëllime armiqësore, i tregon vendin.

Populli i ka zgjedhur udhëheqësit jo për të sunduar, por për të realizuar vijën e Partisë dhe interesat e tij. Po nuk e ndoqe me besnikëri këtë vijë, atëherë qorollisesh. Me tapi asnjeri nuk e ka marrë atë vend që i është besuar sot, sepse asnjeri nuk është me yll në ballë. Kush ka fituar ca dituri dhe zotësi, të mos mendojë se ka zënë qiellin me dorë, se ato nuk janë asgjë përpëra diturisë dhe zotësisë së popullit. Prandaj, kurkujt të mos i ngrihet mendja se është i zoti, por të mendojë se është shumë i vogël përpëra forcës së madhe të popullit. Kështu na mëson Partia, ndryshe nuk mund të ketë liri, demokraci e socializëm. Partia e mëson popullin të shohë kush punon drejt dhe kush gabon. Atë që punon drejt e ndershmërisht, Partia e ndihmon dhe e inkurajon, atij që punon shtrembër, i heq veshin një herë, dy, pastaj, në qoftë se nuk korrigjohet, e dënon. Kush cenon interesat e popullit, kritikohet, po kur gabimi

përsëritet, është i rëndë dhe kthehet në faj, ai njeri duhet dënuar.

Partia jonë rrugën e ka të drejtë dhe gjithçka e bën vetëm për popullin, pa të cilin ajo nuk rron dot. Edhe populli nuk rron dot pa Partinë, ndryshe do të hallakateshin forcat e tij. Prandaj të kemi gjithnjë parasysh se është e domosdoshme që populli dhe Partia të jenë kurdoherë të bashkuar, të ecin kurdoherë me guxim përpara, pa u trembur nga vështirësitë dhe pengesat.

Ju keni arritur rezultate të mira në kooperativën tuaj. Shoku Qazim Toptaga<sup>1</sup> na ka folur për to, po mos u kënaqni me çka keni arritur, punoni akoma që t'i shton më tej rendimentet, të merrni më shumë prodhime. Mundësi keni shumë dhe, në këtë drejtim, jeni vënë në garë me Ndërmarrjen Bujqësore të Sukthit. Meqenëse keni kushte të njëllojta, luftoni të arrini rendimentet që merr ajo. Unë mendoj që ju do t'i tejkaloni ato të ndërmarrjes bujqësore, sepse i keni mundësitë, mbasi jeni njerëz punëtorë e përparimtarë. Këtej e tutje do të ndihmoheni edhe me plehra kimike, azotike dhe fosfatike, pasi tani që të dyja uzinat tonë të reja kanë filluar nga puna. Kështu do t'ju shtohet një tjetër faktor i madh për rritjen e rendimenteve.

Jam i bindur se, kur të vij një herë tjetër në Shijak, do të shikoj ndryshime edhe më të mëdha, në radhë të parë te njerëzit, në jetën tuaj, në ngritjen e ekonomisë e të mirëqenies suaj.

---

<sup>1</sup> Në atë kohë kryetar i kooperativës bujqësore të Shijakut.

Ju uroj punë të mbarë, suksese gjithnjë më të mëdha, shëndet dhe jetë të lumtur.

Rroftë Partia e Punës!

Rroftë rinia!

Rroftë populli i Shijakut!

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim që gjenden në AQP*

## **PROBLEMET E ORGANEVË TË PUNËVE TË BRENDSHME NUK QËNDROJNË JASHTË DREJTIMIT E KONTROLLIT TË PARTISË**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**23 shkurt 1987**

*Pasi bëri disa vërejtje për materialet e paraqitura dhe tërroqi vëmendjen se si duhet të trajtohen çështjet në forumet udhëheqëse të Partisë, shoku Enver Hoxha tha:*

Në çdo rrëth Partia ka punuar mirë në organet e punëve të brendshme, por që të forcohet akoma më shumë puna e saj, shokët drejtues të Partisë në rrëth dhe ata që punojnë në organet e punëve të brendshme duhet të kuptojnë thellë disa çështje:

1. Problemet e organeve të punëve të brendshme nuk janë të huaja për Partinë dhe nuk qëndrojnë jashtë drejtimit dhe kontrollit të Partisë. Në përgji-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rrëth raporteve të paraqitura nga komitetet e Partisë të disa rrëtheve për punën ideologjike e politike të Partisë në organet e punëve të brendshme dhe të kufirit.

thësi kjo kuptohet dhe zbatohet drejt, por në praktikë ka shokë që mendojnë dhe veprojnë sikur kjo të ishte një punë «specifike» dhe e mbyllur, që qëndron jashtë drejtimit e kontrollit të Partisë. Ky mendim duhet flakur tej.

Ministria e Punëve të Brendshme dhe organet e saj veprojnë në bazë të direktivave dhe vendimeve që merr Partia për këtë sektor, të cilat duhet t'i njoħe edhe udhëheqja e Partisë në rreth, pérndryshe, ajo nuk ka si i kontrollon dhe si i ndihmon organet e punëve të brendshme. Udhëheqja e Partisë në rreth duhet të kontrollojë dhe të orientojë politikën e goditjes në veprimtarinë e organeve të punëve të brendshme, prandaj as asaj dhe as këtyre organeve nuk u lejohet t'i shmangen kësaj pune, ndryshe do të bien në gabime të rënda vije. Kjo nuk do të thotë që udhëheqja e Partisë në rreth të futet në hollësira të anës profesionale e proceduriale të veprimtarisë së tyre, por, edhe për këto gjëra, njerëzit e organeve të punëve të brendshme nuk mund të veprojnë jashtë kontrollit të Partisë, jashtë ligjeve dhe direktivave të caktuara. Ata për këto çështje vënë në korent, sipas rasteve, sekretarin e parë ose sekretarët e komitetit të Partisë të rrethit dhe, tok me ta, vendosin përmarrjen e masave të nevojshme. Kështu edhe detyrat kryhen, edhe kontrolli e drejtimi i Partisë realizohen.

Në këtë çështje duhet të arrihet një kuptim i thellë i problemit, si nga njerëzit e Partisë, të cilët, ndonjëherë, duke menduar se çështjet e organeve të punëve të brendshme janë speciale, nuk u futen si

duhet e nuk interesohen për to, ashtu edhe nga një-rëzit që punojnë në këto organe, që mund të krijojnë mendimin se ata mund të veprojnë jashtë kontrollit të Partisë, ose ta kuptojnë këtë kontroll në mënyrë të përciptë dhe gjysmake dhe që, në fund të fundit, kataniset në varësi dhe kontroll vetëm shtetëror.

Këto mendime janë të gabuara. Punonjësit e Sigurimit të Shtetit, të Policisë e të tjera janë, në radhë të parë, punëtorë partie, punëtorë politikë. Në qoftë se ndonjëri e harron këtë për një çast, ai nuk bën të jetë punonjës i organeve të punëve të brendshme. Të gjithë punonjësit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të degëve të punëve të brendshme dhe të kufirit duhet të kenë virtytet më të mira të komunistëve, ta kenë të qartë vijën e Partisë, të vënë politikën në plan të parë dhe të kuptojnë se puna e tyre është, në radhë të parë, punë politike. Ata përbëjnë një pjesë të organeve të diktaturës së proletariatit, janë drejtpërdrejt në luftë me armiqtë e klasës, të Partisë dhe të popullit, ata zhvillojnë pandërprerë luftën e klasave. Pra, nuk duhet për asnjë moment që ata të konsiderohen si një repart «teknik». Përkundrazi, ky është një repart politik me cilësi të lartë, që zbaton me përpikëri vijën e Partisë në të gjitha shfaqjet. Normalt e jetës së Partisë duhet të kuptohen thellë dhe të zbatohen me përpikëri veçanërisht nga këto organe, ku disiplina e hekurt, konspiracioni i shëndoshë, viaja e masave, mbështetja dhe kontrolli i masave përbëjnë kockën e të gjitha vepprimeve.

2. Duke e shikuar çështjen që diskutojmë në këtë

prizëm, duhet të vendosim kudo marrëdhënie më të drejta pune në mes udhëheqjes së Partisë në rrëth dhe organeve të punëve të brendshme, si dhe në mes këtyre të fundit dhe komitetit ekzekutiv. Nuk duhet të shkohet me mendimin se, duke e pasur kryetarin e degës së punëve të brendshme anëtar të byrosë së komitetit të Partisë ose duke menduar se në degët e punëve të brendshme kemi, si kudo gjetkë, organizata partie, këto në vetvete janë të mjaftueshme dhe nuk del nevoja të interesohemi shumë kolegialisht për këtë sektor kaq të rëndësishëm. Sektorëve të tjerë ne u qepemi që të gjithë dhe vazhdimisht, kurse sektorin e punëve të brendshme, që ka po aq nevojë, në mos më shumë, sepse puna atje është edhe më delikate, ndonjëherë e lëmë rehat, saqë në vitin 1966, siç thotë sekretari i Komitetit të Partisë të Rrethit të Vlorës, nuk është analizuar asnjë problem i punës së Partisë së këtij sektori në këtë rrëth.

Veprimitaria e Partisë në degët e punëve të brendshme dhe të kufirit duhet të kontrollohet dhe të ndihmohet medoemos, pa asnjë hezitim, me të deleguar të komitetit të Partisë, të cilët të jenë njerëz seriozë, shokë që të observojnë si zbatohen normat që përmenda më lart nga punonjësit e Partisë që punojnë në këto organe. A do të flitet konkretisht për të metat dhe gabimet në punë të punonjësve të këtij sektori në mënyrë që të përmirësohet puna dhe të edukohen më tej komunistët dhe punonjësit e tij? Po, sigurisht, do të flitet, bile hapur. Njerëzit e Sigurimit dhe të sektorëve të tjerë të degëve të punëve

të brendshme, ashtu sikurse të gjithë të tjerët, duhet të zbatojnë njëlloj normat e Partisë. Ata, gjithashtu, duhet të jenë edhe nën kontrollin e masave, t'u japid llogari atyre si njerëz politikë që janë, se luftët kundër armikut do ta bëjnë me masat dhe në gjirin e tyre. Prandaj ata nuk mund të qëndrojnë larg masës. Po i qëndrove afër, po punove me të, masa të sheh dhe të kuption kur punon mirë e kur punon keq. Po t'i fshehësh gabimet, ajo nuk të do, nuk të ndjek e, më në fund, edhe të urren.

Nga raportet që studiuam del se ashtu si në organizatat e Partisë të sektorëve të tjerë, edhe në organizatat e Partisë të degëve të punëve të brendshme ka të meta në punë, që rrjedhin nga të metat e komunistëve. Këto të meta duhet t'i spastrojmë kudo me fshesë të madhe dhe, bile, te komunistët e te punonjësit e degëve të punëve të brendshme, ky spastrim duhet bërë më rrënjosor dhe më parë sesa në sektorë të tjerë.

Në këto organe edukimi klasor duhet të jetë në plan të parë, sepse, **së pari**, ato janë reparte politike, organe të diktaturës së proletariatit dhe, së dyti, për arsy se veset e këqija tek ata që punojnë në këtë sektor mund të lindin më lehtë nga abuzimi me kompetencat që u kanë dhënë Partia dhe pushteti. Abuzimet e ndonjë punonjësi të organeve të punëve të brendshme mund të sjellin gjëra të këqija për ne dhe të zhvillojnë tek ai arrogancën, fodullëkun, familjaritetin etj.

Për familjaritetin që ekziston në disa raste midis punonjësve të organeve të punëve të brendshme

kemi sinjalizuar edhe herë të tjera, por për ta luf-  
tuar atë si duhet dhe me një punë të thellë politike  
e ideologjike është e domosdoshme të gjenden shka-  
qet. Një nga këto shkaqe duhet ta gjejmë te «shpir-  
ti i repartit», te mendimi jo i drejtë se organet e  
punëve të brendshme janë «një repart special», «i  
mbyllur», tek ideja se ata që punojnë në Ministrinë  
e Punëve të Brendshme dhe në organet e saj vartëse  
janë «njerëzit më të mirë, që s'bëjnë gabime, por,  
edhe kur bëjnë, prapë janë të mirë, atyre çdo gjë  
mund t'u falet» e të tjera mendime të tilla të ga-  
buara.

Burokratizmi në Ministrinë e Punëve të Brend-  
shme, si në çdo sektor, është një gjë e rrezikshme,  
por këtu ai është edhe specifik, sepse ekzistojnë disa  
forma speciale pune që mund të krijojnë koncepte  
të veçanta burokratike te njerëzit e këtij sektori. Për-  
veç formave të veçanta, burokratizmi në këtë sektor  
shfaqet edhe në format e zakonshme të rutinës buro-  
kratike, sikurse edhe në sektorët e tjerë. Pra, për  
të luftuar me sukses burokratizmin, punonjësit e kë-  
tij sektori duhet t'u bëjnë vetë një analizë të thellë  
me fryshtë revolucionare stilit e metodës së punës së  
tyre, anës teknike, organizative, si dhe koncepteve të  
veçanta që mund të lindin në punë e sipër.

Pra, edukimi në këto organe merr një rëndësi të  
madhe dhe të veçantë për vetë karakterin e tyre. Që  
të bëhet sa më mirë ky edukim duhen flakur referatet  
e përgjithshme, të shpëlara dhe duhet të jemi shumë  
kërkues jo vetëm ndaj atij që referon, por edhe ndaj  
atyre që dëgjojnë. Është e domosdoshme që komu-

nistët e organeve të punëve të brendshme të bëjnë një hop cilësor përpëra në punën për edukimin klasor të tyre, të rinisë dhe të masës. Siç po shoh nga raportet, ju, shokë të organeve të punëve të brendshme, nuk u vini si duhet dhe sa duhet rëndësi organizatave të rinisë, veçanërisht në repartet e kufirit, ku kemi të rinj me shumicë. Prandaj ju duhet të ndërroni stilin e punës me rininë.

Puna edukative me punonjësit duhet bërë e diferencuar dhe e lidhur ngushtë me praktikën, me detyrat. Kjo duhet pasur parasysh vazhdimisht që të mos merremi me formula të zbrazëta, por të flasim konkretisht. Kështu do ta kuptojnë më mirë njerëzit dhe, në radhë të parë, punonjësit e organeve të punëve të brendshme luftën që zhvillohet tani kundër burokratizmit dhe shfaqjeve të tjera të huaja, që ata të mos mjaftohen me sa është bërë deri tani. Me punonjësit e Sigurimit dhe të kufirit është mirë që të ndërtohen disa forma pune edukative të veçanta, duke ua ilustruar çështjet me fakte konkrete dhe shumë kuptimdhënëse nga puna e tyre. Natyrisht, për ta bërë këtë gjë kërkohet një punë serioze. Ata që merren me punën edukative, pasi të studiojnë mirë veprat e Leninit, të Stalinit dhe dokumentet e Partisë sonë, të cilat duhet t'i kenë vazhdimisht mbi tavolinë, kur përgatitin referatin, çdo ide duhet ta ilustrojnë me fakte, me shembuj, pra, teorinë dhe konkluzionet t'i shoqërojnë me eksperiencën e madhe të Partisë sonë. Po si mund të bëhet kjo? Punonjësit e aparatit të komitetit të Partisë, që merren posaçërisht me edukimin, duhet t'i njohin mirë veprat e klasikëve dhe

të Partisë sonë, që, kur t'u kërkojnë, për shembull, një material për çështjet e disiplinës shtetërore, të dinë që në fillim, bile edhe me faqe, se ku flet Lenini ose Stalini për këtë problem. Po kështu, edhe punonjësit e sektorit të edukimit. Mendoj që për shfrytëzimin sa më të mirë të literaturës është e nevojshme të japim edhe disa udhëzime se si të studiohen dokumentet. Duhet të ketë kuadro që të ndihmojnë deri kabinetet e Partisë për këtë punë. Kështu bëhet një punë e organizuar, njerëzve u nxitet vullneti për të studiuar, mësojnë si t'i shfrytëzojnë materialet dhe si t'i përdorin ato.

E dimë që praktika ka rëndësi të madhe, por nganjëherë nuk u vëmë rëndësi fakteve e ngjarjeve dhe nuk bëjmë përgjithësime për të arritur në konkluzione. Të marrim çështjen e emancipimit të gruas, problem ky shumë i rëndësishëm shoqëror. Megjithëse kishte raste që vajzat dhe gratë shiteshin e bliheshin me para dhe trajtoheshin keq, këto fenomene negative paraqiteshin si diçka e thjeshtë; thuhej se filani martoi vajzën me pahir, tjetri e fejoi të mitur etj., por nuk trajtohej çlirimi i grave e i vajzave tonë si një problem i madh shoqëror.

Tani ka shpërthyer një lëvizje masive për emancipimin e gruas. Si trimëresha po ngrihen në luftë kundër të vjetrës gratë e Shalës dhe të Shoshit në malësinë e Veriut. Situata ishte më shumë se e pjekur për shpërthimin e një lëvizjeje të tillë, prandaj vetëm një shkëndijë u desh që të merrte zjarr kjo punë.

Po si do të vazhdojë kjo lëvizje? Në qoftë se nuk

i bëjmë seriozisht analizat e punës politike dhe edukative, ekziston rreziku që ajo të mbarojë si zjarr kashte. Këto analiza në asnjë mënyrë s'duhen bërë jashtë normave të Partisë ose vetëm nga ne, se pastaj do të na krijohen situata të tressikshme. Po nuk e bëmë çdo gjë me mend, do të na dalin vështirësi, se këto masa që merr Partia nuk do t'i kuptojnë menjëherë të gjithë burrat, se nuk do ta kuptojnë të gjithë si duhet lirinë e gruas. Bile mund të krijohet njëfarë armiqësie nga ana e burrave për gratë, jo në kuptimin që këta tani të ndahen nga njëri-tjetri, po në konceptet e tyre. Kjo që po ndodh te ne nuk është një fenomen spontan, por një lëvizje shumë e thellë, është një revolucion. Tani malësori ynë ndërron konceptin, kalon nga një botëkuptim i prapambetur drejt një botëkuptimi të përparuar, gjë që nuk bëhet lehtë. Prandaj t'ia shpjegojmë masës këto gjëra dhe të mos mendohet se kjo punë pas fjalimit<sup>1</sup> të Enverit ka marrë rrugë përfundimisht.

E njëjta gjë duhet thënë edhe për luftën që zhvillohet kundër fesë. Në qoftë se komunistët dhe masat nuk sqarohen politikisht dhe ideologjikisht për dëmin e fesë, kjo nuk mund të luftohet gjer në fund. Në një mbledhje që bënë klerikët e rrethit të Peshkopisë, rreth 40 hoxhallarë e shehlerë, njëri tha që xha-

1 Fjala e mbajtur në mbledhjen e përbashkët të disa organizatave-bazë të Partisë më 6 shkurt 1967, ku shoku Enver ngriti me forcë domosdoshmërinë e luftës kundër zakoneve prapanike dhe të mbrojtjes së të drejtave të grave dhe të vajzave. (Shih në këtë vëllim f. 1.)

minë t'ia japim ta përdorë populli për nevojat e tij, tjetri hoqi çallmën etj. Ata më kanë dërguar edhe një letër, përgjigjen e së cilës e kam përgatitur dhe mendoj t'ua dërgoj. Në këtë përgjigje atyre u them afërsisht se kjo që bëni ju nderon, se është një hap patriotik etj., megjithatë ne jemi realistë dhe e dimë që do të ketë njerëz që nuk do t'u pëlqejnë këto qëndrime, por u theksoj se masa dhe komunistët e kuptojnë vijën e Partisë për këtë çështje, prandaj shumica është me ju dhe e mbështet iniciativën tuaj. Pastaj më poshtë u them që do të ketë akoma njerëz, bile edhe patriotë të flaktë, që do t'i ruajnë për një kohë në ndërgjegjen e tyre besimet fetare, se kjo është një çështje botëkuptimi; prandaj Partia, si doktori i mirë, të bëjë të gjitha përpjekjet për të shëruar të sëmurët kurdoherë me rrugë bindjeje dhe asnjëherë ofenduese.

Punën ateiste e kemi më të lehtë me besimtarët myslimanë, sesa me besimtarët ortodoksë e katolikë, se kisha ka të tjera koncepte. Për besimtarin mysliman nuk ka rëndësi xhamia, se ai falet edhe në mes të rrugës, edhe në mal, pra, kudo që ta zërë namazi. I tillë është koncepti i dogmës së tyre, kurse ortodoxi, që të falet, sipas dogmës kristiane, duhet të vejë medoemos në kishë, gjë që e bën më të vështirë punën ateiste me ta.

Zhvillimi me sukses i luftës kundër besimeve fetare kërkon që të jemi të kujdeshëm, se kemi të bëjmë me ndjenjat e popullit, i cili, në një mënyrë ose në një tjetër, është lidhur me institucionet fetare, që vepronin tek ai si krimbi në pemë. 40 klerikë my-

slimanë kishte Peshkopia, 40 propagandistë fetarë, me një fjalë kishte 40 shefa të kulturës islame dhe 20-30 xhami si vatra të kësaj kulture. Natyrisht, kjo është një forcë e mjeruar, megjithatë ajo ekziston dhe i mban gjallë zakonet fetare.

Të jemi realistë dhe gjérat t'i masim kurdoherë politikisht. Për çdo hap, që bëhet në luftën kundër fesë, të merret aprovimi i popullit dhe të mos cenohen në asnje mënyrë ndjenjat e tij. Ka nëna e baballarë që nuk venë në xhami apo në kishë, megjithatë vazhdojnë të thonë «shyqyr zotit» se kjo shprehje u është rrënjosur që kur kanë lindur.

Lufta që jemi duke bërë, të gjitha masat që po merren janë një hap i madh cilësor i bazuar në eksperiencën e madhe të Partisë, në punën e madhe që ka bërë gjer më sot Partia. Ne po i përgjithësojmë mendimet dhe iniciativat e shumta që lindin nga masat dhe është pozitive që ato i përkrah jo vetëm Partia, po edhe populli. Kudo ka një ngritje të madhe në këtë lëvizje, të cilën duhet ta përkrahim që të ecë përpara. Këtë përkrahje nuk duhet ta neglizhojmë, duke thënë se ka entuziazëm të madh dhe çdo gjë do të ecë vetë, se vërtet ka entuziazëm, por duhet që edhe ne ta forcojmë punën për t'i quarmë tej atë dhe vrullin që ka shpërthyer, për t'i lidhur ato edhe me realizimin e planit. Të mos i harrojmë dhe as të mos i errësojmë këto gjëra gjatë punës, por të reflektojmë mirë, që të mos i bëjmë me fushata. Çështjet politike, ideologjike t'i bëjmë probleme të masave, të popullit. Të gjitha këto duhet të reflektohen sa më mirë në organet tona të

shtypit, por që të bëhet si duhet kjo punë, kërkohet një mjeshtëri jashtëzakonisht e madhe.

Kryesore është që të bëjmë më shumë përpjekje për t'i dhënë një hov cilësor edukimit të komunistëve, të punonjësve dhe të rinisë. Unë kam bindjen se organizatat e Partisë në organet e punëve të brendshme do të janë në pararojë, se ato janë të forta, monolite, me anëtarë partie besnikë dhe të sprovuar, por që asnjëherë nuk duhet të mbyllin sytë përpara të metave që shfaqen në punën dhe në njerëzit.

*Botuar për herë të parë me shkurtimi në librin: «PPSH për Organet e Punëve të Brendshme», vëll. 1, f. 535*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## TE PERMIRESOJME PUNEN ME KUADRIN DHE PRANIMET NE PARTI

*Diskutim ne mbledhjen e Sekretariatit  
te KQ te PPSH<sup>1</sup>*

23 shkurt 1967

Edhe unë jam dakord me raportin e paraqitur. Ai përmban mendime dhe konkluzione të drejta, të cilat ne duhet t'i shohim si po realizohen në praktikë dhe të ndihmojmë që ato të zbatohen mirë. Do të them vetëm pak fjalë për dy çështje që lidhen me problemin që shqyrtojmë.

Orientimet mbi emërimet dhe qarkullimin e kuadrove duhet t'i vëmë mirë në jetë, duke u larguar nga metoda burokratike. Ndodh që, për emërimin dhe lëvizjen e kuadrove paraqiten biografitë e tyre të shkurtra sipas nomenklaturës dhe, mbi bazën e tyre, vendoset për to. Një praktikë e tillë ka krijuar te shumë kuadro konceptin jo të drejtë që emërimi i tyre varet vetëm nga organet e nomenklaturës. Natyrisht,

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi disa probleme të punës me kuadrin për vitin 1966».

emërimi i kuadrove nuk është bërë arbitrarisht, sepse janë mbajtur parasysh meritat që kanë pasur dhe kanë njerëzit dhe pikërisht se kanë këto merita janë vendosur në vendet ku është menduar dhe ku i kanë dhënë më tepër ndërtimit të socializmit. Në punët ku janë caktuar shumica e kuadrove tanë kanë bërë përparime, kanë fituar eksperiencë, kanë kryer, kush më shumë e kush më pak, edhe shkollë. Megjithatë, shpesh, kuadrot i kanë shpëtuar kontrollit të masave. Kjo është një çështje me shumë rëndësi që duhet ta praktikojmë më mirë në të ardhmen.

Partia, ashtu siç bën dhe do të vazhdojë ta bëjë kurdoherë politikën e kuadrit, duhet të drejtojë e të kontrollojë edhe zbatimin e orientimeve mbi qarkullimin e kuadrit. Ka edhe kuadro që nisen nga mendimi i gabuar se kanë lindur dhe do të vazhdojnë kurdoherë në përgjegjësinë që u është ngarkuar më parë. Edhe po t'i lëvizësh, për arsyen të shëndosha, këta njerëz bëhen të pakënaqur. Një koncept dhe qëndrim i tillë e ka burimin në faktin se nuk është zhvilluar mirë dhe si duhet kontrolli i masës mbi të gjithë kuadrot, qofshin drejtore, sekretarë partie, shefa llogarie etj. Pra, te këta kuadro, që i kanë shpëtuar kritikës, me kohë është krijuar pikëpamja e gabuar se ata nuk duhet të ulen në përgjegjësi, pasi këtë e quajnë cениm të autoritetit, prandaj, në fakt, bëjnë çmos që të mos lëvizin nga posti që kanë.

Tani, në qoftë se fillojmë t'i shkarkojmë ose t'i qarkullojmë, pa zhvilluar si duhet një punë sqauese, që ata ta kuptojnë drejt realitetin e krijuar, pra, pa përgatitur më parë terrenin, do të krijonim

pakënaqësi. Prandaj, më parë, duhet shkatërruar mentaliteti i gabuar që përmenda e që është krijuar te disa nga kuadrot tanë. Këtyre u duhet bërë e qartë se nuk është e thënë që, medoemos, gjersa të dalin në pension, duhet të mbeten drejtues. Ky koncept nuk është i drejtë, se nuk janë vetëm meritat e së kaluarës por, në radhë të parë, është puna që bën aktualisht secili, janë përpjekjet dhe rezultatet e kuadrit në punë, është qëndrimi i tij konsekuent që përcaktojnë nëse ky ose ai duhet të vazhdojë të punojë në vendin ku është caktuar apo duhet hequr andej.

Ne duhet të luftojmë për të rrënjosur te njerëzit e zyrave dhe te drejtuesit konceptin e ri, pikëpamjen e drejtë që vetëm me punë ata do ta meritojnë detyrën ku janë caktuar dhe se punën e tyre nuk do ta vlerësojë vetëm udhëheqja, organi që e ka në nomenklaturë, por edhe organizata e Partisë, bile edhe masa. Në këtë mënyrë do të evitohen gjykimet subjektiviste për kuadrin, të lindura në rrugë personale, do të zhduken qëndrimet sektare, hatëret, pikëpamjet për vlerësimin e njëanshëm të kuadrit, vetëm mbi bazën e pjesëmarrjes së tij në luftën për çlirimin e vendit etj., etj. Partia askujt nuk ia mohon pjesëmarrjen në luftë, por, në qoftë se ai që ka luftuar dhe sot nuk zbaton si duhet vijën e Partisë, bëhet shembull i keq, atëherë, ajo ka të drejtë të kërkojë mbledhjen e organizatës-bazë, e, kur është nevoja, edhe të kolektivit, që të gjykojë për veprimet e tij.

Duhen luftuar konceptet e vjetra dhe duhet rrënjosur te të gjithë koncepti i drejtë që emërimi ose shkarkimi i kuadrit varet kryesisht nga qëndrimet

dhe puna e tij, jo vetëm dje, por edhe sot. Por edhe mendimin e masës duhet ta kemi parasysh në këtë çështje. Masa mund ta kritikojë e të kërkojë shkarkimin e një drejtori dhe, me argumente, të propozojë në vend të tij një tjetër që punon më mirë, pastaj çështjen le ta shikojë organi përkatës, që e ka në nomenklaturë. Propozimet për emërimin, transferimin, shkarkimin e kuadrove të mos i bëjmë nga zyra, por pasi të ndiqet kuadri në punë e të merret edhe mendimi i organizatës-bazë të Partisë e i kolektivit punonjës, sepse mund të ketë vërejtje për kuadrin.

Kështu, në këtë fryshtë, duhet të veprojmë për kuadrin. Kjo nuk do të thotë të mos kemi plane perspektive për ngritje të kuadrove në përgjegjësi dhe për përgatitjen e aftësimin e tyre, por, mendoj, ta vëmë në zbatim këtë praktikë se është rruga më e mirë. Përse të mos ia shtrojmë për gjykim masës, për shembull, emërimin e një llogaritari, të një drejtori etj.? Një praktikë e tillë është në rrugën marksiste-leniniste dhe në përputhje me mësimet e Komunës së Parisit, ku të gjithë funksionarët ishin të zgjedhur nga masa.

Po ta bëjmë qarkullimin e kuadrit në mënyrë burokratike dhe pa e menduar mirë, mund të na krijohet edhe rreziku i ndarjes së kuadrove në të rinj e në të vjetër, në burra e në gra. Pse u mblo-dhën mënjanë në dhomën e një fabrike në Durrës 15 burra dhe folën keq për gratë që ishin ngritur në përgjegjësi? Kjo, natyrisht, është vërtet një rast, por megjithatë tregon për konceptet e tyre të gabuara, të cilat i ushqen edhe metoda burokratike që përdoret

në disa raste në emërimin e kuadrove. Këtë duhet ta kemi parasysh për të gjetur një metodë të përshtatshme, masovike, që njerëz me pikëpamje të tilla të mos kenë mundësi të bëjnë nga këto gjëra. Në qoftë se ndonjëri në mbledhje të kolektivit do të ngrihet dhe do të pyesë, pse të vendoset kjo vajzë e re në këtë ose atë vend, kolektivi, që e do dhe e ka propozuar vetë atë, do të dijë t'i japë përgjigje. Edhe kur duhet ulur dikush nga përgjegjësia, se nuk ka punuar mirë, prapë kolektivi duhet t'i nlohë të metat e tij dhe të gjykojë për të. Nuk është e drejtë të veprohet, siç bëhet në disa raste, që një kuadër shkarkohet nga detyra pa qenë kritikuar asnjëherë më parë dhe në vend të tij vihet një tjetër. Për të mos ndodhur kjo dhe për ta pasur të gjithë të qartë pse bëhet ndryshimi, drejtuesi që nuk punon mirë të thirret dhe t'i numërohen një për një të tëra ato që ka bërë dhe mund të pyetet edhe masa nëse e do ta mbajë akoma këtë njeri në krye apo jo. Po të veprohet kështu, atëherë askush nuk do të flasë dhe nuk ka për ta kundërshtuar largimin e tij.

Qarkullimin ta zbatojmë në bazë të orientimeve të Partisë, e cila duhet të jetë vigjilente ndaj kuadrit, të dëgjojë zërin e masës dhe çdo vërejtje të saj për kuadrot, ta mbështetë kuadrin e mirë dhe të mbajë qëndrim ndaj atij që nuk i kryen detyrat. Kur them të dëgjohet zëri i masës, nuk do të thotë të dëgjohet vetëm fjala e dy-tre vetave, që mund edhe të mos diskutojnë drejt në kolektiv. Të mos mbështetemi në marrjen e vendimeve tek ato që mund të thonë dy-tre veta llafazanë, se, po të vepronim kështu, nuk do të bënimi mirë. Masa nuk përbëhet nga

një ose nga dy njerëz, prandaj të krijojmë kushte që, në këto raste, të flasin të tërë.

Problemi tjetër që doja të prekja është ai i pranimit të komunistëve të rinj në Parti. Komitetet e Partisë të kenë kujdes që në Parti të futen elementët me të vërtetë më revolucionarë, ata që dallohen në këto momente. Njerëzit që dallohen në këtë luftë të madhe që po bën Partia duhen pranuar në Parti, por kjo të mos bëhet në mënyrë mekanike, se, po të mos jemi vigjilentë në këtë çështje, do ta dëmtojmë punën e Partisë. Edhe sot ka disa anëtarë që nuk e meritojnë të jenë në Parti, bile, ka edhe disa komunistë të vjetër që luten të lihen edhe disa muaj si fshatarë individualë dhe të mos futen në kooperativë. Ç'e do një komunist të tillë, që mund të ketë marrë pjesë edhe në luftë? Për numër? Të tillë njerëz pengojnë edhe futjen e elementëve të rinj në Parti. Këta komunistë në asnjë mënyrë nuk duhen lejuar të vazhdojnë të na pengojnë në forcimin e Partisë.

Çështjen e pranimeve në Parti nuk duhet ta shohim në mënyrë burokratike, me përqindje. Në qoftë se të katër komunistët, fjala vjen, që përbëjnë prej kohësh një organizatë-bazë partie, pengojnë pranimin e anëtarëve të tjerë të rinj, duhet t'i mbledhim, t'i shkundim, me qëllim që më të mirët e kolektivit, njerëzit më revolucionarë, besnikë të Partisë dhe energjikë të futen në Parti që t'ua prishin ca qetësinë. Pranimi i anëtarëve të rinj në organizatë do të bëjë që këta katër komunistë ose të ecin përpara, ose të shikohet qenia e tyre në Parti.

Çështjen e pranimeve të mos e lëmë asnjëherë pas dore, se ka të bëjë me jetën e Partisë. Në momente revolucionare, si këto të tanishmet, dalin njërëz që shquajnë, që janë në pararojë. Ne, si udhëheqje, duhet t'i kemi parasysh dhe të punojmë që të tillë njerëz të mbushin radhët e Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

# **DISA PROBLEME PËR KOOPERATIVAT BUJQËSORE TË ZONAVE MALORE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**24 shkurt 1967**

Krijimi i kooperativave bujqësore ka një kuptim të madh politik jo vetëm në përgjithësi, por edhe në veçanti për çdo kooperativist, i cili duhet të kuptojë thellë se, duke u futur në kooperativë, ndërron mënyrën e jetesës, formën e ekonomisë, ndërron, pra, botëkuptimin e mëparshëm për pronën, për punën, ndryshon mënyrën e të menduarit dhe të të jetuarit. Natyrisht, kjo kthesë nuk bëhet menjëherë dhe as me një punë të përciptë në parashtrimin e parimeve teorike. Rrënjosja e botëkuptimit të shëndoshë bëhet me një punë të vazhdueshme politike dhe ideologjike,

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga komitetet e Partisë të rretheve Kukës, Peshkopi e Librazhd për zbatimin e orientimit të Kongresit të 5-të të PPSH lidhur me kolektivizimin e bujqësisë në fshatrat e zonave malore dhe masat për forcimin ekonomiko-organizativ të kooperativave të reja.

duke i lidhur në çdo rast parimet me jetën ekonomike të kooperativistëve.

Të marrim çështjen e kredisë që shteti u jep kooperativave bujqësore dhe të kësteve që kooperativa duhet t'u paguajë me to fshatarëve për kafshët e kooperuara. Mua më duket se kjo çështje nuk kuptohet drejt politikisht, dhe po nuk u kuptua kështu, masat konkrete ekonomike nuk mund të janë të drejta dhe nuk do të kenë rrjedhime të mira.

Kur fshatari hyn në kooperativë, ai duhet ta konsiderojë të gjithë pasurinë e kolektivizuar pronë të përbashkët. Këtë pronë fshatarëve nuk ua dhanë të tjerët, ajo është krijuar nga pasuria e tyre personale. Tani ata, të organizuar në kooperativë, duhet të punojnë në mënyrë të tillë që kjo pronë kolektive të zhvillohet sa më shumë, prodhimi të jetë pa krahasim më i madh se në të kaluarën, kur prona ishte private. Që të arrihet kjo është e nevojshme që në kooperativat e reja të përcaktohen që në fillim, saktë e drejt, masat e format e organizimit, të shpërblimit, marrëdhëniet e kooperativës me shtetin dhe me anëtarët e saj. Disa thonë se format e shpërblimit të punës, oborret e shumë çështje të tjera i kanë të qarta, por nuk kanë të qartë çështjen e shpërblimit të kooperativistëve për pasurinë e kolektivizuar. «Po të jetë e mundur, thonë ata, të gjitha ç'kanë kooperuar, përveç tokës, t'u paguhen kooperativistëve menjëherë». Po kush do t'ua paguajë këto, kooperativa? Ajo tani për tani s'ka mundësi ta bëjë këtë. Mjetet që ka kooperativa duhet t'i vëré në punë dhe t'i shfrytëzojë sa më mirë, që të sigurojë riprodhimin

e zgjeruar, të sigurojë për anëtarët një vleftë të kënaqshme për ditët e punës, të sigurojë fonde për investime prodhuese dhe, me të ardhurat që mbeten, të paguajë me këste ato që u detyrohet kooperativistëve. Kështu të veprohet dhe jo të kërkohet, pa menduar mirë, që shteti t'u japë kredi, me të cilën të paguhen kooperativistët!

Kjo nuk është e drejtë jo vetëm ekonomikisht, por edhe në aspektin politik. Po t'i paguajë shteti ato që anëtari futi në kooperativë, atëherë del se, në fakt, ai nuk bashkoi gjë, pse shteti në të vërtetë ia bleu, fshatari mori paratë, i futi në xhep dhe ato që ka kooperativa janë falas, janë një plus, që anëtari do t'i paguajë, por për një kohë të gjatë, bile, shkohet edhe me mendimin se mund edhe t'i falen. Domethënë anëtari i kooperativës nuk bën në këtë mes asnje sakrificë, ndjenja e pronës private nuk i preket, kurse ajo e pronës së përbashkët nuk i nxitet. Në rast se atij i paguhet malli, ai do t'i qepet oborrit personal, nuk do të punojë si duhet në kooperativë dhe, në qoftë se do të bëjë ditë-punë pak, paratë i ka në xhep dhe me to mund të plotësojë nevojat që i dalin. Kurse kooperativa futet në borxh me shtetin, por anëtari i kooperativës në ndërgjegjen e tij si individ nuk e ndien këtë barrë dhe detyrim, pasi që në fillim nuk e ndjeu detyrimin kolektiv, nuk iu rrënjos në ndërgjegje mendimi se do t'i duhej të bënte edhe sakrifica, dhe sakrifica kryesore është që të mos kërkojë këstet porsa lind kooperativa, pse kjo s'ka, se kooperativa është ai dhe jo shteti. Ai duhet të kuptojë se këtë sakrificë e bën për veten e tij që të punojë, të rrojë e të kri-

jojë më mirë dhe nga rritja e të ardhurave të kooperativës t'i paguhen dalngadalë, me këste, ato bagëti që ka futur në kooperativë. Pjetjen «kur do të më paguhet?» kooperativisti duhet t'ia bëjë më mirë vete, pse vetëm ai e di dhe ai do ta krijojë mundësinë që të vetëpaguhet.

Por për çfarë duhet të vetëpaguhet anëtari i kooperativës? Të gjitha ato që bashkoi në kooperativë, me përjashtim të tokës, ai mund t'i shiste kur ishte privat, sepse ishin sende të tregtueshme. Por, në realitet, ai nuk i shiste ato, ose shiste fare pak në vit, shiste gjithashtu prodhimet e tyre. Tani që u fut në kooperativë, anëtari kërkon të paguhet menjëherë për ato që kur ishte privat i ruante me kujdes, se me to do të rronte. Edhe në kooperativë ai i ka të gjitha këto dhe prapë janë të tijat, ato prodrojnë për të, por ai kërkon plus këtyre edhe të paguhet për to. Politikisht një gjë e tillë nuk është e drejtë. Qetë, kur fshatari ishte privat, i kishte për të punuar tokën e vet, tani qetë punojnë prapë tokën e tij të bashkuar. Në qoftë se kooperativisti edhe tani thotë se qetë janë pronë e tij personale, atëherë politikisht nuk është i qartë, po kështu edhe kur thotë që shteti t'ia paguajë këstet. Në qoftë se do të thotë që këstet duhet t'ia paguajë kooperativa e tij dhe vetëm atëherë kur të gjithë anëtarët ta krijojnë vetë këtë mundësi me punën e tyre, vetëm atëherë ai e ka kuptuar drejt çështjen.

Po shteti do t'i ndihmojë kooperativat? Sigurisht që do t'i ndihmojë, por brenda mundësive të tij dhe jo sipas dëshirës së gjithsecilit. Në qoftë se shteti disponon traktorë, ai duhet t'i ndihmojë kooperativat me

traktorë, por jo të zëvendësohen qetë dhe të lihet pas dore kujdesi për shtimin e tyre. Ujemi i traktorëve, në qoftë se kooperativa është e varfër, mund të jepet si kredi. Ja, pra, një formë e drejtë kredie. Kur kooperativës i mungojnë lopë ose qe për shtimin e tyre, shteti do të japë gjithashtu kredi. Po kështu edhe për të shtuar tufën e kooperativës me bagëti të imëta, por jo për të paguar bagëtitë që u bashkuan. Shteti mund t'u japë kredi kooperativave të reja edhe për farëra, për investime prodhuese, si për kanale, hauze etj., në format që u jepen edhe të tjera. Pra, shteti do të japë kredi për fuqizimin e ekonomisë së kooperativave, për shtimin e prodhimit dhe jo që ato të paguajnë kooperativistët për bagëtitë që kanë kolektivizuar.

Kështu duhet kuptuar kredia e shtetit dhe kështu duhet t'u paguhen këstet kooperativistëve nga kooperativa për ato që kanë bashkuar. Shteti u jep kredi kooperativave me afat të shkurtër dhe të gjatë, por edhe vetë kooperativisti duhet t'i japë kredi kooperativës së tij me afat të gjatë ose të shkurtër. Këtë ai e vendos vetë, në fryshtë e interesit të përgjithshëm. Kështu kuptohen politikisht drejt çështja e kolektivizimit, e kredisë shtetërore dhe pagimi i kësteve kooperativistëve.

Një çështje tjetër është ajo e tokave të ndërmarrjeve shtetërore. Jam i mendimit se nuk duhet të pranojmë kërkesën e bërë që disa toka të ndërmarrjeve bujqësore, ose ato që kanë hapur ushtria dhe repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, t'u ndajmë kooperativave bujqësore. Ato janë pronë socialiste shtet-

tëreore dhe ne duhet të shkojmë drejt shtimit të sektorit socialist shtetëror, natyrisht, jo në kurriz të sektorit kooperativist. Kooperativave nuk duhet t'ua jepim të gatshme, ato duhet t'i hapin vetë tokat e reja. Për këtë qëllim ne kemi edhe plane të mëdha e mjaft tokë për të hapur. Natyrisht, te dera e shtëpisë këto toka nuk janë. Prandaj të mos biem në pozitat dhe në kërkesat e atyre fshatarëve që duan të rritin të ardhurat me mënyra të lehta dhe të rehatshme.

Lidhur me bashkimin e kooperativave duhet ecur me kujdes, sidomos me kooperativat e reja. Nuk është vetëm çështja se ka kooperativa që plotësojnë njëratjetren. Kjo është një gjë që ka rëndësi, por rëndësi kanë gjithashtu edhe madhësia e pronës kolektive në këtë kohë, mungesa e traditës, e eksperiencës dhe e kuadrove të nevojshëm. Tani ju sapo i formuat kooperativat në zonat malore, shumë kryetarë të tyre nuk kanë fare eksperiencë në drejtimin e një ekonomie të madhe kolektive, prandaj t'i edukojmë kuadrot, të eksperimentojmë për një kohë në një ekonomi të përbashkët, të vogël në fillim, dhe të pjekim situatat për të arritur në ekonomi më të mëdha. Çdo gjë duhet ta bëjmë me durim, të luftojmë më parë për të krijuar situatën, ta pjekim atë dhe pastaj të bëjmë hopen cilësor.

Një çështje që duhet parë, që duhet ndrequr e rregulluar menjëherë, është edhe madhësia e oborrit kooperativist (e tokës në përdorim personal të familjes kooperativiste). Është gabim që në kushtet e kooperativave bujqësore të porsangritura në zonat malore, ku toka nën kulturë është mjaft e kufizuar, t'i lihen

çdo familjeje kooperativiste nga 2-3 dynymë tokë. Partia mendon se një gjer në një dynym e gjysmë tokë është e mjaftueshme për çdo familje. Kjo çështje të shtrohet në popull, vetë ai ta korrigjojë praktikën e ndjekur dhe ta aprovojë këtë orientim.

Kërkesat e rretheve për t'u dhënë ndihmë kooperativave të reja malore nga ana e shtetit duhet të studiohen seriozisht nga Ministria e Bujqësisë, të vendoiset çfarë masash do të merren dhe t'u jepet ndihma pa zvarritje, sepse, sidomos, tani në fillim ato kanë nevojë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

# PRAKTIKAT FETARE T'I LUFTOJMË ME FRYMËN PATRIOTIKE DHE REVOLUCIONARE TË MASAVE

*Letër e KQ të PPSH drejtar komiteteve të Partisë  
të rretheve mbi luftën kundër fesë, paragjykimeve  
e zakoneve fetare*

27 shkurt 1967

Duke marrë parasysh se kohët e fundit në shumë rrethe është intensifikuar lufta kundër fesë, paragjykimeve e zakoneve fetare dhe me qëllim që kjo luftë të bëhet sa më drejt, pa gabime dhe më me sukses, u pa e nevojshme t'u jepen orientimet e mëposhtme:

Feja është opiumi i popullit. Duhet të bëjmë çmos që këtë të vërtetë të madhe ta kuqtojë çdo njeri, edhe ata që janë të helmatisur (e që nuk janë pak) duhet t'i shërojmë. Kjo nuk është një punë e lehtë, por as edhe e pamundur. Këtë luftë të madhe nuk duhet t'ia lëmë spontaneitetit apo të kënaqemi duke thënë se brezat e rinj do ta braktisin këtë opium, ose feja dhe praktikat e saj ekzistojnë vetëm te plakat dhe te pleqtë. Kjo nuk është e saktë; ato mund ta humbasin virulencën e tyre vetëm në rast se i luftojmë e i demas-

kojmë, por ringjallen, propagandohen e zgjerohen në rast se i nënveftësojmë.

Sigurisht, feja ka të bëjë me botëkuptimet, me ndërgjegjen, vepron me koncepte të cilat me shekuj klerikët jo vetëm i kanë kthyer në dogma filozofike, por, për t'i rrënjosur këto dogma animiste në ndërgjegjen e njerëzve, i kanë shoqëruar ato edhe me disiplina konkrete, me organizime të veçanta e i kanë lidhur me ngjarjet e jetës së njeriut. Feja çdo gjë është munduar ta lidhë me ndodhitë e jetës së njeriut dhe ka bërë që ky çdo mendim, çdo veprim të tij ta lidhë me fenë, me besimin idealist, mistik etj.

Luftën tonë kundër fesë ne duhet ta drejtojmë si kundër vetë dogmave fetare, pikëpamjeve filozofike idealiste e mistike të saj, ashtu edhe kundër disiplinave fetare, që kanë hyrë deri në zakonet e përditshme të atyre që besojnë, bile edhe të atyre që nuk besojnë, por që ndonjëherë i zbatojnë pa i ditur, pa treguar kujdes, shpesh nga forca e zakonit.

Populli ynë, në përgjithësi, nuk është fetar në atë kuptim siç janë mjaft popuj të tjerë, por prapëseprapë edhe ai diçka beson. Klerikët, me përjashtim të katolikëve, aktualisht janë injorantë dhe fenë që predikojnë e mbështetin më shumë në ruajtjen e disiplinave fetare, me anën e një liturgjie arkaike, me psoma dhe duara ose me lutje të mësuara përmendsh, në rastin e hoxhallarëve, pa u kuptuar as brendinë, pa lëre interpretimin e tyre filozofik.

Ne nuk kemi lënë asnjë nga shkollat, qoftë edhe të ulëta, nga dilnin klerikët e rinj, për të interpretuar doktrinën e tyre fetare. Kështu që klerikët e çdo be-

simi në vendin tonë kanë shteruar vazhdimisht si kuadro. Kurse për sa i përket botimit të librave e të dogmave të tyre, kjo mundësi ka vdekur me kohë për ta.

Myslimanët as kanë, as mund të kenë dhe as mund të lexojnë ndonjë kuran të vjetër, pse ai është në arabisht. Praktikisht ata «rrojnë» me disa syre të Kur'anit, që i mësojnë përmendsh, që nuk i kuptojnë dhe i transmetojnë gojarisht.

Ortodoksët s'janë as më të pasur në libra fetarë dhe as më të ngritur. Ata kanë vetëm avantazhin që ungjillin e kanë në shqip.

Kurse katolikët, sidomos klerikët e tyre, janë më të pasur në libra, më të ngritur dhe ata, atje ku mundin, vazhdojnë ta zhvillojnë fenë katolike si filozofi.

Pra, bazën materiale dhe propagandistike për shumëzimin e librave fetarë e kemi zhdukur. Ne kemi zhdukur gjithashtu mundësinë e përgatitjes së kuadrit të ri klerik. Tani çështja është te kishat dhe xhamitë që ekzistojnë te ne, si të vetmet mjete kryesore ku klerikët grumbullojnë besimtarët për të mbajtur gjallë besimin, qoftë edhe në forma dekadente. Prishja e kishave, e xhamive, e teqeve dhe e manastireve, natyrisht, paraqet një vështirësi, për arsy se nuk duhet shkuar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me atë pjesë të popullit që beson. Prandaj në këtë drejtim duhet pasur kujdes e takt. Por mjaft prej tyre janë prishur me iniciativën e masës pa ngjallur asnjë reaksion, disa të tjera kanë rënë, ka nga ato që janë kthyer në depo ose kanë mbetur pa hoxhë apo pa prift dhe praktikisht nuk funksionojnë. Me këto forma duhet të

vazhdojmë ne derisa t'i rrafshojmë ato nga faqja e dheut. Institucioneve fetare duhet t'u heqim, atje ku u kemi lënë diçka, të gjithë tokën, ndonjë rrënëjë ulliri ose të ardhur tjetër që mund të kenë akoma.

Është interesant se në fshatin tonë nuk ka rezistencë për këto gjëra. Kjo është rezultat i punës ateiste që ka bërë dhe bën Partia, por edhe i mungesës së hoxhallarëve, të priftërinjve dhe të librave fetarë. Në përgjithësi në fshat çështja e besimit fetar mbahet në zakonet e jetës e në interpretimin pragmatist të tyre, por kjo nuk duhet as të nënveftësohet e as të neglizohet, sepse dëmton shumë zhvillimin dhe përparimin e vendit.

Për t'i zhdukur praktikat fetare ne duhet t'i luftojmë ato kryesisht me frymën patriotike dhe revolucionare. Le të marrim çështjet e praktikave fetare myslimane. Gjatë 14 shekujve ato ruajnë karakterin e unititetit arab, të dominimit arab me anën e fesë; Kurani është libri i këtij ligji. Tek ai çdo gjë predikon ruajtjen e kësaj ideje, propagandimin e saj, të pleksur natyrisht me dogma filozofike idealiste, monoteiste, më racionale, si të thuash, se judaizmi ose kristianizmi.

Disiplinat fetare myslimane ruajnë të paprekur çështjen që, kur një person falet, qoftë ky egjiptian, kinez ose shqiptar, duhet ta kthejë fytyrën nga Meka. Kjo do të thotë ruajtje e besimit të unititetit fetar jo vetëm shpirtëror, por edhe temporal. Sipas fesë myslimane për të gjithë qendra është Meka.

Disiplina e fesë myslimane kërkon që çdo mysliman, i çdo kombësie që të jetë, duhet të falet në

gjuhën arabe, Kuranin ta mësojë dhe ta këndojë vetëm në arabisht. Myslimanët falen kudo njëloj, numri i të falurave çdo ditë është i njëjtë, marrja avdes bëhet njëloj. Gjithashtu njëloj janë kudo, deri në përcaktimin e datave të tyre: agjërimi, festat e bajrameve, matemi etj. Ne duhet t'i thyejmë këto praktika dhe t'u tregojmë të gjithë atyre që besojnë sa absurde është të ruash dhe të zbatosh zakone të tilla që nuk kanë asnje lidhje me jetën tonë, jo vetëm me të tashmen, por edhe me të kaluarën. T'u shpjegojmë origjinën dhe qëllimin e tyre, t'u vërtetojmë se si, nën petkun e perëndisë, fshihej ligji i otomanëve, i pushtuesve turq dhe i shërbëtorëve të tyre.

Pra, asgjë s'na lidhte dhe as na lidh me fenë, me praktikat e saj, jo vetëm si ateistë, por edhe si patriotë shqiptarë. A mund të imagjinohet që shqiptari të vazhdojë t'u bindet ligjeve të të huajve, ligjeve të pushtuese, qofshin këto ligje të veshura me petkun e fesë e të sheriatit? Të vazhdosh t'u bindesh këtyre ligjeve e zakoneve, do të thotë të jesh shpirtërisht me të huajt, me reaksionin më të zi. Nuk është e mundur që nga njëra anë të mendosh dhe të veprosh drejt politikisht, kurse nga ana tjetër të mendosh shtrembër ideologjikisht.

Feja të bën të gabosh rëndë politikisht dhe të frenon të ecësh përpara. Bota po përparon. Shqipëria po ndërton socializmin, kurse disa njerëz vazhdojnë akoma të besojnë ëndërrimet e një njeriu të shekullit VI që kishte botëkuptimin e tij mbi jetën, qëllimet e tij mbi popullin e vet dhe mbi popujt e tjerë. Ç'lidhje mund të kenë këto ëndërrime të Muhametit me

realitetin tonë të shekullit XX? Asnjë lidhje! Prandaj duhen zhdukur përfundimisht dhe pa nishan këto lidhje që e shtrëngojnë njeriun këmbë e duar dhe e poshtërojnë.

Këtë anë të shpjegimit historik të praktikave të fesë myslimanë ne nuk duhet ta harrojmë, por ta përdorim dhe, tok me të, të ngjallim dhe të vëmë kundër praktikave fetare patriotizmin e madh të masave. T'u shpjegojmë masave, historikisht dhe materialisht, ç'vuajtje, ç'mjerime, ç'gjakderdhje e ç'shtypje ka pësuar populli ynë, veçanërisht nga feja, se si ajo na përcante e vinte në luftë vëllanë kundër vëllait, duke i shërbyer shtypësve e pushtuesve për të na shtypur më mirë, për të na robëruar më lehtë dhe për të na pirë gjakun nën emrin e fesë.

Kjo duhet bërë kunëdër fesë myslimanë, ortodokse e asaj katolike, pse të gjitha kanë të njëjtin karakter të theksuar reaksionar, shtypës, idealist, qoftë në zhvillimin e dogmave e në përbajtjen e tyre, qoftë në liturgjinë e ngarkuar, të rafinuar dhe pompoze, qoftë në praktikat dhe në disiplinat fetare.

Kur feja myslimanë sheh te Muhameti vetëm profetin, domethënë njeriun të cilit, gjoja, zoti i transmetoi urdhrat e tij, që u përmblodhën në Kur'an, Krishti për fenë ortodokse dhe për atë katolike është perëndia i bërë njeri, i zbritur mbi tokë etj., etj.

Nëse myslimanizmi xhaminë e konsideron si një vend të thjeshtë për t'u falur, kristianizmi i konsideron kishat fronë të zotit, ku idealizohet perëndia dhe minimizohet qenia njerëzore, skllavërohen e shtypen shpirti dhe fiziku i njeriut nën një liturgji të tmerrshme

e pompoze, nën një luks të shfrenuar të klerit dhe të katedraleve, nën një praktikë të tmerrshme të përditshme që i është qepur besimtarit që kur lind dhe derisa vdes.

Besimtarit, sa është gjallë, kisha jo vetëm i merr pasurinë nëpërmjet një mijë zakoneve grabitëse, praktikës frymëmbytëse dhe skllavërimit brutal, por, nëpërmjet një mijë teorive animiste, ajo përpinqet të ruajë te njerëzit edhe kultin, edhe praktikat «e shpirtit të të vdekurit» të katër deri gjashtë mijë vjetëve më parë, siç janë çuarja në varre e grurit, kulegëve e zahireve të ndryshme, të cilat, natyrisht, grumbullohen në mbrëmje nga priftërinjtë.

Lufta kundër fesë, veçanërisht në vendin tonë, ku nuk ka mundur të zhvillohet në forma filozofike të stërholluara, për arsyen të mungesës së një baze klerikesh të zhvilluar e me kulturë, duhet të bëhet me këmbëngulje, sidomos kundër zakoneve, traditave, mënyrës së jetesës, interpretimit të fenomeneve, pse nëpërmjet kësaj rruge klerikët kanë mundur, për shekuj me radhë, të futin helmin e fesë dhe këtë helm ta përizojnë me gëzimet, me hidhërimet, me ngjarjet e përditshme të jetës së njeriut.

Pra, na vihet detyra që të studiojmë me imtësi ku dhe si shfaqet ky helm, në ç'forma shfaqet, ç'trajta ka marrë gjatë zhvillimit, ç'praktika zbatohen, si zbatohen e si kamuflohen ato. Në jetën e njeriut, që nga lindja e tij deri në vdekje, kanë depërtuar ritet fetare, pagëzimi, vënia e kurorës, synetllëku etj. si krimbi brenda mollës së kuqe. Duke i analizuar e duke i njobur mirë këto, lufta kundër fesë do të bëhet

e studiuar e sistematike, ideologjike, politike e organizative, pa pushim e pa pushim. Për të luftuar konceptet fetare ne duhet të përgatitim leksione teorike të bazuara në marksizëm-leninizmin, të thjeshta, reale, t'ua përshtatim vendit, njerëzve, zakoneve dhe nivelit tonë intelektual. Të mos kopojmë gjëra që nuk i përshtaten realitetit tonë. Të mos hyjmë në gjëra dhe në mendime që nuk janë të nevojshme për gjendjen tonë.

Lufta kundër fesë është mjaft e koklavitur, prandaj kush nuk armatoset mirë në këtë luftë, nuk mund të arrijë rezultatet që dëshiron. Ne i kemi të gjitha mundësitë dhe terreni ynë paraqitet i favorshëm që këtë luftë ta kryejmë me sukses.

Një armë historike kundër fesë dhe klerikëve reaksionarë është edhe fakti se feja myslimanë ka qenë ideologji e pushtuesve turq, feja ortodokse ideologji e shovinistëve grekë, që kanë pushtuar në të kaluarën vardin tonë, dhe feja katolike, me qendër Vatikanin, ka qenë ideologji e pushtuesve italianë, e imperializmit austriak dhe e fashizmit italian.

Ndjenjat patriotike të popullit tonë dhe lufta e tij për t'u çliruar nga zgjedha e të huajve, gjatë shekujve janë ndeshur edhe me ideologjinë fetare të pushtuesve dhe të klerikëve reaksionarë të çdo besimi që u shërbenin atyre. Në këtë fakt historik ne nuk mund të mos shohim edhe një nga arsyet që populli ynë nuk është edhe aq fanatic e i lidhur me fenë, sepse kjo, në esencë dhe në fakt, ka qenë në kundërshtim me idenë e çlirimt kombëtar.

Gjatë historisë së popullit shqiptar ka pasur kle-

rikë patriotë, që, edhe pa e mohuar besimin e tyre, kanë qenë të lidhur me popullin dhe me idenë e çlirimt kombëtar, por në asnjë kohë feja si fe nuk ka qenë një faktor përparimtar, bile nuk ka dhënë as ndihmën më të vogël në çlirimin kombëtar. Pra, ky është një argument tjetër me baza historike që ne s'duhet ta lëmë pas dore në luftën tonë kundër fesë.

Duke pasur parasysh të gjitha ç'u thanë më lart, ne si komunistë dhe ateistë duhet të jemi edhe realistë. Me gjithë propagandën tonë të organizuar kundër fesë, riteve, dogmave, institucioneve fetare dhe klerikëve profesionistë të kemi vazhdimisht parasysh që të mos futemi në luftë të hapët me njerëzit që besojnë në fenë, sepse në popull do të ketë edhe njerëz të ndershëm, të lidhur me Partinë e patriotë të flaktë, që do të ruajnë në ndërgjegjen e tyre edhe për shumë kohë, mundet edhe derisa të vdesin, besimet e tyre. Me ta duhet të bëjmë një punë bindëse, të vazhdueshme dhe me durim të madh, por të mos lejojmë që ajo të kthehet në ofenduese. Me këta njerëz Partia duhet të sillet, si të thuash, si mjeku i mirë që bën të gjitha përpjekjet për ta shëruar të sëmurin, për tarikthyer atë në gjëzimet e jetës.

Besimet e kota fetare nuk do t'i gjejmë vetëm te klerikët, të cilët janë njerëz profesionistë që i propagandojnë e i ruajnë të gjalla, që bëjnë spekulime dhe mashtrime të poshtra. Besimet fetare ekzistojnë edhe në popull. Prandaj, pa e ngadalësuar për asnjë çast propagandën kundër fesë, të kemi kurdoherë parasysh se kemi të bëjmë me popullin. Veprimet e pa-

matura, të ekzaltuara duhet të evitohen, çdo veprimi i duhet përgatitur me kujdes terreni politik.

Të mbyllësh xhamitë dhe kishat me fushatë apo me një urdhër, është punë e lehtë, por është më vëشتirë të përgatiten besimtarët shpirtërisht dhe ideologjikisht që të kuptojnë kotësinë e ekzistencës së këtyre institucioneve, të zhdukin fenë nga zakonet e jetës, të heqin dorë me bindje nga praktikat e saj. Atëherë për ta s'ka as rëndësinë më të vogël xhamia apo kisha, prifti apo hoxha. Shumë kisha dhe xhami po braktisen dhe po rrënohen. S'ka përsë të marrim përsipër meremetimin e tyre kur kemi kaq ndërtimë të dobishme për të bërë. Disa mund të kthehen në muze, në qoftë se vlejnë si të tilla, disa të bëhen depo, të mos hezitohet, të merren, por jo me dhunë ose pa marrë aprovimin e popullit, i cili duhet përgatitur shpirtërisht dhe politikisht.

Në këto situata revolucionare kemi marrë vesh se kryesia e klerit bektashian dhe ajo e klerit mysliman u kanë lëshuar një qarkore të gjithë hoxhallarëve e dervishlerëve të heqin çallmat dhe taçet, të heqin xhybet dhe të dorëzojnë tejetë e xhamitë. Këtu nuk ka asnjë shtytje, asnjë presion, qoftë edhe sugjерim nga ana e shtetit. Kjo është krejtësisht një iniciativë e tyre. Kur e kërkon rasti, të shpjegohet që kjo është iniciativë e vetë klerikëve, sepse elementët armiq mund ta përdorin këtë kundër pushtetit. Menjëse i njohim këta klerikë, ne mendojmë se, për këtë zell që kanë treguar, nuk janë shtyrë nga ndonjë qëllim i keq, pse ata janë të lidhur me popullin dhe me pushtetin. Gjesti i tyre, sido që i shpejtuar, prapë i shër-

ben interesit të përgjithshëm. Ai është një gjest patriotik dhe i guximshëm, sepse, pavarësisht se do të vazhdojnë të besojnë në fe, ata thyen një traditë shekullore, gjë që i nderon, sepse në veteve është një mendim dhe veprim përparimtar.

Por do të ishte më politike që klerikët të kuptionin dhe të ndihmonin, duke ndjekur me kujdes strategjinë dhe takтикën e Partisë në luftën kundër fesë. Do të ketë njerëz në popull që nuk do t'i aprovojnë veprimet e këtyre klerikëve. Ne nuk duhet të qëndrojmë sehirxhinj, por t'i mbrojmë ata në qëllimet e tyre të mira, sepse shumica e popullit, e në radhë të parë të rinjtë dhe të rejat, do t'i aprovojnë ato. Kjo ka rëndësi të madhe. Çdo gjë të bëhet me durim, me konsekuençë, në rrugën që shpjeguam më lart.

Për Komitetin Qendror të PPSH

Sekretari i Parë

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në  
«Dokumente kryesore të  
PPSH», vëll. V, f. 240*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

**KOMUNISTËT TË UDHËHEQIN ME SHEMBULLIN,  
ME SAKRIFICAT, ME PUNËN E TYRE  
VETËMOHUESE**

*Diskutim në organizatën e Partisë të sektorit  
të turnit «C» të uzinës «Enver»*

**2 mars 1967**

Të dashur shokë dhe shoqe komunistë të uzinës,

Jani shumë i gjëzuar që mora pjesë në mbledhjen e organizatës suaj. Këtu mësova nga ju shumë gjëra që do të më shërbejnë në punën time. Përveç të tjera ve, më gjuan situata revolucionare që ekziston në organizatën tuaj, diskutimet tuaja të gjalla, kritikat e guximshme, në frymën e klasës punëtore, kundër të metave. Të gjitha këto janë garanci për ecjen përpara dhe për suksese të mëtejshme, të cilat, siç e dini mirë, nuk mund të arrihen pa luftë dhe pa përpjekje. Sukseset, kur lindin dhe arrihen, kanë me vete edhe të metat, edhe gabimet, të cilat ndreqen vetëm atëherë kur shihen drejt në sy e kritikohen.

Në mbledhjen e përbashkët të disa organizatave-bazë që bëmë këtu në Tiranë, muajin e kaluar<sup>1</sup>, pas

---

<sup>1</sup> Është fjala për mbledhjen e 6 shkurtit.

diskutimit të anëtarit të organizatës suaj, i cili numëroi vetëm sukseset që janë arritur në uzinë, unë ndërhyra dhe thashë se do të vija në mbledhjen tuaj, pse aty duhet të ketë edhe të meta.

Janë të njoitura për të gjithë përparimet dhe sukseset e uzinës suaj. Kjo është uzina e parë në vendin tonë; si e tillë ka ndihmuar fuqimisht në ndërtimin e socializmit, ka qenë pionierja e industrisë sonë mekanike, që, përveç prodhimeve, i ka dhënë asaj edhe mjaft kuadro të vlefshëm. Me fjalë të tjera, uzina ka qenë dhe do të jetë vazhdimesht një shkollë kudrosh teknikë dhe politikë.

Por, edhe pa e njoitur në detaje punën tuaj, më duket se nuk u gabova kur thashë se te ju duhet të ketë edhe të meta. Diskutimet tuaja e vërtetuan këtë. Të metat, në çdo situatë, nuk duhet të fshihen kurrë, pse nga të metat dhe gabimet ne mësojmë, kritika kundër tyre është një shkollë që na armatos me eksperiençë për të mos bërë ose për të bërë sa më pak gabime.

Unë nuk mendoj që ju nuk i vini në dukje dhe nuk i luftoni gabimet e të metat tuaja. Jo, por edhe shoku që përmenda, mendoj se i la pa i vënë ato në dukje për arsyet e metodës së gabuar dhe stereotipe të raporteve, të manisë për të numëruar në çdo rast sukseset, deri në hollësitë më të vogla, pa u ndalur në të metat. Metoda pune të tilla duhen braktisur, sidomos nga klasa punëtore që është realiste, e cila, ashtu siç jep shembullin e mirë në të gjitha drejtimet, duhet t'u japë të tjerëve shembullin më të mirë edhe për stilin e metodën e punës.

Kam bindjen e plotë se çështjet që ju rrahët në këtë mbledhje do t'ju shërbejnë shumë për revolucionarizimin e mëtejshëm të prodhimit, tuajin dhe të kolektivit.

Ne kemi detyra dhe përgjegjësi të mëdha, të cilat do t'i kryejmë me nder dhe do t'i mbajmë me krenari, sado të rënda që të jenë, sado sakrifica që të kërkojnë, sepse realizimi i tyre çon përpaga çështjen e madhe të popullit, të Partisë, të socializmit.

Prandaj të mos ulet për asnjë çast hovë revolucionar, organizata-bazë t'i kalitë vazhdimisht në ku-dhrën e saj komunistët dhe kolektivin; të qëndroni kur-doherë në ballë të punës dhe të edukimit klasor, në trugën që na tregon Partia!

Ashtu siç jeni ekzigjentë, të kujdeshëm, të zell-shëm e të përpiktë në fabrikimin e detalit më të ndërlikuar që prodhon uzina juaj, po kështu duhet të jeni edhe në punën për edukimin tuaj ideologjik. Për asnjë çast nuk i lejohet punëtorit të mendojë se «ka kush e mëson këtë», «për mua kjo është e zorshme» etj. Punëtori duhet të zaptojë çdo kala dhe, në radhë të parë, ideologjinë e klasës së tij, së cilës i takon roli i lavdishëm i udhëheqjes së revolucionit botëror, i ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit. Klasa punëtore nuk mund të presë nga të tjerët, përkundrazi, të tjerët presin që ajo t'i edukojë, t'i bashkojë, t'i udhëheqë sipas doktrinës dhe ligjeve të saj.

Partia, Komiteti Qendror dhe Qeveria, që kanë një respekt të madh për punën tuaj të frytshme e të shumanshme, ju urojnë për sukseset që keni arritur dhe janë plotësisht të bindur se ju do të korrni suksese

të tjera akoma më të mëdha në realizimin e planit tonë pesëvjeçar, në realizimin e direktivave historike të Kongresit tonë të 5-të.

Të gjitha detyrat që na shtroi ky Kongres kanë një rëndësi kolosale për Partinë dhe për popullin, sepse synojnë në zhvillimin e mëtejshëm të pronës së përbashkët socialiste, në ndërtimin e plotë të socializmit, në kalimin gradual dhe me etapa në shoqërinë pa klasa, në shoqërinë komuniste. Krahas zhvillimit të vrullshëm të anës ekonomike dhe materiale të socializmit, Partia po i kushton një kujdes të madh e të veçantë thellimit të revolucionit ideologjik, politik e kulturor në rrugën marksiste-leniniste. Superstruktura duhet t'i përgjigjet ndërtimit të socializmit, ideologjisë së klasës punëtore, ligjeve objektive të zhvillimit dialektik dhe historik materialist të shoqërisë. Gjithë ky revolucion duhet të përfshijë jo vetëm superstrukturën, por edhe zemrat, ndjenjat dhe veprimet e të gjitha masave, të cilat janë ato që bëjnë historinë dhe transformojnë botën, shembin botën e vjetër me klasa, botën borgjeze, me strukturat e superstrukturat e saj antipopulllore, shtypëse, antidemokratike, skllavëruese, idealiste dhe ndërtojnë shoqërinë e re pa klasa, komunizmin.

Ky aspekt kaq i rëndësishëm i revolucionit proletar, që udhëheq me sukses Partia jonë, është nga më të vështirët e që kërkon më shumë kohë. Revolucioni realizon në rrugën socialiste shndërrimin e pronës private në pronë të përbashkët. Tok me ndryshimin e formave konkrete të ekonomisë së vjetër, që kanë për bazë pronën private, ai ndërron edhe mëny-

rën e jetesës, ndërron botëkuptimin e mëparshëm për pronën, për punën, për të menduarit dhe për të jetuarit në shoqërinë e re që po ndërtojmë.

Nuk është rasti për të zhvilluar këtu një leksion filozofik, por dëshiroj të ritheksoj atë që na mëson dhe na rekomandon posaçërisht Partia, për luftën këmbëngulëse që duhet të bëjmë për revolucionarizimin e mëtejshëm të Partisë, që konkretisht do të thotë të vetë ne komunistëve, për revolucionarizimin e masave dhe të të gjithë jetës sonë.

Ky revolucionarizim i mëtejshëm që udhëheq Partia, ka marrë një hov të ri të madh dhe të paparë. Do të ishte gabim të mendohej se deri tani Partia dhe komunistët kanë fjetur, kanë lidhur duart. Jo, përkundrazi, Partia ka qenë kurdoherë vijgilente, ka pasur dhe ka zbatuar një vijë revolucionare, e cila përgatiti terrenin për këtë hüp të paparë cilësor. Partia e kishte punuar mirë «tokën» në këtë drejtim, kishte hedhur, si të thuash, «farën» e mirë e të shëndoshë, i kishte bërë «grurit» të gjitha shërbimet agro-teknike, «gruri» kishte mbirë i shëndetshëm, tani ai ka zënë bukë, ka hedhur shtat dhe është në rrugë të mirë.

Partia tani hodhi kushtrimin: të spastrohen barërat e këqija që pengojnë të arrihen rezultatet e mëdha, të sigurohet farë e shëndoshë për të ardhmen dhe përsëri në të ardhmen Partia do të bëjë thirrje për hope të tjera revolucionare, për të spastruar barërat e këqija që lindin. Nuk e di në e zgjodha drejt këtë shembull për të treguar natyrën e vërtetë të këtij hopi revolucionar që ka shpërthyer në Parti dhe në popull dhe që po jep kaq rezultate të mëdha në pro-

dhim, në politikë, në ideologji e në kulturë dhe po revolucionarizon ndërgjegjen e jetën e njerëzve tanë.

Vihet re një gjallëri e jashtëzakonshme te njerëzit dhe në veprimtarinë e tyre. I madh e i vogël janë çuar në këmbë, kritikojnë veten dhe të tjerët për gabimet e të metat në punë, në jetë dhe në shoqëri, dërrmojnë e djegin me guxim e hov revolucionar mbeturinat e këqija të së kaluarës, i flakin ato nga ndërgjegjja e tyre dhe nga shoqëria jonë, për të mos lejuar që ato të shndërrohen në plagë shoqërore të shëmtuara. Duke bërë këtë, i madh e i vogël kuptojnë më mirë, shohin më qartë rolin e tyre në shoqëri dhe kryejnë më me sukses detyrat që u takojnë në shoqërinë socialiste që po ndërtojmë. Kështu prodhimi ecën përpara, ecën përpara përparimi teknik, zhvillohen drejt e me hapa të mëdhenj arsimi, kultura, shkenca.

Pra, tok me hopin në prodhim, po bëhen njëkohësisht transformime më të thella revolucionare në botëkuptimin e njerëzve, në konceptet e tyre për pronën, për punën e për mënyrën e të jetuarit. Zakonisht ndryshimet në botëkuptim bëhen më me ngadalë, më me vështirësi se zhvillimi i prodhimit, por këto ndryshime bëhen dhe bëhen me rrënje, vetëm duke përdorur një stil e metodë revolucionare në punë. Pra, varet nga intensiteti i punës së Partisë dhe i masave të popullit që rezultatet e këtyre ndryshimeve të janë më të mëdha dhe kurdoherë më të mëdha, më të thella e më revolucionare.

Si në çdo gjë, edhe në këto çështje kapitale, vërtetohen mësimet e marksizëm-leninizmit dhe të Par-

tisë sonë se masat e popullit janë me socializmin, me komunizmin, me atë parti të vërtetë marksiste-leniniste që ndjek e zbaton me besnikëri, me konsekuencë dhe në mënyrë krijuese marksizëm-leninizmin, ideologjinë e klasës punëtore.

Jeta na tregon se masat duan të ecin dhe ecin vazhdimisht me heroizëm përpara në rrugën në të cilën i udhëheq Partia jonë. Prandaj nuk vihet çështja që të rekomoandojmë «kjo të mos jetë si një zjarr kashte», por të rekomoandojmë që revolucioni të vazhdojë me një flakë të madhe, të përhershme dhe që zjarri asnijëherë të mos shuhet në zemrat e njerrëzve. Të veprojmë tok me masat, të lidhur fort me to; ne komunistët të jemi në krye dhe jo vetëm të drejtojmë, por të udhëheqim me shembullin tonë, me sakrificat tona, me punën tonë vetëmohuese, atje ku dhe vështirësitë janë më të mëdha, në shembullin e qindra heronje të Partisë dhe të popullit.

Pavarësisht se është ende shpejt të përgjithësojmë eksperiencën e këtyre lëvizjeve revolucionare, prapë mund të nxjerrim disa mësime e konkluzione të rëndësishme.

Ne shohim me një kënaqësi të madhe se komunistët dhe njerëzit e masës jo vetëm i njohin ndershmërisht të metat dhe gabimet, jo vetëm i kritikojnë drejt, në rrugë parimore dhe me guxim të tjerët, por (çka është me një rëndësi të pallogaritshme), edhe i kritikuari nuk e ndien veten të fyter nga kritika e drejtë, nuk mendon si një mikroborgjez se, kështu, i ulet dinjiteti i tij personal. Përkundrazi, ai kritikën e ndien si një ndihmë që i jepet nga shokët dhe nga masa:

Nga ana tjetër, ai që bën autokritikë të hapët e të sinqertë për të metat e tij, nuk ndihet as i vrarë, as i braktisur, përkundrazi, e ndien veten të qiruar dhe shumë afër masës, ndaj së cilës ai krijon një ndjenjë të vërtetë respekti. Këtë hop ne duhet të vazhdojmë ta thellojmë, pse ka akoma shumë që nuk e kanë kapërcyer këtë lumë.

Dëgjimi i zërit të masave, lidhjet më të ngushta me to, zbatimi i kontrollit dhe i vijës së masave kanë marrë një hov të madh. Askush të mos frikësohet nga disa gjëra të ekzagjeruara, të ekzaltuara që ngjasin e mund të ngjasin. Këto, natyrisht, duhet t'i ndreqim kurdoherë në rrugën e drejtë të politikës së Partisë. Në gjirin e masës ka edhe njerëz që, duke marrë shkas nga gabimet e një drejtori, i përgjithësojnë këto dhe dalin me konkluzionin e gabuar se të gjithë drejtorët ose shefat e reparteve janë si ai që ka bërë gabime, prandaj, sipas këtyre njerëzve, tërë luftën duhet ta drejtojmë kundër shefave e drejtorëve. Këto prirje të gabuara duhet të luftohen. Në masë, gjithashtu, ka të atillë që, megjithëse me plot vese në veten e tyre, i fshehin këto dhe nën maskën e revolucionarizimit dhe me qëllime të kundërta me qëllimin tonë të madh, që është edukimi i njerëzve, përpiken ta bëjnë Mizën buall. Këtyre njerëzve masa duhet t'u tregojë vendin.

Kur themi «masa», me këtë nuk duhet kuptuar mendimi i dy ose tre vetave, qofshin këta të mirë ose të këqij. Për çdo gjë që diskutohet në masë, duhen gjetur të gjitha format dhe mënyrat që e tërë ajo të japë mendimin e vet dhe mendimi i drejtë të mbizotërojë.

Kjo është forma e vërtetë e demokracisë popullore, e demokracisë së shumicës.

Problemet e rëndësishme të jetës së shqërisë socialiste, në të gjitha aspektet e saj, po hidhen e po diskutohen frontalisht në masë. Përvoja e fituar deri tani tregon se masa, e udhëhequr nga Partia, është në gjendje të studiojë, të thellojë, të konkludojë. Këtu duhet pasur kujdes, dhe kjo është një nga detyrat e Partisë si udhëheqëse, që të mos i reduktojmë, të mos i minimizojmë e të mos i thjeshtëzojmë problemet, të mos i shkëputim nga njëri-tjetri, por të dimë t'i zgjidhim ato frontalisht dhe të mos themi «na mbuluan punët e mëdha dhe harruam të voglat». Por, në fakt, «të voglat» nuk janë të vogla, edhe ato janë pjesë të pandara dhe vepruese të çështjes së madhe. Të gjitha problemet, ekonomike, ideologjike dhe politike, janë një zinxhir i vetëm me shumë hallka, prandaj asnje hallkë nuk duhet lënë të ndryshket ose të këputet.

Gazetat, radiot, gazetat e murit, fletërrufetë, mbledhjet e ndryshme kanë marrë kudo një gjallëri të madhe dhe, në përgjithësi, e zhvillojnë veprimtarinë e tyre shumë drejt. Kështu duhet të vazhdojnë. Mund të ketë, dhe ka, edhe gabime, ekzagjerime e disa forma jo të përshtatshme për situatën tonë, të cilat, kur shfaqen, duhet t'i kritikojmë, t'i ndreqim, t'i futim në rrugën dhe në vijën e drejtë të Partisë.

Aktivizimi i masave, angazhimi i tyre me problemet e ndryshme që preokupojnë Partinë dhe sozializmin është rruga më e përshtatshme dhe më e mirë për gjallërimin e Frontit Demokratik të udhëhequr

nga Partia. Të ecim me vendosmëri në këtë rrugë të gjetur nga Partia. Vija e saj, vija e masave, të gjejë këtu zhvillimin e saj më revolucionar. Mbledhjet me masat janë mbledhje pune, mbledhje edukative, jo formale, sektare e të mbyllura dhe as mbledhje pazari. Ato kanë një qëllim të lartë edukativ, kontrolli dhe këshillimi masiv për mbarëvajtjen e punës. Do të ketë njerëz që diskutimin për ndonjë çështje, për të cilën mund të ketë vend edhe për kritikë, do të përpiken ta shmangin nga qëllimi edukativ dhe nga zgjidhja e drejtë e problemit, ta kthejnë në «skandal». Kur këtë e bëjnë me qëllime të këqija, të caktuara, ata duhen demaskuar dhe, kur nuk shtyhen nga qëllime të tilla, të edukohen për të gjetur kurdoherë masën dhe mënyrën e drejtë të shtruarjes së çështjes dhe të kritikës, që kjo të mos jetë fyeze, por edukuese.

Nëpërmjet këtyre mbledhjeve masive, Partia duhet të realizojë edukimin klasor në masën e popullit, edukimin e tij me normat e drejta, për të bërë në mënyrë masive çrrënjosjen e botëkuptimeve, të normave e të zakoneve të vjetra. Dhe që kjo të bëhet siç kërcohët, çdo komunist duhet të jetë plotësisht i ndërgjegjshëm për përgjegjësitë e tij. Komunistët duhet jo vetëm të marrin pjesë aktive, jo vetëm të japid gjykime të matura, të pjekura, të drejta, por nga çdo mbledhje të nxjerrin mësimet e duhura për çdo gjë, për çdo rast, për çdo ngjarje; kryesoret t'i diskutojnë në organizatbazë të Partisë dhe, në mbledhjet e tjera me masën, të japid orientimet e nevojshme. Kjo është e domosdoshme, asnë komunist të mos e harrojë këtë.

Lëvizja revolucionare për emancipimin e gruas

ka marrë një hov të mrekullueshëm dhe po zhvillohet pa gabime, me një kuptim të drejtë e të lavdërueshëm nga vetë gratë dhe nga burrat. Ky hov kurrë të mos ndalet dhe të kuptohet drejt nga të dyja palët. Këtu nuk është çështja për të luftuar burrat ose gratë, apo për të mbrojtur gratë në dëm të burrave. Këto koncepte janë të huaja për marksizëm-leninizmin, për Partinë tonë. Çështja qëndron te lufta kundër pikëpamjeve prapanike që ekzistojnë si mbeturina të së kaluarës, si te burrat, ashtu edhe te gratë, por sidomos te burrat në këtë rast. Prandaj, edhe burrat t'i përkrahin gratë e të rejat me të gjitha forcat, që të çajnjë përpara, sipas mësimeve të Partisë, të çlironen plotësisht nga çdo mbeturinë e së kaluarës. Marksi na mëson se në rast se nuk lufton për të çliruar edhe të tjerët, atëherë nuk je i lirë vetë.

Partia dhe populli ynë ndihmojnë me të gjitha forcat e tyre çlirimin e popujve të tjerë, prandaj për asnjë minutë nuk mund të lëmë pas çlirimin e mëmave, grave, motrave dhe vajzave tona. Prandaj përkëtë çështje të shenjtë çdo patriot shqiptar, qoftë hapur, qoftë në mënyrë të heshtur, duhet të jetë orë e çast në rolin e gjykatësit për ndërgjegjen e vet.

Dëshiroj të prek shkurtimisht edhe dy çështje, të cilat, duke qenë probleme të jetës materiale dhe mendore, janë edhe probleme teorike dhe politike, që Partia i ka trajtuar për të na armatosur, për të luftuar drejt në jetë. E kam fjalën tek ideja e pronës dhe te feja e te zakonet fetare.

Prona, siç dihet, është shprehje e raporteve pasurore në shoqëri dhe, sipas teorisë marksiste-leninis-

te, forma e pronës përcakton karakterin e mënyrës së prodhimit. Në kundërshtim me teoritë borgjeze kapitaliste që pretendojnë se prona private individuale është një kategori e përjetshme dhe e pandryshueshme, marksizëm-leninizmi provoi se prona individuale ose private e mjeteve të prodhimit nuk është aspak një kategori e përjetshme dhe as e pandryshueshme, por një formë e pronës që u shfaq në një etapë të caktuar të zhvillimit shoqëror dhe që historikisht është e destinuar të zhduket. Format e pronës kanë ndryshuar në etapat e ndryshme të historisë së shoqërisë njerëzore, duke filluar nga prona kolektive e komunës primitive e deri në pronën kapitaliste të rendit borgjez ku ajo përbën bazën e raporteve në prodhim.

Në rendin tonë socialist vendosja e pronës kolektive në mjetet e prodhimit, që përbën bazën e marrëdhënieve në prodhim, zhduku përgjithmonë shfrytëzimin dhe të shfrytëzuarit u çliruan.

Këto i përmenda për të ardhur në atë që tok me ndryshimet rrënjosore që ka bërë shoqëria jonë në çështjen bazë të sistemit tonë socialist, në çështjen e pronës, në shndërrimin e saj nga një pronë private e karakterit feudal e kapitalist në një pronë kolektive socialiste, ne duhet të bëjmë një luftë të përditshme për të zhdukur nga ndërgjegjja jonë mbeturinat që rrjedhin nga konceptet e vjetra të pronës private. Partia jonë ka luftuar e ka punuar me konsekuençë për transformimin e pikëpamjeve të vjetra të pronës private dhe për konsolidimin e vazhdueshëm të pronës së përbashkët e të koncepteve të reja lidhur me të.

Përparimet e mëdha të bëra në industri, në buj-

qësi e gjetkë, ndërtimi me sukses i socializmit në vendin tonë e vërtetojnë këtë. Çështja për ne qëndron në atë që, duke u bazuar në këto transformime socialiste bazë, të forcojmë çdo ditë e më tepër në praktikë dhe në botëkuptimin tonë filozofik pronën e përbashkët të popullit dhe konceptet marksiste-leniniste mbi të. Prona e përbashkët është burimi i mirëqenies së popullit dhe të individit, i harmonizimit të interesit të përgjithshëm me atë personal. Ajo krijoj bazën objektive për lindjen e koncepteve të reja mbi pronën, shoqërinë, punën dhe për rrënjosjen e botëkuptimit komunist. Puna e masave për zhvillimin e vazhdueshëm të pronës socialiste është shprehje e këtyre koncepteve.

Vënia e interesit të përgjithshëm mbi atë individual është një shprehje e këtyre parimeve socialiste mbi marrëdhëni e individit me shoqërinë, që as nuk e shtypin personalitetin e njeriut, as e privojnë atë nga të gjitha liritë dhe as frenojnë mirëqenien e tij, siç pretendojnë teoritë borgjeze, me të cilat jemi në luftë për jetë a për vdekje. Në të kundërtën, njeriu në shoqërinë tonë socialiste ka gjetur zhvillimin e plotë të dinjitetit dhe të lirisë në kuptimin e vërtetë të fjalës, për arsy se ka këputur të gjithë zinxhirët e robërisë dhe të skllavërimit që e mbanin të shtypur materialisht dhe shpirtërisht. «Parajsa» kapitaliste është një skëterrë për masat punonjëse dhe «liritë demokratike» të borgjezisë janë një gënjeshtër, një mjegull për masat që shtypen nga regjimi i shfrytëzimit total.

Sa më thellë t'i kuptojnë njerëzit tanë këto kon-

cepte bazë të filozofisë sonë mbi pronën (dhe për këtë Partia duhet të punojë vazhdimisht), aq më mirë e më shpejt do të zhduket nga ndërgjegjja e njerëzve ai bagazh i vjetruar, që i mundon në jetë dhe që mund ta shprehim me dy fjalë të thjeshta: «imja» dhe «jotja».

Sigurisht, në çdo kohë, edhe në komunizëm, disa gjëra, në një kuptim të ngushtë, do të jenë të individit për të plotësuar nevojat personale. Qëllimi ynë është që të çrrënjoset ai kuptim i vjetër i sigurimit të avantazheve vetëm për vete ose vetëm për familjen. Puna edukative e Partisë si dhe ligjet e shtetit synojnë në rrënjosjen e koncepteve të reja dhe në zhdukjen e çolloj tendencë për të përfituar nga puna e të tjerëve. Normalat e jetës së kulturuar socialiste dhe ligjet që rregullojnë raportet e shpërndarje së të mirave materiale midis qytetarëve, në varësi nga puna e dhënë prej seçilit shoqërisë, janë të drejta parimi përkëtë etapë dhe perfeksionohen gjatë zhvillimit të pandërprerë të revolucionit tonë.

Askush nuk mund t'i thotë gjë një qytetari të ndershëm të Republikës sonë, nëse ato që fiton më djersën e punës së tij, i shpenzon ashtu si mendon dhe dëshiron ai vetë. Por kjo nuk përjashton që qytetarët e Republikës t'i edukojmë që djersa ose fryti i ligjshëm i punës së tyre t'u shërbejë për të plotësuar nevojat personale, për të bërë një jetë të kulturuar, duke ndjekur normat e moralit proletar të shoqërisë sonë e për të mos shkuar në kundërshtim me to. Luksi,jeta e shfrenuar, ndjenja egoiste e pronës private, frika mikroborgjeze nga jeta, nga e nesërmja

gjoja e papritur etj., etj. janë shfaqje që nuk frymëzozen e nuk rrjedhin nga botëkuptimi ynë materialist. Por në shumë aspekte të jetës ne do të ndeshemi me këto mbeturina, të cilave shumë herë nuk u kushtojmë vëmendje, por që ndikojnë keq në edukimin e njerëzve.

Të marrim ndjekjen e modës së huaj nga disa. Ç'do të thotë kjo, qytetërim? Jo. Përveç ekstravagançës, ajo mban në vetvete konceptin se personaliteti i njeriut shquhet nga veshja sipas modës. Por të bësh ekstravagancë, të braktisësh thjeshtësinë, që ka në vetvete pastërtinë morale, ndershmërinë dhe bukurinë natyrore; do të shpenzosh më tepër nga sa ke mundësi; mund të korruptohesh, të kërkosh rrugë jo të ndershme fitimi dhe të humbasësh vetitë më të mira të punonjësit. Morali i shthurur që sundon në jetën e vendevc kapitaliste dhe revizioniste, të çon deri në krimë.

Revizionistët sovjetikë kanë shpallur se po ndërtojnë komunizmin. Kjo është një gënjeshtër e madhe. Ata as materialisht, as ideologjikisht nuk shkojnë në komunizëm, por në kapitalizëm. Ata na akuzojnë ne për dogmatizëm, na akuzojnë se jemi pér varfërimin e jetës materiale dhe ideokulturore të masave, sepse ndjekim me besnikëri marksizëm-leninizmin dhe ndërtojmë me sukses, ndershmërisht dhe me forcat tona socializmin. Ata na akuzojnë se ne qenkemi pér «socializmin e kazermës». Po pse e bëjnë ata këtë propagandë? E bëjnë pér të maskuar kthimin e tyre në kapitalizëm, pér të maskuar krijimin e një shtrese të aristokracisë punëtore që rron në luks e bën një jetë

të korruptuar në kurri zyrtar të popullit punonjës. Revisionistët na akuzojnë ne për varfërim të jetës shpirtërore, pse nuk bëjmë një jetë të shthurur, të degjeneruar, të korruptuar. Për ata tradhtarë jeta e popullit tonë kaq e bukur, kaq e këndshme në punë, në ndershëmëri, në dëfrime të pastra e me një ndjenjë morale të lartë, qenka varfëri.

Filozofët e partisë revizioniste franceze mbushin libra e libra të tërë për të helmatisur klasën punëtore se marksizëm-leninizmi gjoja është vjetruar dhe se kjo doktrinë jetëdhënëse duhet «t'i përshtatet» zhvillimit aktual të kapitalizmit, të shndërrohet në një doktrinë të re, që është revizionizmi. Me fjalë të tjera, këta reformistë tradhtarë i shërbejnë kapitalizmit botëror për t'i zgjatur jetën, duke e çarmatosur klasën punëtore dhe duke dobësuar revolucionin.

Socializmi është etapa tranzitore për të kaluar në komunizëm; gjatë saj ne punojmë dhe luftojmë që ekonomia jonë e përbashkët socialiste të forcohet, të zhvillohet, të pasurohet. Njëkohësisht me këtë ne luftojmë e punojmë që të ndërtojmë edhe njeriun e ri komunist, njeriun me virtytet më të larta proletare. Prandaj ka kaq rëndësi për Partinë tonë edukimi politik dhe ideologjik i njerëzve, edukimi i tyre me normat e moralit të lartë të Partisë, të moralit proletar.

Në këtë edukim të madh, të vazhdueshëm, të pandërprerë e të gjatë, që nuk mund të bëhet me dekrete dhe në një ditë, përfshihet edhe edukimi ateist, lufta kundër fesë, kundër dogmave të saj, kundër praktikave dhe zakoneve që ajo ka mundur të krijojë në shëkuj. Unë nuk do të zgjatem mbi këtë problem,

pse në këto situata Partia ka një material të shkurtër orientues dhe ju mund edhe të njiheni me të<sup>1</sup>. Por, duke u bazuar në mendimin e madh të Marksit që thotë se feja është opiumi i popullit, shkurtimisht dva të them se ne duhet të zhvillojmë një luftë të zgjuar, të shkathët e të vendosur kundër të gjitha feve, të cilat kanë helmuar dhe helmojnë mendjen e njeriut, janë përdorur e përdoren për ta paralizuar atë, për ta frenuar në rrugën e përparimit, për ta mbajtur skllav të kapitalistëve dhe të ideologjisë borgjeze. Feja është ajo armë e kapitalizmit që mbron me të gjitha forcat idenë e pronës private, të pronës kapitaliste, gjoja të shenjtë dhe të përjetshme. Vini reme kujdes se si lidhen edhe këtu te ne, në mënyrë të heshtur, gjoja tradicionale, ndjenjat e pronës private me besimin fetar e deri edhe te vetë ekzistenca jonë si qenie njerëzore. Kur e pyet tjetrin: «Si je?», padashur ai të përgjigjet: «Shyqyr zotit, mirë jam», ose «E ndërtove shtëpinë?», ai të përgjigjet: «Me ndihmën e zotit e ndërtova», megjithëse «zoti» nuk ka vënë asnjë gozhdë.

Neve, si komunistë e ateistë, na bie detyrë e madhe ta luftojmë fenë si ideologji, si dogmë, si rit, si disiplinë dhe si praktikë. Partia na mëson që kjo luftë e pandalshme për të pastruar ndërgjegjen duhet të jetë bindëse dhe për asnjë çast të mos harrojmë se kemi të bëjmë me ndjenjat e popullit, i cili është gjithçka për Partinë. Prandaj dënohen dhuna, ekzalti-

---

<sup>1</sup> Shih në këtë vëllim Letrën e KQ të PPSH mbi problemet e luftës kundër fesë, f. 103.

met ose veprimet e pamatura në këtë çështje. Këtu duhet bindje dhe vetëm bindje, punë politike e ideologjike, me qëllim që çdo veprimi konkret kundër fesë t'i përgatitet terreni.

Populli duhet të bindet për kotësinë dhe rrezikshmërinë e fesë, të kishës, të xhamisë ose të çdo institucioni apo zakoni fetar dhe vetë të marrë vendim ta prishë ose jo, ta braktisë menjëherë ose dalngadalë fenë. Të kemi parasysh se këto besime janë rrënjosur me shekuj në ndërgjegjen e njerëzve, prandaj duhen një kohë dhe një punë mjaft e gjatë që të zhduken. Të mos harrojmë gjithashtu se vetë dhe pa luftë ato nuk zhduken; po i harruam, atëherë do të na qorrojnë.

Përveç luftës që duhet t'u bëjmë dogmave fetare, siç na mëson Partia, ne duhet të ndërmarrim edhe spastrimin sistematik të principeve të fesë, të pleksura me zakonet e jetës së njeriut tonë deri në gjënë më të vogël, por që kanë një kuptim të neveritshëm dhe armiqësor, antisocialist, antipatriotik, siç është qoftë edhe shprehja «addio» që përdoret për të përshtendet e që do të thotë «te zoti».

Në vendin tonë, ku populli është patriot i flaktë dhe në përgjithësi jo fanatik, për shumë arsyesh objektive dhe historike, ne kemi një terren shumë të favorshëm për ta zhvilluar këtë luftë përparimtare pa bujë, pa reklama. Klerikët ortodoksë, myslimanë, bektashianë, me ndjenja patriotike të lavdërueshme, ndihmojnë në këtë çështje jetike për të sotmen dhe për të ardhmen e vendit tonë. Ata janë bashkuar me popullin dhe me Partinë në të gjitha çështjet.

Bëni krahasimin e klerikëve tanë patriotë me revizionistët polakë dhe me revizionistët çekoslovakë që na hiqen si komunistë. Revizionistët polakë fenë e kanë futur si mësim në shkollë. Do ta futin fenë në shkollë edhe revizionistët çekë. Këta tradhtarë të komunizmit nuk u treguan as në nivelin e demokratëve borgjezë francezë, të cilët mbrojtën shkollën laike që në kohën e revolucionit të tyre borgjez.

Më në fund ju kërkoj ndjesë shokë, se ju mora shumë kohë, por besoj se kjo nuk është një kohë e humbur kot. Ju uroj edhe një herë suksese në punë dhe në edukim. Ne komunistët dhe klasa punëtore, të jemi kurdoherë në pararojë, në punë, në mendime, në luftë e në sakrifica.

Rroftë Partia!

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## PARTIA ASGJË NUK MUND TË ZGJIDHË DREJT, JASHTË MASAVE DHE PA NDIHMËN E TYRE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

22 mars 1967

Në diskutimin tim do të flas vetëm për dy nga çështjet që u shtruan këtu: për gjallërimin e organizatës së Frontit, si dhe për iniciativën e arsimtarëve. Nuk do të ndalem në çështjen e luftës së klasave, sepse shokët folën dhe shoku Hysni [Kapo] e trajtoi drejt e gjerë këtë çështje.

Nga raporti që ka paraqitur Komiteti i Partisë i Rrethit të Tropojës kam krijuar përshtypjen se organizata e Partisë në këtë rreth punon më mirë me organizatën e Frontit. Prandaj mendoj se shokët e rretheve të tjera duhet të ndjekin shembullin e Tropojës. Këtu nuk është çështja se këta nuk e kuptojnë

---

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua puna e Partisë në disa rrethe për gjallërimin e organizatës së Frontit, për zhvillimin e luftës së klasave dhe për zbatimin e iniciativës së arsimtarëve për përhapjen e kulturës socialiste në fshat, për studimin e traditave patriotike, të kulturës e të krijimtarisë popullore.

teorikisht rëndësinë e organizatës së Frontit, si një levë e fuqishme e Partisë, por duhet të dinë si ta organizojnë më mirë punën e komunistëve në Front, sepse kjo është një çështje që ka rëndësi vendimtare dhe, natyrisht, këtej mund të gjykosh nëse kuptohet drejt në praktikë roli i Frontit.

Fronti Demokratik, si një organizatë që përçon në masat vijën e Partisë, duhet të merret me të gjitha problemet, duke u hyrë atyre thellë në kuptimin politik, sepse, siç na mëson marksizëm-leninizmi, në çdo gjë politika është në plan të parë. Të luftohet prirja për të aktivizuar këtë organizatë «nga pak» për çdo gjë, në mënyrë spontane, të sipërfaqshme. Në raportin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit, për shembull, thuhet se «Në ndonjë rast Fronti është marrë edhe me aksione të gjera ekonomike» ose «Ka filluar të merret me sqarimin politik të anëtarëve». Ta shtrosh kështu problemin dhe ta ndërtosh kështu punën e Frontit, do të thotë të mos kuptosh si duhet mësimet e Partisë për punën me organizatat e masave dhe rolin e tyre, për vijën e masave dhe vënien e politikës në plan të parë, të mos kuptosh tezën marksiste se janë masat ato që bëjnë historinë.

Në punën me organizatën e Frontit duhet pasur parasysh veçoria e saj si organizata më e gjerë politike, që ka një gamë shumë të gjerë problemesh, me të cilat duhet të merret. Çdo gjë që i intereson Partisë, që i intereson popullit, i intereson edhe organizatës së Frontit dhe duhet të jetë objekt i veprimtarisë së saj. Partia asgjë nuk mund të zgjidhë drejt dhe me bazë jashtë masave dhe pa ndihmën e tyre, prandaj

ajo vë në lëvizje të gjitha organizatat e masave e, veçanërisht, atë të Frontit. Është në pozita revolucionare ajo organizatë partie që nuk mbyllët në vetvete, por punon me masën, që di ta organizojë, ta edukojë dhe ta hedhë atë në aksion, që di të përfitojë nga eksperiencia e saj.

Shumë herë kemi folur për organizatën e Frontit, për përpjekjet që duhet të bëjmë për të gjetur format më të mira të punës me masat. Nuk mund të themi se nuk kemi rezultate, por këto janë akoma të pamjatueshme dhe burimi i kësaj qëndron në atë që disa nga kuadrot tanë nuk dinë të punojnë në mënyrë të organizuar me masat. Ata nuk kanë sa duhet parasysh faktin se asnje problem te ne nuk mund të zgjidhet si duhet në mënyrë individuale, pavarësisht se shumë herë në dukje ndonjë problem paraqitet si i tillë; ata nuk e kanë të qartë se edhe një problem që duket i veçuar dhe ka raste që duhet zgjidhur në mënyrë të veçuar, në të njëjtën kohë ai është edhe një problem shoqëror. Prandaj, duke e zgjidhur atë, nuk do të thotë se ka mbaruar çdo gjë. Nga ky rast duhen nxjerrë mësime që t'u dilet përpëra problemeve e rasteve të tjera, që mund të paraqiten në shumë forma, por që në thelb e kanë burimin në paqartësinë politike dhe ideologjike të njerëzve tanë. Pra, Partia duhet të kuptojë se pa mobilizuar organizatën e Frontit e ka të vështirë t'i zgjidhë problemet e mëdha.

Aksionet që ndërmarrin masat në qytete dhe në fshatra janë një gjë shumë e mirë dhe duhet të jenë të vazhdueshme. Por nuk duhet menduar se detyrat e organizatës së Frontit janë vetëm ndërtimi i çezmave

osë i një rrugë automobilistike. Ajo, në radhë të parë, është një organizatë politike. Prandaj, detyra kryesore është që, nëpërmjet punës së kësaj organizate, vija e Partisë të depërtojë deri në skajin më të thellë të ndërgjegjes së njerëzve tanë.

Nuk mund të kënaqemi vetëm me formula për rolin, për rëndësinë e organizatës së Frontit dhe të bëjmë me të një punë të përgjithshme. Mua më duket se shokët e rrethit të Tropojës e shohin më drejt këtë çështje nga ana organizative dhe kjo u ka sjellë edhe rezultate më të mira. Mundet që edhe rrethet e tjera e bëjnë këtë, por në raportet e tyre nuk munda të shoh shumë gjëra nga ato që bën organizata e Partisë e rrethit të Tropojës. Shokët e komitetit të Partisë të këtij rrethi i konsiderojnë aktivistët kryesorë të organizatës së Frontit si instruktorë partie, i mbledhin, i sqarojnë, i udhëzojnë njëlloj si këta. Kjo është një punë shumë e mirë dhe shumë e drejtë, që të bën të mendosh se drejtuesit e Partisë në këtë rreth e kuptojnë drejt dhe mirë rëndësinë e organizatës së Frontit.

Komiteti i Partisë i Rrethit të Tropojës ka krijuar grupe aktivistësh që i do dhe i dëgjon populli, të cilët, në rrugën e Partisë dhe të Frontit, zgjidhin shumë probleme të koklavitura. Shumë mirë kanë bërë. Kjo është një formë që duhet të përdoret dhe që u jep ndihmë të madhe Partisë, organizatave dhe kryesive të Frontit.

Format e punës që përdoren në rrethin e Tropojës për zgjidhjen e shumë problemeve ekonomike e shoqërore, konkretisht dhe një për një në çdo fshat, duke

véné nē lëvizje organizatën e Frontit, masën, tregojnë sē shokët komunistë atje jo vətäm e kanë kuptuar mirë vijen e masave, por e vrasi mendjen dhe gjejnë edhe format e ménnyrat se si ta konkretizojnë atē nē praktikë. Prandaj tē tjeret duhet tē pérfitojnë nga pérvoja e këtij rrethi.

Sot, më tepér se kurdoherë, situata ēshtë shumë revolucionare, shumë e përshtatshme pér gjallërimin e organizatës së Frontit nē ménnyrë më tē organizuar. Tē mos lejojmë tē na ikë nga duart kjo situatë, puna e mirë që ēshtë bërë tē mos mbetet si një zjarr kash-te, por ta zhvillojmë më tej atē, duke zgjeruar aktivitetin e organizatës së Frontit e duke kalitur më tej themelet e shëndosha tē punës së Partisë me tē.

Lëvizjet revolucionare, që kanë ngritur peshë gjithë vendin, propozimet e sugjerimet e shumta tē punonjësve, fushatën e madhe që ka shpérthyer kudo te ne, duhet t'i vazhdojmë e t'i thellojmë më tej. Pér t'ia arritur kësaj nuk duhet tē mbetemi nē format deklarative dhe zhvillimi i lëvizjes tē mos i lihet spontaneitetit. Pér këtë Partisë dhe pushtetit u bie një detyrë e madhe përgjithësimi, konkretizimi dhe marrja e një sërë masash politike, ideologjike, organizative, administrative, që dëshirat e propozimet e punonjësve tē materializohen. Çdo iniciative, çdo propozimi revolucionar, nē cilindo rreth, duhet t'i shkohet deri nē fund me detyra tē përcaktuara, tē pérhershme ose tē pér-kohshme, me afate tē shkurtra ose me një periudhë kohe më tē gjatë.

Si duhet tē veprojnë rrethet, pér shembull, pér disa nga çështjet e shumta aktuale? Tē marrim çësht-

jen e fesë, të xhamive dhe të kishave. Derisa ka filluar dhe bëhet, me iniciativën e masave dhe pa rezistencë, prishja e tyre të vazhdohet në bazë të orientimeve që kemi dhënë. Për sa kohë do të zgjasë kjo, këtë nuk e caktojmë dot nga lart, por me këtë rast hoxhallarëve e priftërinjve t'u gjendet punë në kooperativa dhe me ta të punohet veçanërisht, që të çhelmatisen. Por luftha kundër fesë nuk mbaron me prishjen e kishave e të xhamive. Prishja e tyre është më e lehta. Shumë më e vështirë është të luftohen zakonet fetare, të çrrënjosen ato nga ndërgjegjja e njerëzve tanë. Për këtë duhet të punojmë të gjithë e të arrijmë, në radhë të parë, që njerëzit të mos agjerojnë, të mos mbajnë kreshmë, të mos falen, të mos festojnë pashkët, bajramin, ditën e emrit, të mos bëjnë djemtë synet, të mos i pagëzojnë fëmijët, të mos i bëjnë varrimet me prift e me hoxhë etj. Të gjitha këto nuk zhduken as me dekrete, as përnjëherësh dhe as vetëm me deklarata. Në qoftë se do të mbeteshim te deklaratat, atëherë puna e filluar do të ishte zjarr kashte, sepse atavizmi shekullor do t'i mbulonte deklaratat.

Atëherë si do të zhduken ato zakone të rrënjosura prej shekujsh? A kanë menduar thellë komitetet e Partisë se si do ta organizojnë sistematikisht këtë luftë të madhe e të vështirë politiko-ideologjike, me leksione, me thellim e zgjerim të iniciativave, me mbledhje të posaçme, me shtimin e aktivitetit të organizatës së rinisë dhe të organizatës së gruas në këtë punë etj., etj.? Kjo, mendoj, nuk është bërë si duhet dhe, po s'u bë një punë e tillë, nuk do të kemi rezultatet e dëshiruara dhe fajtorë për këtë nuk do të jetë

masa që beson, por ne, drejtuesit, që nuk kemi ditur dhe nuk kemi shfrytëzuar, organizuar e materializuar si duhet dhe kur duhet besimin, entuziazmin dhe gatishmërinë e masave.

Të marrim çështjen e emancipimit të plotë të gruas. Ky problem është shumë kompleks. Le të mos fillojmë që nga lindja e vajzës, megjithëse në mentalitetin e vjetër që këtej fillon nënveftësimi i së resë në krahasim me djalin, por ne duhet të kujdesemi që vajza të kryejë arsimin e detyruar dhe, ajo që është kryesore, të ndalohen me të vërtetë dhe totalisht fejesat në moshë të vogël. Partia kërkon heqjen e ngarkësës nga shpina e grave, ndryshimin e veshjes së tyre, zhdukjen e pajës dhe sidomos ndalimin e shitjes së femrës. Të gjitha këto, ta kemi të qartë, nuk zhduken pa një punë të dendur e të vazhdueshme sqaruese, politike dhe ideologjike, pa masa organizative, pa zbatimin me rreptësi të ligjeve që ekzistojnë.

Veç kësaj, duhet kuptuar se këto probleme nuk janë të shkëputura nga problemet ekonomike, përkundrazi, ato duhet të merren të lidhura ngushtë me to, sepse ndikojnë shumë te njëra-tjetra. Prodhimet bujqësore, për shembull, duhet të transportohen nga arë në depo, se ato nuk mund të lihen në arë, por kjo nuk do të thotë që për këtë të ngarkohen gratë. Kooperativa të sigurojë kafshët e ngarkësës. Heqja e ngarkësës nga kurrizi i gruas kërkon një punë të madhe edukative për të çrrënjosur konceptet e huaja që pengojnë. Është një mentalitet i tërë ky që duhet të ndryshojë. Për këtë kërkohet një punë e gjithanshme. Sepse ç'ndodh në praktikë? Burri ose gruaja në publik

mund të flasin drejt e në parim për këto gjëra, por në kokën e tyre mund të ruajnë konceptet e vjetra dhe në familje, me dashje ose pa dashje, veprojnë ndryshe. Prandaj na vihet detyrë të bëjmë një luftë të ashpër kundër këtyre koncepteve e njëkohësisht të kultivojmë konceptet e reja, të përhapim normat e reja socialiste në marrëdhëni të shoqërore midis njerëzve tanë. Partia të kuptojë se normat e reja, në radhë të parë, duhet t'i përvetësojë, t'i ketë të qarta e t'i përaqofojë çdo komunist, por ajo duhet të bëjë një punë të gjerë e të organizuar që këto norma t'i vendosë edhe në popull. Mirëpo kjo nuk bëhet me dekrete. Për këtë kërkohen bindje të thella, punë sqaruese kokë më kokë me njerëzit, kërkohet, në radhë të parë, shembulli i komunistëve. Ky është i domosdoshëm, por nuk mjafton, ai duhet të shoqërohet me argumentimin politiko-ideologjik të çështjeve dhe me forma të efektshme të organizimit të punës sqaruese e bindëse.

Partia, pra, duhet të jetë në ballë të luftës përzgjidhjen e këtyre problemeve, por ajo nuk mund t'ia dalë mbanë detyrës së saj historike në rast se nuk mobilizon dhe nuk edukon organizatën e Frontit, të rinisë, të gruas, të bashkimeve profesionale. Kjo që them nuk është diçka e panjohur, por situatat janë të tilla që Partia duhet t'i rishikojë format dhe metodat e punës, pasi shumë nga metodat e vjetra nuk janë më të përshtatshme. Edhe përpala janë marrë zotime të mos bëheshin fejesa që në vogëli, të mos blihej gruaja si kafshë, të hiqeshin litari i ngarkesës së shpinës dhe veshjet e rënda të gruas, por ç'u bë në realitet? Rezultatet nuk qenë ato që prisnim. Prandaj dalim

me konkluzionin se duhen gjetur forma e metoda pune të përshtatshme me situatat.

Nuk mund të punohet më me organizatat e Frontit, të rinisë, të gruas dhe të bashkimeve profesionale me të njëjtat metoda dhe me atë mentalitet si më parë. Opinion i masës nuk mund të konsiderohet e të trajtohet në mënyrë aq formale, siç konsiderohej më parë. Nuk mund të ecet më me atë formë e metodë pune të mbyllur, sektare, siç vepronin dhe punonin dje disa organizata-bazë partie, ku viheshin re tarafet, grindjet, mungesa e kritikës dhe e autokritikës, arroganca, mendjemandhësia dhe fshehja e të metave, e tendencave dhe e përfitimeve të dënueshme prapa tesarës së Partisë ose funksionit shtetëror.

As komitetet e Partisë, as byrotë e as aparatet e tyre nuk mund të mos e rishikojnë metodën e punës që, në disa raste, është skematike, rutinë e burokratike. Puna e Partisë është kolosale, e gjërë, pa kufi, që nuk mund ta bëjnë vetëm pesë ose njëzet veta. Këta, edhe sikur të jenë shumë të zotë (pale që ka prej tyre që vijnë rrëth me disa shifra, që e kanë zor të nxjerrin një konkluzion, që mezi hedhin dy radhë në letër), nuk mund t'ia dalin dot punës së madhe që ka Partia, prandaj duhet të mobilizohen të gjitha vlerat e njerëzve, pa lënë pas dore dhe prirjet më të vogla e të mira të një individi të thjeshtë.

Problemin, pra, e shtroj për të gjithë Partinë, nëse janë në lartësinë e duhur format e edukimit, të informimit, leksionet, vatrat e kulturës, konferencat, mbledhjet e shumta, a i përgjigjen ato situatës dhe hovit revolucionar, a i përgjigjen dot nivelistët të ngritur

të kuadrove të sotëm, që kanë mundësi të mëdha, por të pashfrytëzuara si duhet, për mungesë mobilizimi të mjaftueshëm e për të meta të metodës së punës, a i përgjigjen ato si duhet nivitet ideopolitik të masave të popullit, që ecin përpara? Unë mendoj se këto kanë dhënë rezultate të mëdha, por ka ardhur koha që të gjithë këtë punë ta përmirësojmë akoma, sepse nuk po ecim si duhet me kohën dhe me kërkesat e saj. Këto kërkesa të kohës mund t'i përbushim dhe do t'i përbushim vetëm duke analizuar më mirë punën dhe duke marrë masa rrënjosore për të bërë një hop cilësor. Asgjë nuk duhet t'ia lëmë spontaneitetit ose dëshirave individuale.

Merreni me mend, shokë, si do të ziejë komiteti i Partisë, si do të ziejë kabinetin Partisë etj., në qoftë se punojmë si duhet në të gjitha këto drejtime. Tani në komitetet e Partisë shkojnë disa njerëz të caktuar për punë zyrtare dhe ata që kanë ndonjë hall për të zgjidhur. Këtej e tutje ato duhet të kthehen në koshere bletësh punëtore, që punojnë të gjitha në mënyrë të organizuar dhe nxjerrin mjaltë.

Nuk ka çdo familje komunistë, por te secila rron një i ri i organizuar, një grua e organizuar, me një fjalë, të gjithë në familje bëjnë pjesë në një organizatë, rrojnë me frymën e re. Këta duhet të edukohen e të frymëzohen nga Partia.

E gjithë kjo mori kuadrosht e njerëzish të mrekullueshëm që rriten, prodhojnë, mendojnë e krijojnë, duan ndihmë, duan përkrahje, duan t'u hapet perspektiva e mëtejshme. Këtë duhet ta bëjnë organet udhëheqëse të Partisë në rreth, organizatat-bazë, duke pu-

nuar me ta, me masën, duke i vënë këta në lëvizje, duke shfrytëzuar kapacitetet e tyre fizike e mendo-re, duke i organizuar e drejtuar të gjitha këto ener-gji, për t'i kthyer në vlera materiale e shpirtërore. Ky është roli i madh i Partisë si udhëheqëse e po-pullit.

Iniciativa të mëdha po merren nga populli, nga masat punonjëse. Njoftimet për to botohen në gazetë, por, që të gjithë, duhet të nxjerrin mësime, sepse ka edhe shokë që ndiejnë vetëm kënaqësi kur i lexojnë dhe nuk bëjnë shumë përpjekje që këto iniciativa t'i studiojnë me syrin e mjekut të klinikës dhe t'i përshtatin deri në fund në rrethin e tyre, t'i përhapin, t'i popullarizojnë, të kapin edhe iniciativat e tjera të reja që lindin nga të parat, t'i përgjithësojnë, të përgatitin materialin propagandistik të veçantë për cilëndo dhe të mendojnë për masat organizative e të sigurojnë zbatimin e tyre.

Ka drejtues partie, të cilët presin që këto përgjithësime të bëhen nga qendra dhe materialet propagan-distike t'u dërgohen të gatshme. Kësaj i thonë të pre-sësh të të ushqejnë të tjerët. Sigurisht, nga udhëheqja e Partisë do të bëhen përgjithësime, por këto nuk mund të janë përgjithësime të një propozimi ose të një eksperience, po i shumë prej tyre. Troshanasit, për shembull, thanë që kuadrot e kooperativës të bëjnë nga 100 ditë-punë në vit drejtpërdrejt në prodhim, ata të Frashtanit kanë marrë vendim që të bëjnë edhe më shumë, kurse në kooperativa bujqësore të rretheve të tjera kuadrot s'kanë bërë as 100 ditë-punë, ose disa hiç fare. Përse disa komitete partie nuk e kanë vënë ujin

në zjarr për të vënë në zbatim propozimin e kuadrove të kooperativës së Troshanit?

Jo të gjitha rrethet dhe komitetet e Partisë në to e kuptojnë rëndësinë e madhe politike dhe ekonomike të iniciativës së troshanasve ose të frashtanjotëve. Ato nuk po kuptojnë sa duhet se këto iniciativa revolucionarizojnë më tej konceptet e metodat e drejtimit, vendosin norma të reja në këto çështje, norma me një përbajtje më të thellë revolucionare marksiste-leniniste. Iniciativa e troshanasve, që kuadrot edhe të drejtojnë, edhe të punojnë drejtpërdrejt në prodhim, është një vendim i drejtë prej revolucionarësh, që duhej kapur përnjëherësh dhe gjer tani duhej të ishte përgjithësuar, por shumë kuadro ende nuk e kanë vlerësuar.

Përse ngjet kjo? Sepse tek ata mbizotëron koncepti që kryetari i kooperativës bujqësore, drejtori i ndërmarrjes, drejtori i shkollës ose brigadieri duhet vetëm të drejtojnë, të kontrollojnë, të udhëzojnë, por jo të punojnë drejtpërdrejt në prodhim. Natyrisht, gjenden shumë arsyë për ta mbajtur në këmbë këtë koncept dhe arsyja kryesore është ajo e kohës, sipas së cilës kuadrove, gjoja, nuk u mjaftoka koha që edhe të drejtojnë, edhe të punojnë në prodhim. Për ta përforuar këtë «arsye» të mbushin dëng me thënie të tilla, si: «Kryetari ose drejtori ka përgjegjësi të madhe, ai duhet ta ketë syrin kudo, të vejë kudo, ai duhet t'i përgjigjet çdo punëtori ose kooperativisti, duhet t'i përgjigjet ministrisë ose komitetit ekzekutiv, duhet të drejtojë edukimin, të kontrollojë realizimin e planit, ai ka telefonat, shkresat etj., etj.». Një libër të tërë mund të mbushësh me gjëra të tilla.

Në iniciativat e lavdërueshme që lindin ka një frymëzim të madh ideologjik dhe politik, sepse ata që i marrin e i zbatojnë, shkrihen me masat, zvogëlojnë hapjen e gérshërës midis punës mendore dhe asaj fizike. Njerëzit që u frymëzuan në këtë mënyrë dhe morën këto iniciativa, e kuptojnë drejt rrugën ku shkojnë Partia dhe masat, rrugën e revolucionarizimit, jo vetëm të disave, por të të gjithë popullit. Duke ecur në këtë rrugë, Partia edukon se cilin punonjës të bëhet çdo ditë e më shumë i ndërgjegjshëm për të kryer si duhet detyrat e tij në punë, në jetë dhe në shoqëri, gjë që e lehtëson shumë barrën e brigadierëve, drejtoreve, kryetarëve ose kontrollorëve, të cilët, aktualisht, merren me mjaft punë që kanë karakter burokratik.

Kur Partia lufton me sukses në gjirin e klasës punëtore, të kooperativistëve, të trupit mësimor dhe i bën ata të ndërgjegjshëm për rëndësinë e pronës socialiste, të punës, të edukimit, për kuptimin e drejtë të normave dhe realizimin e tyre, për vënien e interesit të përgjithshëm mbi interesin vetjak, atëherë përse duhet që brigadieri, skuadërkomandanti e të tjerë të kalojnë kohën me disa funksione që vetë masa punëtore apo kooperativiste i ka bërë dhe çdo ditë po i bën të vetat? Përse të mos kenë mundësi kuadrot e kooperativës të punojnë një pjesë të kohës në prodhim, gjersa kanë një kolektiv të tillë të mrekullueshëm, që i kupton drejt detyrat e tij? Pra, gjithçka është e mundshme, natyrisht, duke parashikuar edhe disa thjeshtime të mëtejshme në punët administrative.

Vij përsëri në atë që thashë më parë: shokët që po kritikojmë dhe që përsëritin vazhdimesh fjalët: «Të

dëgjojmë eksperiencën e masave», «Të mësojmë nga masat», përse nuk e kanë dëgjuar këtë eksperiencë dhe përse nuk kanë shkuar kooperativë më kooperativë, organizatë më organizatë dhe të bënин që eksperiencia e troshanasve të vihej menjëherë në zbatim? A do të lejojnë më këta shokë që të gjitha këto iniciativa, që po merren nga punonjësit tanë të mrekullueshëm, të kalojnë vetëm duke lexuar pranë zjarrit çfarë shkruhet në shtyp për to dhe të kënaqen me kaq? Jo. Prandaj duhet të ndërrojmë metodën dhe stilin në punë.

Kuadrot dhe komitetet e Partisë, që nuk e kanë vënë si duhet ujët në zjarr për këto propozime kaq të mëdha, nuk kanë kuptuar përfitimet e pallogaritshmë që do të vinin nga zbatimi i këtyre iniciativave në kalitjen e njerëzve dhe sidomos të kuadrove, të cilët duhet të lyejnë duart me vaj dhe këpucët me baltë, që hallet, nevojat dhe punët të mos i shohin vetëm nga lart, në mënyrë që, kështu, edhe te njerëzit që drejtojnë, të zhduken shfaqjet e burokratizmit, të mendjemadhësisë dhe të arrogancës, fryma e komandimit dhe e hatëreve që lindin më shumë tek ata që, duke u veshur me pushtet, mendojnë se janë të vëmit që krijojnë çdo gjë, se pa ata puna nuk ecën.

Nga ana tjeter, me përgjithësimin e këtyre iniciativave, ne do t'i sillnim ekonomisë së vendit tonë një përfitim kolosal, se të gjithë këta shokë, që do të vazhdojnë të drejtojnë dhe njëkohësisht të punojnë, nuk janë një ose njëqind veta, por me mijëra dhe ekonomia e përbashkët popullore do të kishte kështu fitime shumë të mëdha.

Pra, po t'i kishin thelluar të gjitha këto kuadrot dhe shumë komitete të Partisë, ne do të realizonim më shpejt dhe më mirë atë që kërkon Partia: ruajtjen e pastërtisë së kuadrove, për të mos lejuar të shfaqet rreziku i krijimit të asaj shtrese burokratësh dhe aristokratësh që po shohim të ngrihet si një forcë e tmerrshme në vendet kapitaliste dhe revizioniste.

Të gjithëve na gëzon fakti se iniciativa aq e lartë e arsimtarëve të Mirditës ka marrë një zhvillim shumë të mirë dhe po jep rezultate të mëdha jo vetëm në këtë rreth. Nga raporti i Komitetit të Partisë të Rrethit të Kolonjës shohim se edhe këtu, s'ka dyshim edhe në rrethe të tjera të vendit tonë, rezultatet janë të konsiderueshme.

Shokët e rrethit të Mirditës, që po ndjekin me aq guxim e pjekuri rrugën e ndritur të Ndrec Ndrec Gjokës, të këtij militanti të shquar të arsimit të Shqipërisë së re, vunë në lëvizje dhe gjallëruan këtë aktivitet të gjerë e të lavdérueshëm, duke materializuar e zbatuar në jetë vijën e Partisë, për përhapjen e arsimit dhe të kulturës në masat. Rezultatet e arritura në kuadrin e kësaj lëvizjeje duhet të na shërbejnë si bazë e mirë nisjeje për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës, duke kaluar nga rrethi në shkallë Republike. Punimet me vlerë të arsimtarëve të rretheve të ndryshme të vendit janë me rëndësi të madhe jo vetëm lokale, por edhe kombëtare.

Shokët e rretheve kritikojnë me shumë të drejtë punonjësit e kulturës të kryeqytetit, që pak i ndihmojnë, qoftë në metodikën e punës së tyre, qoftë në

përgjithësimin dhe vënien e kësaj krijimtarie në dispozicion të të gjithë popullit. Unë do të thosha se në mes të njerëzve të kulturës të kryeqytetit, në mes atyre që zakonisht i quajmë «të afirmuar», gjen mjaft nga ata që kanë një konsideratë aq të madhe për çka krijojnë vetë, saqë mbyllen në vetvete, në biblioteka. Të tillë njerëz merren me disa tema ose gjini, duke u orientuar veçanërisht nga studimi i disa autorëve, që shumë herë i ka mbuluar pluhuri i kohës, dhe përbuzin ose harrojnë të konsultohen dhe të mësojnë nga biblioteka e madhe e popullit, nga ajo bibliotekë e mrekullueshme, e gjallë, dinamike, që në çdo minutë të jep temë, të hap perspektiva, të jep forma dhe metoda pune krijuese.

Ka nga këta njerëz «të afirmuar» të kulturës që, edhe kur shkojnë në bazë, këtë e bëjnë me qëllime të ngushta dhe egoiste, për të plotësuar vetëm studimet e temat e tyre të paracaktuara, të cilat disa herë janë të demoduara, disa herë joaktuale, disa herë me qëllime thjesht arkivale, për të përforcuar te të tjerët atë bindje që ata kanë formuar për veten e tyre se këta janë «shkencëtarë», «dijetarë». Ka edhe disa që përvetësojnë në mënyrë të pandershme krijimet me vlerë të shumë njerëzve të thjeshtë ose që dokumente me vlerë të madhe për popullin i mbajnë të mbyllura në sirtarët e tyre. Këta njerëz duhet t'i zhveshim nga këto vese, t'i edukojmë dhe t'i bëjmë të vlefshëm për kulturën popullore.

Mendoj se është e nevojshme që udhëheqja e Partisë, të paktën një herë në vit, të bëjë bilancin e krijimtarisë së madhe në fushën e kulturës, pa përfshire

këtu ndihmën e vazhdueshme që duhet t'u japim rretheve gjatë gjithë vitit. Kur them të bëjmë bilancin nuk do të thotë t'i marrim në raport të gjitha rrëthet me radhë, siç po bëjmë sot me disa rrethe, por Ministria e Arsimit dhe e Kulturës të marrë masa organizative që të dërgojë konkretisht në vend, në çdo rreth, ekipe të veçanta e kompetente, me detyra konkrete të caktuara për të shoshitur se cila krijimtari është e nevojshme dhe si duhet të bëhet pronë kombëtare, e cila të përgjithësitet, duke u botuar, duke u kënduar, duke u luajtur në skenë; cili gërmim arkeologjik duhet vënë në dukje ose duhet zgjeruar; çfarë fondesh materiale dhe ç'ndihmë me teknikë ose me kuadro kërkohen etj., etj. Kështu propozoj që çdo vit të bëhet ky bilanc, i cili do të jetë një ndihmë konkrete dhe do t'i japë një hov të mëtejshëm lëvizjes që kanë ndërmarrë arsimtarët. Kjo do të jetë jo vetëm një nxitje, por edhe një satisfaksion moral për këta punonjës të palodhur të arsimit dhe të kulturës popullore.

Dëshiroj, gjithashtu, t'u sugjeroj shokëve të studijnë mundësinë e organizimit, jashtë aktivitetit vjetor, të ekipeve të kulturës, të paktën për një muaj ose për 15 ditë (këtë ta përcaktojnë vetë rrëthet), të formuar nga mësues dhe nxënës, me një program kompleks historik, artistik, kulturor, me fotoekspozita, që t'i shërbejë sidomos materializimit e konkretizimit të problemeve të mprehta aktuale, siç janë lufta kundër fesë e zakoneve prapanike, problemet e emancipimit të gruas e të së resë etj. Këto tema dhe ky program, natyrisht, duhet të përgatiten bukur, me ndodhi, me le-

gjenda, me recitime, me skeçe, të gjitha têrheqëse dhe me qëllime edukuese, ashtu siç na mëson Partia.

Arsimtarët e rrethit të studiojnë dhe të caktojnë vetë, në vija të përgjithshme, programet, grupet e arsimtarëve dhe fshatrat e rrethit ku do të shkojë se-cili grup. Pastaj çdo grup të përcaktojë nxënëset dhe nxënësit më të mirë e më të talentuar, të përgatitë programin dhe, kur vendoset, të dalë në turne. Pastaj grupet më të mira të kalojnë nga një rreth në tjetrin, duke filluar nga më të afërmit dhe pastaj te më të largëtit. Besoj që kjo do të bëjë një efekt të madh në popull. Më vonë, eksperienca do të na mësojë ta përmirësojmë dhe ta pasurojmë këtë punë.

Edhe një gjë dëshiroja të shtoja. Ne, natyrisht, brenda mundësive tonë, duhet t'i shtojmë librat që mungojnë dhe që kërkohen kudo. Ndihma materiale e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës për këto aktivitete të jetë më e mirë dhe e studiuar më nga afër. Ajo mund të bëjë shumë gjëra me fondet që ka, duke i administruar ato në formë joburokratike.

Më në fund, lidhur me propozimin që u bë, mendoj që lëvizja e arsimtarëve të vihet nën drejtimin e organizatës së bashkimeve profesionale, që ka në gjirin e saj një numër të madh anëtarësh, mësues dhe kuadro të tjerë në fshat, që gjer tanë, në fakt, janë lënë pothuajse të gjithë pa u aktivizuar. Pra, duke e marrë në dorë këtë çështje bashkimet profesionale, ku hegjemone është klasa punëtore e udhëhequr nga Partia, puna edukative ideologjike, politike dhe kulturore me masat do të zhvillohet në mënyrë më frytdhënëse. Kështu, nëpërmjet bashkimeve profesionale, do të futet

në fshat fryma revolucionare e klasës punëtore. Ky problem mendoj se mund të trajtohet edhe në kongresin e ardhshëm të Bashkimeve Profesionale.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## SHTYPI KA NEVOJË PËR NDIHMËN E PARTISE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

23 mars 1967

Jam dakord me të gjitha vërejtjet dhe plotësimet që bënë shokët rrëth raportit, por, dëshiroj të shtoj që, në qoftë se i kërkojmë dhe duhet t'i kërkojmë shtypit shumë gjëra, atëherë të mos harrojmë që edhe ta ushqejmë atë, se shtypi ka nevojë për ndihmën e Partisë. Nuk është e drejtë të mendohet që në shtyp duhet të shkruajnë vetëm shokët që janë profesionistë, ose vetëm ata që janë në qendër. Në qoftë se kjo çështje do të kuptohej kështu, atëherë shtypi nuk do t'u përgjigjej currë nevojave tona.

Që në shtyp të zbërthehen si duhet dhe jo mekanikisht direktivat e Kongresit të Partisë, është e domosdoshme që në të të flitet për zbërthimin dhe zbatimin e tyre në bazë. Baza i kuption relativisht mi-

---

I Në këtë mbledhje u diskutua rrëth raportit «Mbi ngritjen e rolit revolucionarizues, edukues dhe organizues të shtypit e të radios në përshtatje me kërkesat dhe detyrat e mëdha që shtroi Kongresi i 5-të i PPSH».

rë edhe teorikisht, edhe organizativisht direktivat e Partisë dhe ashtu siç i kupton, edhe i zbaton. Në këtë drejtim kemi rezultate, por rrallë shohim që ndonjë sekretar komiteti partie, kryetar komiteti ekzekutiv, ose ndonjë kuadër tjetër partie ose pushteti, që ka kulturë dhe punon aktivisht për zbatimin e direktivave të Partisë, të shkruajë në këtë ose në atë organ të shtypit për zbërthimin e direktivave të Partisë. Zbërthimin e këtyre direktivave, që është një punë me përgjegjësi shumë të madhe, nuk duhet ta kérkojmë nga redaktorët e gazetave pa e kérkuar, në radhë të parë, nga sekretarët e parë të komiteteve të Partisë. Këta kanë mundësi ta bëjnë këtë në shumë drejtime, por mjaft nga sekretarët e komitetit të Partisë nuk kujtohen të shkruajnë për një problem (dhe probleme për të shkruar nuk ka një, por me qindra), që edhe vetë e gjykojnë të rëndësishëm, të bëjnë për të një artikull pa ua kérkuar njeri. Bile, ndodh që, edhe artikujt që u kérkohen, i bëjnë shkel e shko, duke i mbushur me fraza të përgjithshme dhe i zvarritin aq, saqë, kur botohen, u ka ikur koha. Kjo nuk është aspak e drejtë.

Në qoftë se kuptohet mirë kjo çështje, atëherë, qoftë për shokët e aparatit të Komitetit Qendror, që merren me këtë problem, qoftë për punonjësit e radios dhe të organeve të ndryshme të shtypit, vihet detyra që të punojnë për të përgjithësuar eksperiençën e gjertanishme dhe për të bërë që korrespondentët dhe bashkëpunëtorët kryesorë të shtypit në rrethe të specializohen. Te redaktorët tanë ka njëfarë specializimi që duhet zhvilluar më tej, pa kérkuar që në ga-

zetat tona të kemi një mori njerëzish profesionistë të specializuar, siç ndodh në shtypin borgjez, ku ka me qindra korrespondentë të specializuar, të cilët merren me përpunimin e një vije të caktuar. Shtypi borgjez kërkon të ketë njerëz të specializuar për çdo problem, sepse nuk mbështetet te njerëzit që merren drejtpërsë-drejti me bujqësinë, industrinë etj. Kurse shtypi ynë nuk ka karakter të tillë, prandaj nuk mund ta ndjekë këtë praktikë.

Shtypi te ne ka karakter masiv, por kjo nuk do të thotë që redaksitë nuk luajnë rol. Këto nuk mund dhe nuk duhet të qëndrojnë në bisht të situatës, domethënë të mjaftohen me materialet që u dërgohen gazetave dhe të mos punojnë vetë. Krahas botimit të shkrimeve të bashkëpunëtorëve për probleme të ndryshme, redaktori duhet të mendojë edhe vetë, të bëjë përgjithësimë, të bëjë një artikull ku ta thotë me kompetencë fjalën për një problem të veçantë, të shkojë në bazë për ta parë një çështje në vend, të vërë në lëvizje korrespondentët vullnetarë etj. Por, për t'u realizuar të gjitha ato detyra, nuk mjaftojnë vetëm redaksitë e gazetave.

Komunistët, duke filluar nga shokët sekretarë të komiteteve të Partisë, të organizatave-bazë e gjer tek anëtari i thjeshtë, duhet ta kuptojnë se janë njëkohësisht agitatorë dhe propagandistë të vijës së Partisë dhe si të tillë, si njerëz me eksperiencë të madhe, ata duhet të thonë edhe në shtyp ç'mendon Partia. Në qoftë se sekretari i komitetit të Partisë nuk është në gjendje të pasqyrojë si duhet situatën, të nxjerrë konkluzione për të shëndoshur "punën" e organizatave-bazë

dhe të gjitha këto t'i shkruajë në një artikull, atëherë ne do të vazhdojmë të shikojmë shumë rrallë në gazetë artikuj që përgjithësojnë eksperiencën, sepse vetëm gazetarët nuk mund ta bëjnë dot kurrë këtë gjë.

Por mendoj se duhet parë edhe një problem tjeter. Ndodh, në praktikë, që shumë nga artikujt e botuar në shtyp e që përgjithësojnë eksperiencën e punës së Partisë nuk lexohen nga të gjithë, ashtu siç ndodh që u dërgojmë herë pas here komitetet e Partisë materiale ku përgjithësohen çështje të ndryshme, por, për arsy se mbi to shkruhet «për përdorim të brendshëm», ato mbeten vetëm në duart e drejtuesve kryesorë të Partisë në rrethe, bile, shpesh, edhe këta nuk i përdorin kur venë nëpër organizatat-bazë. Në qoftë se duam që shtypi të jetë i masave dhe të pasqyrojë në nivelin e duhur jetën e Partisë dhe të vendit, me të mirat dhe të metat e saj, është e domosdoshme që atje të bëhen përgjithësime teorike, politike dhe ekonomike, por kjo kërkon që të ndryshohet metoda e punës.

Drejt u tha këtu që në shtyp duhet «të ruajmë masën» për çdo problem. Këtë ta kenë parasysh të gjithë dhe në mënyrë të veçantë drejtuesit e shtypit, që të mos kalojnë sa nga një ekstrem në tjetrin. Situata e kërkon që në një moment t'i jepet përparësi këtij ose atij problemi, por kjo, në asnjë mënyrë, nuk do të thotë të lihen pas dore çështjet e tjera. Sot, për shembull, duke trajtuar me të drejtë problemet tona të brendshme, që kanë rëndësi të madhe jo vetëm ekonomike, po dhe politike e ideologjike, nuk na lejohet

të harrojmë të tjerat, siç është, fjala vjen, lufta kundër revizionizmit ose puna për realizimin dhe tejkalimin e planeve të prodhimit. Një gjë e tillë nuk është aspak e mirë. Por përsë ndodh që në shtypin tonë të mos ruhet masa? Kjo më duket se nuk rrjedh vetëm për arsyen e forcave të pamjaftueshme që punojnë në shtyp, por edhe të ngritjes ideologjike e kulturore jo në nivelin e duhur të njerëzve tanë. Në qoftë se u bëhet e qartë dhe vihen në lëvizje të gjithë sekretarët e komiteteve të Partisë, kryetarët e komiteteve ekzekutive të rretheve dhe kuadrot kryesorë të ekonomisë, në qoftë se atyre u kërkohet dhe u planifikohen çështjet që duhen trajtuar, atëherë qendra do të ketë mjaft kohë disponibël të mendojë, të bëjë përgjithësimë, të japë edhe orientime. Kështu do të vijë më mirë në qendër edhe zëri i bazës, prandaj, edhe në këtë drejtim, duhet bërë një kthesë.

Mendoj të shihet edhe çështja nëse ka mungesa për kuadro në organet kryesore të shtypit dhe të propagandës apo jo, dhe në cilat nga këto organe ka më shumë mungesa. Për plotësimin e tyre me kuadro të aftë, që do ta përmirësonë më tej punën e organeve të shtypit e të propagandës, do të ishte mirë të ngarkohej një ekip, që të përcaktonte se cilët kuadro kanë aftësi dhe mund të merren me shtypin, si janë dhe ku janë ata (se njerëz të tillë kemi jo vetëm në organet qendrore të shtypit, por edhe gjetkë si në bujqësi e në çdo sektor) dhe pastaj të bëhej një ndarje e re e tyre, sipas rëndësisë dhe nevojave të çdo organi, profitit të tyre dhe eksperiencës së kuadrove që do të punojnë në to.

Për sa i përket propozimit që u bë, për botimin e disa gazetave lokale, mendoj që, tanë për tanë, të pranojmë që ato të nxirren në katër rrethe kryesore si: në Durrës, në Shkodër, në Korçë dhe në Gjirokastër, sepse jam i bindur që këto rrethe kanë edhe më shumë probleme. Jam i mendimit që Tirana të mos ketë gazetë lokale, për arsy se këtu dalin dy gazeta të mëdha qëndrore të përditshme, ka abonime të shumta dhe një zhvillim kulturor më të madh, kurse në rrethet që përmenda nxjerra e gazetës është e nevojshme jo vetëm për të komunikuar me punonjësit dhe për të dhënë udhëzime për problemet e rrethit, por, nëpërmjet gazetës, atje do të shfrytëzohen më mirë edhe aftësitë e njerëzve të kulturës e të ekonomisë.

Nuk jam dakord që redaksia e gazetës «Llaiko Vima» të sillet në Tiranë. Këtë gazetë ne e kemi për minoritetin grek, për të dërguar direktivat politike dhe ekonomike të Partisë në popullsinë e minoritetit, prandaj redaksia e kësaj gazete të qëndrojë ku është, në Gjirokastër, për të qenë afër bazës. Sikur ta sillnim redaksinë e saj në Tiranë, gazeta do të shkëputet nga problemet e bazës dhe do të humbiste karakterin që ka. Njerëzit që e lexojnë janë të kënaqur nga përbajtja e kësaj gazete, megjithatë duhet parë mundësia e përmirësimit të mëtejshëm të saj.

Jam dakord, në vija të përgjithshme, për plotësimin e kërkesave që u bënë, të cilat nuk mund t'i shikojmë dot këtu një për një, prandaj shokët e shtypit t'i bisedojnë ato konkretisht me shokun Ramiz dhe me Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës. Byroja Politike është dakord që të plotësohen të gjitha kér-

kesat e drejta, me qëllim që propaganda Jonë nëpër-mjet shtypit, radios dhe ATSH-së të forcohet edhe më shumë në të ardhmen.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verball i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

# PUNA NË PRODHIM U SHËRBEN KALITJES DHE EDUKIMIT

*Diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

23 mars 1967

Duke u mbështetur në raportin që na është paraqitur, mendoj se pjesëmarrja në punën prodhuese është një problem i tërë që duhet studiuar. Në radhë të parë, ne duhet të studiojmë çështjen e pjesëmarrjes në punë prodhuese të nxënësve dhe të studentëve. Nuk është fjala që nxënësit apo studentët të bëjnë gjysmë dite më shumë ose më pak punë praktike, por te proporcioni që duhet të zënë në programet e shkollave teoria dhe praktika. Këtu u dhanë mendime të ndryshme për këtë problem kompleks. Por duhet pasur parasysh që, përveç punës praktike, nxënësit dhe studentët do të shkojnë edhe në aksione, në hekurudhë ose në ndërtimin e rrugëve automobilistike në Veri. Mendoj që puna për përgatitjen e studimit të këtij

---

I Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit: «Për pjesëmarrjen e kuadrove dhe të inteligjencies në punë prodhuese».

problemi të fillojë menjëherë, me qëllim që në prag të vtitit të ri shkollor ai të jetë i aprovuar. Studimi mund të mos i trajtojë konkretisht e në hollësi programet e shkollave, për shembull, sa kohë do të bëjnë nxënësit teori, shtatë apo tetë muaj, por edhe këtu duhet caktuar një masë. Pastaj duhet parë edhe se sa kohë do të bëjnë nxënësit e studentët punë praktike dhe sa punë vullnetare. Të dyja këto, edhe pjesëmarrja në punën vullnetare në aksione, edhe puna praktike të parashikuara në programet e shkollave, kanë rëndësi si për karakterin kompleks të shkollës sonë, ashtu dhe për zhvillimin e saj në perspektivë.

Çështja e dytë është pjesëmarrja e kuadrove të kooperativave bujqësore në punën prodhuese. Mund të vendosim edhe tani që këta kuadro, sipas iniciativës së kuadrove të kooperativës bujqësore të Troshanit, të mos bëjnë më pak se 100 ditë-punë në prodhim në vit, po në qoftë se ka probleme që duhen parë më mirë, atëherë le të studiohet edhe kjo çështje dhe të na paraqitet.

Së treti, duhet parë edhe çështja e kuadrove që punojnë në qendra prodhimi. Puna e këtyre është e ndryshme nga ajo e punonjësve të administratës. Në çdo ndërmarrje prodhimi kemi një drejtor, disa brigadierë, kontrollorë e të tjera. Edhe për këta më duket se duhet studiuar problemi i kohës që duhet të punojnë në prodhim. Gjersa ta studiojmë dhe të vendosim për këtë, puna në prodhim të vazhdohet kudo sipas iniciativës që kanë marrë kolektivat e ndryshëm.

Përveç kuadrove të prodhimit, në ndërmarrje kemi edhe punonjësit e administratës, për të cilët duhet

caktuar, gjithashtu, nëse duhet të bëjnë 15 ditë apo një muaj punë në prodhim. Në caktimin e kësaj kohe duhen pasur parasysh edhe stërvitjet ushtarake që bëjnë punonjësit. Të gjitha këto ne duhet t'i shikojmë në kompleks. Me këtë nuk dua të them që këtyre kuadrove t'u ulim kohën e punës prodhuese, por, para se të marrim vendimin, ta llogaritim mirë që punonjësi i administratës të kryejë si duhet edhe punën që i është caktuar, të bëjë mirë edhe të tjerat, si punën prodhuese, stërvitjen ushtarake etj.

Së fundi, për sa i përket qarkullimit të kuadrit, mendoj që çdo institucion, sipas nomenklaturës, ta shikojë me kujdes këtë çështje dhe lëvizja e kuadrove të bëhet me kriter dhe e studiuar mirë. Për qarkullimin e kuadrove duhen mbajtur parasysh kushtet konkrete. Diku ky qarkullim mund të bëhet pa vështirësi, kurse në një qendër tjetër pune, mund të paraqesë ndonjë vështirësi. Mund të ndodhë, gjithashtu, që një kuadër, për arsyet e ndryshme, të mos e lëvizësh dot menjëherë, megjithëse ai duhet qarkulluar. Në këto raste, sidomos, puna në prodhim duhet të bëhet e tillë që jo vetëm t'u shërbejë kalitjes dhe edukimit të atij kuadri, por edhe të kompensojë atë që do të bënte qarkullimi i tij.

Ne duhet të vendosim që qarkullimi i kuadrove të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt. Mendoj se duhet bërë rregull që ky ose ai kuadër i dalë nga shkolla të tërhoqet në qendër pasi të ketë punuar disa vjet në bazë, sepse në qendër duhet të vijnë njerëz të pjekur, që të kenë edhe eksperiencën e bazës. Afati minimal i qëndrimit të kuadrove në ba-

zë, që mund të caktohen më vonë me punë në institucionet qendrore, duhet parë me kujdes dhe jetë, praktika do të na tregojnë më mirë sa duhet t'i lëmë ata në bazë.

Në qoftë se jeni dakord me sa thashë, atëherë mendoj që Qeveria dhe Komiteti Qendror të ngrenë një komision, i cili t'i shikojë të gjitha këto probleme, të dalë me propozime për afatet dhe t'ia paraqesë studimin Byrosë Politike për të marrë vendim. Gjersa të përgatitet plotësisht ky studim dhe të dalë definitivisht vendimi i përbashkët i Komitetit Qendror dhe i Qeverisë, të vazhdohet siç është vepruar gjer tanë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **TE FORCOJMË MË TEJ KOOPERATIVAT BUJQÈSORE TË MALESISE**

*Fjala e mbajtur në aktivin e Partisë  
të rrethit të Krujës*

**24 mars 1967**

Pikësëpari, dëshiroj të shpreh gjëzimin e madh që marr pjesë në këtë aktiv, i cili na jep një material të vlefshëm pune dhe eksperience, që do të na ndihmojë shumë si ne, ashtu dhe ju. Me këtë rast ju sjell përshtendetjet dhe përgëzimet e shokëve të Byrosë Politike të Komitetit Qendror për sukseset e shumta dhe të mira që keni arritur në të gjitha punët dhe në mënyrë të veçantë në realizimin me sukses të kolektivizimit të bujqësisë në malësinë e rrethit të Krujës, për të cilin po mbahet edhe ky aktiv.

Unë studiova me vëmendje të madhe raportin që u mbajt këtu në emër të komitetit të Partisë të rrethit, dëgjova gjithashtu me vëmendje diskutimet e shokëve të aktivit dhe jam i bindur se ky aktiv do ta konsolidoië dhe do ta forcojë më tej kolektivizimin në zonën e malësisë, ku ju korrët suksesin e parë me kolektivizimin e gati të gjithë tokës dhe të ekonomive fsha-

tare. Konsolidimi ose forcimi i mëtejshëm i kooperativave bujqësore, veçanërisht në malësi, duhet të na bëjë të mos kënaqemi me hapin e parë që kemi bërë, por mbi bazën e arritur ta thellojmë punën në dy drejtime: së pari, në drejtim të shpjegimit sa më të plotë politik dhe ideologjik të këtij problemi jetik dhe, së dyti, në drejtim të thellimit, të përmirësimit dhe të përsosmërisë së organizimit të punëve në kooperativa. Këto dy drejtime duhet të janë objektivi kryesor i punës së Partisë dhe i kooperativistëve. Këto janë vendimtare për përparimin e shpejtë dhe të mirë të kooperativave.

Ç'duhet kuptuar, në fakt, me thellimin e mëtejshëm ideologjik dhe politik të problemit të kolektivizmit?

Në përgjithësi, fshatarët që u bashkuan vullnetarisht në kooperativa, e kuptojnë rëndësinë e kolektivizmit të bujqësisë. Ata kanë besim të madh në direktivën e Partisë se vetëm duke ecur në rrugën e ndërtimit të socializmit në fshat do të përparojnë ekonomikisht, politikisht dhe nga ana arsimore e kulturore. Këtë besim ata e kanë krijuar nga realizimet e mëdha dhe nga ndryshimet rrënjosore që kanë bërë vendi dhe populli ynë drejt përparimit, veçanërisht në bujqësinë tonë socialiste.

Kolektivizimi i bujqësisë në malësinë tonë, i kryer kohët e fundit në një periudhë shumë të shkurtër, është një fitore e madhe. Kjo vërteton se puna dhe lufta e drejtë e Partisë, rezultatet e mëdha të arritura më parë në kolektivizimin e fshatrave të fushës e kishin përgatitur politikisht dhe ideologjikisht terrenin

për arritjen e këtij suksesi. Por, si në çdo punë, ashtu edhe në kolektivizimin e fshatrave të malësisë, nuk duhet harruar e as nënveftësuar, gjithashtu, fakti se kalimi nga një formë jetese, mendimi, organizimi dhe konceptesh në një formë tjetër nuk bëhet menjëherë, pa ngurrimë, pa hezitime, pa pishmanllëqe.

Të gjitha këto që u manifestuan pak a shumë gjatë fushatës, bile edhe te komunistët, dhe jo vetëm në rrethin tuaj, u kapërcyen nga ideja e madhe e kolektivizimit. Mirëpo nuk mund të mendojmë se ato u zhdukën definitivisht, mbasi, ku më shumë e ku më pak, vazhdojnë të ekzistojnë në ndërgjegjen e kooperativistëve dhe të komunistëve. Te disa këto zhduken më shpejt dhe në mënyrë të përhershme, në të tjerë shfaqen herë pas here në forma të ndryshme, kurse te disa të tjerë durojnë më me këmbëngulje dhe veprojnë në drejtim të kundërt.

Çfarë duhet të bëjmë ne që të konsolidohet ky hop cilësor, që i bëri fshatrat me ekonomi individuale të kalojnë në ekonomi kolektive? Ç'ndryshim rrënjesor, pra, u bë në këtë mes dhe ku duhet ta përqendrojmë ne të gjithë vëmendjen tonë?

Ndryshimi i madh kolosal material është kapërcimi nga prona individuale në pronën e përbashkët, në pronën kolektive. Ky është një revolucion që ka anën e vet ideologjike dhe atë materiale.

Materialisht ky revolucion u realizua me krijimin e kooperativave dhe me kohë kjo punë do të shkojë duke u thelluar e duke u perfekcionuar (pa harruar se ekzistojnë edhe oborret personale që ne i lejojmë përtë ndihmuar ekonomikisht kooperativistët).

Por ideologjikisht neve na duhet të punojmë shumë, sepse, pavarësisht nga sukseset që kemi pasur dhe pa të cilat nuk mund të qe arritur suksesi i parë, kjo, ana e revolucionarizimit të ndërgjegjes socialiste të njerëzve, veçanërisht të fshatarëve, bëhet më me zor, më me ngadalë dhe në këtë drejtim hasim e do të hasim në vështirësi të kapërcyeshme. Përse i hasim këto vështirësi dhe ku e kanë ato burimin. Në radhë të parë, në pikëpamjen mbi pronën private. Shumë shokë mendojnë se këtë çështje do ta zhdukin me disa fraza të përgjithshme ose vetëm me masa organizative, ose, ca më keq akoma, me masa administrative dhe, ndonjëherë, kur gjejnë rezistencë, njerëzit që ruajnë të gjallë ndjenjën e pronës private, i cilësojnë si armiq. Kjo është një çështje serioze. Për pikëpamjet mbi pronën private anëtarët e Partisë duhet të studiojnë teorinë e klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe dokumentet e Partisë, pse pa e pasur këtë të qartë, nuk mund të luftohen si duhet shfaqjet e dëmshme, nuk mund të kuptohet e të konsolidohet si duhet prona e përbashkët socialiste.

Por t'i lëmë hëpërhë mënjanë përcaktimet teorike dhe ta shohim më konkretisht në praktikë këtë teori. Malësia dhe malësorët tanë janë patriotë të flaktë, besnikë të Partisë e të lidhur si mishi me thoin me të. Por, pavarësisht se ata ecin si një trup i vetëm me të gjithë vendin drejt rrugës së ndritur të socializmit, në të cilën na udhëheq Partia, pavarësisht se arsimi dhe kultura atje, si në të gjithë vendin, po zhvillohen me vrull, pavarësisht se, si i gjithë vendi, edhe malësia përfiton nga të mirat e socializmit për arsyet që

dimë, Partia me plot ndërgjegje lejoi në këto zona (sa të krijuar kushtet) ekzistencën gjer tani të pronës private mbi tokën, mbi kafshët, mbi mjetet e prodhimit etj. Ruheshin, pra, kështu te malësorët ndjenja e pronës private dhe, ku më shumë e ku më pak, rrjedhimet e këqija që e kanë burimin tek ajo.

Pa qenë i shkëputur nga zhvillimi i përgjithshëm i vendit dhe nga politika e përgjithshme e Partisë (dhe të dy këta ishin faktorët që ndihmuani për arritjen e kolektivizimit në malësi), malësori jetën e tij e mbështete kryesisht në pronën individuale. Duke punuar tokën me mjetet e prodhimit në pronësi të tij dhe me njerëzit e familjes së tij, ai ruante kështu, tok me to, edhe ndjenjën e pronarit të vogël të fshatit me të gjitha rrjedhimet e pronës private, e cila, siç na mëson Lenini,

*«... lind kapitalizmin dhe borgjezinë vazhdimisht, çdo ditë, çdo orë, në mënyrë spontane dhe në shkallë të gjerë»<sup>1</sup>.*

Pa shfrytëzuar njeri të huaj jashtë familjes, pse këtë ia ndalonte ligji, por duke shfrytëzuar ose duke futur në punë njerëzit e familjes së tij, shumë herë në prizmin e ligjeve të vjetra dhe zakoneve prapanike, fshatari ynë shtonte lopët, delet, dhitë dhe pasurinë tjetër të luajtshme. Gjithë këtë pronë që vinte ose e shtonte, ai e bënte me qëllim që edhe të rronte, po edhe të tregtonte për të forcuar ekonominë e tij private. Këtë

---

1 V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 8.

rrugë ai e quante normale, të ligjshme (dhe në fakt në përgjithësi nuk shkelte ndonjë ligj konkret) dhe, deri diku, krijonte bindjen se ndryshe ishte zor të jetë tohej. Fshatari idealizonte përpjekjet individuale dhe ato të familjes së tij dhe nuk shikonte si duhej forcën e bashkësisë, forcën kolektive. Këtë të fundit ai e shihët si një perspektivë, por thoshte: «Kemi kohë, Partia na lejon të mos e ngremë kooperativën dhe këtë lejim të Partisë ta përdorim», dhe disa e përdorën për të rezistuar.

Kur u hodh parulla dhe filloi kolektivizimi i malësisë, në ndërgjegjen e malësorëve, te kush më shumë e te kush më pak, filluan të ndihen shqetësimë. Partia këtë duhet ta kuptojë për arsyen e ndryshimit që do të bëhet, siç e thashë më lart, nga prona private në pronën e përbashkët. Kështu këto shqetësimë që e kanë burimin në botëkuptimin mbi pronën private, u materializuan në disa drejtime që edhe këto duhet t'i kuptojmë.

Malësorët pranuan vullnetarisht të ngrenë kooperativat bujqësore dhe i ngritën. Kjo duhet konsideruar një sukses i madh që tregon qartë patriotizmin e lartë dhe lidhjet e tyre të forta me vijën politike, ideologjike dhe organizative të Partisë dhe të shtetit tonë socialist. Malësorët kapërcyen me sukses një lumë të madh, dolën në kooperativizëm, tek i cili kanë besim. Mirëpo bindja e tyre duhet përpunuar më tej, sepse ka akoma shumë boshllëqe. Boshllëku qëndron në atë se ata e hodhën tej ose e kapërcyen një pjesë të mentalitetit për pronën private, por jo të tërin. Ky mentalitet, në këtë fazë, shfaqet në ruajtjen e maksimales së oborrit

dhe të bagëtive që lejon statuti. Te disa fshatarë të tjerë, që nuk janë armiq, ky transformim nuk është bërë sa në të tjerët. Këta, bagëtinë e tepërt që kanë pasur, në vend që t'ia dorëzonin kooperativës, përpiken ta shesin fshehurazi. Të gjithë pastaj, me përjashtime të rralla, duan që për kafshët e kolektivizuara të paguhën shpejt, përnjëherë ose me këste dhe mundësisht nga shteti. Për këtë çështje unë kam folur edhe në një mbledhje të Byrosë Politike të Komitetit Qendror<sup>1</sup> dhe ju jeni në dijeni, prandaj nuk do të zgjatem.

Sic e shohim, pra, malësorët, e jo vetëm këta, por edhe kooperativistët e fushës, që tani kanë një ekonomi të madhe të përparuar dhe që marrin çdo vit nga 17 deri në 20 lekë për ditë-punë, si, për shembull, në Korçë, vazhdojnë t'i ruajnë të paprekur tredynë-mëshin dhe maksimumin e numrit të bagëtive. Me një fjalë, po ruhet ndjenja e pronës private, natyrisht tash disi më e reduktuar, por që prapëseprapë ekziston.

Partia dhe Qeveria ua kanë lënë oborret kooperativistëve që të plotësojnë me to disa nga nevojat e tyre, kurse të ardhurat kryesore, vendimtare për ta, duhet të jenë ato që rrjedhin nga prona kolektive kooperativiste në sajë të punës së tyre të përbashkët të organizuar mirë. Por këtë ata nuk e kanë kuptuar plotësisht, në këtë drejtim ka boshllëqe.

Nga rrjedhin këto boshllëqe? Përveç atyre që thashë më sipër, arsyen duhet ta gjejmë në botëkuptimin mbi punën vetjake të izoluar të mëparshme, tek e cila fshatari shihte të vetmin mjet jetese. Tani, kur fshatari

---

<sup>1</sup> Shih në këtë vëllim f. 96.

të gjithë pronën individuale që krijoj për 30-40 vjet me punë të lodhshme, e futi në pronën e përbashkët, ai mendon: a do të mundë kooperativa t'i ruajë atij po atë nivel jetese që kishte pasur, kur ishte pronar individual? Këtu ndahen lakinat: fshatari i varfër ka besim të plotë dhe nuk vuan aq shumë nga ndjenja e pronës private; fshatari i mesëm, megjithëse e pranon gjendjen e re, dyshon ca, shkëputet më me vësh-tirësi nga e vjetra se e ka më të theksuar ndjenjën e pronës private; kurse kulaku nuk lufton dot hapur, por interes i pronës e ha atë përbrenda si «kuçi në bark» dhe lëshon parulla e vjell vrer.

Sic e shikojmë, pra, një punë shumë të madhe kemi për të bërë me kooperativistët. Jo vetëm puna e organizimit të kooperativës, që duhet të bëhet me një kujdes shumë të madh, por nuk duhet të lihen mënjanë sidomos puna politike, ideologjike, sqarimet e përbashkëta dhe puna që duhet bërë individualist me çdo kooperativist, duke mos menduar për asnjë çast se me krijimin e kooperativës u arrit çdo gjë.

Çështja e oborreve ka një rëndësi të madhe edhe për kooperativistin, edhe për kooperativën. Nuk e kam fjalën për kooperativat e fushës, të cilat duhet t'i reduktojnë oborret, bile t'i kenë më të vogla se kooperativat e malësisë, por edhe këto duhet t'i mbajnë sic propozoni ju, një deri në një dynam e gjysmë. E njëjtë gjë duhet bërë edhe për kafshët. Veç kjo t'u shpjego-het mirë kooperativistëve, duke pasur parasysh të gjitha sa thashë më lart e shumë të tjera, që ju i dini mirë.

Duhet të merren të gjitha masat politike, ideolo-

gjike, organizative që tē ndërrohet mentaliteti nē punë dhe tē gjitha këto tē kthehen nē tē mira materiale, por nē tē mira materiale nē atë nivel që kooperativisti tē shohë konkretisht se me formën e re tē pronës dhe tē punës, tē ardhurat e tij janë më tē mira. Kur themi tē ardhurat, kjo çështje nuk duhet kuptuar nē mënyrën mikroborgjeze dhe individuale si më parë, sikur kooperativisti do tē marrë nga kooperativa brenda vtit tē gjitha ato që bashkoi nē tē. Ai tē shohë konkretisht se niveli i jetesës së tij nē kooperativë u ngrit dhe prona e përbashkët, që është kryesorja, u forcua, po administrohet si duhet dhe prodhon shumë më mirë se prona e tij e parë individuale.

Pra, që tē mos mbeteni vetëm me 50 për qind tē forcave tē punës që dalin sot nē fushë, siç thuhet nē raport, ju vihet një detyrë e madhe politike dhe organizative, që tē arrini tē dalin nē punë 100 për qind e njerëzve tē aftë. Duke marrë parasysh që kooperativat tuaja tē malësisë janë tē varfra me qé dhe tē pasura nē forca pune, këta duhet tē mobilizohen totalisht që tē hapin toka tē reja, tē bëjnë qilizmë, t'u bëjnë shërbime tē përsosura bimëve etj. Vetëm kështu arrihet ajo që thashë më lart, ngritja e nivelist tē jetesës.

Mos harroni, shokë, se ngritja e nivelist tē jetesës është prova më bindëse, më efektive e politikës dhe e ideologjisë për tē çrrënjosur nga ndërgjegjja e kooperativistëve tanë ndjenjën e pronës private. Ajo do tē provojë materialisht nē jetë epërsinë e pronës kollektive dhe, atëherë, kooperativisti do tē kuptojë më mirë përse oborri i tij nuk duhet tē, jetë më i madh se

një ose një dynym e gjysmë, përsë duhet të mbajë minimumin e bagëtive që i lejon statuti. Ai do të kuptojë se ajo pjesë e oborrit dhe ajo bagëti e tij që iu shtua pronës së përbashkët të kooperativës, prodhoi më mirë dhe më shumë dhe ky prodhim iu kthyc përsëri atij nga ana tjetër.

Prandaj, mendoni, shokë, sa përgjegjësi të madhe kemi, sa me mend e me durim duhet të punojmë, sa vazhdimësi e lodhje kërkohen në punë. S'duhet të kënaqemi me pak, por të përdorim masa administrative më pak ose thuajse aspak, po të jetë e mundur, dhe të mos e lëmë kurrë pas dore dhe në gjumë punën politike, sqarimin e njerëzve, bile edhe atëherë kur ne mendojmë se sqarimi është bërë dhe bindja është arritur e plotë. Kur ne e harrojmë ose e lëmë pas dore punën politike dhe sqarimin, do të dalë me siguri dikush tjetër që të nxitë dhe të sqarojë në të kundërtën, duke shpifur ose duke shfrytëzuar dobësitë tona. Kjo është një anë e luftës së klasave, që ne duhet ta bëjmë ashtu siç na mëson Partia.

Zhvillimi i luftës së klasave, dhe posaçërisht në malësi, është i domosdoshëm të bëhet si duhet dhe, ashtu si në të gjithë vendin, ai duhet të udhëhiqet nga Partia. Por që lufta të bëhet drejt dhe si duhet, është e domosdoshme që shokët e Partisë të mësojnë teorinë marksiste-leniniste.

Teoria që na udhëheq ne komunistët është një shkencë e gjerë, ekzakte dhe e kuptueshme për masat e Partisë dhe të popullit, në rast se trajtohet lidhur me jetën, me ngjarjet konkrete të saj, të cilat ajo i shpjegon të gjitha, në rast se temat që trajtohen, për-

gatiten duke marrë parasysh edhe nivelin e ngritjes sé komunistëve të organizatës ose të rrethit. Prandaj, në këtë drejtim, në trajtimin e çdo problemi, qoftë thjesht teorik, qoftë praktik, çdo herë shokët duhet të theksojnë parimet teorike të doktrinës sonë, në mënyrë të thjeshtë e të kuptueshme për të gjithë. Kjo duhet të bëhet një edukatë, derisa të krijojmë te njerëzit mundësinë dhe lehtësinë e studimit më të thellë të teorisë.

Është fakt i pamohueshëm që teorinë marksiste-leniniste mbi partinë, në shumë aspekte të saj, shokëtanë e dinë, në mos për të mbajtur referate teorike, e kanë kuptuar dhe veprojnë në bazë të saj. Natyrisht, kjo njojje duhet thelluar më tej dhe rruga më e mirë, më e sigurt dhe më praktike për këtë qëllim është ajo që thashë më lart. Siç e dini, çdo veprim i Partisë sonë, çdo direktivë e saj, udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi. Pra, kuptimi i drejtë i direktivës dhe zbatimi i drejtë e korrekt i saj në jetë, do të thotë edhe kuptim i parimeve teorike të doktrinës sonë. Kur të gjithë shokët arrijnë ta kuptojnë direktivën, atëherë ne duhet t'u bëjmë kurdoherë të qartë se në këtë ose në atë direktivë mishërohet ose materializohet kjo pjesë e doktrinës marksiste-leniniste. Kjo është një njojje e teorisë lidhur me luftën dhe me detyrat praktike. Në rast se e vëmë mirë në dukje këtë gjë, atëherë duhet të vazhdojmë më tej t'i zgjerojmë dituritë mbi teorinë, por kurdoherë këtë ta bëjmë jo teori për teori, për teorinë ta thellojmë lidhur me problemet që na dalin përpara.

Në raport u fol për rëndësinë, vendimtare të for-

cimit dhe të kalitjes së Partisë në rrethin tuaj dhe kjo çështje, që ka për qëllim forcimin e kooperativave në malësi, u vu në qendrën e tij. Shokët kanë vepruar drejt, sepse çdo gjë varet nga forca e Partisë, nga pastërtia e saj, nga dinamizmi dhe fryma e saj luftarake, domethënë e anëtarëve të saj. Unë nuk do të zgjattem në të gjitha këto probleme, sepse raporti i trajtoi, por do të theksoja se revolucionarizimi i Partisë, mbajtja e radhëve të saj të pastra, varen, në radhë të parë, nga ne, anëtarët e saj. Kjo është një luftë e pandërprerë që duhet bërë me këmbëngulje nga ana jonë. Edhe pse ekziston një unitet i çeliktë në organizatat e Partisë të rrethit tuaj, si edhe në organizatat e Partisë të rretheve të tjera, prapëseprapë ka të meta, vërtetohen gabime ose pikëpamje të gabuara në disa shokë, të cilat kurdoherë duhet t'i zbulojmë, t'u gjejmë shkakun dhe origjinën, t'i ndreqim e t'i luftojmë. Ato nuk duhet t'i lëmë kurrë të mahisen.

Zbulimi i shkaqeve të gabimeve dhe i pikëpamjeve të shtrembra ka një rëndësi të madhe. Pa këtë asgjë nuk mund të zgjidhet drejt. Ky zbulim bëhet nëpërmjet kritikës dhe autokritikës bolshevikë. Zbulimi dhe shërimi i tyre bëhen mirë kur shokët janë politikisht e ideologjikisht të ngritur dhe njëkohësisht njerëz të aksionit.

Të marrim, për shembull, një çështje që ngrihet në raport: mospranimi i anëtarëve të rinj aq sa duhet dhe siç e kërkon interes i Partisë. Me pranimet duhet t'i vijë Partisë gjaku i ri, por që nuk i vjen si duhet. Mund të thuhet thjesht: «Kjo është e vërtetë, kemi bërë gabim, e kuqtojmë dhe do ta ndreqim». Po të

thellohem, mund tē gjejmë shumë gjëra, tē cilat s'janë aq tē thjeshta dhe jo pak tē rrezikshme, që e ndalojnë ose, më mirë, e pengojnë këtë proces tē natyrshëm dhe jetik pér Partinë. A kanë nxjerrë dhe a po nxjerrin jeta dhe lufta revolucionare e Partisë tē rinj dhe tē reja tē mrekullueshëm, tē pastër, tē vendosur dhe besnikë tē Partisë? Sa tē duash. Ç'gjë i pengon disa organizata që t'i pranojnë në Parti më tē mirët nga këta? Rregullat e vendosura, pérqindjet e caktuara apo kërkkesat e ligjshme? Jo, këto nuk i pengojnë, se këto nuk janë vënë nga Partia që tē pengohet pranimi i anëtarëve tē rinj, ato janë vetëm kritere e synime që duhet tē kihen parasysh pér cilësinë. Mund tē thuhet: «Po, ja, kemi neglizhuar». Prapë edhe kjo nuk e shpregon çështjen. Vihet pyetja më tej: pse është neglizhuar? Ka disa arsyе tē thella që është neglizhuar, tē cilat duhen analizuar deri në fund, sepse mund tē qëllojë që këto arsyе tē janë edhe tē rrezikshme dhe ka mundësi që kjo rrezikshmëri tē mos vlerësohet në bazë tē një shikimi tē vëmendshëm.

Ta zgjerojmë edhe pak problemin. Në disa organizata-bazë ka tarafe dhe atje ku ka tarafe, ka edhe mosmarrëveshje, edhe grindje. Tarafet e grindjet tē çojnë në thyerjen e disciplinës së Partisë, në shkeljen e parimeve, dhe, më në fund, nga grindje tē zakonshme në dukje, ato tē çojnë në grindje politike dhe në gabime tē rënda. Po pérse ngjasin këto? Disa herë këto analizohen përciptazi. Kjo nuk është analizë e mirë. Disa herë analiza e tyre pérqendrohet në arsyet materiale që i shkaktuan. Kjo është një analizë më e mirë, më me baza, po akoma jo e mjaftueshme, në rast se

nuk zbulohen edhe arsyet ideologjike e politike të çësh-tjes. Pikërisht këtu shumë herë nuk thellohem sa duhet.

Ta zgjerojmë edhe ca më tej problemin. Ka në disa organizata kuadro e komunistë të cilëve u rritet mendja, bëhen arrogantë, u hipën dëshira e komandimit dhe fillojnë të krijojnë rrëth tyre favorizime, arrijnë të abuzojnë e të vjedhin dhe të gjitha këto përpinqen t'i fshehin. Kur merren masa të ligjshme kundër tyre, atëherë ka nga këta elementë që bëhen të pakënaqur, që hiqen sikur u qenka bërë një padrejtësi, fillojnë të shpifin kundër njërit e kundër tjetrit, shpifin edhe kundër Partisë.

Të gjitha këto çështje dhe të tjera si këto, ose të natyrave të ndryshme, po t'i lëmë të rriten, përbëjnë rreziqe për Partinë dhe për ndërtimin me sukses të socializmit në vendin tonë. Këto rreziqe e kanë buri-min në konceptet jomarksiste në ndërgjegjen e njerëzve, në konceptet e vjetra, patriarkale, feudale, mikro-borgjeze që qëndrojnë gjallë dhe zhvillohen atje ku nuk zbulohen e nuk luftohen. Disa herë nuk kuptohet sa duhet rrezikshmëria e tyre dhe vajtja në kundërshtim me parimet e Partisë, pse i tërë ambienti mbahet në një amulli të atillë, saqë këto veprime jo të rregullta nuk u bëjnë shumë përshtypje, duken si të natyrshme e normale.

Përse disa organizata-bazë partie nuk bëjnë pranime? Për këtë çështje duhet të kërkojmë arsyet e vërteta politike dhe ideologjike. Shokët që bëjnë pjesë në këto organizata, mund të jenë të mirë, po ata nuk e kanë kuptuar si duhet ç'është Partia, ç'përfaqëson, si duhet të ndërtohet dhe të luftojë ajo.

Ata që nuk pranojnë në organizatat e tyre elementë të rinj në Parti, mendojnë se kanë krijuar një gjendje stabël, të mjaftueshme; Partia ekziston, «jemi ne Partia», thonë ata dhe mjaft. Me të tilla pikëpamje ata kanë krijuar, kështu, familjaritet në mes tyre dhe ngurrojnë ta prishin këtë situatë. Por, mjaft herë situata u ndryshohet, u prishet ekuilibri i vendosur, pse Partia vepron dhe lindin kontradikta që kërkojnë zgjidhje. Atëherë në të tilla organizata, këta njerëz të sëmurë dhe të paqartë, në vend që të ndjekin rrugën e drejtë të zgjidhjes së këtyre kontradiktave, ndjekin rrugët e vjetra të fiseve e të bajraqeve, natyrisht, të veshura me rroba të reja. Krijojnë kështu në Parti tarafet dhe fiset. Pranimet, në rast se bëhen në to, bëhen në këtë frysë, pra në frysë e familjaritetit, të grupit ose të fisit.

Arsye përse grinden këta shokë, përse krijojnë familjaritet, ka shumë, por ajo që sundon është ruajtja e interesit personal, e favorizimeve materiale personale, dhe për t'ia arritur pa rreziqe këtij qëllimi egoist, sundimit ekonomik, ata përpiken të mbizotërojnë edhe politikisht. Secili, pra, qoftë në Parti, qoftë në kooperativë, përpinqet të bëhet i parë, krijon mbështetjen, rrethin e vet dhe, kur mendon se ia ka arritur kësaj, fillon nga përvetësimet e favorizimet për vete, kurse ndaj të tjerëve bëhet arrogant, mendjemadh dhe shkel ligjet e Partisë dhe të shtetit. Nuk janë këto tiparet e feudalëve, të bajraktarëve ose të kryepleqve të kohës së kaluar? Edhe ata kështu vepronin. Këto mbeturina, pra, janë akoma të gjalla dhe te disa ato veprojnë të maskuara; në fillim nisin me ndo-

një shfaqje të vogël që, duke u lënë, trashet si pa gjë të keqë dhe arrin sa të bëhet një gjë e shëmtuar.

Në të tilla raste, në qoftë se nuk luftohen gabimet dhe të metat që në vezë dhe në mënyrë revolucionare, këta njerëz arrijnë ta mendojnë Partinë si një çiflig të tyre, si një pushtet që duhet fituar, me anën e të cilit ata synojnë të kenë privilegje, të grijnë dhe të korrin si të duan. Shikoni, pra, shokë, se si mbeturinat e ideo-logjisë armike infiltrohen, si futen në Parti, si pleksen te njerëzit që arrijnë t'i degjenerojnë me një mijë mënyra e shfaqje.

Prandaj, ruajtja e pastërtisë së radhëve të Partisë është një problem kryesor dhe vendimtar. Kjo arrihet vetëm kur kuptohen dhe zbatohen mirë e me kurajë normat e Partisë, si brenda, ashtu dhe jashtë saj.

Duke e kuptuar mirë shfaqjen e rrezikut të bajraktarizmit, të veshur me petka të reja, te disa anëtarë partie, masa e Partisë dhe e popullit duhet të jetë vigjilente dhe në revolucion të përhershëm, për t'i luftuar me guxim e me rrënëjë këto shfaqje dhe të mos lejojë të imponohet një situatë e rëndë nga disa njerëz të pandërgjegjshëm ose të ligj. Për fat të keq, në disa nga fshatrat tuaja, e po kështu edhe në disa të rretheve të tjera, organizata-bazë ose i gjithë fshati, duke rënë në gjumë, e kanë pasë injoruar deri në njëfarë shkalle këtë ringjallje të ndikimit të keq të së kaluarës, të bajraktarizmit në forma të reja, të shfaqur në disa udhëheqës të tyre.

Udhëheqësit e organizatave-bazë ose kryetarët dhe

kuadrot e tjerë të kooperativave ne i kemi shokë të mirë, luftëtarë, besnikë të Partisë dhe të popullit, por kurdoherë, si për të gjithë anëtarët e saj, ashtu edhe për këta, Partia dhe masa duhet të ushtrojnë vazhdimisht ndikimin e tyre të madh edukues dhe kontrollues. Nuk ka shumë rrezik t'i rritet mendja një punëtori ose kooperativisti të thjeshtë dhe të bëhet arrogant, kurse një udhëheqës mund të bëhet i tillë më lehtë, prandaj baza duhet të ketë kujdes, ta ndihmojë që ai ta ruajë ndërgjegjen të pastër, mendimin të kthjellët dhe të jetë gjithmonë i thjeshtë.

Udhëheqësit tërë jetën duhet të jenë afër masës, të shkrirë me të, të drejtojnë kur zgjidhen në udhëheqje, po njëkohësisht edhe të punojnë fizikisht në prodhim, domethënë të drejtojnë e njëkohësisht të prodrojnë. Iniciativa e shokëve të Troshani, që kuadrot drejtues të kooperativës të bëjnë 100 ditë-punë në prodhim, duhet vënë përmjëherësh në zbatim, pa lëkundje, pa hezitim. Të gjithë komunistët duhet të futen në prodhim dhe jo nëpër depo, në shtëpitë e vatrat e kulturës apo në vende me ditë-punë fikse. Njerëzit që punojnë e prodrojnë i do dhe i respekton pollit, ata që punojnë janë në gjendje të drejtojnë më mirë, pse çështjet dhe njerëzit nuk i shohin vetëm nga lart-poshti. Njerëzit që punojnë nuk kanë kohë të merrën me llafe të kota, ata nuk intrigojnë dhe, përgjithësisht, bëjnë më pak gabime. Njerëzit që punojnë luftojnë përtacinë, favorizimet, sepse ata dinë të respektojnë punën dhe djersën e të tjerëve. Kështu, duke drejtuar e duke punuar në prodhim, ne ndërtojmë udhëheqjen e vërtetë revolucionare dhe nuk lejojmë kriji-

min e asaj shtrese burokratësh e bajraktarësh që janë bërë një shtresë e tërë në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste, ku po shkallmohet socializmi dhe po rivendoset kapitalizmi.

Revolucionarizim i njerëzve do të thotë kalitje e njeriut të ri të socializmit me parime të reja revolucionare, me ideologjinë e Partisë, i armatosur si duhet për ndërtimin me sukses të socializmit dhe të komunizmit.

Nën drejtimin e Partisë dhe sipas mësimeve të saj, revolucioni proletar po thellohet gjithnjë e më me sukses te ne në ekonomi, në arsim e në kulturë, në politikë dhe në ideologji. Me një hov të mrekullueshëm janë ngritur në këmbë të mëdhenj e të vegjël, pleq e të rinj, gra dhe burra, për të zbatuar me sukses e deri në fund direktivat historike të Kongresit të 5-të të Partisë sonë të madhe.

Një entuziazëm të tillë me një kthjelltësi revolucionare në vijë dhe në veprim nuk e gjen vecse te një popull dhe te një parti marksiste-leniniste si kjo jona. Këtë hov ta shtyjmë vazhdimisht përrpara, përrpara e gjithnjë përrpara. Nga çdo fitore të nxjerrim eksperiençë për fitore të reja; nga çdo gabim të mësojmë dhe të nxjerrim gjithashtu eksperiençë, që të mos gabojmë më në të ardhmen. Kurdoherë me Partinë në zemër dhe në mendje, kurdoherë për interesin e madh të popullit dhe të atdheut, të luftojmë akoma edhe më me hov, më me guxim e pjekuri, për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, për krijimin e të mirave materiale më të bollshme, që të ngremë nivelin e jetesës së popullit dhe, njëkohësisht, të edukojmë njerëzit me të

njëtin hov, tè ngremë, tè kalitim, tè zhdukim dhe tè shkulim nga rrënjet prej ndërgjegjes së tyre tè gjitha pikëpamjet e gabuara, veset e këqija, mbeturinat e ideologjisë borgjeze dhe idealiste, tè zhdukim besimet fetare si ideologji dhe si praktikë. Kjo është luftajonë e shenjtë. Të mendojmë vuajtjet e së kaluarës, shoqe dhe shokë, tè mendojmë të sotmen dhe tè ardhmen që na pret. Prandaj në këtë luftë ne duhet tè udhëhiqemi nga parimet e qarta marksiste-leniniste dhe nga një vullnet i hekurt, pse kështu u fitua Lufta Nacionalçlirimtare, kështu u arritën fitoret e gjertanishme, kështu do tè fitohet edhe në tè ardhmen çdo luftë tjetër që do tè ndërmarrë Partia. Kjo luftë nuk është njëloj si lufta që bëjmë kundër armiqve të vendit, tè cilën Partia kurrë nuk e ka pushuar dhe nuk do ta pushojë. Revolucioni i madh që po vazhdojmë, është një luftë e madhe për tè revolucionarizuar më tej jetën e Partisë e tè tè gjithë vendit. Kjo luftë bëhet për tè revolucionarizuar vetveten, bëhet kundër mbeturinave që ekzistojnë në ndërgjegjen timë, tënden, tonën, në ndërgjegjen e gjithë popullit tonë, tè cilin e duam aq shumë, për interesat dhe lumturinë e tè cilit ne jemi hedhur në zjarr dhe jemi gati në çdo moment tè sakrifikojmë edhe jetën tonë.

Populli e ka kuptuar këtë qëllim kaq tè lavdishëm tè Partisë, prandaj ai kurrë nuk e ka ndier veten kaq shumë tè lidhur ngushtë me të. Kur ka ndodhur ndonjëherë dhe në ç'vend është parë që pleqtë dhe plakat tè ngrihen tè flasin e tè vendosin kundër fesë, kundër zakoneve prapanike mbi gruan, tè prishin fejesat

e të miturve? Kjo vetëm te ne ngjet. Dhe ngjet pikërisht për arsyen se populli ka besim të madh te Partia. Sa keq dhe sa turp duhet t'u vijë atyre komunistëve që qëndrojnë në bisht të masave për këto gjëra që kanë karakter ideologjik dhe njëkohësisht mbajnë në xhep teserën e Partisë së lavdishme të pararojës, të përparimit, të komunizmit! Këta komunistë për nderin e Partisë së tyre, për lumturinë e popullit, duhet t'i braktisin menjëherë pozitat e kalbura dhe të dalin në rrugën e ndritur të Partisë, të zhdukin në mënyrë revolucionare çdo të keqe nga vetja e tyre, që të mund të bëhen shembull për të tjerët.

Të marrim problemin e gruas, që është një problem kyç për çdo shoqëri njerëzore dhe veçanërisht për shoqërinë tonë socialistë. Shokë, çdo burrë, çdo komunist, pas pune, gjysmë ore në ditë, të mendojë për vuajtjet e grave të Shqipërisë në të kaluarën, mjerisht edhe për vuajtjet e tyre aktuale nga mbeturinat, të mendojë për to gjérat më të mira e më të pastra, për mëmën që e lindi, që i dha sisë dhe e rriti, për gruan e tij, shoqen e barabartë të jetës, për vajzën e tij, krenarinë e përtëritjes së jetës së re, për gjithë mëmat dhe motrat e Shqipërisë dhe, i frysmezuar nga këto ndjenja të larta njerëzore e parime revolucionare, të luftojë, ashtu siç thotë populli, si luan, për t'i mbrojtur ato nga mbeturinat e këqija, t'i ndihmojë ato në punë e në jetë, të tregojë mirëkuptim për problemet e tyre, të jetë me to zemërgjerë dhe i durueshëm, i thjeshtë dhe i ndershëm.

Të mos mendojmë ne, komunistët, se spastrimi i ndërgjegjes së njerëzve bëhet me ligje e me dekrete.

Këto ndihmojnë, përcaktojnë norma, por puna politike, puna ideologjike, bindja, durimi, urtësia, ndershëmëria, vetëm këto i shfarosin mbeturinat. Vajzat e malësisë kanë nevojë të madhe për përkrahje, ato kurrsesi nuk duhet të pengohen të venë me shumicë në aksione kombëtare, si në hekurudhë, në hidrocentral etj. Duhet të kuptohen drejt përpjekjet që bëjnë ato për zhvillimin e tyre. Vajza e malësisë del nga fshati i saj dhe për dy-tre muaj punon e gjzon, së bashku me shoqet dhe shokët e saj të ardhur në aksion nga të katër anët e Shqipërisë. Ajo mëson shumë gjëra, njihet me bukuritë e vendit, fushat e gjera që i ka bërë kopshte puna e Partisë dhe e njerëzve, njihet me pasuritë e atdheut, me kantieret e punës, me fabrikat e kombinatet madhështore që ka ngritur e i vë në lëvizje klasa jonë punëtore.

Merreni me mend, vëllezër, ç'forca të mëdha ka fituar ajo në aksion. Ajo do të vijë në fshat krejt ndryshe dhe ndershëmëria e saj, kjo karakteristikë e vajzës shqiptare, nuk do të jetë prekur, siç pëshpëritin gjuhët e këqija, të cilat duhen prerë, pse gratë dhe vajzat tonë që venë e punojnë për të mirën e përgjithshme, janë të ndershme dhe askush nuk guxon t'u prekë nderin.

Më falni, shokë, se u zgjata në diskutimin tim, posa konkluzion dua të them edhe këtë: Parti dhe popull në rrethin tuaj, si një trup i vetëm, të organizojnë punën për të realizuar e për të tejkaluar planet ekonomike, detyrat në bujqësi dhe në industri, në arsim e në kulturë, detyrat për ngritjen politiko-ideologjike. Partia

të na frysmezojë, të na udhëheqë në çdo gjë. Direktivat e Kongresit të 5-të t'i bëjmë realitet me punë, me luftë. Vini të gjitha forcat që çdo gjë që keni vendosur më parë dhe çdo gjë që vendosët edhe në këtë aktiv, ta realizoni dhe ta tejkaloni. Organizoni kudo punën tuaj si në luftë, pse me luftë korren fitoret.

Dëshiroj ta mbyll diskutimin tim me një notë historike. Jubileu i heroit të madh të popullit tonë, Skënderbeut, po afron. Kush thotë Skënderbe, thotë Krujë. Populli ynë, me Skënderbeun në krye i bënë Shqipërinë dhe Krujën të famshme në historinë e njerëzimit, pse luftuan së bashku si ata për lirinë, për drejtësinë e popullit tonë dhe të popujve të tjerë. Skënderbeu ishte kurdoherë në sulm mbi armiqtë dhe korrte vetëm fitore. Populli shqiptar me në krye heroiken, të lavdishmen Partinë tonë të Punës, ndjek gjurmët legjendare të të parëve dhe çan përpara në revolucion, në fitore, në socializëm. Në këtë luftë vigane që zhvillojnë populli dhe Partia jonë, unë u bëj thirrje komunistëve dhe komunisteve krutane, vëllezërve dhe motrave të Krujës, që në jubileun e madh të heroit, i madh e i vogël të hidhen në sulm të gjithanshëm, që Kruja kreshnike të qëndrojë në ballë për çdo gjë, si në ato kohëra heroike, dhe sot tradita të përtërihet e të bëhet edhe më e shkëlqyer.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968»,*

f. 59

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## **RRUGA E PARTISË ëSHTË E VETMJA RRUGË E LUMTURISË SË POPULLIT**

*Fjala e mbajtur në takimin me kooperativistët  
e kooperativës bujqësore «Partizani»  
të Fushë-Krujës*

**25 mars 1967**

Të dashura shoqe dhe shokë kooperativistë,

Jam shumë i gjuar që po takohem sot me ju  
dhe ju sjell përshëndetjet e shokëve të Komitetit  
Qendror dhe të Qeverisë.

Qysh në fillim dua t'ju them se më vjen mirë  
kur shoh që ju, gra e vajza, jeni ulur përpara në ven-  
din e këtij takimi. Kjo tregon se vëllezërit tuaj koo-  
perativistë i kuptojnë si duhet direktivat shpëtimtare  
të Partisë pér çështjen e grave dhe të vajzave. Në  
përgjithësi, të gjithë ju keni ndjekur me besnikëri  
rrugën e Partisë, që është e vetmja rrugë e shpëti-  
mit tuaj, e lumturisë së popullit, rruga e lulëzimit  
të Shqipërisë dhe e forcimit të saj nga ana ekono-  
mike, e ngritjes së saj arsimore, kulturore etj. Rruga

që ka ndjekur dhe ndjek Partia, është rruga e forcimit të pavarësisë së Shqipërisë. Pikërisht për këtë arsyе populli ynë është i lidhur si mishi me thoin me Partinë.

Ju, të rinj dhe të reja, nuk i keni jetuar, prandaj edhe nuk i njihni vuajtjet dhe të këqijat që kanë hequr nënat dhe baballarët tuaj. Ata duhet t'i doni dhe t'i respektoni me gjithë shpirt, t'ua dëgjoni këshillat e urta, sepse ata kanë një përvojë të madhe në jetë, janë rrahur, si të thuash, me vaj e uthull.

Përpara Çlirimtit në rrëthim tuaj sundonin njërez armiq, si Abaz Kupi me shokë. Ju e njihni mirë këtë xhelat, por atë e njoha edhe unë gjatë luftës, e di ç'gjakatar, dinak e tradhtar ishte. Në kuadrin e Frontit Nacionalçlirimtar ne u përpoqëm ta futnim në luftë kundër fashistëve italianë, po Bazi nuk hodhi asnjë pushkë kundër pushtuesve, ai ishte i shitur kokë e këmbë tek anglezët. Duke përfituar nga lufta e popullit dhe e Partisë sonë, ai synonte të sillte përsëri në fuqi në Shqipëri Ahmet Zogun. Mirëpo populli, i udhëhequr nga Partia, në këtë luftë kundër pushtuesve e tradhtarëve, ishte shumë më i fortë. Kishin shkuar kohët e hileve e të dinakërive të Abaz Kupit me shokë në kurriz të popullit. E kaluara nuk mund të përsëritez më, sepse Partia e mësoi popullin t'i njihte mirë miqtë dhe armiqtë e tij tëhe të bënte në mënyrë të qartë dallimin në mes tyre.

Gjatë luftës, në Shëngjergj të Tiranës, në një takim që bëmë me Abaz Kupin<sup>1</sup>, ne ia vumë këtij

<sup>1</sup> Më 7 dhjetor 1943.

këmbët në një këpucë, e këshilluam t'i linte dallaveret dhe të hidhej në luftë kundër pushtuesve, i thamë se armiku nuk mund të shporrej nga atdheu pa e ndjekur ne, pa hedhur pushkë kundër tij. Bazi na u përgjigj se pushkë do të hidhte kur të donte ai. Ne atëherë mbajtëm qëndrim, e paralajmëruam të futej në luftë, ndryshe do të përjashtohej nga radhët e Frontit. Mbasi ai zgjodhi rrugën e dytë, domethënë vazhdoi rrugën e tij prej agjenti e mashtruesi, ne e përjashtuam nga Fronti Nacionalçlirimtar. Dhe s'kishte si të ndodhte ndryshe, ai kishte qenë kurdoherë kundër popullit. Kur ishim duke biseduar me të, Bazi doli në dritare dhe, që ta dëgjonin «trimat» e tij, më fliste mua me zë të lartë se, kur të fitohej lufta, ai do t'ia jepte tokat popullit. Ne e demaskuam menjëherë, aty për aty, duke i thënë se ato që fliste nuk ishin të vërteta, ai asnjëherë s'kishte bërë ndonjë gjë të mirë dhe se po të ishte në dorën e tij, ai vetëm helm do t'i jepte popullit. Kurse Partia i tha popullit se tokat do t'i merrte ai vetë. Dhe me të vërtetë kështu ndodhi. Me luftën që bëri populli, nën udhëheqjen e Partisë, çlroi vendin, vendosi pushtetin e vet, toka iu dha atij që e punon dhe u pastruan për jetë të gjitha mikrobet e rrezikshme, si Abaz Kupi me shokë.

Tani tradhtarët si ky janë spiunë të amerikanëve dheëndërrojnë të kthejnë edhe një herë të kaluarën në Shqipëri. Por ata i njojin mirë forcën e Partisë dhe të popullit tonë, lidhjet e ngushta në mes tyre, kanë mësuar për ndryshimet e mëdha që janë bërë në Shqipërinë e re socialiste, të cilën s'e luan as topi.

Ju, të rinj e të reja, mos e harroni kurrë të kaluarën e vendit. Të gjithë, të bashkuar rreth Partisë, ta mbrojmë Shqipërinë e re që kemi ndërtuar, të derdhim vazhdimisht djersën dhe mundin tonë përlulëzimin e mëtejshëm të këtij vendi të shtypur e të copëtuar në të kaluarën nga armiqtë e huaj. Kujtoni një milion e ca vëllezërit tanë kosovarë se si po vuajnë akoma nga shtypja e shovinistëve serbë, që vrasin, vjedhin, grabisin, përdhunojnë, i lënë në errësirë pa shkollë e u mohojnë të drejtat e kulturën e tyre. Ata janë vëllezërit e motrat tona, pjesë e pandarë e popullit shqiptar. Në të katër anët i ka shpërndarë tradhtari Tito vëllezërit tanë kosovarë, që nga Turqia e gjer në Gjermaninë Perëndimore e në Skandinavi, ku heqin të zitë e ullirit. Shumë prej tyre na dërgojnë letra prekëse, na tregojnë se, me gjithë gjendjen e tyre të mjerueshme, kur dëgjojnë emisionet e Radio Tiranës, marrin forca të reja dhe shpresat u përtërihen. Por serbomëdhenjtë nuk do t'i nënshtrojnë dot kosovarët, sepse zjarri i patriotizmit qëndron i pashuar në zemrën e çdo shqiptari.

Miqtë që vizitojnë Shqipërinë, si dhe dëgjuesit e Radio Tiranës, që na drejtohen me letra, flasin me respekt për popullin shqiptar, për luftën e tij përliri dhe për sukseset që ka arritur. Ne u tregojmë atyre si kemi luftuar e si kemi punuar, si e kemi organizuar punën tonë, kurse ata na japin kurajë të qëndrojmë, pse kemi edhe përkrahjen e tyre, përkrahjen e dhjetëra e qindra milionë njerëzve në botë.

Kur luftonte Skënderbeu Shqipëria nuk kishte dy milionë njerëz. Atëherë populli ynë ishte edhe më i vogël se sot e, megjithëse Turqia ishte e madhe, kishte miliona njerëz dhe ushtria e saj numëronte qindra mijëra, Skënderbeu dhe populli që ai udhëhiqte, domethënë gjyshërit e stërgjyshërit tanë, u bënë ballë hordhive të sulltanëve. Me qindra mijëra e dhjetëra mijëra prej tyre u grinë, u shkatërruan, u mundën. E gjithë Evropa fliste me admirim për këtë luftë legjendare të Shqipërisë, për Skënderbeun dhe për Krujën dhe i shikonte köta si mburojën e qytetërimit.

Kështu, shqiptarët, të udhëhequr nga Skënderbeu, vite me radhë luftuan me armë në dorë për mbrojtjen e lirisë së atdheut e të qytetërimit dhe sot ne, stërnipërit e tyre, me Partinë tonë të lavdishme në krye, ecim në rrugën që ndoqën ata. Por tani detyra jonë është më e madhe: ta bëjmë Shqipërinë të fortë, të çeliktë, jo vetëm nga ana ushtarake, por edhe nga ana politike, ideologjike, ekonomike, sepse kështu atdheu ynë jo vetëm siguron lirinë dhe pavarësinë për tani dhe për brezat që vijnë, por kështu ai shërben si shembull dhe u jep kurajë të gjithë popujve që luftojnë për liri. Këtë detyrë të madhe të mos e harrojmë, ashtu siç nuk e pati harruar as Skënderbeu, kur udhëhiqte luftën në krye të shqiptarëve. Edhe ai, duke luftuar për lirinë e Shqipërisë, mendonte, njëkohësisht, për lirinë e njërezimit. Prandaj ne, megjithëse të paktë në numër, ashtu siç ishin të parët tanë, duke luftuar për lirinë e Shqipërisë, për forcimin e Republikës, japim, një-

kohësisht, ndihmën tonë për lirinë e popujve të tjerë.

Të kemi parasysh, vëllezër dhe motra, se në çdo punë që bëjmë, të mendojmë për të sotmen, por të mendojmë edhe për të ardhmen. Shihni fëmijët tuaj si pëllumba, ata sot rriten të qeshur, të gëzuar. Partia mendon thellë për ta, se janë e ardhmja e Shqipërisë socialiste. Ne duhet të punojmë që ata të mos kenë kurrë halle e vuajtje dhe zemrën ta kenë kurdoherë të fortë si çeliku, pse kështu Shqipëria do të rrojë në shekuj dhe do të korrë suksese kurdoherë e më të mëdha. Prandaj të rinjtë dhe të rejat Partia i ka me vete dhe ata e duan si shpirtin Partinë e tyre.

Gjatë këtij viti ne jemi para jubileut të 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Në të gjithë Shqipërinë po bëhen, me këtë rast, konferanca përkujtimore, por, siç e thashë edhe në aktivin e Partisë, në mënyrë të veçantë, ju, krutanët, burra e gra, të mëdhenj e të vegjël, për jubileun e heroit tonë të madh, Skënderbeut, duhet të jeni në ballë të çdo pune në të gjitha drejtimet, në bujqësi, në industri, në arsim e në kulturë. Përparime duhet të arrini ju edhe në luftën kundër zakoneve prapanike, që t'i tregoni kështu gjithë Shqipërisë se fryma heroike e Skënderbeut, e gjallëruar, e përtërirë, e zhvilluar dhe e frymëzuar nga Partia, jo vetëm mbahet gjallë, por edhe se populli ynë po e ngre atë akoma më lart, nën flamurin e lavdishëm të Partisë. Të gjithë, pra, le të punojmë për ta lulëzuar akoma më shumë vendin tonë, ta çojmë përpara bujqësinë, që të prodhojmë

me bollëk për popullin çdo gjë për të cilën ai ka nevojë, ta bëjmë atdheun tonë të bukur një vend me industri të përparuar, ku çdo vit ngrihen fabrika e uzina të reja moderne, çahan male për të ndërtuar hekurudha e hidrocentrale gjithnjë më të fuqishme, ndërtohen shkolla e institucione kulturore për ta bërë gjithnjë e më të bukur jetën e popullit tonë.

Mund të ketë njerëz që thonë se edhe të tjerët kanë ndërtuar e ndërtojnë vepra të tilla, bile edhe më të mëdha. Kjo është e vërtetë, siç është e vërtetë që të gjitha këto, kudo, ngrihen me duart e punëtorëve e, megjithatë, nuk janë pasuri të popullit, por të Bazëve, të bejlerëve, të feudalëve, të kapitalistëve, që rrojnë me gjakun e popullit. Çdo gjë në botë e ndërtojnë punëtorët, deri edhe pallatet e mëdha të Nju-Jorkut, por puna është se kush i ka në dorë ato, kush i gëzon ato të mira. Çdo gjë që bëhet atje e gëzojnë kapitalistët, kurse punëtorët dhe fshatarët, nga djersa e të cilëve krijohen të mirat materiale, janë robër të pronarëve kapitalistë, të makinave, të fushave, të traktorëve, që ndodhen në duart e pasanikëve. Te ne zot i çdo gjëje është populli punojnës, për arsyen se atë e udhëheq Partia që ka dalë nga populli dhe lufton e punon vetëm për lumturinë e tij.

C'po ndodh sot në Bashkimin Sovjetik, në Jugosllavi, në Bullgari dhe në vendet e tjera ku sundojnë revizionistët? Kur në vendin tonë çmimet mbahen në vend, bile edhe ulen, atje ngrihen në qiell, prodhimi bie, fshatarët braktisin tokat e kërkojnë punë në qytete, por punë s'ka. Me qindra e mijëra

njerëz nga Jugosllavia, midis tyre edhe kosovarë, bredhin në rrugët e Evropës për punë, kurse te ne u sigurohet punë të gjithëve dhe ndonëse populli ynë është i paktë në numër po bën e do të bëjë mrekullira, sepse ai është punëtor e trim dhe udhëhiqet nga një Parti e urtë dhe e guximshme.

Partia mendon e punon gjithnjë për popullin, ajo i di kërkesat e dëshirat e tij dhe e frysmezon atë si të mendojë e të punojë për të arritur qëllimet. Ato që ka thënë Partia kurdoherë janë realizuar. Por të gjithë e dinë se veprat e mëdha që janë ngritur, janë ngritur me djersën dhe punën e popullit dhe jo me «frymën e shenjtë». «Frymën e shenjtë» e kanë sajuar klerikët, të cilët edhe në vendin tonë e gënjenin popullin, e ushqenin me përralla për t'i pasur njerëzit e thjeshtë si shërbëtorë të bindur, që t'u çonin zogj e pula, dele e qengja, gjalpë e vezë etj., për nevruz, për matem, për pashkë e bajram, që klerikët të maheshin, të hanin e të pinin pa punuar, duke gënjerë njerëzit me nga një nuskë. Më falni, motra dhe vëllezër, nuk dua të prek ndjenjat e atyre që besojnë, por klerikët të tillë ishin, prandaj Partia i tha popullit se nuk duhet lejuar më që këta njerëz të na gënjejnë, le të venë më mirë të punojnë si gjithë të tjerët dhe ta fitojnë bukën me nder. Populli, në fakt, e kuption këtë luftë të drejtë të Partisë.

Ne nuk i prekim ndjenjat e popullit, prandaj në qoftë se duam t'u rrënjosim njerëzve në mendje të vërtetën se nuk ka perëndi, për këtë qëllim duhet bërë një punë e gjatë e me durim të madh. Kushdo

e kupton se janë të kota shpresat për t'u mbështetur te zoti dhe këtë e vërtetonjeta çdo ditë. Kur njëriu sëmuret, është mjeku ai që e shëron dhe jo hoxha ose prifti. Edhe kur i sëmuret kau fshatarit, atë nuk ia shëron byzebeja e hoxhës që ia varin në qafë, por vajza që ka mbaruar shkollën për veterinere, pra, jo zoti, siç mund të thotë ndonjë.

Teoritë fetare mbi zotin janë legjenda të krijuara gjatë shekujve, që kanë mbetur gjer më sot e që u kanë shërbyer interesave ekonomike e politike të klasave sunduese. Kështu, Muhameti, që, për t'i bërë më të besueshme ligjet e tij, hiqet si i dërguari i perëndisë, e shfrytëzoi fenë myslimanë për të pushtuar vende të tjera. Nën udhëheqjen e Muhametit e të pasardhësve të tij dhe me flamurin e fesë, arabët sulmuani popuj të tjerë dhe erdhën gjer në Evropë. Disa popujve ata ua impononin me forcë fenë myslimanë dhe besimtarëve u predikonin të mbanin ramazan, të festonin bajramin, të paguanin hoxhallarët e dervishlerët etj., etj., sepse kështu do të venin në «xhenet». Zakonet e tyre u rrënjosën kështu edhe në Shqipëri me anën e pushtimit të Turqisë. Pushtuesit osmanë e përdorën fenë myslimanë që të na mbanin në errësirë, të ishim të bindur ndaj tyre dhe ndaj pasanikëve e bejlerëve vendas. Dhe, në fakt, feja e këshillon popullin të jetë i bindur, të mos ngrejë krye kurrë, se vetëm kështu njerëzit do të venë në «xhenet» që, sipas fesë, na qenka një kopsht me lule, mbushur me gra të bukurë e me të gjitha të mirat, ku, sa të hapësh musllukun, qumështi derdhet si ujë! Kësaj i thonë të

ngopesh me lugë të zbrazët. Feja myslimane, me një fjalë, kërkon nga besimtarët që në këtë jetë njerëzit e popullit të punojnë për dedenë, për hoxhën, për teqenë dhe xhaminë, për Zogun, Bazin, beun, aganë etj.

Këtë punë bën edhe kisha katolike. Ç'është Krishti që predikon kisha? Për këtë nuk dihet në ka ekzistuar ndonjëherë apo është pjellë e imagjinatës. Thonë se ai qenka kryqëzuar bashkë me dy hajdutë, disa të tjerë tregojnë se edhe vetë paska qenë një hajdut. Dhe ky «shenjtor» na paska flutruar në qiell. Kështu, rreth personit imagjinar të Krishtit kanë thurur një legjendë të madhe dy mijë e ca vjeçare, me anën e së cilës përpiqen t'i mbajnë njerëzit të bindur, që të bëjnë siç thonë papa e priftërinjtë e tij, që njerëzit të marrin meshë, të pagëzohen, të bëjnë si thotë kisha, klerikët, t'u tregojnë atyre ç'ka secili në zemër dhe, me këto rrugë, njerëzit e fesë t'u rrjepin pasurinë dhe t'i mbajnë të nënshtuar. Nëpër kisha ne kemi gjetur tapira të njerëzve, të cilët, përpara se të vdisnin, kungohe-shin nga priftërinjtë që i këshillonin t'ia linin kishës pasurinë. Kemi gjetur, gjithashtu, letra të poshtra, që vërtetojnë për aktet e ulëta që bënин brenda qelave të tyre priftërinjtë me gratë e popullit; kemi gjetur telegrame me të cilat priftërinjtë uronin ardhjen e fashizmit italian në Shqipëri. Partia, porsa i zbuloi këto dokumente, mendoi t'ia tregonte dhe ia tregoi popullit, që ta çlironte atë nga këto besime fare të kota, të cilat kishin rrënjosur te njerëzit tanë disa zakone jo të mira.

Feja ka luajtur një rol shumë negativ për rrënjosjen e zakoneve të këqija që kanë të bëjnë me qëndrimin ndaj gruas dhe me vendin e saj në shoqëri e në familje. Feja predikon që bejlerët e pasnikët mund ta shtypin popullin, kurse burrat mund t'i mbajnë në skllavëri gratë e tyre. Po cilën të kesh skllave? Nënën që të ka lindur dhe të ka dhënë sissë, që të ka përkundur në djep kur ke qenë i vogël? A lejohet të mos kesh respekt për atë që të solli në jetë, bile të kesh të drejtë, sipas kanunit dhe fesë, edhe ta rrahësh? Ai që nuk ka respekt për nënën, nuk mund të jetë njeri i mirë. Nëna duhet nderuar, duhet vënë në krye e sipër, jo t'ia lajë ajo këmbët burrit apo djalit, po ky t'ia lajë asaj, ky t'ia puthë dorën nënës, pse është ajo që e përtërin, e krijon dhe e mbron jetën.

Zakonet e këqija kanë për qëllim që gratë të mbahen të shtypura. Po, vallë, a është e drejtë ta mbash gruan tënde në skllavëri? Ajo është shoqja e jetës, me të ecën së bashku në jetë, qan e shëron hallet, punon e krijon të ardhmen, lind kalamanët, bijtë dhe bijat që janë krijesat tona më të dashura. Atëherë, si mund të lejohet ta përdorësh gruan si kafshë ose ta rrahësh? Në asnjë mënyrë dhe kurrë nuk duhet ngritur dora kundër saj! Por të tilla zakone i këshillon feja, e cila ka punuar vazhdimit që ato të forcoheshin sa më shumë.

Në qoftë se ka akoma njerëz që i zbatojnë të tilla zakone, dhe në të vërtetë ka, këta nuk duhet t'i bëjmë shumë fajtorë, sepse ashtu e kuptonin këtë çështje, ashtu ishin mbrujtur dhe edukuar. Pran-

daj, ta kuptojmë situatën e tyre, t'i ndihmojmë që të pastrohen gradualisht prej këtyre mendimeve, pse ata janë gjyshërit, baballarët, vëllezërit tanë, të cilëve nuk duhet t'u hedhim gurin, por, nga ana tjetër, nuk na lejohet të mos u hapim sytë, të mos u themi se këto zakone nuk janë aspak të mira, prandaj duhet t'u vëmë shqelmin.

Nuk është aspak e mirë ta fejosh vajzën tënde në moshë të vogël. Shihni si i ndritin sytë kësaj vajze të vogël që kam përpara, sa të pastër i ka. Kjo tani mëson në shkollën fillore, është e qeshur dhe e gëzuar. Partia, këtë dhe shoqet e saj, i edukon të jenë të lira, jo të ndrydhura, të mësohen, të bëhen të afsta për veten dhe për shoqërinë. Ne përpinqemi që ato të mos vuajnë hidhërimet që kaluan nënënat tonë, të cilat prindërit, për shkak të zakoneve, në shumë raste, i fejonin, bile, akoma pa lindur, me djem të «miqve» të tyre. Nuk është zakon i mirë të shesësh shpirtin tënd, vajzën tënde, sikur të ishte një kafshë për pazar, aq më tepër tani, në kohën e socializmit, në kohën e Partisë. Këto zakone, në fakt, ekzistojnë te ne, por ato nuk janë në ndjenjat e popullit tonë, ato na i kanë sjellë të huajt. Nuk dua të zgjatem për këtë temë, po dëshiroj t'ju them se në Evropë bëhen gjëra akoma më të poshtra kundër gruas, megjithëse burrat atje hiqen si njerëz «të mësuar» e «të qytetëruar».

Partia na këshillon t'i zhdukim zakonet prapanike se nuk janë të mira. Me punën e madhe që po bën ajo në këtë drejtim, mendjet e njerëzve janë zgjuar më shumë. Shqiptari është njeri me besë, i

zgjuar, patriot dhe me mend. Çdo njeri te ne po mendon për ato që këshillon Partia lidhur me të drejtat e femrës, që vajza të mos shitet, të mos fejohet që e vogël, që gruaja të mos rrihet, të mos ngarkohet etj. Dhe tani burrat i kanë vënë gishtin kokës dhe po mendojnë si t'i zbatojnë mirë e më mirë këto këshilla. Edhe ju të mendoni nëse kanë qenë të drejtë të tilla qëndrime ndaj grave. Jam i bindur se do të arrini me siguri në atë që thotë Partia, se ato ishin krejtësisht të padrejta. Po të gjykon sa të shtrembra kanë qenë dhe të mos i zbatoni më këto zakone të këqija, që kanë rënduar gjatë shekujve mbi gruan, do të shihni pastaj ç'dashuri e madhe do të rrënjoset në familje, ç'respekt do të kenë gruaja dhe vajza për babanë dhe vëllanë, por ama një respekt të vërtetë dhe jo «respekt» prej skillaveje që t'i përulet, apo t'i puthë dorën burrit. Marrëdhëniet në familje atëherë do të jenë të drejta, të tilla saqë vajza, krejtësisht e lirë, kur të vijë në moshën e martesës, pa asnje frikë, do t'u drejtohet babait dhe nënës, si njerëzve të saj më të dashur, dhe do t'u thotë se asaj i ka pëlqyer një djalë dhe dëshiron të fejohet me të. Po të jetë i mirë djali, babai duhet ta përgëzojë menjëherë të bijën, por edhe kur di se djali ka ndonjë të metë, t'i thotë vajzës: «Bija ime, unë nuk dua të ta prish zemrën, por ky djalë ka edhe të meta që duhet t'i ndreqë» dhe vete, takohet e biseton me të, e këshillon të korrigjojë të metat që ka.

Duke punuar të gjithë për t'u pastruar nga zakonet prapanike, do të shikoni pastaj ç'përparimë të mëdha do të ketë në vendin tonë, pse këto zakone

që do të zhduken, nuk do të jenë më pengesë, mendja e burrave do të çlirohet, njerëzit do të marrin frysë më lirisht, do të shtohet gëzimi në jetë, në familje, zemrat e grave e të vajzave do të rrahin të lira. Dhe, kur të jenë të gjithë të gëzuar në familje, edhe puna do të bëhet më mirë. S'ka dyshim se kur je i gëzuar, punon më mirë, brengat e shpirtit, që janë më të këqija se varfëria, do të zhduken, sepse, kur ke diçka që të bren, asnje e mirë nuk të zë vend. Kur njerëzit të pastrohen nga këto gjëra, do të qeshin e do të gëzojnë, do të jenë plot optimizëm, prandaj kur kryesia të marrë vendim për ta rritur rendimentin e misrit, anëtarët do të zotohen dhe do të punojnë ta tejkalojnë dhe të jeni të sigurt se kjo do të arrihet. Njerëzit do të jenë çliruar nga këto zakone të këqija,jeta e tyre do të bëhet si dita me diell, kushdo do të punojë me guxim e dëshirë më të madhe. Ju po vendosni këtu, në fshatin tuaj, disa zakone shumë të mira. Për shembull, më bëri përshtypje që burrat tanë tregojnë respekt për gratë, të cilat nuk ngarkohen më si në disa krahina të tjera të vendit tonë. Ky është një shembull i mirë për gjithë Shqipërinë, por sidomos për malësitë tona.

Pleq e plaka, fshatarë e qytetarë, nga të katër anët e vendit më drejtojnë çdo ditë me qindra letra, me të cilat shprehin vendosmërinë e tyre për të hedhur poshtë zakonet e këqija. Kjo tregon patriotizmin e madh të popullit tonë, të pleqve, të nënave e të baballarëve tanë. Kanë rëndësi të madhe këto që po bëni edhe ju këtu. Zakonet prapanike e besimet fetare nuk i gjen te fëmijët tanë në atë shka-

llë që i ka brezi ynë. Të tilla mbeturina i gjen më të forta te burrat e moshës së kaluar, i gjen, gjithashtu, edhe te vetë gratë, pse ka edhe nga ato që mben ten përsëri të përulura, megjithëse Partia u thotë si të vaprojnë. Prandaj, kur shohim që deri edhe pleqtë ngrihen dhe i hedhin poshtë zakonet prapanike, ne me të drejtë gëzohemi e themi se kjo është me të vërtetë një gjë e mrekullueshme. Ky është një qëndrim trimëror si shumë trimëri të shqiptarëve, që nuk kanë duruar zgjedhën e përuljen. Kështu ata hedhin poshtë me vendosmëri disa zakone të këqija të vendosura me shekuj në jetën e popullit tonë. Kjo do të ndihmojë që Shqipëria të ecë akoma më shpejt në rrugën e drejtë të socializmit, të mirëqenies e të përparimit.

Duke kaluar këtej, vura re kodrat e bukura që keni hapur këtu afër me punën tuaj dhe m'u bë zemra mal. Por u gëzova ca më shumë kur mësova se kjo punë është bërë nën drejtimin e nënkyetares suaj, që nga trupi nuk ta zë syri, se është e paktë, por juua zuri syri juve, kooperativistë patriotë, që i besuat asaj udhëheqjen, sepse e njihnit kush ishte, i njihnit zotësinë dhe punën. Sigurisht, ajo nuk ka si t'i dijë të gjitha, prandaj ju ka ju, që ta mësoni e ta korrigjoni. Sado i mësuar të jetë një njeri, sado shkollë të ketë e sado libra të ketë kënduar, nuk mund të dijë më shumë nga sa di mësuesi i madh popull. Unë dua që të rinjtë e të rejat t'i ndjekin shkollat, por nga eksperiencia personale them se nuk do t'i kisha mësuar nga librat të gjitha ato që më kanë mësuar lufta e popullit dhe e Partisë gjatë

këtyre gati 30 vjetëve. Prandaj, edhe nënkyretarja e re, edhe kuadrot e tjerë e çdo udhëheqës duhet të mësojnë nga ju, kooperativistët.

Duke zgjedhur nënkyretare të kooperativës një grua, ju patët parasysh mësimet e Partisë për ngrijtjen e gruas në përgjegjësi, për të zgjedhur në udhëheqje njerëzit që punojnë mirë, qofshin këta burra ose gra. Ju, pra, keni vepruar shumë mirë dhe një punë e tillë ju nderon, sepse, me këtë që bëtë, tregoni se e keni kuptuar drejt vijën e Partisë. Ai që ka merita duhet të udhëheqë, por edhe atë, kur bën gabime, ta kritikojmë; kur i përsërit dhe vazhdon të mos punojë mirë, ta heqim.

Partia, që është pjellë e popullit, na mëson që zëri i tij duhet të dëgjohet në radhë të parë. Po nuk u dëgjua ky zë, mori fund puna jonë, sepse forca e Partisë qëndron të populli, drejtësia e Partisë e ka burimin te drejtësia e tij, lumturinë dhe çdo gjë të mirë e krijon populli. Prandaj Partia këshillon vazhdimisht që, për çdo gjë, të mbështetemi kurdoherë te populli, vullneti i të cilit duhet të vihet në zbatim. Populli ka gjithnjë të drejtë. Një njeri, dy, tre, pesë ose dhjetë qofshin, mund të gabojnë, kurse mijëra njerëz jo. Një mendje është e mirë, thotë një fjalë e urtë, dy janë më të mira, kurse një mijë janë edhe më të mira. Atëherë, na lejohet neve të kënaqemi me mendimet e një apo dy vetave? Jo! Duhet të shohim ç'mendojnë njerëzit e punës. Kjo është ajo demokraci për të cilën flet Partia. Prandaj, populli duhet të ngrihet i téri në këmbë dhe të thotë fjalën e tij për çdo gjë.

Ne, udhëheqësit, duhet të jemi kurdoherë në shërbim të popullit. Partia, Qeveria dhe populli na kanë besuar detyrat e rëndësishme që mbajmë jo që të bëhem i zotërinj, por të zbatojmë me rreptësi dëshirat dhe kërkesat e masave të udhëhequra nga Partia. Masat e gjera punonjëse, burrat, gratë, të rinjtë e të rejat, me një fjalë gjithë populli, mendojnë, punojnë, prodhojnë e krijojnë. Por kjo nuk do të thotë se nuk ka rëndësi edhe udhëheqja. Dhe kjo udhëheqje është Partia jonë e Punës. Vazhdimit Partia na mëson se komunistët duhet të janë të pastër, të thjeshtë, të ndërgjegjshëm, punëtorë dhe të ndershëm, ashtu siç është vetë populli ynë. Veçanërisht, në qoftë se ne, udhëheqësit, nuk do të jemi të tillë, atëherë populli, Partia kanë të drejtë të na heqin nga vendet me përgjegjësi që na kanë dhënë. Masa duhet t'i vërë në dukje të metat atij që gabon dhe vetë ajo të gjykojë nëse e meriton të qëndrojë në këto përgjegjësi apo jo. Njerëzit e ndreqshëm, ata që i kuptojnë gabimet, populli di t'i falë, por ndaj atyre që nuk i kuptojnë dhe i përsëritin, ai mban qëndrim, i spastron. Pikërisht, për një punë të tillë kemi nevojë ne, sepse duke ecur në këtë rrugë Shqipëria nuk dobësohet, përkundrazi, forcohet edhe më shumë.

Kryetari i kooperativës më foli pak për zhvillimin e kooperativës suaj dhe mësova se ju keni arritur mjaft suksese. Po përparime akoma më të mëdha do të keni në të ardhmen. Përparimi vjen nga puna, e cila krijon çdo gjë. Prandaj njerëzit tanë, kudo që janë, në fusha e në malësi, t'i këshillojmë t'i shtrohen sa më mirë punës, sepse ajo shton begatinë,

shëndosh mendjen dhe muskujt, forcon besimin, na edukon të mos e kalojmë kohën kot. Ai që punon, është i ndershëm, nuk ka kohë të merret me llafe të kota ose të mbajë nëpër gojë njerëzit, ai ka respekt edhe për punën e djersën e shokut, nuk i shkruan tjetrit as më shumë dhe as më pak ditë-punë nga sa ka bërë.

Bujqësia jonë do të marrë një hov akoma më të madhi në të ardhmen, do të shfrytëzohen më mirë të gjitha tokat. Partia dhe shteti i kanë dhënë e po i japin bujqësisë çdo ndihmë. Në të ardhmen do t'i japin asaj një rëndësi edhe më të madhe, me qëllim që fshatarësia të prodhojë më shumë dhe jeta e saj dhe e të gjithë popullit tonë të bëhet më e begatshme, më e lumtur. Këtë vit ne do të kemi më shumë pleh kimik. Kjo do të thotë që do të prodhojmë grurë, missë, zarzavate, qumësht e mish më shumë se gjer tani, por nuk duhet të harroni në asnjë mënyrë plehun e bagëtisë. Për këtë qëllim mbani edhe lopë më shumë, i ushqeni ato më mirë se gjer tani, sepse, kështu, jo vetëm do të keni qumësht e mish më shumë, por me plehun që do t'ju japin do të ngrini më lart edhe rendimentet e prodhimeve bujqësore. Kujdes duhet të tregoni, gjithashtu, edhe për bagëtitë e imëta.

Mos u pendoni për zvogëlimin e sipërfaqes së oborreve kooperativiste. Ua thashë edhe dje shokëve të aktivit të Partisë të rrethit tuaj që të punojnë për ta kuptuar drejt të gjithë këtë iniciativë. Pakësimi i sipërfaqes së oborrit nga tre dynymë në një ose në një e gjysmë, disa njerëz i ka shqetësuar ca dhe

këtë Partia e kuption, por ajo nuk i do kurrë shqetësimin dhe të keqen e popullit. Prandaj kini besim në rrugën e Partisë, kini besim në kolektivizimin, mobilizohuni me të gjitha forcat tuaja, duke vënë të gjithë zotësinë dhe diturinë tuaj për forcimin e ekonomisë së përbashkët kolektive dhe, atëherë, me siguri do të keni më shumë se gjer tani mish, gjalpë, gjizë, qumëshët etj. Partia ju këshillon që oborrin personal ta keni jo më shumë se një dynym e gjysmë, sepse kështu do të jetë më mirë për ju. Në kooperativën tuaj, për shembull, nga shkurtimi i oborreve kooperativiste përqendruat rreth 40 hektarë tokë. Kjo tokë është prapë juaja dhe do të krijojë mundësinë që niveli i jetesës suaj jo vetëm të mos ulet, por të ngrihet. Duke mobilizuar si duhet forcat, ju duhet të arrini që nga këta 40 hektarë, me një punë e organizim më të mirë, të merrni dyfishin e prodhimit që merrnit kur e kishit vetë dhe mendoj se kësaj mund t'ia arrini. Në tokën e kolektivuar, që punohet me mjete të mekanizuara, ku do të përdoret edhe pleh kimik e kujdesi për shërbimet e duhura do të jetë më i madh, me siguri do të merrni prodhime më të mëdha, të cilat përsëri do t'ju kthehen juve.

Partia dhe Qeveria mendojnë ta shikojnë çështjen e shpërndarjes sa më mirë të të ardhurave të kooperativës. Tani që po pakësohen sipërfaqet e oborreve kooperativiste, do të ishte e arsyeshme të ndahej qumëshët e zarzavate nga prodhimet e kooperativës për nevojat e anëtarëve. Është mirë që kryesia të mendojë për të caktuar një fond toke për prodhimin e zarzavateve për kooperativistët, në mënyrë që ju

të merrni patate, domate, bamje, patëllxhanë, bostan, specia, etj. nga prodhimet e kooperativës. Duke vepruar kështu, ju nuk do të pendoheni për tokën dhe kafshët që dorëzuat, gjë që tani ndonjërit i duket pak e vështirë. Nuk do të kalojë shumë kohë dhe vetë do ta kuptioni se këto masa që po merren do t'ju sjellin më shumë fitime.

Për t'ua arritur qëllimeve që thashë, rëndësi të madhe ka organizimi si duhet i punës. Partia është e bindur se udhëzimet, që është duke dhënë, po zbatohen nga masat me rezultate të mira. Populli i vë në jetë udhëzimet e Partisë, sepse ka besim të paku-fishëm tek ajo. Ky besim ka bazë të shëndoshë bindjen e popullit se Partia lufton për të bërë realitet dëshirat e tij. Prandaj, vëllezër dhe motra, le të hidhem me të gjitha forcat në punë, t'i ndajmë drejt punët dhe të gjithë, burra e gra, në fusha e në malësi, në fshatra e në qytete, të mos kursejmë asgjë për ta bërë atdheun tonë më të pasur, më të bukur, më të lumtur, më të fortë e të paprekshëm nga çdo armik.

Me kaq dëshiroj t'i jap fund fjalës sime. Më falai se u zgjata ca, por edhe një herë ju them se jam shumë i kënaqur për sukseset që keni arritur dhe që ju shoh të gjithëve të qeshur e plot shëndet. Të gjitha këto tregojnë se jeta te ne është duke u përmirësuar vazhdimisht. Në vitet e para, kur porsa ishte çliruar Shqipëria, djemtë dhe vajzat, që parakalonin në manifestimet popullore në Tiranë, ishin të dobët fizikisht. Kurse sot kemi një rini të shëndetshme, plot gjallëri, sypatrembur, të vullnetshme, të mësuar, të aftë e të ndërgjegjshme për detyrat e

saj, që shkon me dëshirë të madhe në aksione, ku derdh pa kursim djersën, ku edukohet, forcohet e kalitet edhe nga mendja, edhe fizikisht. Të rinxje e të rejave, që shkojnë në aksione nga të katër anët e Shqipërisë, do t'u hapen sytë, sepse atje ata do të shkëmbjnë mendime me njëri-tjetrin, do të punojnë e do të jetojnë të gjithë si motra e vëllezër. Gjuhët e liga mund të flasin, por të jeni të sigurt se një vajze që shkon të punojë, që di të mbajë pushkën, ashtu si edhe kazmën e çekiçin në dorë, askush nuk ia merr dot nderin. Mos u trembni nga gjuhët e këqija, që duhen prerë; shqiptarët janë njerëz të ndershëm e të besës. Dhe në qoftë se guxon kush t'i shkelë normat e shoqërisë sonë, kundër tij do të bien me forcë ligjet e Partisë e të shtetit. Dërgoni, pra, djemtë dhe vajzat tuaja në aksione dhe, kur të kthehen, të shikoni se si do t'i nderojë fshati, pse ata do të sjellin me vete hovin revolucionar dhe dashurinë e thellë për punën dhe jetën e gëzuar, për lumturinë në familje.

Ju, këtu në fushë, keni bërë mjaft përparime, por në malësi vëllezërit tanë janë akoma prapa, prandaj, na bie barra që të mendojmë edhe për ta, si vëllezër që jemi, t'i ndihmojmë edhe ata të ecin përpara, ashtu si në çdo fushë tjetër, edhe në drejtim të pjesëmarrjes së vajzave e të grave në të gjitha fushat e jetës së vendit. Në shumë fshatra gratë dhe vajzat janë akoma të ndrydhura. Mbaj mend kur isha i vogël, në Gjirokastër kishte gra të qytetit, të cilat nuk dinin ç'ishte Kordhoca, një vend fare afër këtij qyteti, pse nuk kishin dalë

kurrë jashtë Gjirokastrës. Por Shqipëria tani është e të gjithëve; shqiptari, në çdo skaj të vendit që të punojë, e ndien se i shërben atdheut, gjithë popullit të vet. Kur vajza kooperativiste do të vejë në aksion, atje do të shohë dhe do të mësojë shumë gjëra, do të shikojë veprat e mëdha që janë ndërtuar pas Çlirimt, hekurudhat, fabrikat, uzinat, fushat që punohen me traktorë etj., do të shikojë sa e sa qytete e fshatra. Duke punuar kështu, Shqipëria do të bëhet kopshë me lule, do të zbulurohet çdo ditë e më mirë nga duart e arta dhe mendja e ndritur e njerëzve tanë, të udhëhequr nga Partia. Kështu, kur të kthehen në fshat, djemtë dhe vajzat, që do të dërgoni në aksione, do të vënë të gjitha forcat për zbulimin e fshatit të tyre; ata do të janë të parët që do të kërkojnë të thyejnë normat, që të prodhojnë e të shtojnë sa më shumë rendimentet, që kooperativa të pasurohet, që ju të keni më shumë të ardhura. Vetëm me punë të palodhur dhe me mendjen e njerëzve tanë të mrekullueshmë do të bëhen edhe zonat malore të bukura e të pasura, ashtu sikurse edhe fushat.

Ju uroj suksese dhe shëndet, juve, vëllezër dhe motra kooperativiste, që ndodheni në këtë takim, dhe, nëpërmjet jush, përvëndes dhe të gjitha familjet tuaja!

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

# **POPULLSIA SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI NUK MASHTROHET DHE NUK MPOSHTET DOT NGA KLIKA TITISTE**

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit».*

**5 prill 1967**

S'ka pak ditë që presidenti i revizionistëve jugosllavë, Josip Broz Tito, la në mënyrë të papritur ishullin e qetë të Brionit dhe zbriti për një vizitë të shkurtër në krahinën më të shqetësuar të mbretërisë së tij, në Kosovë e në Rrafshin e Dukagjinit, të cilën nuk e kishte parë që prej 16 vjetësh dhe që nuk ka bërë kurrë pjesë në agjendën e tij turistike. Në ndonjë rast tjetër supozimet mund të ishin të ndryshme, por kësaj here në fjalimet e tij të pambaram, që mbajti në Mitrovicë e Prishtinë, në Prizren e Gjakovë, në Pejë e Zveçan, në takimet e ngushta dhe darkat pompoze që i shtruan pa kursim shërbëtorët e tij, ai nuk i fshehu dot shkaqet që e detyruan të merrte këtë rrugë të gjatë.

Klika e Titos ndodhet tani në një nga periudhat më të vështira të sundimit të saj në Jugosllavi. Në qarqet drejtuese të klikës titiste ka shpërthyer një

përlleshje e madhe dhe e gjithanshme nacionalshoviniste, e cila ka arritur kulmin në ndeshjen ballë për ballë, për çështjen e gjuhës midis dy rivalës të vjetër dhe dy grupeve më të fuqishme — grupit serb e grupit kroat. Këto kacafytje marrin një karakter edhe më të acaruar për shkak të reformës ekonomike, e cila, duke koncentruar jo vetëm fuqinë ekonomike, por edhe atë politike në duart e grupeve të fuqishme dhe rivale, serbe e kroato-sllovene, kan gjallur rezistencën dhe sabotimin në republikat e tjera. Nga ana tjetër, aparati shtetëror dhe ai i partisë revizioniste, që deri pak kohë më parë ndodheshin nën drejtimin dhe nën influencën e njerëzve të Rankovicit, nuk tregojnë gatishmëri për të shërbyer pa hezitim dhe pa çoroditje pas ndryshimeve që u bënë në komandën e lartë të udhëheqjes jugosllave. Po t'u shtojmë këtyre situatave edhe presionet ekonomike e politike, ndeshjen në terrenin jugosllav të interesave të veçanta të imperializmit amerikan dhe të revizionistëve sovjetikë, kuptohet se sa ditë të rënda janë këto të tanishmet për klikën titiste dhe sa e vështirë është pér të që të vendosë njëfarë rregulli, të ulë gjakrat dhe të evitojë, ose më mirë të themi, ta largojë edhe ca katastrofën e paevitueshme.

Titoja, jo rastësisht, zgjodhi Kosovën pér t'i trajtuar dhe pér të ndërhyrë në këto probleme. Kosova është vendi ku është zbatuar në mënyrën më radikale, më të egër dhe me mjetet më barbare politika shoviniste e revizionistëve jugosllavë ndaj një kombësie të madhe, siç është ajo shqiptare, ku kontradiktat

ekonomike, të lindura nga shfrytëzimi kapitalist, janë shumë të acaruara, ku aparati shtetëror dhe ai i partisë nuk kanë kurrfarë besimi në popull etj. Sigurisht, ai nuk shkoi atje për ta ndryshuar gjendjen, mbasi fati i popullit të Kosovës dhe i shqiptarëve të tjerë të Jugosllavisë është ajo që i intereson më pak atij. Por ai donte të krijonte me vizitën e tij në Kosovë një kuadër idilik të realitetit revisionist, një truk propagandistik, për të mashtruar shqiptarët e kësaj krahine dhe të gjithë popujt e Jugosllavisë. Duke e paraqitur gjendjen në Kosovë dhe në Rrafshin e Dukagjinit, ku banojnë edhe disa pakica të vogla serbe e malazeze, sikur çështja nationale na qenka zgjidhur në mënyrë «shembullore», sikur ngritja e ekonomisë, zhvillimi i kulturës, përparimi në fushat shoqërore etj. atje paskan arritur kulmin dhe nuk ekzistoka më asnjë problem preokupues, ai donte t'u thoshte popujve të Jugosllavisë se «shembulli i Kosovës» tregon që grindjet e tanishme nacionaliste, kaosi ekonomik dhe vështirësitë e tjera nuk kanë të bëjnë me vijën e udhëheqjes, e cila është e kulluar, por janë, gjoja, vështirësi të përkohshme, keqkuptime, gabime të individëve të veçantë, pasoja të aktivitetit të Rankoviçit e të tjera.

Por me gjithë përpjekjet e Titos, megjithëqë u këput së foluri në Kosovë që nga mëngjesi e deri në mbrëmje, ai nuk mundi të gënjejë me demagogjinë dhe me manovrat e tij të rafinuara as popullin e Kosovës, as edhe atë të krahinave të tjera. Nga fjalimet e tij, sado të maskuara që ishin qëllimet, doli fare qartë se klika titiste është e vendosur të ndjekë,

si gjer tani, ndaj shqiptarëve në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni e në Malin e Zi, politikën e vjetër shoviniste serbomadhe të shkombëtarizimit të tyre, politikën e shtypjes nationale e të dhunës policeske, politikën e ruajtjes në këto krahina të gjendjes koloniale e të shfrytëzimit të saj, si burim lëndësh të para e fuqie punëtore të lirë. Ai shkoi në Kosovë për t'i sigruuar dhe për t'u dhënë zemër shovinistëve serbomëdhenj vendas, për t'u thënë se fjalët mbi demokracinë, barazinë kombëtare etj., që kanë shpërthyer si lumë pas plenumit të Brionit<sup>1</sup>, janë thjesht propagandë, që imponohen nga situatat, dhe për të kërcënuar shqiptarët se ata s'kanë çfarë të presin, se gjendja si ka qenë ashtu do të jetë në Kosovë.

Dhe, në fakt, çfarë bëri dhe çfarë deklaroi Titoja gjatë vizitës së tij në Kosovë?

Krahina e Kosovës dhe përgjithësisht zonat ku jetojnë shqiptarët, janë shumë të preokupuara nga problemet e mëdha që prekin çështjet më themelore të një populli, siç janë ato kombëtare, ekonomike, kulturore, arsimore etj. Kohët e fundit, jo se nuk diheshin, por titistët u detyruan të pranonin vetë publikisht krimet e rënda të gjenocidit, që ata kanë bërë kundër shqiptarëve, të flisnin nëpër mbledhje të hapëta dhe të shkruanin në shtyp për aktet e tmershme të shovinistëve serbomëdhenj në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi, të tregonin ngjarje e histori nga

---

<sup>1</sup> Në ditët e para të korrikut të vitit 1966 u mbajt në Brioni Plenumi i 4-t i KQ të LKJ, ku u përjashtuan nga KQ i LKJ A. Rankoviçi dhe shefi i UDB-së, S. Stefanoviç.

më rrëqethëset, që ua kalonin edhe atyre të inkvizicionit të mesjetës. Por Titoja, i cili nuk është një njeri i çfarëdoshëm në Jugosllavi, por president i republikës, kryetar i LKJ, komandant i përgjithshëm i ushtrisë, dhe mban mbi vete përgjegjësitë kryesore politike të atij vendi, nuk foli fare për këto ngjarje, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Ai nuk mori mundimin as t'ia hidhte fajin Rankoviçit, siç vepron het tani zakonisht në Jugosllavi, për të mashtruar opinionin publik në lidhje me shtypjen nationale, persekutimet e terrorin politik të klikës titiste. Largimi i Titos nga kjo temë nuk ishte i rastit. Duke mos i prekur këto, duke mos i justifikuar, qoftë edhe në mënyrë demagogjike, ai donte t'u thoshte shqiptarëve në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni e në Malin e Zi, se terrori, shtypja nationale, shpërngulja në masë, shkombëtarizimi nuk ishin politikë ose gabim i Rankoviçit, që do të korrigjohej, siç është thënë atje deri më sot, por një vijë themelore e vetë atij, e gjithë udhëheqjes jugosllave, që do të vazhdonte dhe në të ardhmen si më parë, me konsekuencë dhe pa asnjë lëshim. «Në radhët tona, — deklaroi Titoja në aktivin politik në Pejë, duke pasur parasysh shqiptarët. — nuk duhet të durojmë shovinistët», ndërsa në një fjalim, që kishte mbajtur dy-triditë më parë në Mitrovicë kishte thënë se «nuk duhet që shqiptarët, të cilët janë këtu të shumtët, të shikojnë mbrapa». Bile ai foli për «shtrembërimë irredentiste» të shqiptarëve dhe për «armiqjtë e klasës», ndaj të cilëve duhet mbajtur një qëndrim vigjilent dhe duhet luftuar me vendosmëri.

Me një fjalë Titoja përsëriti ato parulla të koshme, me anë të të cilave jeniçerët e tij në Kosovë janë lëshuar me tërbim kundër popullsisë shqiptare dhe që me siguri do t'i përdorin edhe në të ardhmen për të justifikuar krimet, vrasjet dhe të gjitha mjetet e tjera barbare për shkombëtarizimin e saj.

Vizita e Titos në krahinën e Kosovës e nxori fare mirë në dritë edhe një herë tjetër vijën e vjetër shoviniste të revizionistëve jugosllavë për shkombëtarizimin dhe serbizimin e krahinave me popullsi shqiptare në Jugosllavi, vijë që është ndjekur që nga fillimi dhe vazhdon akoma edhe sot pa asnjë ndërprerje. Kjo u duk, sidomos shumë qartë në faktin që Titoja, gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, e injoroi këtë si një krahinë me kombësi shqiptare, si një krahinë autonome, që ka të gjitha karakteristikat kombëtare, ashtu siç i ka Kroacia, Sllovenia apo Mali i Zi. Ai e trajtoi Kosovën sikur të ishte një tokë djerr e pa zot, vetëm si një fushë investimesh e shfrytëzimi lëndësh të para për industrinë e madhe serbo-kroate. Bile ai u mundua ta sillte atë si shembull të një vendi, ku është likuiduar kombësia, ku problemi nacional, ndjenjat kombëtare etj., nuk luajnë asnjë rol, nuk kanë asnjë rëndësi. «Në këtë krahinë, — deklaroi Titoja, — gjenden disa kombësi. Por unë dëshiroj që pikërisht kjo përzierje e kombësive dhe vëllazërimi e bashkimi i tyre në këtë territor të janë shembull për të gjithë vendin tonë... Në këtë krahinë relativisht të vogël me shumë kombësi mund të realizohet bashkimi, që është aq i nevojshëm... Unë do të dëshiroja që Kosova e Metohia të jetë shembull i një kra-

hine ku realizohet bashkimi dhe vëllazërimi në një masë të plotë».

Sigurisht Titoja e di më mirë se kushdo tjetër se çfarë «bashkim e vëllazërim» ekziston në Kosovë dhe aq më tepër me ç'metoda e me ç'mjete mbahet në këmbë ky «realizim» titist. Por shovinisti i tërbuar nuk e ka hallin aq tek e tashmja sesa te planet e tij kriminale për të ardhmen. Ai, me sa duket, kërkon të likuidojë krejtësisht edhe atë autonomi të vogël të kësaj krahine, që i lejon akoma asaj, qoftë edhe formalisht, të ruajë njëfarë pamjeje të ftyrrës së vet kombëtare, kërkon të krijojë kushte edhe më të padurueshme politike e ekonomike, që shqiptarët të braktisin tokat e tyre, që në Kosovë të vërshojnë serbët e malazeztë, që gjuha shqipe, zakonet shqiptare, traditat e ndjenjat, fizionomia shqiptare e popullsisë së saj të eliminohet në çdo mënyrë. Për më tepër klika titiste kërkon që, nën pretekstin e krijimit të «shembullit të vëllazërimit e të bashkimit» dhe të realizimit të tij në praktikë, të justifikohen veprimet konkrete për shkombëtarizimin e shqiptarëve, siç janë shpërngulja me forcë e shqiptarëve nga vendlindjet e tyre dhe grabitja e tokave fshatare, ardhja në masë në Kosovë e serbëve dhe e malazezëve në formën e specialistëve, punëtorëve të kualifikuar, funksionarëve etj., manovrimet për mohimin e gjuhës e të arsimit shqiptar, persekutimet, torturat e krimet, që bëhen kundër shqiptarëve etj. «Ju, — u tha Titoja një gruopi përfaqësuesish të punonjësve të arsimit e të kulturës të kombësive shqiptare, — përpinquni që të rinjve, të cilët i edukoni që nga mituria, t'ua rrënjosni në

zemër që mostoleranca nacionale është një e keqë e madhe për çdo njeri dhe për të gjithë bashkësinë». «Mostolerancë nacionale» ai quan dëshirën që kanë fëmijët shqiptarë të mësojnë e të flasin gjuhën amtare, të mësojnë historinë e vendit të tyre, të mësojnë zakonet dhe traditat e etërve të tyre. Dhe ai kërkon ta likuidojë këtë «mostolerancë», me qëllim që shqiptarët të serbizohen me çdo kusht, për hir të «bashkësisë», të «parajsës» titiste.

Po shqiptarët në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni e në Malin e Zi, të cilët u kanë rezistuar burrërisht presioneve dhe shtypjeve barbare të bandës shoviniste të Beogradit, ashtu si nuk i janë trembur dhunës titiste, nuk gënjen as edhe nga demagogjia e saj. Ata e shikojnë se çfarëdo mase që marrin sundimtarët e Beogradit, qoftë me karakter dhune ose lajkash, ajo drejtohet kundër interesave të larta të popullsisë shqiptare, kundër jetës dhe së ardhmes së saj.

Gjatë turneut të tij në Kosovë, Titoja foli shumë për «partinë, për rolin e LKJ, për rolin e cilësitë e komunistit». Me anën e kësaj demagogjje ai u mundua ta heqë veten përpara kosovarëve si marksist e internacionalist, për të fshehur shovinizmin, tradhtinë dhe krimet që janë bërë në Kosovë, gjoja prej dogmatikëve jugosllavë dhe jo prej «marksistëve të kulluar» si Titoja e klika e tij. Natyrisht, kjo demagogji nuk i gënjen dot kosovarët, të cilët e kanë trupin plagë dhe zemrën gjak nga krimet çnjerëzore të Titos me shokë dhe e dinë mirë se Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë nuk ka asgjë të përbashkët

me marksizmin, se ajo është një çerdhe renegatësh e tradhtarësh, një bandë kriminelësh e shovinistësh.

Ndonëse udhëtimi i Titos në Kosovë kishte një karakter të theksuar antishqiptar, ai nuk guxoi të zinte hapur në gojë komunistët shqiptarë dhe Republikën Popullore të Shqipërisë nga frika e kosovarëve, të cilët i njohin mirë faktet dhe politikën e drejtë të Partisë e të shtetit tonë dhe janë në gjendje të gjykojnë në bazë të këtyre fakteve se Republika Popullore e Shqipërisë, e udhëhequr nga Partia e Punës e Shqipërisë, lulëzon dhe ndërton me sukses socializmin e sigurt dhe e pamposhtur.

Titoja, gjatë vizitës së tij në Kosovë, foli shumë për «zhvillimin ekonomik» të kësaj krahine, por e pakëtë problem tamam ashtu siç e shikon një përfaqësues i lartë i metropolit gjendjen e një kolonie. Ai u interesua dhe vizitoi vetëm ato qendra industriale e miniera, si «Trepça» afër Mitrovicës, kombinatin kimik-energjetik dhe minerar «Kosova», kombinatin bujqësor industrial «Progres» të Suharekës e ndonjë tjeter, të cilat shërbejnë për nxjerrjen e lëndës së parë dhe punojnë ekskluzivisht për industrinë e madhe të veriut. Sa për fshatin, ku banojnë e punojnë shqiptarët, ai as që u interesua të dinte ndonjë gjë më tepër, përveç sasisë së prodhimit bujqësor që merret prej andej.

Karakteristikë është fakti se në vizitat e tij në qendrat e lartpërmendura, ku ai u takua me drejtuesit dhe kuadrot serbë (kuadro shqiptarë këtu nuk ka), ai u interesua për investimet, marrëdhëniet me industrinë e republikave të mëdha, perspektivat e tyre,

por e la mënjanë faktin se këto pasuri kolosale të Kosovës grabiten e shfrytëzohen, se asnje dinar nga vlerat e mëdha që prodhohen këtu nuk shkon në dobi të kosovarëve, të përparimit të tyre ekonomik e kulturor. Bile, si me mburrje, ai deklaroi se i gjithë fondi federativ dhe i Serbisë, i caktuar për zhvillimin e ekonomisë së republikave të pazhvilluara, tani shkon për ndërtimin e kombinatit të Trepçes dhe të kombinatit «Kosova», domethënë asgjë për arsimin e kulturën, asgjë për shëndetësinë, asgjë për përmirësimin e kushteve ekonomike e të jetesës së popullit.

Titoja u mundua t'i qetësojë kosovarët duke u thënë se «rezultati i investimeve në këto objekte të mëdha tani nuk ndihet në masën e duhur nga njeriu i zakonshëm në territorin tuaj. Por ai do ta ndiejë këtë nesër, kur këto kombinate të mëdha të janë në kulmin e prodhimit». Por këto janë gjenjeshtra dhe premtimi boshe. Shqiptarët në Kosovë nga kjo industri as përfitojnë sot, as do të përfitojnë nesër. Në radhë të parë, vlerat që krijohen në këtë industri nuk investohen për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës në Kosovë, për ndërtimin e uzinave e të fabrikave, që Titoja i quan «fabrika politike», domethënë të panevojshme, ku mund të punonin kosovarët dhe të ushqenin familjet e tyre, por i shkojnë Beogradit, i cili i përdor për nevojat e regjimit të tij. Në radhë të dytë, në këtë industri shumica dërrmuese e kua drove, e specialistëve, e punëtorëve të kualifikuar janë serbë e malazez. Shqiptarët aty mund të merren vetëm në ndonjë punë të rëndë, që nuk preferohet nga të parët, kështu që këtyre, për të jetuar, nuk u mbetet

gjë tjetër, përveçse të rropaten me ndonjë copë të vogël toke, që u ka mbetur, për të bërë ndopak misër sa t'u mbajë gjallë fryshtën kalamanëve. E vëtmja perspektivë, që u tregoi Titoja shqiptarëve në Kosovë, është vuajtja, papunësia, dallimi nacional e shtypja, shpërngulja, shkombëtarizimi.

Gjatë qëndrimit në Kosovë, Titoja dha direktivën që grupet e fuqishme ekonomike të veriut të lejohen të investojnë kapitale drejtësore drejt dhe në mënyrë të pavarur në industritë e reja, ose në ato ekzistuese të Kosovës. Kjo «reformë» do ta shfojë edhe më tepër shfrytëzimin kolonialist të Kosovës. Industritë dhe fermat që do të krijojnë këto grupe ekonomike, përveç faktit që, duke qenë më të fuqishme, me anë të konkurrencës së lirë do t'i gllabërojnë edhe ato ekzistuese, nuk do të lejojnë në asnje mënyrë që qoftë edhe një dinar i vetëm nga fitimet e tyre të shkojë në krahinë për zhvillimin e saj ekonomik e kulturor. Në këtë rast do të veprojë si kudo ligji kapitalist, sipas të cilit nuk bëhet asnje investim në qoftë se nuk garantohet fitimi maksimal, në qoftë se kapitalisti nuk lejohet t'i përdorë ato si të dojë dhe ku të dojë. Gjendja do të bëhet edhe më e rëndë po të kemi parasysh se tani qeveria jugosllave ka lejuar kapitalistët e huaj perëndimorë të bëjnë çfarëdo investimi dhe ku të duan brenda territorit jugosllav, t'i drejtojnë vetë ndërmarrjet e tyre, duke u dhënë njëkohësisht edhe garancinë t'i tërheqin të parrekura fitimet e tyre.

Janë pikërisht këto kushte të rënda dhe këto perspektiva të errëta, që e bëjnë gjendjen ekonomike

të mos ketë ndonjë rrugëdalje. Kosova vuan tani nga sëmundja e rëndë e papunësisë dhe nga pasiguria ekonomike. Për të kuptuar se sa i mprehtë është ky problem, se sa e vajtueshme është gjendja ekonomike e Kosovës, dhe cila është e ardhmja, po sjellim këtu një shembull nga Gjakova, që është tipik për gjithë Kosovën, Rrafshin e Dukagjinit dhe krahinat e tjera të banuara nga shqiptarët. Në takimin që pati Titoja më 27 mars në Gjakovë me këshilltarët e Skupshtinës të komunes dhe përfaqësuesit e organizatave të ndryshme shoqërore dhe politike, sekretari i komitetit të komunes i tha atij: «Mundësítë e gjetjes punë janë shumë të kufizuara, sepse investimet deri në vitin 1970 janë caktuar vetëm për modernizimin e kapaciteteve ekzistuese dhe për specializimin e tyre. Sot punon një njeri në çdo 11 veta, nga gjithsej 22 000 banorë të komunes në Gjakovë. Nataliteti i popullsisë është 3,1 për qind, që do të thotë se çdo vit numri i banorëve në Gjakovë rritet për 2 000 veta».

Sipas fjalës së Titos, në Kosovë, e cila ka 29 lindje për një mijë banorë, që nga 1952 e këtej kanë hyrë në punë vetëm 3 700 veta në vit. Me të vërtetë një shifër qesharake. Sikur këta të kishin qenë shqiptarë, kjo do të ishte gjysma e së keqes. Por këta, në pjesën dërrmuese, kanë qenë serbë e malazez. Vetë ai, në fjalimin e Pejës, u detyrua të pohonte për «mospërputhjen në strukturën e njerëzve në marrëdhënie pune», se «ka shumë serbë në punë, megjithëse shqiptarët përbëjnë shumicën», se «shumica e specialistëve dhe e punëtorëve të kualifikuar janë të kombësive serbe e malazeze» etj.

Daljen nga situata, regjimi titist përpinqet ta gjejë me intensifikimin dhe shtrëngimin e masave shtypëse e shkombëtarizuese. Ai po mundohet tani që forca punëtore e paangazhuar në punë, që është krejtësisht shqiptare, të largohet nga krahina, duke emigruar ose jashtë shtetit, si në Gjermaninë Perëndimore, në Vendet Skandinave, në Francë, në Zvicër etj., ose në republikat e veriut, të cilat kanë nevojë për krahë të lirë pune. Për ta nxitur këtë shpërngulje të imponuar, titistët organizojnë edhe kurse të posaçme për t'u dhënë të shpërngulurve disa njohuri e njoftime se ku mund të shkojnë e ku mund të gjejnë punë. Me këtë metodë, që nuk është më pak barbare nga ajo e përdorur pak vjet më përpara, kur shqiptarët e Kosovës e të Maqedonisë i shpërngulen me forcë për në Turqi, klika titiste kërkon t'u heqë krahinave shqiptare brezat e rinj, forcën më të gjallë për përtëritjen e vetvetes dhe më të aftë për të punuar e për të luftuar.

Këtë veprim çnjerëzor titistët kërkojnë ta nxitin e ta mbështetin me të gjitha mjetet administrative, si dhe me masa diskriminuese në fushën e arsimit e të kulturës. Ata krijojnë të gjitha pengesat e imundshme e të pamundshme që shqiptarët të mos gjejnë punë në vendin e tyre, të mos kenë mundësi të fitojnë zanate të reja, të mos kualifikohen. Fëmijët shqiptarë i detyrojnë dhe i shtrëngojnë me të gjitha mënyrat të ndjekin shkollat serbe, mbasi kështu gjoja ka mundësi të gjejnë punë, dhe, kur këta nuk e duan ose nuk mundin ta bëjnë një gjë të tillë, dëbohen nga shkolla. Para disa ditësh gazeta e Prishtinës «Rilindja» shkruante se në shkollën e mesme teknike të Prizre-

nit, «Gani Çavdërbasha», drejtori serb nuk lejon që mësimet të bëhen në gjuhën shqipe. Kështu, me gjithë dëshirën e nxënësve shqiptarë për t'u bërë teknikë, për t'u kualifikuar, atyre u vihen të tilla pengesa sa ndjekja e shkollës bëhet e pamundur.

Akoma më e vështirë është për shqiptarët pranimi në universitet. Atyre, sidomos atyre që mbarojnë shkollat e mesme në gjuhën amtare, ua kërkojnë provimet e pranimit në gjuhën serbe, duke qenë bile më shumë rigorozë se për vetë serbët apo kroatët, që vijnë nga Beograd i Zagrebi. Në këtë mënyrë ata duan jo vetëm të pengojnë arsimin në gjuhën shqipe, por edhe të mos lejojnë fëmijët shqiptarë të marrin specializime të larta.

Titistët, për demagogji, hiqen sikur e favorizojnë arsimin në gjuhën shqipe në Kosovë dhe vetë Titoja nuk mungoi të mburrej për këtë. Por cila është gjendja në fushën e arsimit e të kulturës në Kosovë? Autoritetet jugosllave thonë se akoma 40 për qind e popullsisë është analfabete. Rrjeti i arsimit është jashtëzakonisht i dobët, mungojnë arsimtarët dhe mbi të gjitha mungojnë godinat shkollore. Titoja tha se në territorin e Kosovës nxirret 6 për qind e energjisë elektrike e të gjithë Jugosllavisë, 8 për qind e prodhimit të qymyrgurit, 50 për qind e plumbit të pastër, 30 për qind e mineralit të magneziumit, 90 për qind e argjendit etj., pa përmendur prodhimin e madh bujqësor. Por fëmijët kosovarë, nuk kanë asnje kassolle të thjeshtë, ku të mësojnë abetaren dhe janë të detyruar të mbeten përjetë analfabetë, nuk kanë mjek, që t'i shpëtojë nga vdekja kur bie epidemi, siç qe

ajo e fruthit vitin e kaluar. Nuk janë mjetet finanziare, që i mungojnë Kosovës për të hapur shkolla, siç gënjejnë revizionistët jugosllavë, por është politika shoviniste serbomadhe e sunduesve të Beogradit, të cilët e grabitin pa mëshirë popullin e Kosovës dhe mundohen me të gjitha mënyrat për ta mbajtur në errësirë, në prapambetje.

Në Kosovë, që nga çlirimi e këtej, është e vërtetë se janë ngritur mjafit institucione kulturore, por ato jo vetëm që nuk janë shqiptare, por janë ngritur qëllimi i funksion antishqiptar, për të shtypur shqiptarët, për të eliminuar kulturën e tyre, për t'i serbizuar ata. Përse nuk ka akoma shkollë të lartë në gjuhën shqipe, teatër ose film shqiptar, përse botimet në gjuhën shqipe mbahen në një nivel mizerabël, kurse ato serbe në Kosovë shtohen e zgjerohen nga dita në ditë? Përse gjuha shqipe nuk është, të paktën në atë masë që parashikohet nga ligjet themelore jugosllave, gjuhë e barabartë zyrtare në Kosovë, po zyrtarët serbë çdo letër shqipe, siç thotë «Rilindja», e flakin menjëherë në kosh nën pretekstin se nuk e kuptojnë? Në këto kushte, a nuk është krejtësisht një demagogji e ulët pretendimi i Titos se Federata Jugosllave bën përpjekje që «kjo krahanë t'i afrohet sa më shumë nivelit kulturor e arsimor të zonave të tjera»?

Në fjalimet e tij të shumta në Kosovë Titoja u mor shumë me grindjen që ka shpërthyer tanë në Jugosllavi midis klaneve rivale serbe e kroate, se cila gjuhë duhet të dominojë, se cila duhet të bëhet zyrtare, serbishtja apo kroatishtja, çështje që ka për-

fshirë sferat më të larta të inteligjencies dhe të organizatave shoqërore. Por edhe këtë grindje, që është një shprehje e qartë e degjenerimit të regjimit titist, e ashpërsimit të kontradiktave klasore e nacionale, Titoja u përpoq ta shfrytëzojë për të goditur ndjenjat kombëtarë të shqiptarëve, përpjekjet e tyre për të ruajtur e për të folur në gjuhën amtare. «Ne, — u tha ai atyre, — nuk jetojmë nga gramatika, nga ky apo ai dialekt». Por çështja e gjuhës shqipe për kosovarët nuk është gramatikë e dialektologji. Për ata ajo është një çështje e madhe, që ka të bëjë me gjërat më të shenjta që ka një popull, me karakterin kombëtar të tij, me historinë e traditat e tij, me jetën e tij. Gjuha shqipe në Kosovë nuk është dhe nuk do të jetë kurrë një çështje e thjeshtë linguistike, por një problem jetik, për të cilën kosovarët luftojnë pa u përkultur për ta vënë në vendin që meriton.

Vizita e Titos në Kosovë, me gjithë përpjekjet që bëri ai për të lënë në heshtje të kaluarën dhe për të bërë pretime boshe, zbuloi edhe një herë tjetër përrapa kosovarëve dhe gjithë botës se vija e Titos është vija e mohimit të kombësisë shqiptare, se ajo është një vijë antishqiptare, që synon në shtypjen e gjith-anshmë nacionale dhe në shkombëtarizimin e popullit të Kosovës. Dhe populli i Kosovës e kupton se Titoja shkoi atje jo nga dashuria që ka për të, por me qëllim që të forcojë pushtetin e tronditur të klikës titiste, të forcojë shtypjen nacionale dhe shfrytëzimin kapitalist, të nxitë shkombëtarizimin me metoda edhe më barbare e më të rafinuara. Nga eksperiencia e tij e gjatë nën sundimin titist populli i Kosovës e di se

sa herë kanë qenë atje hierarkët e lartë titistë, mbi të kanë shpërthyer valë të egra terrori e krimesh çnjerëzore, janë ndërmarrë masa të rrepta kundër interesave dhe jetës së tij. Prandaj ai i ndjek ngjarjet me shumë vigjilencë dhe di të jetë kurdoherë në gjendje për të demaskuar e për të goditur me forcë si masat e dhunës shoviniste, ashtu edhe intrigat e mashtrimet demagogjike të klikës titiste.

Shqiptarët në Kosovë, në Rrafshin e Dukagjinit, në Maqedoni e në Malin e Zi e dinë mirë se arkitekt iniciator dhe organizator i kimeve të zbatuara kundër tyre është vetë Titoja, se përderisa të jetë në fuqi klika titiste, përderisa vendin ta sundojnë revizionistët, për të nuk do të ketë kurrë siguri, të drejta demokratike, nuk mund të sigurohen të drejtat dhe barazia kombëtare. Prandaj ata nuk do të bien kurrë në kurthet që ngre klika titiste, po do të dinë që krahas popujve të tjerë të shtypur të Jugosllavisë, krah për krah me marksistë-leninistët, të vazhdojnë luftën për demaskimin deri në fund të klikës titiste, për mbrojtjen e interesave të tyre të pamohueshme.

*Botuar për herë të parë në  
gazeten «Zëri i popullit»,  
nr. 81 (5806), 5 prill 1967*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

**NË LUFTËN KUNDER BESIMEVE FETARE KA  
VETËM NJË RRUGË — PUNË POLITIKE,  
IDEOLOGJIKE, BINDJE**

*Nga biseda me sekretarin e parë të Komitetit  
të Partisë të Rrethit të Dibrës*

**7 prill 1967**

Dua të tē jap ndonjë këshillë për disa çështje që dalin në rrethin tuaj, për zgjidhjen e të cilave Partia duhet tē bëjë kujdes të madh.

Po e filloj nga vendimet që merren për kooperativat bujqësore dhe, në përgjithësi, për fshatarësinë, të cilat nuk duhet tē jenë të nxituara, tē rastit. Këto vendime, që kanë lidhje me probleme ekonomike të fshatarësisë, shumë herë merren të pastudiuara, shikohet vetëm interes i tregut tē qytetit, furnizimi i rregullt i tij. Kështu, pa menduar mirë, mbyllen pazaret, duke u udhëhequr vetëm nga arsyaja se «fshatari harxhon kohë». Por nuk shihet ana ekonomike e pazarit si për fshatarët, ashtu edhe për qytetarët. Pastaj, marrja e këtyre masave administrative është e lidhur me faktin nëse ka mundësi ose jo që tregtia

kooperativiste dhe shtetërore të plotësojë kërkesat e popullit, të sigurojë furnizimin e qytetit dhe të fshatit. Këto llogari duhen bërë.

Gjithashtu, kur pakësohen sipërfaqja e oborreve dhe numri i bagëtive personale, nuk merrn masa të forta për një planifikim më të mirë të kulturave, përtu ardhur në ndihmë kooperativave, të cilat të sigurojnë për anëtarët sasitë e nevojshme të zarzavateve, të bulmetit etj. Ose grumbullohen bagëtitë në kooperativat e reja dhe nuk mendohet seriozisht për ushqimin dhe strehimin e tyre, nuk mendohet thellë se bagëtitë e kolektivizuara duhet të prodhojnë më shumë nga sa prodhonin kur ekonomia ishte private. Po të mos bëhen këto studime ulet niveli i jetesës së kooperativistit, kurse qëllimi i Partisë është që ta ngremë këtë nivel, të paktën ta mbajmë konstant për një vit pas krijimit të kooperativës.

Është për të ardhur keq se, në bazë, ka mjaft shokë që flasin me terma të përgjithshëm për çështjet ekonomike të fshatarësisë. Ata nuk janë në gjendje të japid një pasqyrë të saktë, veçanërisht për këto çështje, por të ngopin me fraza stereotipe, me gjëra të njoitura. Shumë herë jemi në vështirësi të nxjerrrim konkluzione dhe të bëjmë përgjithësime të drejta. Pikërisht kështu na ndodhi me oborret dhe me bagëtitë e tyre.

Për sa i përket problemit të fesë dhe të zakoneve prapanike, edhe ju, shokë të Dibrës, keni bërë deklarata e keni marrë zotime se s'do të agjerohet, s'do të festohet bajrami etj., etj. Kurse tani vini e na thoni se në rrëthim tuaj ka fanatizëm dhe, indirekt,

kërkonit të merrni pëlgimin për ndonjë masë administrative.

Jo, Partia nuk e lejon këtë, sepse një rrugë e tillë nuk është e drejtë. Ne nuk do të lejojmë të përdoren masa administrative për zhdukjen e institucioneve fetare, të zakoneve e të besimeve të kota. Për zgjidhjen e këtyre problemeve ka vetëm një rrugë: punë politike, ideologjike dhe bindje. Ne vazhdimisht po ju themi se zakonet prapanike e besimet fetare nuk zhduken menjëherë, por gradualisht, me një punë të gjerë e të vazhdueshme, duke përdorur forma të shumëlllojta dhe të përshtatshme jo vetëm për çdo rreth, por për çdo familje dhe individ veç e veç.

Mos lejoni, shokë, që njerëz të ekzaltuar të prekin ndjenjat e popullit. Në asnje mënyrë nuk duhet të acarohemi me popullin për majën e një minareje, e cila në rast se nuk rrëzohet sot, do të rrëzohet mot, kur populli të bindet për kotësinë e besimeve fetare.

Unë do t'ju këshilloj një gjë: Në rast se ne duam që feja dhe zakonet prapanike të zhduken nga brezi ynë dhe nga brezat e ardhshëm, Partia duhet ta fillojë punën në radhë të parë nga gratë, te të cilat, për këto çështje, duhet të mbështetemi fuqimisht.

Problemi i gruas, e kam theksuar dhe do ta theksoj vazhdimisht, është një nga problemet kyç të Partisë dhe të socializmit. Partia dhe klasa punëtore ta kenë të qartë se, pas rinasë, gruaja është pjesa më përparimtare e popullit; se gruaja është më e lidhur me jetën, me hallet, me punën, me familjen, me to-

kën. Pavarësisht se ajo ka mbetur më prapa nga burri, pavarësisht se zakonet, traditat, fenë ajo i ruan në familje, gruaja është më në gjendje t'i hedhë tej, t'i shkelmojë e t'i përvëlojë ato, se i kanë rënduar në kurri zhekuj me radhë.

Duhet të kuptojmë se këto zakone në familje i ka ushqyer edhe burri. Gruaja vuan nga zakonet prapanike, shumë herë pa i kuptuar, duke menduar se në to gjen zbutjen e vuajtjeve, sheh shpresën e shërimit të plagëve të saj. Edhe kur ajo i zhduk pjesërisht këto zakone që rëndojnë mbi të, ka burra që janë të predispozuar t'i ruajnë në njëfarë mënyre, pse me to plekset atavizmi i «superioritetit» të tyre, i «zotësisë» së tyre, i «zgjuarsisë» së tyre.

Përse, pra, disa organizata partie kënaqen, kur këto zakone zhduken vetëm nga burrat? Mos vallë nëpërmjet burrit do ta çlrojmë gruan? Përkundrazi, me anën e grave ne do t'i çlrojmë edhe burrat nga pikëpamjet dhe zakonet e këqija. Prandaj, t'i futemi si duhet punës për çlirimin e gruas, duke aktivizuar, së pari, gratë, doemos, pa neglizhuar edhe aktivizimin e burrave.

Ka shokë që flasin shumë për «ngritjen e personalitetit të gruas», po për këtë bëjnë pak dhe atë pak e bëjnë si «lëmoshë» për gruan, si një favor për të. E quajnë të natyrshme të pranojnë disa burra në Parti dhe të kënaqshme të pranojnë vetëm një grua. Kjo, padashur dhe pa e kuptuar, do të thotë të mendosh si prapanik.

Për të justifikuar këto qëndrime sillen shumië arsyë, pa asnjë bazë, thuhet se burri është më i ngri-

tur etj., etj. Kjo nuk është e vërtetë, sidomos deri në moshën 35-vjeçare. Deri në këtë moshë nuk ka asnje ndryshim në mes vajzës dhe djalit, pse që të dy janë rritur njësoj në regjimin tonë socialist, por mendjet patriarchale në këtë çështje nuk kanë bërë ndryshim. Është absolutisht e nevojshme të bëhet kjo kthesë në punën e Partisë për çështjen e gruas. Mbështetuni fuqimisht te gratë në punën tuaj dhe do të shihni ç'rezultate të shkëlqyera dhe të shpejta do të keni, veçanërisht në zhdukjen e zakoneve prapanike dhe të fesë.

Çështja e besimeve fetare te ne, si në burrat, edhe në gratë, nuk ka të bëjë me bindje filozofike. Ky është më shumë një problem pragmatik, një çështje zakoni, i lënë trashëgim. Zakoni i keq, natyrisht, ka pësuar ndryshime të mëdha, duke shkuar drejt zhdukjes, bile pa bërë edhe një punë ateiste të dendur. Edhe në kohën para vendosjes të rendit tonë socialist, praktikat fetare, megjithëse ekzistonin, prapëseprapë, po t'i krahasojmë me besimin dhe praktikat fetare në vendet e tjera, kanë qenë të zbehta.

Edhe po të marrim besimin katolik, që shërbehej nga klerikë të mësuar, prapë ne do të konstatojmë se edhe këtu klerikët nuk kanë mundur të dalin jashtë praktikave të liturgjisë, të zhvilluara në mënyrë «të zbehtë» në krahasim me vendet e tjera.

Kurse faljet në xhamitë dhe në kishat bëheshin relativisht të rralla dhe kufizoheshin më shumë në ditët e festave fetare. Agjërimet dhe kreshmët e humbisnin efektin e tyre, sidomos në të rinjtë, por edhe në të kaluarit nga mosha nëpër qytete.

«Magjité» dhe nuskat po dobësoheshin dhe ato ruanin një karakter aq primitiv, saqë zhdukej kredia e tyre në masat. «Magjistarët», fallxhorët, njerëzit e nuskave, natyrisht, bëheshin anakronikë, ata mbeteshin nga më injorantët e injorantëve përpara zhvillimit të shoqërisë.

Me vendosjen e pushtetit popullor, me përparimin e madh arsimor e kulturor, me ngritjen e nivelit të jetesës së popullit, e gjithë ajo prapambetje në zakone dhe në fe hëngri një grusht tjetër, më të rëndë.

Disa shokë i vënë më tepër rëndësi «influencës» së një hoxhe ose të një prifti injorant të fshatit, i cili, në realitet, nuk ka asnë kredi, sesa sqarimit të masës mbi këto besime e zakone që janë shumë të lëkundshme, të zbehta e pa baza dhe që, me një punë më të kujdeshshme, do të lëkunden akoma më tepër, derisa të zhduken fare.

Ja, këto ishin disa gjëra që doja të të thosha. Nuk është se këto Partia i thotë për herë të parë, por qëllimi është të térheqim vëmendjen tuaj që me këto çështje të merreni më mirë, duke i dhënë vendin e duhur punës bindëse e politiko-ideologjike me masat.

*Botohet për herë të parë si-  
pas originalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë:*

**MIQËSI E VËRTETË ËSHTË VETËM AJO QË  
KARAKTERIZOHET NGA BESNIKËRIA NDAJ  
MARKSIZËM-LENINIZMIT**

*Nga biseda në takimin me ambasadorin kinez  
në Tiranë*

**12 prill 1967**

*Shoku. Enver Hoxha, pasi i uroi ambasadorit të ri mirëseardhjen në Shqipëri, bisedën në fillim e përqendroi rreth hovit revolucionar të komunistëve e të masave tonë punonjëse që kishte shpërthyer në vendin tonë:*

Komunistët nuk rrojnë dot të qetë, ata janë kurdoherë në revolucion. Qetësia për ta është vdekje, ajo është armikja e tyre. Ata gjithnjë përpara shtyhen nga revolucioni. Sa më shumë që t'i ngrenë masat në revolucion, aq më tepër korrin rezultate të shkëlqyera në të gjitha aktivitetet e jetës. Sa rezultate të mëdha nën udhëheqjen e partive marksiste-leniniste arrijnë popujt në periudha revolucionare jashtëzakonisht të shkurtra! Në periudhë qetësie, të tillë rezultate nuk mund të arrihen as me vite të tëra.

Ne e kemi studiuar historinë e Partisë Komuniste të Kinës dhe të popullit kinez, luftën tuaj të madhe çlirimtare, gjatë së cilës u goditën rëndë Guomindani, imperialistët japonezë, amerikanë dhe të gjitha klikat e kapitalit botëror, njëkohësisht rrymat e ndryshme të djathta e të majta, që janë shfaqur herë pas here gjatë rrugës së partisë suaj. Duke i parë objektivat e Revolucionit Kulturor konstatoj se arritja e tyre është shpëtimtare për popullin e partinë tuaj.

Ju jeni në dijeni të zhvillimit të situatave edhe në vendin tonë. Tani që erdhët në Shqipëri me cilësinë e ambasadorit të vendit tuaj, do të keni rast të merrni kontakt me popullin, me komunistët, me punonjësit e me kuadrot dhe do të shihni vetë konkretisht realitetin e vendit tonë, që është i shëndoshë, revolucionar. Natyrisht, siç ka suksese të mëdha, ka edhe të meta e dobësi, po ajo që vihet re, në radhë të parë, është se te ne sundon fryma e lartë politike, hovi i madh revolucionar. Politikisht njerëzit tanë, të udhëhequr nga Partia, i kuptojnë mirë e drejt problemet që kanë përpara, e përqafojnë vijën e Partisë dhe, megjithëse janë vazhdimisht në luftë me vështirësitetë dhe pengesat, bëjnë përpjekje për realizimin e detyrave që ka përcaktuar ajo.

Kudo në Shqipëri kanë shpërthyer lëvizje revolucionare, që kanë rëndësi të madhe, veçanërisht në momente të tilla revolucionare, sepse ndihmojnë forcimin e situatave të brendshme, për arritjen e objektivave të brendshëm dhe të jashtëm të Partisë. Partia jonë mendon se këta objektiva janë të lidhur ngushtë dhe nuk harron se forcimi i socializmit edhe në vendin

tonë të vogël i shton forcat e lëvizjes botërore në luftën kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye.

Partive marksiste-leniniste revolucionare u bie barra të luftojnë në të gjitha frontet, sepse në të gjitha frontet ka shpërthyer edhe lufta e armiqve kundër marksizëm-leninizmit dhe kundër partive revolucionare. Armiqtë na luftojnë politikisht, ideologjikisht, ekonomikisht, ushtarakisht e me çdo mjet tjetër që disponojnë dhe, siç e dini, nuk disponojnë pak. Prandaj edhe ne jo vetëm që duhet t'i përgjigjemi me guxim luftës së tyre, por kemi detyrë që t'i mposhtim e t'i bëjmë të pavlefshme mjetet që përdorin ata.

Partia jonë mendon se çdo komunist, bile çdo njeri, edhe më i thjeshti, pikëpamjet dhe qëndrimet e veta duhet t'i shohë në prizmin politik. Me këtë frymë i edukojmë njerëzit tanë dhe korrim gjithnjë suksese. Duke i parë çështjet me syrin politik, do të jemi më të përgatitur për të bërë një luftë të fryshtshme kundër ideologjisë borgjeze në radhët tona, kundër mbeturinave në ndërgjegjen e njerëzve, kundër ndikimeve fetare dhe pikëpamjeve e qëndrimeve mikroborgjeze; do të luftojmë më me sukses kundër rrymës regresive armiqësore, propagandës revisioniste e imperialiste dhe me siguri do të arrijmë rezultate edhe më të mëdha në ndërtimin e socializmit.

Partia jonë, qëkurse u themelua, e ka zhvilluar e po e zhvillon drejt luftën e klasave dhe ka pasur suksese në këtë drejtim. Sukseset tona, duke marrë

parasysh veprimitarinë e egër të armiqve të brendshëm e të jashtëm që kemi përballuar e shpartalluar, janë të mëdha. Por Partia na mëson që kurrë të mos e flemë mendjen dhe ne vetë konstatojmë se sa më shumë të thellohem i në këto probleme kaq jetike për çështjen e socializmit, gjithnjë e më tepër shohim se kemi akoma shumë për të bërë.

Pas Kongresit të 5-të të Partisë, te ne ka marrë një hov të madh e po thellohet gjithnjë e më shumë revolucionarizimi i mendjes së njerëzve, revolucionarizimi i mëtejshëm i gjithë jetës së vendit. Është fakt se edhe disa probleme, që përpara mund të gjykohe shin si mjaft delikate për t'u trajtuar, sot po realizohen jo me aq vështirësi të mëdha sa mendohej. Kjo vjen ngaqë gjejmë një mbështetje të madhe në masat e gjera të popullit. Ç'tregon kjo? Kjo tregon pjeturinë politike të masave tona punonjëse. Tani, në luftën që po bëhet kundër mbeturinave e zakoneve të vjetra dhe ideologjisë fetare që është pleksur me to, vëmë re një gatishmëri të plotë dhe një rritje të mëtejshme të hovit revolucionar në masat punonjëse.

Tani ne shohim sa të thella janë rrënjet e ideologjisë fetare në vendin tonë dhe përpinqemi t'i shkulim ato. Ndërkohë ne po e studiojmë atë për të nxjerrë nëse ajo është rrënjosur në bazë të një zhvillimi filozofik-teologjik, apo është përhapur më tepër nëpërmjet dokeve e zakoneve të ndryshme. Duke studiuar burimet dhe rrënjet e fesë mbi baza shkencore, po përpinqemi të ndërtojmë edhe një propagandë antifetare filozofike, marksiste-leniniste, po edhe praktike njëkohësisht. Klerikët tanë injorantë janë përpjekur

ta pleksin fenë edhe me zakone të ndryshme si, për shembull, me ato të martesës ose të fejesës etj. Partia me propagandën e saj mbi baza shkencore i tregon popullit se si duhet t'i bëjë këto, si duhet t'i ruajë zakonet e mira, si t'ua zhveshë atyre petkun fetar. Ajo përpinqet t'i shpjegojë në mënyrë bindëse se magjia, për shembull, dhe besime të tjera të kota janë përdorur nga përfaqësues të klasave të pasura për t'i mbajtur popujt në gjumë, për t'i helmuar, për t'i shtypur e për t'i shfrytëzuar më lehtë ata.

Kështu, pra, ne po luftojmë në dy drejtime, teorikisht e praktikisht, dhe kemi arritur rezultate që janë realisht të larta e që na inkurajojnë. Çështja ka arritur deri aty sa edhe pleq e plaka fshatarë të flasin kundër mashtrimeve të hoxhallarëve ose të priftërinjve, të shprehen lirisht, pa u druajtur, se feja ka qenë dhe është një gjenjeshtë. Kjo, mendojmë ne, është një gjë shumë pozitive. Kush nuk është në brendi të çështjes dhe nuk e njeh këtë realitet të vendit tonë, mund të thotë se lufta kundër fesë në këtë shkallë, saqë vetë masat të kërkojnë të prishen kishat dhe xhamitë, zhvillohet në bazë të «urdhrale» që ka dhënë Partia, kurse, në të vërtetë, Partia nuk ka dhënë asnjë urdhër të tillë. Përkundrazi, Partia ka dhënë direktivën për të qenë shumë prudentë, shumë të matur në këto çështje. Por kurrë ajo s'e ka pushuar, sadopak, luftën ideologjike kundër fesë e zakoneve prapanike. Si për çdo gjë, edhe këto Partia ia ka shtruar popullit, ia ka shpjeguar mirë të këqijat e tyre, ia ka bërë të qartë se ç'rreziqe fshihen prapa fesë veçanërisht, dhe ai është bindur. Për këto rezultatet flasin

vetë; pa vënë dorë fare komunistët ose pa dhënë fare udhëzime për prishjen e institucioneve e riteve fetare, në shumë fshatra, vetë pleqtë kanë thënë: «Nuk ka ç'na duhet xhamia, le ta bëjmë më mirë vatër a shtëpi kulture ose muze të fshatit».

Zakone të egra kemi trashëguar veçanërisht në drejtim të trajtimit të gruas. Për luftën kundër këtyre zakoneve, për emancipimin e gruas, Partia ka punuar vazhdimisht. Por studimet e bëra dhe rezultatet e arritura gjer tani na linin të pakënaqur për këtë problem kaq të madh jetik. Kohët e fundit, Komiteti Qendror i Partisë erdhi në përfundimin që çështja e emancipimit të plotë të gruas, si një nga problemet më të rëndësishme për ndërtimin e socializmit, duhej të merrej edhe më mirë në dorë nga Partia. Ai theksoi edhe një herë se në goftë se gruaja do të çlironët plotësisht nga zakonet feudale, borgjeze e praktikat fetare, çështja jonë, fitorja e socializmit, do të arrihet më shpejt. Gjithashtu Komiteti Qendror i Partisë sonë erdhi në përfundimin që gruaja, megjithëse në disa drejtime është më prapa nga burri, e përqafon më shpejt përparimtaren dhe është më e ndjeshme në vijën e Partisë; se të gjitha zakonet prapanike e bashkë me to edhe feja kanë rënduar e rëndojnë shumë kryesisht në kurrizin e saj; se burri, goftë zakonet prapanike, goftë paragjykimet fetare që kanë të bëjnë me marrëdhëniet burrë-grua, i ka inkurajuar, i ka ushqyer e i ka nxitur ca më tej për të ruajtur e për të forcuar pushtetin e tij mbi gruan, mbi familjen. Ka burra, që nuk bëjnë aq shumë propagandë antifetare; ose nuk luftojnë me forcë kundër zakoneve prapanike

brenda në familje, sepse instinktivisht dëshirojnë të dominojnë përsëri ata, si gjer tani, prindërit ose gjyshërit e tyre.

Partia dha kushtimin edhe në drejtim të emancipimit të plotë të gruas, dhe, me kënaqësi, shohim që edhe në këtë fushë kemi rezultate të mira. Asnjë situatë të vështirë ose pengesë nuk na shkaktoi edhe kjo lëvizje. Për kundrazi, kudo, në fshatra, në qytete, në ara, në fabrika, në shkolla e në institucionet kulturore, ka një gjallëri e zell edhe më të madh në punë.

Shumë drejtësia e kuptuar edhe çështja e stimulit moral nga masat tona punonjëse. Komitetit Qendror po i vijnë përditë me qindra letra nga punonjës të ndryshëm, ku i shkruajnë dhe i kërkojnë që stimujt materialë, që ishin vënë përpara, të huajtura nga të tjerët, gjoja për të nxitur prodhimin, të braktisen. Ja dhe një tregues tjetër i hovit të madh revolucionar që ka shpërthyer te ne e që ka përfshirë të gjitha masat.

Në valën e këtij vrulli e entuziazmi të paparë revolucionar, brenda një kohe të shkurtër u kolektivizua edhe gjithë malësia e vendit tonë. Ky kolektivizim tani u bë në një shkallë më të përparuar politike dhe ideologjike. Në Statutin e Kooperativave Bujqësore ekziston një nen sipas të cilit anëtarët e kooperativës mund të mbajnë për nevojat e familjeve të tyre gjer në tre dynym tokë, si edhe dy lopë e nga 20 krerë bagëti të imëta. Por tani, me iniciativën e tyre, vetë kooperativistët, bile edhe ata të kooperativave të reja, vendosën t'i shkurtojnë në një deri një

dynym e gjysmë tokë dhe deri 10 krerë bagëti të imëta. Këtë çështje tani ne jemi duke e studiuar, si nga ana politike, ashtu edhe nga ana ekonomike, duke pasur parasysh që të mos ulet niveli i jetesës së kooperativistëve. Në mënyrë të veçantë po e studiojmë këtë për kooperativat e porsakrijuara. Anëtarët e këtyre mund të mbajnë edhe 20 krerë bagëti derisa të forcohet ekonomia e tyre kooperativiste.

Si përfundim, dua të them se fryma revolucionare e masave tona punonjëse, nën udhëheqjen e Partisë, është kurdoherë në ngritje dhe në sajë të kësaj po arrijmë rezultate të mëdha në rrugën tonë.

Këto doja të thosha shkurt dhe në përgjithësi. Shkëmbimi i mendimeve dhe i eksperiencës në mes nesh, si kurdoherë, do të jetë i hapët dhe marksist-leninist dhe mendoj se duhet të jetë më i shpeshtë.

Miqësinë dhe dashurinë për njëri-tjetrin marksistë-leninistët nuk e kuptojnë si borgjezët dhe revisionistët, të cilët në marrëdhëniet e tyre kanë në bazë interesat e ngushta egoiste e materiale, kurse marksistë-leninistët në bazën e marrëdhënieve të miqësisë e të dashurisë ndërmjet tyre kanë besnikérinë ndaj parimeve të marksizëm-leninizmit dhe ndjenjat e pastra që mbi gjithçka vënë interesat e revolucionit e të socializmit. Vetëm mbi këtë bazë ekziston miqësi e vërtetë. Miqësia midis marksistë-leninistëve presupozon kompaktësi të pathyeshme në beteja revolucionare, sakrifica e deri në derdhje gjaku në mbrojtje të njëri-tjetrit. Ajo është e tillë jo vetëm në periudha qetësie, por veçanërisht në furtuna, kur fryn murlan ose bie tërmet, ajo merr një kuptim

edhe më të lartë. Në mes vendesh socialiste diplomatët i zhvillojnë bisedimet në fryshtë partie. Prandaj edhe ju vërtet jeni ambasador i Kinës në Shqipëri, por ne ju konsiderojmë më shumë përfaqësues partie dhe bisedimet tonë, në radhë të parë, bëhen në linjë e fryshtë partie.

Kurdoherë Partia e Punës e Shqipërisë i ka vënë rëndësi të veçantë çështjes së miqësisë e të aleancave dhe në çdo hap ajo ka pasur parasysh si anën kombëtare, ashtu dhe atë ndërkombëtare të tyre. Në lidhjen e aleancave borgjezia imperialiste ose revisioniste u vë rëndësi të madhe vetëm akteve të nënshkruara zyrtare, prapa të cilave fshihen ligjet e xhunglës, ndërsa midis nesh çdo gjë lidhet, brumoset e kalitet vazhdimesht, sepse nuk ka në botë miqësi e aleancë më të fortë se ajo që ka në bazë marksizëm-lininizmin dhe internacionalizmin proletar.

*Shoku Enver Hoxha, më poshtë, pasi foli për Revolucionin Kulturor kinez, u ndal në domosdoshmërinë dhe rolin e pazëvendësueshëm udhëheqës të partisë në revolucion:*

Revolucioni proletar, si në kushtet e luftës për përbysjen e pushtetit të borgjezisë, ashtu edhe gjatë thellimit të tij në kushtet e diktaturës së proletariatit, dallohet nga revolucionet e tjera nga organizimi, rregulli, disiplina dhe qartësia që e karakterizojnë. Pa këto karakteristika nuk mund të ketë revolucion të vërtetë proletar të udhëhequr nga pararoja e klasës punëtore, partia marksiste-leniniste, nuk mund të ketë revolucion pa qëllime të qarta politike, ideologjike, ushtarake, ekonomike, të afërta dhe të largëta. Vetëm

një revolucion proletar i tillë, që udhëhiqet nga partia dhe nga idetë marksiste-leniniste, aprovohet nga masat. Ky është një ligj i vërtetuar plotësisht në praktikë.

Por gjatë rrugës së revolucionit dalin edhe njërëz që hiqen si marksistë, që në teori, derisa janë të fshehtë, flasin dhe e përkrahin këtë ligj, por në praktikë, sidomos kur u krijohen situata që mendojnë se janë të përshtatshme, hidhen me tërbim kundër partisë, heqin maskën dhe ngrihen kundër revolucionit.

Partia jonë ka hasur në të tillë elementë armiq gjatë historisë së saj dhe ka marrë vendime të drejta kundër tyre. Në asnjë rast Partia jonë nuk e ka harruar politikën e riedukimit të elementeve që jepnin shpresë se mund të ndreqeshin, por, në radhë të parë, ka marrë masa për forcimin e punës për edukimin e masave të fryshtuara nga Partia. Partia është një forcë e madhe dhe, me punën e saj edukative, politiko-ideologjike, është në gjendje të ndryshojë jo vetëm karakterin e njeriut, por të rrëzojë edhe male. Por kjo s'do të thotë që ndaj armiqve të betuar, qofshin këta edhe të kamufluar, të mos nxjerrë shpatën e t'u japë dënimin e merituar.

Historia e revolucioneve, historia e Partisë sonë na kanë mësuar të ecim sipas parullës «beso dhe kontrollo». Kjo dō të thotë që vigjilanca duhet mbajtur kurdoherë parasysh. Sidomos në këto momente vigjilanca revolucionare është një çështje me rëndësi të madhe, për arsy se ne nuk rrojmë dhe nuk luftojmë vetëm për një ose dhjetë vjet, por punojmë që çështja e socializmit të triumfojë në shekuj, punojmë në më-

nyrë të atillë që imperializmi, revizionizmi dhe ideologjia e tyre idealiste të shkatërrohen gjer në fund.

Cili është ai faktor që do të siguronte mundësinë e përjetësimit të regjimit socialist? E vetmja përgjigje marksiste-leniniste do të ishte: **Ky faktor është partia e brumosur me idetë e marksizëm-leninizmit që udhëheq drejt masat e gjera të popullit.** Vetëm këta, të harmonizuar e të organizuar, mund të sigurojnë fitoren e t'u bëjnë ballë me sukses të gjithë armiqve, të hapët e të fshehtë.

Prandaj është plotësisht marksiste-leniniste në shkallën më të lartë ajo që çështja e partisë është çështja themelore, faktori subjektiv vendimtar për fitoren. Këtë e kuptojnë mirë edhe armiqtë tanë, dhe ata luftën më të madhe sot e drejtojnë pikërisht këtu, kundër partisë, për ta degjeneruar atë, për të bërë që ajo të shtrembërojë të gjitha parimet marksiste-leniniste të ndërtimit të partisë, për ta nënshtruar pastaj dhe, më në fund, të çojë në degjenerimin e gjithë vendit, në restaurimin e kapitalizmit.

Qëllimi kryesor i armiqve është jo vetëm të shkatërrojnë partinë, duke u përpjekur në radhë të parë të godasin parimet e ndërtimit të saj, por njëkohësisht edhe të gjithë ata që mbrojnë parimet. Me këto synime kanë vepruar dhe veprojnë trockistët, buharinistët, imperialistët, revisionistët kundër të gjitha partive marksiste-leniniste, kudo e kurdoherë. Në përgjithësi, lufta e armiqve të partisë mund të ndryshojë formën, por strategja e tyre kurdoherë ka qenë dhe mbetet e njëjtë. Prandaj strategja dhe taktikat e partive marksiste-leniniste bazohen në të kundërtat e

drejtimeve të strategjisë dhe të taktikave të armiqve të marksizëm-leninizmit. Strategjia dhe taktika e partive marksiste-leniniste synojnë në kalitjen, spastrimin dhe forcimin e partisë, në likuidimin nga radhët e saj të të gjithë elementëve që kanë hyrë kontrabandë. Vetëm kështu bëhet e mundur që, me partinë në krye, të organizohen lufta revolucionare, lufta për socializmin e forcimin e tij dhe për likuidimin e klasave shfrytëzuese.

Marksizëm-leninizmi dhe praktika revolucionare na mësojnë se reaksionarëve, armiqve, elementëve të borgjezisë, që kanë depërtuar në parti dhe në push-tet, të cilët kanë bërë kaq të këqija kundër popullit dhe partisë, gjatë revolucionit u jepet një grusht shumë i rreptë, tronditës. Armikut i tregohet forca. Ai përdor edhe dredhi, por gjithashtu nuk lë pas dore forcën goditëse kundër nesh.

Asnjë revolucion nuk përjashton dhunën, goditjen kundër armiqve të tij. Goditja është një nga elementët e domosdoshëm përbërës të luftës së klasave. Sigurisht, shkalla e goditjes në luftën kundër armiqve varet nga rrezikshmëria e punës së tyre armiqësore. Armiqve u duhet treguar vendi që të sigurohet e nesërmja. Por, që të sigurohet e nesërmja, është e domosdoshme të forcohet e tashmja. Armiqtë e fshehtë mendojnë ndryshe. Ata thonë: «të kalojë një herë kjo valë, pastaj shohim e bëjmë nesër». Prandaj «ustalla-rët», kur shohin se po ngrihet me furi vala e revolucionit, u thonë miqve të tyre të tërhiqen, të strukanë dhe të dalin në skenë më vonë, kur situatat të jenë të favorshme.

Marksizëm-leninizmi na mëson se një nga detyrat themelore të partisë në revolucion është që ajo të zhdukë të gjitha llojet e ndikimit të renegatëve, armiqve dhe tradhtarëve politikë dhe ideologjikë. Kjo do të bëjë që të rritet ndërgjegjja e masave dhe edukimi i tyre klasor. Kështu sigurohet fitorja dhe partia mbetet e pastër, vetëm kështu dalim fitimtarë dhe sigurojmë të ardhmen. Në fillim u duhet dhënë goditje vdekjeprurëse eksponentëve, të tjerët, ata të dorës së dytë e të tretë, le të demaskohen më vonë, puna është të veprohet me rrëptësi kundër kryesore, veçanërisht kundër atyre që janë demaskuar një herë.

Ne duhet të sqarojmë politikisht dhe ideologjikisht çdo njeri tonin, miqtë dhe shokët tanë, dhe krahas kësaj pune të përpinqemi me të gjitha forcat që jo vetëm t'i bëjmë të dështojnë planet e armiqve, por edhe t'i shkatërrojmë forcat e tyre. Goditjet kundër tyre duhet të jenë të shumanshme e të pareshtura.

Këto kisha. Ju thashë edhe më parë, ne do të kemi rast të takohemi e do të bisedojmë herë pas here. Tani, punë të mbarë në detyrën e re!

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha. «Kun-  
dër revizionizmit modern  
1965-1967», f. 461*

*Botohet sipas shënimeve të  
mbajtura në këtë takim  
që gjenden në AQP*

## **MBLEDHJA E KARLOVI-VARIT — NJË MBLEDHJE TRADHTARESH**

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**13 prill 1967**

Më 24 të këtij muaji, në qytetin klimaterik të Çekoslovakisë, Karlovi-Vari, do të zhvillohet një mbledhje e disa partive revizioniste të Evropës. Në rend të ditës është çështja e «sigurimit evropian».

Revisionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, po mundohen ta paraqesin këtë mbledhje si një «succès» të vijës së tyre, si një manifestim të «unititetit» dhe të «kompaktësisë» të radhëve revizioniste.

Por e gjithë kjo është një reklamë e bujshme për të shitur një mall të dobët. Qëllimi i saj kryesor është pengimi i revolucionit proletar dhe vendosja e «socializmit» borgjez. Revisionistët do të përpinqen ta shfrytëzojnë këtë mbledhje për realizimin e politikës së tyre evropiane, të cilën po e zbatojnë prej kohësh në rrugën zyrtare shtetërore. Ata mundohen të balancojnë fuqinë e vet me imperialistët amerikanë, duke ruajtur njëkohësisht aleancën me ata dhe

duke ndërtuar aleanca të reja me vendet e tjera kapitaliste.

Analiza e fakteve tregon se «sigurimi evropian»-revisionist është një parullë, një manovër, që ka përqëllim të kamuflojë komplotet e përbashkëta imperialisto-revisioniste kundër popujve të Evropës, kundër forcave të vërteta antiimperialiste e antirevanshiste, kundër kryengritjes revolucionare të popujve.

Me anë të formulës së «sigurimit evropian», revisionistët hrushovianë kërkojnë të forcojnë marrëdhëni me fuqitë kapitaliste të Evropës, të nxitin procesin e integrimit të socializmit në kapitalizëm, të sigurojnë kushte lehtësuese për restaurimin kapitalist, që po zhvillohet tanë në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revisioniste. «Sigurimi evropian» duhet t'u shërbejë revisionistëve si mjet justifikimi përpara opinionit publik dhe si urë kalimi drejt Perëndimit, drejt zgjerimit të bashkëpunimit të gjithanshëm politik e ekonomik me shtetet kapitaliste. Hapat e parë në këtë drejtim tanimë janë bërë. Monopolet italiane, franceze e britanike kanë filluar të investojnë kapitale të mëdha në Bashkimin Sovjetik. Një gjë të tillë po përgatiten ta bëjnë edhe trustet sovjetike në industrinë perëndimore. Gjatë vizitës në Londër, Kosigini e kërkoi hapur zëvendësimin e Tregut të Përbashkët me një «treg të përbashkët evropian». Kuptohet se në këto kushte të dyja palët do të bëjnë përpjekje të zhdukin pengesa për qarkullimin e lirë të kapitaleve, të mallrave, të ideve, të njerëzve etj. Do të quhet ky «treg i përbashkët evropian», apo «sigurim i përbashkët evropian», kjo pak

rëndësi ka. Në çdo rast, ai do të jetë një bashkëpunim klasor midis borgjezisë së vjetër evropiane dhe borgjezisë së re revisioniste.

Revisionistët, duke menduar të shfrytëzojnë luf-tën revolucionare e çlirimtare të popujve, si në Vietnam e gjetkë, të cilën në fakt e minojnë, kërkojnë të krijojnë atë peshë në balancë, që do t'u japë mundësi për ujdi të mëtejshme me imperializmin amerikan dhe socialdemokracinë botërore. Kjo, mendojnë revisionistët, mund të arrihet duke dobësuar të paktën, në mos duke eliminuar, «të tërbuarit» amerikanë. Ata mendojnë se në një rast të tillë fitorja e tyre demagogjike do të ishte e madhe dhe se bashkërisht do të mund ta luftonin më me sukses zhvillimin e revolucionit.

Bashkëpunimi i revisionistëve francezë me partitë borgjeze franceze, si rrjedhim i të cilit revisionistë francezë hoqën dorë përfundimisht nga një politikë e pavarur dhe tanj luajnë një rol të vogël në opozitën tradicionale socialdemokrato-radikale, enciklikat e papës, konformimi gjithnjë e më i theksuar i revisionistëve italianë me interesat e borgjezisë italiane dhe të Vatikanit, liberalizmi dhe shthurja ideologjike e politike në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revisioniste, janë kushtet dhe premisat në të cilat mbështetet borgjezia e re revisioniste në planet e saj tradhtare, e cila mendon dhe shpreson se «bashkekzistenca paqësore», të cilën e pengon agresioni amerikan, do ta shuajë flakën e revolucionit.

Udhëheqësit e Bashkimit Sovjetik dhe të shteteve të tjera revisioniste mendojnë se politika e tyre

e lëshimeve dhe e kapitullimit përpara shteteve kapitaliste të Evropës ka dhënë mjaft prova garancie dhe janë të vendosur të vrapojnë me të gjitha forcat në këtë rrugë. Tani ata janë të gatshëm t'i bëjnë akoma më shumë lëshime ideologjisë reaksionare borgjeze, për të realizuar tok me shtetet e tjera kapitaliste të Evropës balancimin e ndikimit amerikan.

Kjo duket shumë qartë në faktin që Bashkimi Sovjetik dhe revisionistët e tjerë tani tërhiqen zvarrë nga politika e shteteve kapitaliste të Evropës, me nevojat dhe kërkesat e së cilës ata koordinojnë qëndrimet dhe iniciativat e tyre. Kontradiktat midis vendeve perëndimore dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë bërë për revisionistë sovjetikë si fare ndriçuese, që i tërheqin, që i afrojnë dhe i hedhin në fushën e koniunkturave të ngatërruara të botës së sotme kapitaliste. Si revisionistë që janë, si shërbëtorë të borgjezisë dhe të kapitalit, ata nuk mund t'i përdorin këto kontradikta për krijimin e një situate të favorshme revolucionare. Përkundrazi, mundohen për krijimin e një gjendjeje të re në Evropë, që të ndihmojë, sidomos, në forcimin e pushtetit të fuqive kapitaliste evropiane dhe në dëm të revolucionit. Ata mendojnë se tani janë të gjitha mundësítë që ky pushtet mund të maskohet me parulla «socialiste», «liberale», «demokrate» etj. me qëllim që të jetë më i aftë për të luftuar forcat revolucionare.

Pritja e madhe që iu bë Dë Golit në Moskë, vizita e Podgornit në Itali dhe te papa, bisedimet e Kosiginit në Londër etj. kanë synuar drejt këtij qëllimi kryesor. Me sa duket, kolegët perëndimore të

revisionistëve sovjetikë, gjatë këtyre pazarllëqeve, u kanë dhënë tradhtarëve të Moskës disa «shpresa», natyrisht të lëkundshme, inkurajuese për politikën e tyre evropiane. Por këto «shpresa», në të njëjtën kohë, u kanë kushtuar udhëheqësve sovjetikë dhe partnerëve të tyre revisionistë të Evropës koncesione të mëdha politike, ideologjike dhe ekonomike, që kanë dobësuar potencialin e tyre ekonomik dhe kanë futur brenda në vendet e tyre «kalin e Trojës» kapitalist të degjenerimit. Veprimit të tyre zyrtar qeveritar në Evropë, që mbështetet mbi këto «shpresa» utopike, revisionistët sovjetikë duan tani t'i jepin edhe ngjyrën ideologjike. Pikërisht këtu qëndron thelbi i mbledhjes së Karlovi-Varit mbi të ashtuquajturin sigurim evropian si titull të fasadës.

E gjithë kjo kështjellë me themeli prej balte, që revisionistët hrushovianë duan të ndërtojnë në Evropë, është nën mbikëqyrjen e kujdeshme të imperializmit amerikan dhe të partnerit të tij në Bon. Këta nuk do të lejojnë kurrë që kjo ndërmarrje t'i kalojë caqet që do të prekin interesat e tyre të mëdha në këtë kontinent.

Aleatët e revisionistëve sovjetikë, imperialistët amerikanë, nuk e kanë humbur as kredinë, as ndikimin e tyre mbi shtetet kapitaliste të Evropës. Këta e kanë konsideruar dhe e konsiderojnë gjithnjë Amerikën si shpëtimtaren e përhershme të tyre nga revolucioni. Pa imperializmin amerikan, ata do t'i kishin ditët e numëruara. Sigurisht, mosmarrëveshje midis tyre dhe amerikanëve ekzistojnë, bile edhe mund të

acarohen, por, në fazën e tanishme, ato kanë kryesish karakter koniunktural, karakter shantazhi, që shtetet perëndimore i përdorin për të përfituar ekonomikisht më shumë, për të konsoliduar tregjet kombëtare dhe për t'i zgjeruar ato në kurrit të popujve e të shteteve më të dobëta dhe, më në fund, për të shkundur disi tutelën e politikës së diktatit amerikan.

Në këtë drejtim shtetet kapitaliste të Evropës përdorin ndaj aleatëve të tyre amerikanë edhe shantazhin revizionist sovjetik, natyrisht brenda disa çave, brenda këuadrit të aleancave të tyre, të cilat ata i mbrojnë me vendosmëri. Sepse, as imperialistët amerikanë, as partnerët e tyre kapitalistë të Evropës nuk kanë hequr kurrë dorë dhe nuk harrojnë kurrë qëllimin kryesor të përbashkët, shkatërrimin e likuidimin e sistemit socialist. Në këtë garë imperialistët amerikanë dhe partnerët e tyre kapitalistë të Evropës synojnë kurdoherë në dobësimin sa më shumë të Bashkimit Sovjetik, edhe tani që ky po transformohet në një vend kapitalist, por edhe shpartallimin e aleatëve të Bashkimit Sovjetik për të realizuar izolimin e tij.

Këtu synon edhe qëllimi i «ndërtimit të urave» të Xhonsonit, i vërshimit të kapitalistëve të ndryshëm amerikanë dhe të borgjezisë kapitaliste evropiane në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste. Në këtë garë, natyrisht, partneri më i pasur dhe më i fuqishëm ka kurdoherë pjesën e luanit.

Ujdia e re, që përgatitin revizionistët modernë dhe kapitalistët evropianë ndesh në mjaft pengesa serioze. Ajo ndesh në vullnetin e fuqishëm të imperializmit amerikan, në politikën agresive të kapitalit

gjermanoperëndimor, si dhe në çështjen e Republikës Demokratike Gjermane.

Revisionistët sovjetikë, ata polakë dhe çekoslovakë nuk janë në gjendje hëpërhcë ta sakrifikojnë Republikën Demokratike Gjermane, pasi do të humbisnin shumë politikisht dhe do të demaskoheshin plotësisht. Për ta Republika Demokratike Gjermane është një hapësirë strategjike territoriale para kufijve të tyre. Nga ana tjetër, ata e përdorin akoma Republikën Demokratike Gjermane si një mjet shantazhi e pazallëqesh të mëtejshme me imperializmin amerikan dhe me fuqitë kapitaliste të Evropës dhe nuk kanë për qëllim mbrojtjen e vërtetë revolucionare të Republikës Demokratike Gjermane. Sakrifiki nga ana e tyre i Republikës Demokratike Gjermane, në koniunkturat e sotme të marrëdhënieve ndërkombëtare, do të thoshë forcimi edhe më shumë i kapitalizmit agresiv gjerman, shpejtimi i procesit të shpartallimit të aleatëve të Bashkimit Sovjetik në Evropë dhe kërcënimi drejtpërdrejt i kapitalizmit të ri sovjetik dhe i kufijve kombëtarë polakë.

Nga ana tjetër, për imperializmin amerikan, Republika Federale Gjermane, në gjendjen e tanishme, është një pikëmbështetje e rëndësishme për ruajtjen e statukuosë aktuale në Evropë, për ruajtjen e ndikimit amerikan në këtë kontinent. Ajo, në mënyrë të vegantë, luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e «urave» amerikane me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera revisioniste, rolin e frikës të revanshisteve gjermanë.

Pozita dhe politika e Republikës Federale Gjer-

mane aktualisht i interesojnë shumë imperializmit amerikan, i cili i përdor për të përballuar kontradiktat me shtetet e tjera kapitaliste të Evropës, për të mbajtur nën frikë e presion Bashkimin Sovjetik dhe për të zhvilluar me sukses degjenerimin politik, ideo-logjik dhe ekonomik të këtij.

Por vetë Republika Federale Gjermane është një vend kapitalist agresiv i fuqishëm, është një imperializëm agresiv revanshist, me një politikë të vetën të përcaktuar mirë. Në këtë politikë, pa u tërhequr nga qëllimet e saj bazë dhe kryesore, ne shohim se tani Gjermania Federale po nxiton dhe po futet të marrë pjesë në garën e depërtimit ekonomik dhe politik në vendet ku sundojnë revisionistët, të cilët janë shumi sensibël ndaj kredive gjermane të Bonit. Kjo e ka shqetësuar Bashkimin Sovjetik (që sheh se aleatët e tij revisionistë po i dalin nga kontrolli) dhe Poloni, që kà hallin e kufirit Oder-Najse; por ky proces do të vazhdojë, duan apo nuk duan revisionistët sovjetikë e polakë.

Imperialistët amerikanë duan gjithashtu ta pengojnë oreksin e Bonit në këto drejtime, por nuk kanë ç'të bëjnë. Interesi kryesor i tyre e do që të kënaqin edhe dhinë, edhe lakin.

Vija e depërtimit politik dhe ekonomik, që po ndjek Boni ndaj vendeve revisioniste të Evropës, vendosja e marrëdhënieve diplomatike të Rumanisë me Gjermaninë Federale dhe interesimi që treguan Hungaria e Bullgaria për t'u afruar me Bonin, shkaktuan reaksion te Republika Demokratike Gjermane, te polakët e deri diku te çekët.

Edhe revizionistët francezë, të cilët janë të hidhëruar që Dë Goli nuk njeh Republikën Demokratike Gjermane, janë të shqetësuar nga politika revanshiste e Bonit. Përpara një gjendjeje të tillë, udhëheqësit revizionistë sovjetikë u detyruan të anojnë nga polakët, nga Republika Demokratike Gjermane e nga revizionistët francezë dhe të ndërhyjnë në mes të rrugës për të bllokuar përkohësisht lidhjet diplomatike me Bonin që kërkonin të vendosnin bullgarët, hungarezët dhe çekët. Ndryshe do të dështonte konferanca e Karlovi-Varit, gjë që do të thotë të dështonte krejtësisht qëllimi i sovjetikëve, për të cilin bëjnë këtë mbledhje, të dështonte gjithashtu edhe qëllimi i partisë revizioniste franceze dhe i polakëve, që janë dirigjentët aktualë kryesorë të mbledhjes së Karlovi-Varit.

Nga ana tjetër, përsëritja e traktateve bilaterale midis vendeve revizioniste të Evropës bën pjesë në këtë plan politik për nënvleftësimin e Traktatit të Varshavës, dobësimin e zhdukjen e tij dhe krijimin e mundësive të aleancave të reja me shtetet kapitaliste të Evropës, për t'iu përshtatur ndryshimeve dhe koniunkturave të reja.

Kështu, Gjermania e Bonit është bërë për mbledhjen e Karlovi-Varit «kafsha e zezë», pasi pengon planet që revizionistët sovjetikë po kurdisin me kapitalistët e Evropës. Po për këta të fundit, edhe pse tregohen «mirëdashës» ndaj miqve të rinj lindorë, prapëseprapë, Gjermania e Bonit mbetet një aleat i sigurt, sido që është një partner i vështirë.

Tani, udhëheqësit sovjetikë dhe partnerët e tyre revizionistë përpilen ta bindin aleatin e tyre ameri-

kan, që ky të mos i japë armë bërthamore Republikës Federale Gjermane dhe t'i frenojë asaj oreksin revanshist ndaj Republikës Demokratike Gjermane dhe kufijve Oder-Najse. Por në këtë plan ata synojnë shumë më larg. Mospërhapja e armëve bërthamore për revizionistët sovjetikë do të thotë ruajtja e monopolit të armëve bërthamore nga Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara. Nën këtë «ombrellë» është ndërtuar edhe i gjithë projekti i «kështjellës me themeli prej balte» i «sigurimit evropian».

Pra, baza e «paqes» revizioniste në Evropë mbështetet mbi monopolin e armëve bërthamore, Bashkimi Sovjetik — SHBA, ashtu si dhe «sigurimi evropian» bazohet mbi alcancën amerikano-sovjetike. Nën këtë aleancë të dyfishtë zhvillohen «buzëqeshjet», bëhen lëshimet dhe kompromiset, zhvillohen debatet dhe takimet, me shpresë se do t'i arrihet qëllimit.

Gjithë propaganda e revizionistëve sovjetikë është përqendruar tani në këtë pikë dhe një nga objektivat kryesorë, që i ka caktuar vetes mbledhja e Karlovi-Varit është «mobilizimi politik dhe ideologjik i popujve të Evropës» për të braktisur luftën revolucionare kundër kapitalizmit evropian dhe botëror, për të braktisur luftën kundër imperializmit amerikan, për të konsoliduar politikisht dhe ekonomikisht borgjezinë e vjetër dhe të re evropiane, për t'i hequr kësaj frikën nga revolucioni, për të konsoliduar pajtimin klasor, bashkekzistencën paqësore, politikën ekonomike dhe ideologjinë borgjeze, të shkallmuara dhe të rrezikuara nga marksizëm-leninizmi dhe nga revolucioni botëror.

Por mbledhja e Karlovi-Varit është një mbledhje e paradështuar, është një mbledhje tradhtarësh të marksizëm-leninizmit, të revolucionit dhe të popujve. Të gjithë ata që do të mblidhen atje i ka zënë «kanceri». Ata fatalisht zgjodhën për mbledhje një vend ku kurohen të sëmurët, por sëmundja e tyre është pa shërim. Ata shpejt ose vonë do të groposen nga revolucioni.

Pse e bëjnë revisionistët modernë këtë mbledhje pa sukses dhe pse me një rend dite të tillë të cunguar?

Revisionistët hrushovianë nuk kishin këtë plan që ka mbledhja e tanishme, por u katandis kokoshi një thelë. Plane të tjera shumë më të mëdha kishin udhëheqësit sovjetikë në torbën e tyre të shpuar. Në fillim ata mendonin për një mbledhje të gjerë të partive komuniste të botës. Atje ata shpresonin t'i dënonin partitë marksiste-leniniste dhe t'i përjashtonin ato (sikur varet prej tyre!) nga lëvizja komuniste ndërkombëtare.

Me këtë veprim revisionistët sovjetikë, në radhë të parë, pas kaq dështimesh të bujshme në luftën e tyre të ndyrë kundër marksizëm-leninizmit, dëshironin të merrnin aprovin nominal të renegatëve të tjerë për vijën tradhtare të tyre dhe ta pagëzonin zyrtarisht këtë si «vijën e lëvizjes komuniste ndërkombëtare».

Në mos në fakt, të paktën në formë, ata donin të tregonin se ekziston «uniteti» në lëvizjen komuniste botërore dhe se në krye të tij qëndrojnë, si kurdoherë, revisionistët e Moskës. Me një fjalë, ata donin të ri-

afirmohej «shkopi i tyre i dirigjentit» në forma të reja dhe në kushtet e reja centrifugale të frontit revizionist.

Këta objektiva që nuk i arriti dot Nikita Hrushovi, u përpoqën t'i arrinin nxënësit e tij. Por ata ndeshën në pengesa e vështirësi edhe më të mëdha se mësuesi i tyre. Dështimet që pësoi në çdo lëmë vija e tyre tradhtare, në ideologji, në politikë, në ekonomi etj. më tepër se kurrë kishin nevojë për një perde tymi që të gënjenin popujt e tyre dhe të frenonin kryengritjet në vendet e tyre. Dhe kjo perde tymi, mendonin revizionistët sovjetikë, do të ishte një mbledhje e gjërë e partive komuniste të botës.

Së dyti, në këtë mbledhje revizionistët sovjetikë kishin vënë në plan të bënин shumë zhurmë «për të mbrojtur» Vietnamin. Qëllimi i tyre ishte të fshihnin tradhtinë e tyre ndaj popullit vietnamez, si dhe pazarllëqet e turpshme dhe komplotet e fshehta që ata bëjnë së bashku me imperializmin amerikan, për të gjunjëzuar Vietnamin heroik dhe për të shpëtuar agresorët e veten nga disfata e turpshme. Gjithashtu ata mendonin ta përdornin çështjen e Vietnamit si atû për të gënjer popujt e botës, dhe veçanërisht ata të Evropës, për të aderuar më lehtë në planet për «sigurimin evropian».

Dhe së fundi, revizionistët sovjetikë donin të shitin planin e «sigurimit evropian», për të cilin folëm më sipër, synimi konkret i të cilit është të luftohet revolucioni në Evropë dhe të çohet zjarri i luftës grabitqare imperialiste në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine.

Por këto qëllime të hapëta dhe të fshehta të re-

visionistëve sovjetikë ndeshën në kundërshtime të ndryshme nga ana e partnerëve të tyre, që ndjekin qëllime dhe politika të tyre të veganta.

Disa parti të ashtuquajtura komuniste, por që në realitet ndjekin një kurs oportunist, duke dashur t'i përbahen gjoja vijës së mesme, pasi i kuptojnë hiletë e revisionistëve sovjetikë dhe duke dashur të ruajnë «manovrimin» e lirë të tyre, bëjnë përpjekje të tërhiqen nga pjesëmarrja në këtë mbledhje. Ato kërkojnë ta luftojnë marksizmin, Partinë e Punës të Shqipërisë dhe partitë e grupet revolucionare marksiste-leniniste me mënyrat e tyre, me dy faqe, dhe të bëjnë tregti e të marrin ndihma e kredi nga imperialistët, pa zemëruar as Uashingtonin, as Moskën, as Bonin.

Për sa i përket Partisë së Punonjësve të Vietnamit, ajo nuk pranoi të merrte pjesë në këtë mbledhje tradhtarësh.

Partitë revisioniste të vendeve kapitaliste të Evropës, siç duket, nuk e gjejnë oportune rendin e ditës të plotë të formular nga revisionistët sovjetikë për mbledhjen në fjalë të Karlovi-Varit. Ato hezitojnë dhe kundërshtojnë për shkak të frikës që kanë nga polemika dhe nga lufta, e pashuar kurrë, e marksistë-leninistëve revolucionarë në botë, si dhe për shkakun tjetër se veprimet e tyre, aktualisht, janë më shumë të ndërvarura e të koordinuara me partitë borgjeze dhe socialdemokrate të vendeve të tyre sesame Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. «Pavarësia» e tyre është varësi nga borgjezia e vet nacionale dhe largimi i tyre nga Partia Komuniste e Bash-

kimit Sovjetik është kthyer në bashkimin me partitë borgjeze dhe socialdemokrate.

Në këto kushte është krejt e qartë pse iniciativa e mbledhjes kaloi në duart e revizionistëve polakë e francezë dhe pse rendi i saj i ditës katandisi vetëm në çështjen e «sigurimit evropian».

Partia Komuniste Franceze, si iniciatore në mbledhjen e Karlovi-Varit, shpreh vullnetin e koalicionit revizionisto-socialdemokrat të krijuar kohët e fundit në Francë e që mori formë të organizuar gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e presidentit të republikës dhe të deputetëve të asamblesë kombëtare.

Mbledhja e Karlovi-Varit është një dëshmi e realizimit të policentrizmit toliatist, e rigrupimeve të partive të ndryshme revizioniste dhe e mbledhjeve të tyre të veçuara me interesa e plane të veçanta, që nuk kanë asgjë të përbashkët me mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të socializmit, të revolucionit dhe të unititetit të vërtetë internacionalist të komunistëve.

Marksistë-leninistët revolucionarë në të gjithë botën, popujt dhe shtetet e vogla përparimtare duhet ta kuptojnë këtë situatë, të ngrihen në këmbë dhe të luftojnë. «Sigurimi evropian» nuk është një problem i izoluar për Evropën, por është një kërcënim serioz për të ardhmen e njerëzimit. Në Evropë, manjatët e mëdhenj kapitalistë të botës, amerikanë, sovjetikë, anglezë, francezë, revanshistët gjermanë e të tjerë po përpilen të bien në ujdi me njëri-tjetrin për një rindarje të re të botës, për të caktuar sferat e tyre të influencës në kurrit të popujve dhe të shteteve të tjera. Kolonizatorët e rinj, me maska të reja, me

demagogji dhe me potenciale të fuqishme ekonome dhe ushtarake, kërkojnë të shtypin popujt, t'i s' tëzojnë ata, të shuajnë revolucionin e tyre.

Është e qartë, pra, për të gjithë se ç'janë revisionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, që puthen me imperialistët dhe kapitalistët në të katër anët e botës, që luftojnë me tërbim marksizëm-leninizmin, partitë e vërteta marksiste-leniniste, grupet revolucionare dhe popujt që janë ngritur në luftë për t'u çliruar.

E gjithë kjo vërteton edhe një herë tjetër degjenerimin e partive revisioniste, që do të marrin pjesë në mbledhjen e Karlovi-Varit. Kjo është një etapë tjetër drejt rrugës së varrit, ku po ecin me nxitim revisionistët hrushovianë dhe shokët e tyre.

*Botuar për herë të parë në gazeten «Zëri i popullit», nr. 88 (5813), 13 prill 1967*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revisionizmit modern 1965-1967», f. 472*

# PA U KUPTUAR ROLI I GRUAS, TRANSFORMIMET REVOLUCIONARE NUK DO TË KRYHEN ME ATË VRULL QË DËSHIRON PARTIA

*Bisedë me një grup grash e të rejash që morën pjesë në takimin kombëtar të luftëtareve të së resë*

19 prill 1967

Jam shumë i gjëzuar që më jepet rasti të takohen me ju, gra e të reja përparimtare, luftëtare të së resë.

Historia juaj është historia e grave të të gjithë Shqipërisë, me të cilat Partia dhe populli ynë kanë përsë të krenohen. Që në krijimin e saj Partia i ka kushtuar një rëndësi të madhe problemit të gruas. Pas ca kohësh Komiteti Qendror do të bëjë një plenum të veçantë për problemin e gruas, sepse përvardin tonë ky është një nga problemet më të rëndësishme.

Me gjithë rezultatet që janë arritur në përparimin e gruas shqiptare, ka raste që nuk kuptohet si duhet roli dhe rëndësia e saj në shoqërinë tonë socialiste.

Para tri javësh pata rastin të merrja pjesë në punimet e aktivit të Partisë të rrëthit të Krujës, ku

mësova se në gjithë këtë rrëth ka vetëm 10-12 gra në Parti, ndërsa në tërë zonën malore të këtij rrëthi është vetëm një shoqe anëtare partie. A mund të konsiderohet i mirë ky qëndrim i shokëve komunistë të organizatës së Partisë të këtij rrëthi? Jo, aspak. Përkundrazi, ky qëndrim tregon se ata nuk e kuptojnë si duhet rëndësinë dhe rolin e gruas në shoqërinë tonë socialiste dhe tregohen, kështu, konservatorë. Prandaj Partia u ka hequr vazhdimisht vëmendjen anëtarëve të saj për këtë problem dhe tani shohim që dikë po lëviz, gjendja është disi më e mirë; megjithatë jemi akoma prapa asaj që duhet bërë.

Një qëndrim i tillë te shokët komunistë ndodh padashur. Në fakt ata janë revolucionarë, njerëz të pararojës. Gjersa kanë hyrë në Parti, do të thotë se e kanë merituar këtë nder, por është e qartë se e kaluara u rëndon akoma në ndërgjegje dhe i nënyleftësojnë të renë dhe gruan. Ata, në mënyrë të gabuar, mendojnë se Partia bëhet më e fortë vetëm kur në radhët e saj futen burra, sikur vetëm këta janë në gjendje të drejtojnë. Tani Partia jonë ka përgatitur me qindra njerëz, jo vetëm burra, por edhe gra e vajza, që janë në gjendje të drejtojnë fabrika, uzina, kooperativa bujqësore, organizata partie etj. Megjithatë ka njerëz që mendojnë se gruaja është më e dobët, gjë që nuk është e vërtetë. Ku duken forca e burrit dhe e gruas? Natyrisht në punë. Po ta studiojmë si duhet çështjen, do të shohim se gruaja nuk punon më pak nga burri. Përkundrazi, shumë herë bile ia kalon atij. Por fizikisht, siç ka burra të dobët, ka edhe gra të dobëta. Prandaj pikëpamja e disa nje-

rëzve, se gruaja qenka më pak e aftë nga burri dhe ky u dashka preferuar më tepër në punë, nuk është aspak e drejtë e nuk i përgjigjet realitetit.

Po kështu këto pikëpamje ekzistonin edhe për aftësitë mendore. Përpara te ne qarkullonte shprehja reaksionare «Gruaja është flokëgjatë e mendjeshkurtër». Kjo është gënjeshtër. Ju keni dëgjuar dhe keni parë vetë me sytë tuaj se në fabrika, në uzina, në ara, në shkolla, në spitale e kudo në Shqipëri punojnë me qindra e mijëra gra e vajza dhe punojnë shumë mirë. Vetë ju, që keni ardhur në këtë takim, jeni nga gratë e vajzat më të dalluara në bujqësi, në industri, në arsim e në sektorë të ndryshëm dhe punoni shumë më mirë nga sa e sa burra.

Atëherë, nga na dilka se burri qenka më i zgjuar nga gruaja, kur një pikëpamje të tillë e hedhin poshtë praktika e jetës dhe shkenca? Por, kur do ta poshtërosh një njeri, atëherë thua një mijë e një fjalë të liga kundër tij dhe kështu tjetrit, duke i dëgjuar ato vazhdimisht, në mos një herë, një herë tjeter, do t'i ngulen në mendje dhe do t'i besojë. Një ambient i tillë nën-vleftësimi e poshtërimi e rrëthonte gruan në të kalluarën, për ta bërë atë të bindur nën sundimin e burrit. Për këtë qëllim atëherë thuhej se gruaja fizikisht është e dobët, kurse burri është i fortë, gruaja s'mëson dot, kurse burri është i zgjuar, gruaja ka frikë, ndërsa burri është trim, prandaj u dashkej që burri të qëndronte në ballë për çdo gjë dhe gruaja vetëm t'i nënshtrohej atij. Por të gjitha këto pikëpamje për gruan tashmë janë rrëzuar në vendin tonë, ato i hedhin poshtë teoria dhe praktika e Partisë sonë.

Vihet pyetja: Kush është më përparimtar, burri apo gruaja? Po të bëjmë krahasimin, duke u nisur nga realiteti ynë, del se gruaja nuk është më pak përparimtare se burri. Përse luftojnë Partia dhe populli? Sigurisht për përparimin e atdhëut dhe në përpjekjet që bëhen për këtë qëllim në vendin tonë, gruaja është një nga elementët më përparimtarë, megjithëse në disa drejtime ajo ka mbetur më prapa se burri.

Po ku bazohet Partia kur thotë që gruaja është, në fakt, përparimtare? Mos vallë për t'i bërë asaj qejfin? Jo, aspak për këtë, po këtu ka disa arsyе:

Së pari, gruaja është faktori vendimtar i krijimit të jetës, i lindjes së jetës së re.

Së dyti, më përparimtar është ai që punon, ai që e do punën, pse vetëm puna e mban gjallë shoqërinë dhe e zhvillon njeriun. Po ta shohim historikisht pjesëmarrjen e gruas shqiptare në punë, themi me bindje se, me përjashtim të bezlereshave, të grave të bajraktarëve dhe të borgjezisë, masa e grave të popullit tërjetën ka punuar dhe është robtuar. Gruaja ka punuar në arë dhe në shtëpi; duke kryer këtu edhe shërbimet më fyeze dhe, sikur të mos ishin të mjaftueshme këto, ajo ishte e detyruar të duronte në shpinën e saj edhe të sharat, bile, në shumë raste, edhe të rrahurat e burrit e, më së fundi, ndarjen pa asnjë arsyé. Gruaja, pra, është përparimtare edhe nga pikëpamja e punës që ka bërë kurdoherë e vazhdon të bëjë edhe sot.

Është fakt, gjithashtu, se në të kaluarën gratë-kanë qenë më të vuajturat, më të shfrytëzuarat, më të mjeruarat e më të shtypurat dhe kush është më i shtypur e më i vuajtur, është më revolucionar, më-

përparimtar. Pse themi ne që klasa punëtore është klasa më pérparimtare e shoqërisë? Marksia dhe Engelsia këtë e shpjegojnë me shprehjen e tyre të famshme se në revolucion, për të dërrmuar pasanikët, ajo nuk ka q'të humbasë veç prangave. Klasa punëtore ka punuar dhe punon vazhdimesht. Çdo gjë, duke filluar nga shtëpitë dhe gjer tek aeroplanët e raketat që shkojnë në kozmos, janë frysht i mendjes dhe i punës së punëtorëve. Por në vendet kapitaliste klasa punëtore është e shtypur dhe e shfrytëzuar, sepse fryshtet e punës së saj i gëzon borgjezia. Sigurisht, për ndërtimin e gjithë këtyre gjëra marrin pjesë e ndihmojnë edhe inxhinierët e shkencëtarët, por dituria e tyre nuk është veçse frysht i punës dhe i diturisë së punëtorëve, pa të cilët asgjë nuk mund të bëhet. Prandaj ne themi që klasa punëtore është më e zgjuara, më e zonja, por edhe më pérparimtarja, më revolucionarja dhe më besnikja për çështjen e popullit, për revolucionin. Po kështu, edhe gruaja ka vuajtur e është robtuar tërë jetën, prandaj është edhe revolucionare, e zgjuar e pérparimtare. Vërtet që në disa drejtime ajo është më e prapambetur nga burri, por jo për faj të saj. Ashtu ishin ato kohë të vështira, që populli i përmbysti me revolucion, i udhëhequr nga Partia. Në shoqërinë e re që ndërtojmë, ku burri dhe gruaja janë të barabartë, po zhduken gradualisht të gjithë faktorët që rëndonin më parë mbi gratë.

Po në çmënyrë po zhduken? Në radhë të parë, nga pikëpamja ekonomike, pse ky është çelësi kryesor. Gruaja, ashtu si i gjithë populli ynë, duhej qëlluar në radhë të parë ekonomikisht, pa lënë pas dore

njëkohësisht punën për ta ngritur atë edhe politikisht e ideologjikisht. Dihet se zhvillimi i ekonomisë ecën kurdoherë më shpejt, kurse ngritja ideologjike dhe politike e njerëzve bëhet më ngadalë. Për këtë arsy, shumë mbeturina të së kaluarës ruhen për një kohë të gjatë, nuk kuptohet si duhet dëmi i tyre. Megjithatë, çdo vit që kalon, si rrjedhim i ngritjes së vazhdueshme arsimore, politike dhe ideologjike të njerëzve tanë, këto çështje kuptohen gjithnjë e më mirë. Edhe juve, grave, në punë, në ara, në fabrika e kudo nuk jua kalon dot njeri, por Partia kërkon që t'i vini një kujdes të jashtëzakonshëm edhe mësimit, se në këtë drejtim jeni ca më prapa. Prandaj bëni përpjekje për ngritjen e nivelit tuaj. Po e fituam edhe këtë betejë, do të shikoni çfarë shpërthimi do të ketë akoma më shumë në jetën e gruas dhe të të gjithë vendit tonë. Kur të tërë, burra e gra, të jemi të mësuar, të fortë politikisht dhe ideologjikisht, me një horizont të gjerë kulturor dhe të aftë teknikisht, atëherë një punë, të cilën përpara mund ta bënim brenda një viti, do ta bëjmë shumë më shpejt.

Partia të gjithë i këshillon që, njëkohësisht, të punojnë dhe të mësojnë. Kështu, në vendin tonë po përmirësohet vazhdimi i jeta e popullit, po ngrihet niveli i tij arsimor, politik dhe ideologjik.

Ne themi se gruaja është një rregulator i madh i jetës, prandaj, në qoftë se do të kujdesemi që ta ngremë atë politikisht e ideologjikisht, dhe Partia do të bëjë të gjitha përpjekjet që ajo të ngrihet në nivelin e dëshiruar, atëherë, me punën e saj të palodhur e të zgjuar, ajo do të luajë një rol të rëndësishëm që za-

konet e këqija të zhduken brenda një kohe të shkurtër. Gruaja ka ndjenja më të dëlira, ndërgjegjen e ka të pastër, është më e vuajtur në jetë; tek ajo nuk ekziston prirja për sundim, ashtu si te burri. Kështu, duke pasur këto anë të mira në përgjithësi, gruaja është më e ndjeshme për drejtësinë e vijës së Partisë dhe më revolucionare në mbrojtjen e kësaj vije.

Prandaj atyre që u mbyllin portat e Partisë grave e vajzave të pararojës, të tilla si ju, u tregoni vendin. I sulmoni këto porta dhe atyre që ju pengojnë u thoni se dëshironi të hyni në Parti, u tregoni biografinë tuaj të pastër, punën tuaj të palodhur, si dhe sakrificat që bëni dhe jeni gati të bëni në luftën për socializëm dhe për mbrojtjen e forcimin e atdheut. Përse të mos hyjnë në Parti ato gra e të reja që i kanë këto cilësi? Partia është e burrave dhe e grave më të mira të vendit tonë; gra të tilla si ju duhet të futen në Parti, sepse kështu kjo bëhet më e fortë e më e pastër. Dhe nën qoftë se ndonjëra nuk i plotëson akoma kushtet dhe organizata-bazë e këshillon të punojë edhe më mirë, duhet ta sqarojë, ta bindë që ajo të mobilizohet në rrugën e Partisë, të bëjë akoma më shumë përpjekje për të ecur përpara që të bëhet e denjë për t'u futur në radhët e saj.

Duhet shembur njëherë e përgjithmonë pikëpamja sipas së cilës vetëm burrat të punojnë, kurse gratë të jetojnë nën ombrellën e tyre. Për vijën e Partisë duhet të luftojnë të gjithë, pa përjashtuar gratë. Për këtë qëllim, vetë ju, shoqet, duhet të luftoni, sepse kështu ndihmoni Partinë dhe veten tuaj dhe kur të luftoni vetë, atëherë është më lehtë t'ju ndihmojnë të tjerët.

Të gjitha këto që po bën Partia për ju kanë qëllim që t'i japid kurajë dhe energji gruas, ta bëjnë të zonjën e të ditur që, së bashku me burrat, të çajnë të gjithë përpara.

Për këtë ka rëndësi të veçantë vajtja e të reja ve në aksione të tillë të mëdha, si në ndërtimin e hekurudhës. Sigurisht, shumë nga prindërit tuaj u shqetësuan kur ju dhatë fjalën për të vajtur atje, bile, gjersa i bindët, mund të ketë pasur prindër që ju kanë penguar. Ata kanë pasur frikë mos ju ndodhë ndonjë gjë, duke kujluar se po t'ju kenë afër, ju mbrojnë më mirë. Ata nuk kanë kuptuar akoma që ju jeni rritur e edukuar, se ju jeni gra dhe vajza të tillë që jeni vetë në gjendje ta mbron shumë mirë veten nga kushdo. Veç këtyre, në hekurudhë me ju është e gjithë shoqëria, e, në radhë të parë, atje ju keni, si kudo, Partinë që ju mbron. Prindërit tuaj nuk para i kuptojnë këto ndryshime që kanë ndodhur në vendin tonë, sepse në kohën kur ishin në këtë moshë si ju tani, s'kishte kush t'i mbronte, prandaj mos ua vini re. Pastaj ata i keni prindër, kështu që edhe sikur ndonjëri të ketë bërë gabim ndaj jush, jemi të sigurt që do ta kuptojë dhe do të korrigohen.

Por edhe ne kemi faj ndaj tyre se nuk kemi punuar si duhet për t'i edukuar me normat e reja. Ne duhet të bëjmë një punë të madhe bindëse e sqaruese me ta. Komunistët kështu kanë vepruar e kështu duhet të veprojnë kurdoherë me njerëzit. Shumë nga ata, që në të kaluarën kanë mbajtur qëndrime jo të mira ndaj popullit, Partia i ka korrigjuar, i ka edukuar. Kështu, edhe brenda në familje, kur ndonjë

pjesëtar mban qëndrime jo të mira, siç është, për shembull, rasti kur babai pengon vajzën të vejë në aksion, ne nuk e hedhim dot poshtë, se e kemi baba, por edhe duarlidhur nuk rrимë, as nuk heshtim, përpinqemi e duhet të përpinqemi ta bindim atë.

Më kanë thënë se disa nga prindërit, të cilët ishin të shqetësuar për vajzat që kanë dërguar në hekurudhë, shokët e Partisë në rrith i mblohdhën dhe i çuan atje për të parë vetë me sytë e tyre si punojnë të rinjtë e të rejat aksioniste, si jetojnë dhe si edukohen. Këta prindër, kur panë gjithë ato gjëra të mira dhe kujdesin që tregohej për vajzat e tyre, u larguan shumë të gëzuar.

Ju jeni të gjitha të reja dhe nuk e keni njohur plotësisht të kaluarën e vendit tonë. Por pa na pyesni ne më të shkuarit nga mosha, ose pyesni më mirë mëmat tuaja dhe do të mësoni se përpara Çlirimt nuk bëheshin kurrë dhe as që ishte e mundur të bëheshin mbledhje të tillë si kjo që bëtë ju sot në Tiranë. Prindërit tanë nuk mund të merrnin shkollë e dituri për vete e përbijtë e tyre, ndonëse zemra u qante për to, sepse populli ynë ka qenë gjithnjë arsimdashës. Kurse sot gjendja ka ndryshuar si nata me ditën. Këtë ndryshim e bëri Partia, prandaj, nën udhëheqjen e saj, vendi ynë po ecën dhe kurdoherë do të ecë gjithnjë e më përpara.

Revolucioni ynë popullor është duke u thelluar. Ne nuk e kemi zakon të mburremi, po mund të themi pa frikë se këto ndryshime revolucionare që po bëhen në Shqipëri, janë shembull edhe për vende të zhvilluara të botës.

Partia jonë, si parti marksiste-leniniste, është në ballë të revolucionit. Ajo na mëson ta çojmë gjithnjë përpjekje revolucionin proletar, i cili bëhet me luftë kundër imperializmit, kundër rezolucionizmit modern, kundër ideologjisë borgjeze, kundër mbeturinave të së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve, si dhe me përpjekje e punë të palodhur për zhvillimin e pandërprerë të ekonomisë sonë socialiste. Të ndërtosh socializmin do të thotë t'i bësh arat të prodhojnë çdo vit e më shumë drithëra buke, pambuk, duhan, panxhar, perime, fruta etj., të shtosh blegtorinë që të rritësh prodhimin e mishit, të qumështit, të vezëve etj., të hapësh miniera të reja, për të nxjerrë sa më shumë pasuri që fsheh nën-toka jonë, të ndërtosh fabrika e uzina të reja, për rritjen e pandërprerë të prodhimit industrial, të hapësh kudo shkolla, për të marrë dituri e për të mësuar zanate. Por socializmi nuk ndërtohet pa ndriçuar mendjen e njerëzve me ideologjinë e Partisë, duke luftuar njëkohësisht kundër gjithë pikëpamjeve e mbeturinave të vjetra, që kanë zënë vend në ndërgjegjen e njerëzve. Prandaj, krahas gjithë këtyre, ne duhet të punojmë, ashtu siç bëjnë kooperativistët për të pastruar tokën nga gjembat dhe ferrat e këqija, të pastrojmë ndërgjegjen e njerëzve tanë nga mbeturinat e së kaluarës, për zhdukjen e zakoneve të vjetra dhe për të rrënjosur në jetën tonë të përditshme zakonet e reja përparimtare që i kërkon koha.

Mendoj se jo të gjithë e kuptojnë mirë që në këtë fazë të revolucionit gruaja të ne do të luajë një rol shumë të rëndësishëm për realizimin e këtyre transformimeve të mëdha. Partia këtë duhet t'ua sqarojë

mirë, t'uа bëjë të kuptueshme gjithë popullit, veçanërisht vetë juve, grave e, në radhë të parë, komunistëve. Pa u kuptuar roli i gruas, transformimet revolucionare nuk do të kryhen me atë vrull që dëshiron Partia.

Çdo vend e çdo shtet drejtohet nga disa rregulla e ligje, të cilat mbrojnë interesat e asaj klase që është në fuqi. Në vendin tonë, në të kaluarën ligjet e shkruara reaksionare kanë ndihmuar feudalët e fajdexhinjtë për të shtypur e shfrytëzuar të varfërit, bujqit, zanatçinjtë e punëtorët. Ato ishin ligje mbi bazën e të cilave ishte organizuar shteti monarkik feudal. Por luftha e Partisë i përmbysi ato ligje dhe i zëvendësoi me ligje të reja, siç janë Kushtetuta e Republikës sonë, Kodi Civil, Kodi Penal etj. Hartimin e këtyre ligjeve të reja, përparimitare, populli ynë e ka bërë vetë dhe vetë i ka aprovuar. Kur Partia hodhi parullën «Toka i përket atij që e punon», populli e brohoriti atë. Kur Partia filloi të hapë pas Çlirimt më shumë shkolla dhe porositi që ato që ndiqen nga vajzat dhe djemtë, populli e brohoriti edhe këtë masë. Më vonë Partia krijoi kushte që te ne të ndërtosheshin fabrika e uzina, rrugë e hekurudha e kështu me radhë. Të gjitha këto u bënë në bazë të ligjeve të shkruara, që shprehnin dëshirat dhe aspiratat e popullit. Me mijëra ligje të kësaj natyre u përgatitën në fryshtë e dëshirave e të kërkesave të popullit, në fryshtë e socializmit.

Po ka edhe shumë ligje të pashkruara dhe nga këto do të ketë edhe nesër. Të tillë janë zakonet.

Jeta, ndër të tjera, është edhe një kompleks zakonesh të vendosura në shekuj, një palë nga të cilat, më të vjetrat, me zhvillimin e shoqërisë zhduken për t'uа

lënë vendin zakoneve të tjera, të reja. Nuk mund të ketë shoqëri pa zakonet e veta. Këto janë disa norma që kanë të bëjnë me marrëdhëni midis njerëzve, u tregojnë atyre si të ndërtojnë jetën në familje e në shoqëri, si të punojnë, si të vishen, si duhet pritur një mik, ç'duhet bërë në lindje e në vdekje, si përgatitet një dasmë etj., etj. Të gjitha këto ngjarje të jetës shoqërohen me zbatimin në praktikë të këtij apo atij zakoni. Ka nga ato zakone që janë të mira, shkojnë në harmoni me kohën, ka të tjera që janë të këqija, që pengojnë shoqërinë dhe duhen ndryshuar e zëvendësuar me zakone të reja. Për ne vihet detyrë të ngrihem politikisht dhe ideologjikisht, që të jemi në gjendje të vlerësojmë përbajtjen e tyre, në mënyrë që zakonet e mira t'i ruajmë, kurse të këqijat, që pengojnë ecjen tonë përpara, t'i zhdukim.

Të tillë janë, për shembull, zakonet fetare. Feja është një fenomen shoqëror. Ajo te ne është dënuar të zhduket, pse predikon diçka që nuk ekziston, që nuk e pranon arsyja njerëzore dhe çdo gjë që është jashtë arsyses, nuk është e vërtetë. Feja, pra, nuk ka asnje bazë shkencore, nuk bazohet në qenien materiale, por në gënjeshrën. Por në ndërgjegjen e shumë njerëzve, duke qenë e trashëguar me shekuj nga brezi në brez, kjo gënjeshtër merret si diçka e vërtetë. Atëherë si t'i shpjegohet kjo popullit? Në mënyrë filozofike? Te ne tani ka shumë që e kuptojnë edhe në këtë formë, por shumica shpjegimin filozofik nuk arrin ta kuptojë, sepse është më i vështirë, kërkon njëfarë përgatitje. Prandaj qoftë fenë, qoftë zakonet e këqija, që akoma ekzistojnë në gjirin e shoqërisë sonë, e kemi

për detyrë t'ua shpjegojmë masave me gjuhën e thjeshtë të popullit, pse kështu ato do të kuptojnë dëmin e tyre, do të binden e do t'i braktisin.

Pata rastin të takohesha një ditë me një nënë nga Mirdita. E pyeta ç'mendonte ajo për të gjitha këto aksione të rëndësishme që ka ndërmarrë Partia, siç është lufta kundër zakoneve të këqija e paragjykimeve fetare etj. «Mirë u bë», tha ajo, por e pashë që diçka donte të thoshte akoma, dukej që nuk ishte fort e qartë. Atëherë u ndala dhe bisedova me të. I shpjegova thjesht se, kur ajo ka nevojë të blejë një palë këpucë, natyrisht, drejtoshet në dyqan. I thashë pastaj, sikur shitësi t'i japë në vend të këpucëve bukë, në fillim ajo do të kujtojë se ai nuk e ka dëgjuar mirë kërkesën e saj dhe do t'ia përsëritë shitësit porosinë, duke i thënë se nuk kërkon bukë, por këpucë. Por në qoftë se shitësi, duke ngulur këmbë, vazhdon t'i thotë se buka janë këpucët që kërkon të blejë, ç'duhet menduar për të? Vetë kjo nënë më tha se një shitës i tillë që i thotë bukës këpucë është i marrë. Dhe jo vetëm kaq, ndërhyra unë, por njeriu me arsyen do të thotë edhe diçka tjetër: Pse e mban Qeveria në dyqan një njeri të marrë? Ai duhet të hiqet andej, sepse pengon shërbimin. Le ta lëmë tani shitësin dhe le të marrim kishën. Atje prifti, gjatë meshës, para besimtarëve e quan bukën «mishi i Krishtit», megjithëse të gjithë e shohin vetë që ajo është bukë dhe jo mish. Ai edhe për verën thotë se na qenka «gjaku i Krishtit», megjithëse të gjithë e dimë mirë se ajo s'është gjak, por lëng rrushi, i përpunuar në verë nga njeriu. Duke u nisur nga këto dy krahasime, i shpjegova nënës nga

Mirdita që pristi është pikërisht si shitësi pa mend në kokë që bukën ta jep për këpucë, vetëm se nuk është i marrë, e megjithatë çdo ditë predikon gjëra që nuk i pranon arsyjeja, domethënë gënjen. Atëherë edhe për priftin kushdo ka të drejtë të thotë që gjersa ky po na gënjen në mes të ditës, ç'na duhet ta mbajmë këtë njeri këtu? Jo vetëm kaq, po priftërinjtë bënin një mijë e një poshtërsi nën çatinë e kishës dhe nën pet-kun e fesë.

Lufta kundër paragjykimeve fetare, zakoneve prapanike dhe qëndrimeve jo të drejta ndaj gruas, duhet bërë e menduar mirë. Nuk mjafton t'u thuhet njerëzve se këto zakone nuk janë të mira, prandaj nuk duhet të duken më në jetën e shoqërisë sonë. Ne duhet të dimë t'u marrim krahët këtyre çështjeve, t'ua shpjegojmë me kujdes njerëzve psenë, që t'i bindim të heqin dorë. Ata nuk shkëputen dot lehtë prej tyre, sepse priftërinjtë e hoxhallarët kanë qindra e qindra vjet që u kanë thënë të mbajnë kreshmë e ramazan, të festojnë pashkë e bajram etj.

Po ç'është ramazani? Hoxhallarët thonë se ramazani u dashka mbajtur që edhe beu, agai e bajraktari të ndiejnë ç'do të thotë uri. Kështu, sipas fesë, të pasurit, duke e provuar edhe vetë ç'është uria, do të mendojnë për t'u dhënë të varférve ndonjë lëmoshë. Mirëpo bejlerët dhe agallarët nuk agjeronin, ata hanin e pinin dhe agjërimi mbetej kështu një zakon vetëm për njerëzit e popullit. Por këta se mos agjeronin vetëm në ramazan, ata agjeronin tërë vitin, pse çdo gjë që prodhonin ua rrëmbenin pasanikët dhe mbeteshin me gisht në gojë, se tërë jetën ishin të detyruar të

rronin në skamje, duke ngrënë nga pak bukë e tervok. Zakonet fetare klerikët i propagandonin që populli të ishte i nënshtuar, që njerëzit të duronin, pse, sipas tyre, kush vuan e duron në këtë jetë, do të fitojë në «botën tjetër të përjetshme», do të gjëzojë të mirat e «parajsës» e të tjera, e të tjera gjepura.

Feja, pra, është diçka jashtë arsyes, e shpikur nga vetë njeriu në disa kushte të caktuara të zhvillimit shoqëror. Ajo pengon ecjen përpara të shoqërisë sonë, për këtë arsyen duhet luftuar. Duhet punuar që feja të çrrënjoset edhe nga të gjitha zakonet e jetës sonë, me të cilat është e pleksur. Kur Partia na këshillon të ngrihem politikisht dhe ideologjikisht, qëllimi është që të bëhem i aftë t'i kuftojmë mirë të gjitha fenomenet e natyrës dhe të shoqërisë, të jemi në gjendje të dallojmë cili zakon është i mirë e cili jo dhe të mbajmë qëndrim, t'i luftojmë, t'i zhdukim të këqijat si gjëra që na dëmtojnë.

Megjithëkëtë, duke bërë krahasim me shumë popuj të tjerë, mund të themi se te populli shqiptar besimet fetare nuk janë kaq të rrënjosura, prandaj lufta kundër tyre po pritet mirë nga masat. Kur Mustafa Qemali, që udhëhoqi revolucionin demokratiko-borgjez në Turqi, u hodh në fushën e reformave, veprimtaria e tij u cilësua nga kundërshtarët si një veprimtari e drejtuar kundër fesë myslimanë. Në fakt, ai nuk luftoi aspak kundër fesë, ai luftoi vetëm kundër fuqisë së Sheh-ul-Islamit. Megjithatë, edhe për ato reforma jo të plota që bëri Mustafa Qemali, ndeshi në kundërshtime të mëdha, për këtë arsyen iu desh të priste sa e sa koka njerëzish, të pushkatonte sa e sa hoxhallarë

e kadilerë që t'i zbatonte reformat e tij dhe të qetësonte gjendjen. Kurse në Shqipëri jo vetëm populli, por edhe shumica e klerikëve aprovojnë masat që po merr Partia. Mundet që këta njerëz në brendësinë e tyre nuk i kanë kuptuar akoma sa duhet këto ndryshime revolucionare, por ata do të binden çdo ditë e më tepër se rruga që kemi nisur është e drejtë.

Zakonet që kanë rënduar dhe vazhdojnë të rëndojnë mbi gruan janë të egra, sidomos në malësitë tona të Veriut, ku sundonte fryma e Kanunit të Lekë Dukagjinit, që ishte një sistem mesjetar zakonesh që rregullonte marrëdhëniet midis njerëzve. Tani Partia na hapi sytë dhe ne jemi në gjendje të kuptojmë se sa çnjerëzore janë këto zakone, por, kur gjykojmë për to, duhet t'i lidhim me kushtet dhe fenomenet shoqërore të periudhave kur kanë lindur.

Kanuni, për shembull, lejon që kalamanët të fejohen që në djep, bile edhe në bark të nënës. Po ku e ka burimin një zakon i tillë? Sigurisht, në kushtet ekonomike e shoqërore të vendit tonë në periudhën kur lindi Kanuni. Në kushtet e copëtimit feudal në vendin tonë nuk kishte një shtet të centralizuar që të mbronte njerëzit. Këta ishin të organizuar në fise e fisi duhej të mbrohej vetë dhe një nga rrugët ose mënyrat për t'ia arritur kësaj ishte të lidhej me një fis tjetër më të fortë me anën e krushqisë. Stërgjyshërit tanë nuk ishin njerëz pa ndjenja, barbarë, që nuk ushqenin dashuri për fëmijët, por fejesën e bijve dhe të bijave të tyre e përdornin si një mënyrë për të përballuar situatat e vështira të jetës. Intercsat e

kalamanit, pra, ata ia nënshtronin një interesë më të gjerë, interesit të pronës dhe të politikës së fisit.

Ndryshe praktikohej zakoni i fejesave në Jug. Këtu ky ishte më pak i egër, pse Jugu i Shqipërisë ka qenë diçka më përpara se Veriu nga pikëpamja e zhvillimit ekonomiko-shoqëror. Ky zakon i mbetur që nga kohët e fisit, në sajë të kushteve më të përparuara, kishte ndryshuar në Jug, sepse edhe zakonet, me ndryshimin e kushteve ekonomiko-shoqërore, gjithash tu ndryshojnë. Në Shqipërinë e Jugut nuk ndodh si në Veri, që fëmijët t'i fejojnë akoma pa lindur, bile edhe në djep i fejojnë rrallë. Megjithatë, edhe atje, ndonëse nuk ekzistonte më interesë i theksuar i fisit, pse ky ishte shkatërruar prej kohësh, mbisundonte interesë i pronës e i familjes, kështu që forca e zakonit e periu-dhës së fisit vazhdonte t'i mbërrthente njerëzit, prandaj edhe në Jug, shpesh, i fejojnë fëmijët në moshë 5-7 e 10 vjeç edhe sot e kësaj dite.

Të tilla zakone, të lindura nga kushtet e atyre kohëve, në ndonjë krahinë kanë mbetur në fuqi gjer në ditët tona, megjithëse gjendja ekonomiko-shoqërore e vendit tonë ka ndryshuar, pse populli tani ka push-tetin e vet, ka deputetët, këshilltarët e gjyqtarët që i zgjedh vetë e që mbrojnë interesat e tij. Tani populli dhe e gjithëjeta e vendit udhëhiqen, në radhë të parë, nga Partia, për të cilën nuk ka gjë më të shtrenjtë se interesat e larta të popullit dhe të atdheut. Vajzat sot venë në shkollë njëlloj si edhe djemtë, jeta është e siguruar për çdo njeri. Prandaj vihet pyetja: është e arsyeshme të kenë vend sot në Shqipëri të tillazakone? Në asnje mënyrë jo! Përkundrazi, ato duhen

flakur tej, pse janë në kundërshtim me kohën, me vijen e Partisë. Po realiteti tregon se akoma ekzistojnë te ne shumë zakone të vjetra që janë në kundërshtim me kohën dhe që mbajnë të ndrydhur akoma ndërgjegjen e njerëzve tanë.

Mos i bëni fajtorë prindërit që i praktikojnë këto zakone. Duhet të keni parasysh që këto janë trashëguar brez pas brezi dhe janë rrënjosur thellë në mendjen e në ndërgjegjen e njerëzve tanë me moshë të kaluar, prandaj nuk shkëputen dot lehtë prej tyre. Atëherë çfarë të bëjmë? Të nisim dyfek me ta? Në asnjë mënyrë. Ata na kanë lindur, na kanë mëkëmbur, kur kemi qenë të sëmurë na kanë qëndruar mbi kokë. Atëherë t'ua shpjegojmë në mënyrë filozofike? Këtë ta bëjmë, por duke marrë parasysh nivelin e tyre arsimor e kulturor, horizontin e tyre, t'ua shpjegojmë me gjuhën e thjeshtë të popullit, që të na kuptojnë dhe të binden. Unë mendoj se gratë e të rejat mund të bëjnë një punë të madhe në këtë drejtim. Fakti që këto zakone prapanike i ndeshim sidomos në malësi, sikurse thashë, shpjegohet me prapambetjen që ka ekzistuar historikisht në këto zona. Edhe atje, si kudo te ne, gjendja ka ndryshuar pas vendosjes së pushtetit popullor. Por, këtej e tutje, zhvillimit të zonave malore Partia do t'u vërë një rëndësi të veçantë. Ndiham deri tani nuk ka munguar, sepse Partia e di që në malësi jetojnë njerëz trima, punëtorë e besnikë, por duhet të njohim, se, gjer tani, rrethanat kanë qenë të tilla që nuk na kanë lejuar t'i ndihmonim ato aq sa duhej ekonomikisht. Kjo ka ndodhur jo se nuk ka dashur Partia, por sepse vendi ishte akoma i varfër

dhe bujqësia në këto zona akoma e pakolektivizuar. Populli pas Çlirimt kishte nevojë për bukë, prandaj Partia u vuri kujdes më shumë fushave. Në këto kushte traktoret dhe investimet më të mëdha për bonifikime, ujitje etj. duheshin përqendruar në fushat tona më të gjera e pjellore, si ajo e Myzeqesë etj., për të marrë prej tyre më shumë dhe sa më parë prodhimë, për të mbajtur kështu me bukë popullsinë e fushave dhe të vetë malësisë. Për këto arsyen, në fillim, ndihmat në bujqësi u përqendruan më shumë nëpër fusha, të cilat edhe u kolektivizuan shumë vjet më parë dhe tashmë janë mëkëmbur dhe ecin mirë.

Për zonat malore Partia, gjer tani, pati dhënë orientimin të mos ngriheshin hëpërhcë kooperativat. Por tani u krijuan kushtet që edhe zonat malore të kolektivizohen. Prandaj, në Kongresin e 5-të u dha direktiva për kolektivizimin e plotë të vendit, e cila u përqafua menjëherë brenda një kohe rekord dhe jastë parashikimeve, në të gjitha zonat malore të vendit tonë. Kjo tregon pjekurinë e madhe ideologjike të popullit tonë dhe lidhjet shumë të ngushta të malësorëve shqiptarë me Partinë, besimin e patundur të të gjithë popullit te via e saj. Po kështu u zbatua këshilla e Partisë që anëtarët e kooperativave në malësi të mbajnë vetëm nga një dynë e gjysmë tokë për oborrin kooperativist. I tillë është besimi i fshatarësise sonë patriote në vijën e Partisë.

Gjendja ekonomike e fshatrave të zonave kodrinore e malore tanë e tutje do të përparojë më me shpejtësi, sepse Partia dhe Qeveria, brenda pak kohësh, do të marrin masa konkrete për t'u ardhur në

ndihmë, me qëllim që ato të forcohen më shpejt ekonomikisht. Kooperativat bujqësore të malësisë, për shembull, parashikohet të ndihmohen nga ana e shtetit me kredi pa interes bankar, bile, po studiohet mundësia që edhe kooperativave të vjetra të zonave malore e kodrinore që janë akoma të dobëta, t'u hiqet interes bankar për kreditë që kanë marrë dhe t'u zgjatet afati i shlyerjes së kredive. Mendohet, gjithashtu, të hiqet tatimi mbi të ardhurat e ekonomisë bujqësore në kooperativat e reja, të shtohen investimet shtetërorc në zonat malore e kodrinore, sidomos në favor të bonifikimit dhe të ujitjes, të tejkalojen detyrat e Kongresit të 5-të të Partisë për elektrifikimin e fshatrave etj. Kooperativat e zonave malore do të ndihmohen më shumë me pleh kimik, farëra të zgjedhura, me ndihmë teknike falas, si dhe me një sërë ndihmash të tjera, për të cilat së shpejti do të diskutojnë dhe do të vendosin Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria. Partia, gjithashtu, u ka bërë thirrje shumë kuadrove të kooperativave të zonave fushore për të dhënë kontributin e tyre për forcimin organizativ të kooperativave të reja të zonave malore. Prandaj, është detyra e këtyre shokëve dhe shoqeve, nga Myzeqeja, Korça, Durrësi, Vlora, Gjirokastra e Dropulli, që të hidhen për një ose për dy vjet në malësi, sidomos në vise të tilla si në Dukagjin, në Pukë, në Malësinë e Madhe, në Orosh, në Kukës, në Tropojë etj. dhe të bashkohen me shokët dhe shoqet e Veriut, të forcojnë lidhjet me ta dhe të mësojnë nga njëri-tjetri, të ndihmojnë shokët e malësisë në shumë drejtime, në radhë të parë, për t'u dhënë eksperiencën e fituar gjatë kolektivizimit, pastaj për

të çuar në kooperativat e reja malore kuptimin e drejtë të këtyre problemeve të mëdha ekonomiko-shoqërore. Por shokët e shoqet që do të kenë nderin të venë atje, të mos nisen me mendjen se janë më të zgjuar e më të ditur nga vëllezërit e motrat e tyre të zonave malore. Edhe ata janë si vullkani në veprim, që buçet e shpërthen, dhe duan me gjithë shpirt të përparojnë në rrugën kooperativiste, ku i udhëheq Partia.

Malësia po futet më me vonesë në rrugën e kollektivizimit, por tani janë krijuar kushte të tilla që përparimet që arritën fushat në këta 10-15 vjet jete kolektive, në malësi të realizohen, me siguri, brenda një kohe më të shkurtër, për arsyen se edhe mundësi materiale, edhe eksperiencë kemi më shumë, por kemi edhe njerëzit tanë të mrekullueshëm, të edukuar nga Partia, që janë faktori kryesor për ndërtimin e socializmit në malësi me ritme më të shpejta.

Të dashura shoqe,

Në emër të Komitetit Qendror dhe të gjithë Partisë, ju uroj suksese gjithnjë më të mëdha në punë dhe në jetë. Partia ka besim se ju do të luani një rol të madh në ndërtimin e socializmit dhe në revolucion. Ne shohim me kënaqësi se, brenda një kohe shumë të shkurtër, gratë e vendit tonë janë ngritur në një nivel shumë më të lartë se më parë. Hovi i madh revolucionar, që ka shpërthyer kudo në vendin tonë, nën udhëheqjen e Partisë, do t'i gjallërojë edhe më tepër gratë dhe vajzat tona, do t'i bëjë ato të afta t'i kuptojnë gjithnjë më mirë ngjarjet revolucionare që

po ndodhin në vendin tonë, do t'i mobilizojë në një shkallë të atillë të paparë, saqë Shqipëria për disa vjet të tjerë nuk do të njihet dot fare, nga ndryshimet kolosale që do të bëhen.

Ju, shoqe, jeni nga pjesa më e përparuar e popullit tonë dhe Partia ju beson një mision të madh: të sqaroni të gjithë ata që janë më prapa, të punoni pa u lodhur që edhe ata të ecin në rrugën tonë. Ju duhet të forconi lidhjet dhe besimin te Partia, pse ajo është çdo gjë, ajo na hap rrugën dhe horizontet, na jep forca dhe krijon mundësi të shumta që të bëjmë sa më shumë për popullin, dhe atdheu ynë të ngrihet gjithnjë lart e më lart, të bëhet më i fortë dhe të përballojë çdo rrezik. Qëllimet e larta të Partisë arrihen vetëm me përpjekje, me punë, me mësim, me dituri dhe përketo te ne ekzistojnë të gjitha mundësitë, prandaj të rritim dashurinë për punën.

Edhe një herë ju uroj nga zemra suksese sa më të mëdha në punën që keni marrë përsipër. Dalshi kurdoherë faqebardhë! Partinë e keni dhe do ta keni kurdoherë pranë.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha. «Mbi  
problemin e gruas», f. 214.*

*Tiranë, 1973*

*Botohet sipas shënimave të  
mbajtura në këtë takim që  
gjenden në AQP*

## **SI TA FORCOJMË PARTINË ORGANIZATIVISHT DHE SI TA EDUKOJMË ATË IDEOLOGJIKISHT**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**21 prill 1967**

Në raportet e komiteteve të Partisë të rretheve në Sekretariat shohim përmirësimë, por akoma nuk kemi arritur që këto raporte të pasqyrojnë më realisht gjendjen dhe në to të trajtohen thellësisht problemet që janë zgjidhur ose që kërkojnë zgjidhje të mëtejshme dhe ndihmën e Sekretariatit. Problemi që u kerkohet komiteteve të Partisë të rretheve për të raportuar shikohet ngushtë nga ana e tyre, nuk bëhen përpjekjet e duhura që çështjet të thellohen dhe të paraqitet i plotë problemi. Komitetet e Partisë kufizohen në mënyrë të ngushtë rreth temës dhe zor të trajtohet ndonjë

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raporteve «Mbi zbatimin e orientimeve të Byrosë Politike të KQ mbi veprimtarinë e organizatave të Partisë në dikasteret qendrore» dhe «Mbi masat e marra për forcimin e mëtejshëm të unitetit të brendshëm të organizatave-bazë të Partisë».

anë tjetër e problemit që, në dukje, nuk ka lidhje me temën e caktuar. Një shikim i tillë i problemit, ia ngushton atij horizontin. Kjo tregon se Partia në rrëth i shikon problemet të shkëputura dhe ka caktuar një nomenklaturë që është zor ta ndryshojë ose t'ia shpërthejë kornizat e vendosura.

Për shembull, tema aktuale që na paraqitet në Sekretariat ka të bëjë me «forcimin e unitetit të brendshëm të Partisë». Mirëpo, duke trajtuar problemin e «unitetit të brendshëm», vallë, mos trembemi të trajtojmë lidhur me të edhe «unitetin e jashtëm», dua të them atë të Partisë me masat? Jo! Kjo do të bëhet kur të kërkohet dhe me temë të caktuar, si, për shembull, «Lidhjet e Partisë me masat», «Fronti Demokratik dhe Partia» e tema të tjera si këto. Kurse fare lehtë shokët (dhe kjo duhet të jetë e natyrshme) mund të na flisnin edhe për ambientin jashtë organizatës, nga i cili na hyjnë në organizatë elementë negativë. Mund të thuhet se «kjo do ta zgjaste raportin», kurse unë mendoj që një gjë e tillë do ta shpjegojë e do ta plotësojë atë më mirë.

Ose të maririm raportin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Krujës. Ai është i ngjashëm me atë të Vlorës. Unë mora pjesë në aktivin e fundit të Partisë që u bë në rrethin e Krujës dhe, në mes të tjerash, konstatova dy minuse shumë të mëdha e serioze për këtë organizatë.

E para, në të gjithë organizatën e Partisë të rrethit të Krujës ka vetëm 12 shoqe, në qoftë se s'gabohen, dhe në malësi ka vetëm një shoqe komuniste.

E dyta, organizata e Partisë në malësi është, si të

thuash, e braktisur në vetvete, prandaj është e natyrshme që atje të ketë grindje, tarafe, prapambetje, bile edhe ndonjë vrasje etj.

Shokët e Krujës mund të thonë se çështja e dytë mund dhe duhet të trajtohej më thellë, kurse e para sikur nuk hyn në këtë temë. Po ta shohim ngushtë çështjen, ashtu del dhe mund të themi se për këtë «do të flasim kur të trajtojmë problemin e pranimit të grave në Parti». Mua më duket që çështja nuk duhet shikuar kështu. Po të thellohem i në «mungesën e unitetit në disa organizata-bazë», do të gjejmë plot arsy që shkaktojnë këtë mungesë uniteti, të cilat duhet të luftohen, duke marrë plot masa, në mes të tjerash të sjellim gjak të ri në Parti që të përtërijë gjakun e vjetër. Të marrim çështjen e gruas. Gruaja është pjesë përbërëse e këtij gjaku të ri, ajo është një nga pjesët më revolucionare e më përparimtare të popullit. Nga kjo mund dhe duhet të vijë ajo pjesë e gjakut të ri, që gjer tanë Partisë i ka munguar pjesërisht dhe Krujës, veçanërisht, i ka munguar dhe i mungon krejt.

Çështjet që marrim sot në studim janë çështje partie, çështje që kanë të bëjnë me forcimin e Partisë, pra çështje organizative dhe ideologjike. Partinë ne e forcojmë jo vetëm duke e edukuar, jo vetëm duke e spastruar, por, njëkohësisht, atë e kalitim nga ana ideologjike dhe organizative edhe duke sjellë gjak të ri nga masat e popullit, nga ato masa që lufta e Partisë i ka vënë dhe po i vë në lëvizje në mënyrë të mrekullueshme.

A ka një hov revolucionar të shkëlqyer në masat?

Po, bile shumë të madh. A duhet lidhur kjo gjendje e jashtme e organizatës me vetë jetën e organizatës? Sigurisht, duhet lidhur! A dallohen në këto momente revolucionare me qindra e mijëra njerëz të fortë, të cilët duhen futur në Parti? Patjetër!

Por të gjitha këto çështje merren të shkëputura, problemi nuk shikohet e nuk studiohet në tërësi, nuk ndiqen të gjitha anët, nuk ndiqet realizimi i tyre. Disa herë harrojmë më të rëndësishmet, për të cilat vazhdimisht po flasim.

Organizatën e Partisë të rrëthit të Vlorës ne disa herë e kemi kritikuar, bile i kemi dhënë edhe udhëzime mbi çështjet organizative kryesore. Po shokët e Vlorës nuk e kanë vënë si duhet ujin në zjarr për këto çështje. Le të marrim statistikën e kësaj organizate. Nga 116 organizata-bazë që ka rrëthi, 77 s'kanë bërë pranime, nga të cilat 13 organizata për dy vjet, 16 për tre vjet, 4 për katër vjet dhe 44 mbi pesë vjet.

Ose të marrim organizatën e Partisë të Tiranës, ku nga 424 organizata-bazë, 389 nuk kanë bërë pranime. Nga këto 46 organizata nuk kanë bërë pranime për dy vjet, 40 për tre vjet, 28 për katër vjet dhe 231 mbi pesë vjet.

Le të marrim edhe organizatën e Partisë për rrëthin e Krujës. Nga 81 organizata-bazë të këtij rrëthi, nuk kanë bërë pranime 52, nga të cilat 12 për dy vjet, 2 për tre vjet, 6 për katër vjet dhe 7 mbi pesë vjet.

Po të shikojmë pastaj statistikat për të gjithë Partinë, na del kjo pasqyrë:

Nga mbi 3 000 organizata-bazë, nuk kanë bërë pranime 2 168, nga të cilat për dy vjet 477 organizata-ba-

zë, për tre vjet 278, për katër vjet 156 dhe mbi pesë vjet 673.

Kjo, shokë, është një çështje shumë serioze, është një gabim i rëndë që po bëjmë, mund ta cilësoj si një krim që i bëjmë Partisë dhe socializmit. Kjo vërteton atë që parullat: «ta forcojmë Partinë organizativisht», «të sjellim gjak të ri në Parti», nuk zbërthehen seriozisht, nuk zbatohen në jetë, po edhe kur zbatohen, disa herë zbatohen keq, siç është shembulli i një organizate-bazë partie në rrithin e Librazhdit, në qoftë se nuk gabohem, e cila, kur vendosi të pranojë një anëtar të ri pas pesë vjetësh, pranoi një polic.

Partia, shokë, duhet t'i futet seriozisht këtij problemi dhe që t'i futesh seriozisht mendoj, siç e kam theksuar edhe disa herë të tjera, të merret në analizë shkencërisht çdo organizatë, të njihet gjendja brenda dhe jashtë saj. Brenda saj të njihet aktiviteti i çdo komunisti, stazhi, mosha, ngritja e tij politiko-ideologjike, për të dalë me konkluzionin se si duhet të shkojë ritmi i forcimit të organizatës me gjak të ri në bazë të territorit dhe të prodhimit, në bazë të ngritjes së nevojave të ambientit.

Kur themi të sjellim gjak të ri në Parti, duhet jo të flasim më kot dhe të ecim me sy mbyllur, po të studiojmë edhe moshat, edhe pjekurinë, edhe energjitet, edhe eksperiencën, edhe vendosmërinë politike dhe ideologjike, edhe të kaluarën, por edhe të tashmen e kuadrit. E gjithë kjo punë e ushqen vazhdimisht, në masën e duhur e sipas nevojave, organizatën-bazë me gjak të ri. Kjo s'është një punë e lehtë, por është një punë që duhet bërë medoemos, sepse ka të bëjë me

jetën e Partisë. Ta lësh pas dore këtë punë, do të jetë krim, ta bësh pa kujdes ose t'ia lësh spontaneitetit, do të jetë një gabim i rëndë.

Gjendja në drejtëm të pranimeve në rini është akoma më serioze dhe e papranueshme për një organizatë masash, sidomos kur ke një rini të tillë revolucionare e të mrekullueshme si jona. Statistikat na tregojnë se 61 për qind e rinisë së vendit tonë është e paorganizuar. Kjo është për të vënë duart në kokë. Ç'po bëjnë për këtë shokët e Partisë? Ç'po bëni ju, shokë të rinisë?!!! Një gjë po bëni, një gabim serioz, të pafalshëm. Sa më shpejt, në praktikë, pa pritur kongresin e rinisë, t'i heqim kufizimet e dëmshme, të flakim sektarizmin dhe konservatorizmin e dëmshëm në punën e rinisë dhe të vemi në kongresin e saj me një armatë të fuqishme dhe çfarë armate se, ku edhe i riu më i thjeshtë është një hero. Këtë zhvillim në rrugë të drejtë kam përshtypjen se Partia nuk e ndjek, nuk e ndihmon si duhet, prandaj të bëjmë kthesë.

Një tjetër e metë në raportet: na numërohen vetëm ndodhi dhe vetëm ndodhi të zeza. Nuk gjen, ose gjen shumë rrallë në to, anë pozitive, eksperiencën pozitive të Partisë. Ky jo vetëm nuk është një raportim i drejtë përpara Sekretariatit, po tregon edhe predispozicionin jopozitiv të shokëve që në praktikën e edukimit nuk përpiken të përdorin eksperiencën pozitive të Partisë, shembullin e mirë, për të luftuar të keqen.

Shokët mund të më thonë se në praktikë këtë mund që e bëjnë dobët, por e bëjnë. Këtë unë e pranoj, e di që bëhet dhe deri në ç'masë, pavarësisht se

bëhet dobët, ajo do të përmirësohet. Por në raportimet që na bëni ju, shokë, nuk merrni mundimin të na jepni eksperiencën tuaj praktike, si veproni konkretisht, ç'masa po merrni, ç'rezultate japid këto masa. Këtë nuk e shohim si duhet.

Mua më duket se nuk është e mjaftueshme të na thoni se do të bëni një plenum ose një aktiv, ku do t'i shtroni këto çështje. Këtë e dimë, këto janë forma pune, janë forma organizative, por brendinë, thelbin e tyre ne nuk e shohim. Apo do t'i shohim kur t'i shtroni, por atëherë çfarë ndihme efikase mund t'ju japid në, kur nuk kemi mundësinë të diskutojmë më thellë me ju në bazë të propozimeve dhe të masave konkrete që mendoni të merrni?

Le të marrim raportin e Komitetit të Partisë të Tiranës. Konstatimet e bëra në të janë të drejta, si:

«Nuk mbështeten iniciativat dhe propozimet nga poshtë», «qarkullimi i kuadrit dhe të këqijat që vijnë në qoftë se ai nuk zbatohet drejt», «drejtorët nuk kanë iniciativë», «zyrtarizmi, qëndrimi larg masës» etj., etj.

Këto janë disa nga çështjet që unë nxora nga studimi i këtij rapporti. Këto çështje nuk janë as të reja dhe as të panjohura nga ne, por ne dëshironim të dinim çfarë masash janë marrë dhe ç'rezultate pozitive kanë dhënë ato, çfarë masash të mëtejshme mendon të marrë Tirana. Kur them masa, nuk kuptoja vetëm ndonjë mbledhje plenumi, por çfarë forma pune dhe edukative praktikohen për t'i edukuar kuadrot që t'i zhdukin këto dobësi.

Natyrisht, për ne nuk është hera e parë që e shi-

kojmë këtë problem, por në kushtet e avancuara revolucionare ne duam të dimë si punon organizata-bazë pikërisht për këto probleme dhe si duhet t'i zgjidhë ato organizata-bazë e dikasterit.

Një mënyrë e tillë e paraqitjes së këtyre problemeve në raport përpëra Sekretariatit do të ishte një ndihmë e madhe për pjesëmarrësit në mbledhje, si dhe një grumbullim eksperience i vlefshëm për të gjithë Partinë.

Për dobësitë e Vlorës dhe të organizatës së saj është folur veçanërisht në Kongresin e 5-të dhe në mbledhje plenumi para Kongresit. Jo vetëm kaq, po janë përcaktuar dhe format e punës dhe orientimet që duheshin ndjekur për ta forcuar situatën. Po si janë zbatuar këto detyra? Shumë, shumë dobët, sepse ato nuk janë marrë seriozisht, nuk janë zbërthyer, nuk janë bërë objekt i një studimi të thellë, nuk janë nxjerrë konkluzione dhe nuk janë caktuar detyra, për të cilat pastaj të bëheshin përpjekje që të zbatoreshin, të kontrolloreshin, të korrigojeshin e të plotësoreshin herë pas here.

Në vend që të punohej kështu, është vepruar përciptas, kurdoherë me frysken e vjetër të punës dhe duke marrë masa gjysmake, të rastit. Kjo punë ecën kësisoj pse shokët e Vlorës hiqen sikur e njohin situatën në veçoritë e saj, po në realitet nuk e njohin si duhet dhe kënaqen me një njohje të përgjithshme. Kështu që gjendja brenda zien dhe vetëm kur avulli ngre pak kapakun, merren masa gjysmake administrative, duke hequr ndonjë urë nga zjarri, sa për të ulur temperaturën e nxehjes.

Në Vlorë ne kemi një organizatë partie të mirë, po nuk punohet si duhet ideologjikisht për të kalitur cilësitë e mira të vlonjatëve. Si kudo, edhe në Vlorë ekzistojnë zakone jo të mira që në pamjen e parë mbulohen nga cilësitë e larta të trimërisë, të besnikërisë, dhe fshihen pas karakteristikës së përgjithshme të patriotizmit. Në këto zakone jo të mira mund të dallojmë kryelartësinë e sëmurë, dashurinë jo të madhe për punën, pretendimet e tepruara duke spekuluar në qëndrimin e përgjithshëm patriotik të rrethit etj. Të gjitha këto dhe të tjera që lindin si kontradikta të zhvillimit, nuk trajtohen seriozisht ideologjikisht dhe politikisht, jo vetëm kur shfaqen, por edhe para se të shfaqen, duke njojur që më parë karakteristikën e ambientit, dhe në bazë të kësaj njojjeje t'i dilet punës përpara e të punohet në mënyrë sistematike për edukimin e njerëzve.

Është e domosdoshme që shokët drejtues të Komitetit të Partisë të Vlorës të bëjnë një kthesë të mirë në këtë drejtim, të kuptojnë se çështja e punës së Partisë, e forcimit të saj organizativ, varet shumë nga ngritja ideopolitike e komunistëve. Kjo ngritje, ky edukim i tyre, nuk mund të arrihen në shkallën që duhet, pa një përgatitje të thellë e të shumanshme. T'i trajtosh problemet lehtë e përciptazi, kjo nuk jep kurrë rezultate të mira.

Ne kemi suksese në forcimin e brendshëm të Partisë, po është fakt se edukimi i shëndoshë dhe sistematik i komunistëve tanë nuk është në lartësinë e duhur. Mbeturinat e së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve, në botëkuptimin e tyre, nuk zhduken aq lehtë,

as shpejt; zhduken ose dobësohen disa, po ringjallen e marrin hov përsëri të tjera e në forma të reja, në rast se nuk luftohen. Mbeturinat e këqija janë si sëmundjet ngjitëse, kundër të cilave jo vetëm duhen përdorur mjekimet e përshtatshme për t'i luftuar, por kërkohet njëkohësisht edhe profilaksi e vazhdueshme për t'i prerë hovin çdo ringjalljeje.

Mbeturina nuk mund të zhduket nga ndërgjegjja e njerëzve ashtu sikurse mund të zhduket një objekt nga rafti, të cilin e thyen dhe e hedh poshtë si të pa-përdorshëm më. Është për këtë arsyе që me njerëzit duhet të bëjmë një punë edukative, politike e ideologjike të pandërprerë e sidomos të diferencuar, sepse vetëm kështu, me këtë edukatë të përshtatshme prek të gjitha shtresat e popullit. Kuptohet që kjo punë e rëndë u është ngarkuar, në radhë të parë, komunistëve dhe Partisë së tyre. Populli shikon te Partia, po edhe Partia shikon te populli dhe mbështetet te ky për ta kryer si duhet këtë punë të madhe.

Për të luftuar mbeturinat e këqija në ndërgjegjen e njerëzve, Partia mbështetet në virthytet e larta të popullit. Prandaj komunistët, në radhë të parë, duhet të jenë bartës të këtyre virthytreve në jetë dhe në punën e tyre, të jenë ata që të materializojnë në politikë dhe në ideologji atë esencë të edukimit që duhet të shërbëjë si bar për shërimin e sëmundjeve që ekzistojnë ose që shfaqen dhe prapë rishfaqen në ndërgjegjen e njerëzve. Edukimi dhe ngritja e nivelit ideologjik të komunistëve nuk duhet të ndjekë për asnjë çast metodën dogmatike të mësimit të teorisë sonë në mënyrë shkollareske dhe të shkëputur ngajeta. Edhe një ko-

unist i rrahir me jetën, që i kupton mirë problemet në jetë dhe di të diktojë të mirën nga e keqja, shumë herë ndodhet në pozita të vështira për të bluar formulimet filozofike ose metodat dogmatike të atyre që i shpjegojnë dhe që ia mësojnë.

Që edukimi ideologjik të kryhet me sukses, duke u mbështetur në filozofinë tonë marksiste-leniniste, neve na duhet t'i formulojmë po këto parime bazë në forma të reja, të përshtatshme për nivelin ideologjik dhe kulturor të njerëzve tanë. Duhet që parimet e doktrinës sonë të mbështeten dhe të sqarojnë realitetin tonë, të shprehen në gjuhën e thjeshtë dhe të qartë të popullit tonë.

Në këtë drejtim ne kemi shumë për të bërë, pse akoma kemi bërë dhe po bëjmë pak. Një qëndrim krijues ndaj zhvillimit të teorisë marksiste-leniniste ne e konstatojmë te mësuesit tanë të mëdhenj. Njerëzit, kur studiojnë teorinë marksiste-leniniste, e kanë më vështirë Marksin sesa Leninin, e kanë më pak vështirë kur studiojnë Stalinin sesa Leninin. Kjo vërteton unitetin e doktrinës sonë, kompaktësinë dhe ekzaktësinë e saj, por kjo vërteton gjithashtu se ajo nuk është një dogmë e ngrirë, qoftë në zhvillimin e mëtejshëm të saj me pasurimin nga eksperiencia, ashtu edhe nga forma, nga mënyra e shprehjes dhe e formulimit të parimeve. Stalini nuk mund të jetë më pak marksist, për arsyen se shkrimet e tij janë më të thjeshta. Edhe shkrimet e tij të thjeshta janë shprehja dhe mbështetja e teorisë së Marksit dhe Engelsit të zhvilluara dhe të pasuruara më tej nga Lenini.

Kolosi Marks dhe shoku i tij Engelsi, themelues

të doktrinës sonë të lavdishme, e shtrinë studimin e tyre në shekuj të tërë dhe punuan për shekujt. Kjo do të thotë se ata bënë përgjithësimin gjenial të historisë, të krijimtarisë dhe të mendimit njerëzor, deduktuan ligjet e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, zbuluan e treguan ligjet, normat, metodat, format e mundshme të transformimit të shoqërisë, të zhdukjes së kapitalizmit dhe të ndërtimit të socializmit e të komunizmit. Prandaj doktrina e tyre është kurdoherë e re, e freskët dhe e pavdekshme kurrë. Në këtë analizë dhe sintezë gjeniale kuptohet gjenia e tyre, erudicioni i tyre i pafund, dituria e tyre e madhe. Format e mënyrat e përshtatshme që përdorën ata për këtë qëllim madhështor, bënë që doktrina e tyre të ishte pishtar për proletariatin dhe për popujt e botës. Është e kuptueshme përse vepra e Marksit është e vështirë të kuptohet në tërësinë dhe në thellësinë e saj nga komunistët tanë që nuk kanë akoma ngritjen e nevojshme teorike dhe kulturore. Vepra e Marksit është sumumi i shkencës, është kuintesanca e shkencës, ajo është përpunimi i thellë i mendimit dhe i veprimit njerëzor gjatë shekujve, në të shprehët lufta dhe polemika me konceptet dhe me filozofitë e ndryshme idealiste, irrationale, obskurantiste, jo vetëm në thelbin e tyre filozofik, por edhe në paraqitje.

Pra, në të vërtetë, nuk është e rëndë për t'u kuptuar vepra e Marksit, por të rënda, të pakuptueshme dhe të errëta kanë qenë konceptet filozofike, idealiste që Marks i ka demaskuar dhe i ka bërë pluhur e hi. Të vërtetat e Marksit janë të thjeshta dhe të kuptueshme për të gjithë, janë aq të kuptueshme dhe të

thjeshta për të gjithë, saqë komunistët dhe punonjësit tanë fryshtohen, udhëhiqen dhe i zbatojnë ato me sukses në jetë. Marksia ka luftuar, ka punuar, ka menduar për ne.

Lenini e ka pasuruar doktrinën tonë. Atij i është dashur të vazhdojë veprën e Marksit për dërrmimin e armiqve të marksizmit, për dërrmimin e teorive idealeiste borgjeze dhe të renegatëve të marksizmit në luftë kundër kapitalizmit në kushtet e imperializmit, në kushtet e zhvillimit të Revolucionit të Madh Socialist të Totorit, në kushtet e marrjes së pushtetit nga duart e borgjezisë. Të gjitha këto janë më afér nesh, prandaj vepra e Leninit, që është teoria e Marksit në veprim të vazhdueshëm, është relativist më e lehtë për t'u kuptuar. Vepra e Stalinit, rrjedhimisht, po për këto arsyë, bëhet më e lehtë për t'u kuptuar nga komunistët tanë.

Për ne qëndron, pra, si detyrë e dorës së parë që këtë thesar të madh që na ndrit rrugën, të dimë ta shfrytëzojmë sa më thellë dhe në mënyrë të shkallëzuar e të diferencuar. Partisë ne duhet t'i bëjmë të qartë bazën e teorisë sonë, në mënyrë që ajo të jetë në gjendje të kuptojë në rrugën marksiste zhvillimin materialist të historisë së njerëzimit, të kuptojë në rrugën marksiste-leniniste fenomenet e zhvillimit, të kuptojë ligjet e natyrës në rrugën e materializmit dialektik, të kuptojë esencën marksiste-leniniste të politikës së Partisë në ndërtimin e shoqërisë sonë socialistë, të dijë të shpjegojë drejt çdo veprim të saj, në çdo drejtim. Kjo është gjëja kryesore që na vihet përpara të bëjmë. Filozofinë marksiste-leniniste ta bëjmë të kuptueshme për të gjithë.

Në qoftë se Marks i është më i vështirë se Lenini për t'u studiuar dhe Stalini është më i lehtë se Lenini, prapë shkalla e vështirësisë nuk mund të jetë e njëllojtë për të gjithë ata që i studiojnë. Prandaj edhe kërkohet shkallëzimi i ngritjes ideologjike dhe diferençimi që ne duhet të bëjmë në format dhe në metodat e të mësuarit të teorisë.

Marksizëm-leninizmi është teoria universale që shpjegon çdo fenomen. Këto fenomene gjatë zhvillimit historik mund të ndryshojnë formën e paraqitjes, por esenca e tyre mbetet e pandryshuar. Ligjet e natyrës e të shoqërisë duhen interpretuar në mënyrë korakte dhe duhen vënë në shërbim të njerëzimit, të shoqërisë së re socialiste. Si gjetkë, ashtu edhe te ne, e reja lufton me të vjetërën në çdo gjë. Kjo luftë zhvillohet në format konkrete të aktualitetit tonë. Prandaj është e nevojshme të studiohen me kujdes realiteti ynë, luftha jonë, revolucioni ynë që zhvillohet në kuadrin e revolucionit botëror dhe në luftë kundër botës së vjetër, kundër imperializmit, kundër revizionizmit modern.

Është pra e nevojshme, e domosdoshme, që kuadrot e Partisë të bëjnë përpjekje serioze për të studiuar thellë Marksin, Engelsin, Leninin dhe Stalinin, të asimilojnë si duhet teorinë tonë, pse kështu Partia do të jetë më në gjendje ta bëjë këtë edukim ideologjik të diferençuar dhe të përgjithësojë e të shpjegojë më qartë e më shpejt eksperiencën tonë në dritën e teorisë marksiste-leniniste. Kështu, duke e lidhur studimin e teorisë me realitetin historik, ne do të evitojmë edhe prakticizmin, edhe dogmatizmin në edukimin ideologjik të njerëzve tanë.

Në lidhje me këto që thashë më sipër, dëshiroj të nxjerr disa konkluzione për punën e mëtejshme të Partisë. Brenda realizimeve të mëdha të vendit tonë, që bëhen nën udhëheqjen e drejtë dhe të drejtpërdrejtë të Partisë, ne duhet të konstatojmë disa pluse dhe disa minuse në punë.

Është e padiskutueshme se Partia e ka ngritur nivelin politik, ideologjik dhe teknik të komunistëve dhe të masave në përgjithësi dhe kjo matet me rezultatet e arritura. Në këtë ngritje të përgjithshme, ku, natyrisht, ka edhe përparime, edhe dobësi, ne shohim se ngritja tekniqe e kuadrove të prodhimit, thellimi në njoburitë tekniko-shkencore, përpjekjet për të lidhur shkencën me praktikën janë më përpara se ngritja teoretiqe e kuadrove të Partisë, thellimi i tyre në fushën ideologjike, përpjekjet për lidhjen e teorisë me praktikën dhe për përgjithësimin teorik të eksperiencës së Partisë. Kur them kuadro të Partisë, flas për kuadrot e komiteteve, të aparateve të tyre dhe për sekretarët e organizatave-bazë. Këta kuadro në «zanatin» e tyre, që është udhëheqja politike dhe ideologjike, janë më prapa nga kuadri i sektorit të prodhimit. Këta të fundit, duke filluar që nga inxhinieri e gjer te punëtori i thjeshtë, nga agronomi e gjer te kooperativisti i thjeshtë, po bëjnë përpjekje të mira për të zotëruar «zantan», për të zgjeruar njoburitë e tyre shkencore, teknike, agroteknike etj.

Pra, njerëzit e prodhimit, të teknikës, të organizimit të drejtpërdrejtë të punës e ndiejnë më mirë nevojën e aftësimit të tyre. Nëpërmjet përpjekjeve për t'u aftësuar, nëpërmjet punës dhe realizimit material,

njëkohësisht ata ngrihen edhe ideologjikisht, sepse zotërimi i shkencës dhe zbatimi i saj në praktikë, lidhja e teorisë me praktikën, përgjithësimi i eksperiencës dhe, nga kjo, kalimi në shpikje e racionalizime, që konstatojmë me shumicë në radhët dhe në punët e tyre, u hap realisht fusha më të gjera për të kuptuar më mirë përbajtjen shkencore të ligjeve të teorisë marksiste-leniniste, për ta kuptuar në zhvillimin e vet dialektik teorinë që i udhëheq. Prapëserapë kjo nuk përjashton nevojën e studimit të thellë të teorisë marksiste-leniniste, në mënyrë që ata të krijojnë bindje të shëndosha ideologjike. Ky studim duhet të bëhet. Atë duhet ta udhëheqë medoemos Partia, pse, pavarësisht nga përparimi i dukshëm teknik, tek ata ne shohim mbeturina të theksuara të ideologjisë borgjeze, qëndrime politike disa herë jo të drejta. Në këtë drejtim ndikon negativisht edhe fakti që punëtorët e Partisë, komitetet, sekretarët, instruktorët nuk e zotërojnë si duhet zanatin e tyre, nuk bëjnë sa duhet e si duhet përpjekje për t'u ngritur vetë, që të ngrenë edhe të tjerët, të drejtojnë dhe të udhëheqin jo me parulla të përgjithshme, por duke njojur thellë teorinë dhe praktikën tonë revolucionare.

Ishte një kohë kur ne kishim më pak edhe kuadro teknikë, por akoma më pak edhe punëtorë partie me arsim e shkollë partie. Partia e ndryshoi këtë gjendje të fillimit. Ajo përgatiti edhe kuadro partie me arsim të lartë partie. Partia përgatiti dhe po përgatit vazhdimesht një numër të madh punëtorësh të kualifikuar, teknikë, mësues, inxhinierë, agronomë, zooteknikë, ekonomistë etj. Njëkohësisht Partia është kujdesur

dhe kujdeset që jo vetëm sekretarët e parë, por dhe gjithë sekretarët e tjerë të komiteteve të Partisë, si dhe një numër i madh instruktorësh dhe sekretarësh të organizatave-bazë, të kalojnë në shkolla e kurse partie, të pajisen edhe me kulturë të përgjithshme. Kjo ka bërë që të ngrihet gjithmonë më lart niveli i punës së Partisë.

Mendoj se, në përgjithësi, kuadrot teknikë studiojnë më mirë, përpiken më me këmbëngulje për të zotuar shkencën e teknikën dhe për t'i zbatuar ato më mirë në praktikë. Inxhinierët ndërtojnë rrugë, ura, fabrika, hidrocentrale; agronomët drejtojnë fermat e kooperativat, zbatojnë dhe zhvillojnë agroteknikën; planifikët e arkitektët bëjnë plane e projekte, punëtorët prodhojnë e krijojnë. Vetë jeta i mëson dhe i detyron ata që, krahas punës së tyre praktike, të mos neglizhojnë as shkencën e as teknikën, sepse, ndryshe, as hidrocentrali nuk ngrihet, as patatet nuk mbijnë.

Por me sekretarët dhe me punonjësit e Partisë, në përgjithësi, nuk ndodh kështu. Natyrisht, udhëheqja politike, ideologjike, organizative e jetës së Partisë e të shtetit, edukimi i njerëzve, lidhja e teorisë me praktikën dhe përgjithësimi teorik i fenomeneve shoqërore e i eksperiencës së Partisë është një punë më e ndërlikuar sesa zgjidhja e një problemi teknik, ndërtimi i një hidrocentrali, kombinati etj. Për ndërtimin e shoqërisë socialiste, për të shpjeguar e për t'u dhënë zgjidhje fenomeneve shoqërore që hasim në jetë, ne udhëhiqemi nga filozofia marksiste-leniniste, nga ligjet dialektike të zhvillimit të shoqërisë. Por në krahasim me detyrat e mëdha që ka Partia për të udhëhe-

qur e për të drejtuar gjithë jetën e vendit në zhvillimin e saj revolucionar, përpjekjet e punonjësve të Partisë për t'u ngritur si punëtorë partie, me gjithë përmirësimet e vazhdueshme, janë akoma të pamjaftueshme. Ne kemi edhe nga ata sekretarë që pak punojnë me librat, që nuk thellohen si duhet në veprat e Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit, në dokumentet e Partisë sonë dhe në direktivat e saj. Kemi nga ata sekretarë partie të vjetër e me eksperiencë më të madhe si punëtorë partie nga një inxhinier hidrocentrali, që e kanë zor të madh të bëjnë një referat ideologjik, të bëjnë një përgjithësim teorik, megjithëse, në fund të fundit, kjo është puna e tyre, detyra e tyre kryesore.

Prandaj, këtë dobësi, shokë, duhet ta shikojmë drejt në sy, ta kuptojmë e ta zgjidhim drejt. Duhet njobur se punonjësit e Partisë anojnë më shumë nga prakticizmi dhe shumë herë, duke mos bërë detyrën e tyre, ngatérrohen edhe në detyrat e të tjerëve, siç është çështja e interesimit më tepër për anët ekonomike. Nuk është çështja që ata të mos interesohen përkëto, por, në radhë të parë, të interesohen përdetyrën e veçantë që u ka caktuar Partia. Hidrocentralin nuk e ndërton dot sekretari i Partisë. Atë e ka dikush tjetër përdetyrë ta bëjë dhe inxhinierët e ngarkuar për ta kryer këtë punë janë kompetentë; po ashtu janë kompetentë për «zanatin» e tyre edhe agronomi e veterineri. Sekretari duhet t'u japë atyre ndihmën e tij, ndihmë kjo që nuk konsiston në atë që t'u thotë atyre gjëra, të cilat ata i dinë më mirë se ai, por që t'u mësojë pikërisht atë që ata e dinë më pak dhe që sekretari duhet ta dijë më mirë, politikën dhe ideologjinë.

në e Partisë. Në këtë mënyrë evitohet dublimi, por evitohen edhe dobësitë e punës për t'i ngritur njerëzit në lartësinë e detyrave që u janë ngarkuar.

Eshtë fakt se nga ana e Partisë luftohet dhe arrihen suksese të mëdha, por ne konstatojmë se, përveç anëve të mira të Partisë, kemi edhe dobësi, përveç hovit të madh revolucionar të masave, kemi edhe plot gjëra që na pengojnë, përveç sukseseve organizative, kemi edhe dobësi në këtë drejtim.

Të marrim çështjen e organizimit dhe të drejtimit të punës së ndërmarrjeve shtetërore. Atje, me gjithë të metat, puna, organizimi janë më mirë. Dhe kjo është e kuptueshme, për arsyen e natyrës së tyre, për arsyen se atje Partia është më e pjekur, për arsyen se atje kemi klasën punëtore, kuadro të kualifikuar etj., etj.

Në fshat kjo punë është më e dobët. Ne nuk mund të kënaqemi duke thënë se atje puna është e dobët vetëm për natyrën e saj. Duhet të njohim, gjithashlu, se Partia atje punon më dobët. Fshati nuk është më pak patriot, më pak entuziazzt dhe më pak i lidhur me Partinë se qyteti. Por ndihma e komiteteve të Partisë për fshatin ka qenë e pamjaftueshme dhe këtu duket dobësia e tyre që, megjithëse e dinë se në fshat terreni është më i vështirë, organizojnë dobët edhe punën ideo-ologjike, edhe atë politike, gjë që ka pasoja në organizim dhe në prodhim.

Në raportin që po studiojmë, Komiteti i Partisë i Rrethit të Vlorës na thotë se te komunistët e disa organizatave-bazë ka karrierizëm e mendjemadhësi, disa të tjerë vënë interesin personal mbi atë të përgjithshëm, në disa organizata-bazë partie ka shfaqje armi-

qësore, aty-këtu vazhdojnë të luajnë disa herë rolin e vet tarafet, familjet, fiset etj., etj. Natyrisht, këto nuk janë karakteristika negative vetëm në organizatën e Partisë të rrethit të Vlorës. Ku më shumë e ku më pak, shfaqje të tilla kemi edhe në organizata partie të rretheve të tjera. Është fakt që këto shfaqje i luftojmë, por nuk i luftojmë si duhet. Vlora do të bëjë një plenum, ku do t'i shtrojë këto çështje. Mirëpo plenumetë tilla kemi bërë vazhdimisht. Ne nuk duhet të kemi pretendime se me një plenum ose me disa të tilla do t'i zhdukim tërësisht këto të meta. Natyrisht, plenumetë si këto janë të domosdoshme dhe kanë dhënë rezultate, por konstatojmë se ato nuk përgatiten si duhet dhe më pas nuk merren masa të shumanshme për të zhvilluar një punë të thellë ideologjike. Qoftë në përgatitjen, qoftë në zbatimin e vendimeve të plenumit, mbretëron prakticizmi.

Që të bëhet si duhet një paraqitje e të gjithë këtyre të metave, që nga karrierizmi e deri te ndjenja e fisit, e bajrakut, që na pengojnë të gjithë, duhet të bëhen përgjithësime teorike, politike dhe jo të numërohen vetëm shembuj, domethënë të hidhet materiali bruto dhe pastaj ky të kalojë si material i përpunuar.

Përpunimi i eksperiencës nuk qëndron në hedhjen e fakteve në raport dhe në shoqërimin e tyre me një «duhet». Shfaqjet e ndryshme kanë burime të thella politiko-ideologjike; ekonomiko-shoqërore që, po nuk u vu dorë seriozisht mbi to, në radhë të parë nga komiteti i Partisë me sekretarët e tij, me atë të parin në krye, asgjë nuk mund të bëhet mirë. Por përpunimi

i mirë i tyre lyp mbështetjen e studimit në faktet, në kohën, në mënyrën, në terrenin dhe në intensitetin e shfaqjeve të këtyre fakteve, si dhe në teori, që do të thotë të kesh afër, në çdo moment, klasikët tanë dhe dokumentet e Partisë.

Të përgjithësosh eksperiencën nuk do të thotë vetëm të rreshtosh fraza dhe të dalësh me disa konkluzione stereotipe që i shikon çdo ditë në gazetë, kjo nuk është një punë serioze, nuk e mëson Partinë si duhet.

Përse duhet t'i analizojmë me kujdes faktet nën dritën e teorisë sonë? Këtë duhet ta bëjmë, pse, pavarësisht se ato përsëriten në të gjithë vendin tonë në format që thashë më lart, prapëseprapë në to ka ndryshime nga një krahinë në një tjetër, nga një rreth në tjetrin, për arsyet e tjerës së tij. Diçka që është e theksuar më shumë në një zonë, në tjetrën paraqitet e zbehtë. Ndjenja e fisit në Jug, për shembull, nuk është aq e theksuar sa në Veri. Këtë realitet tonin, ndodhitë tona, ne nuk do t'i gjejmë të analizuara as te Marks, as te Lenin, prandaj nuk duhet të mendohet thjesht: «Të na rekomandohet kapitulli dhe t'i referohemi». Marks dhe Lenin i kanë bërë konkluzionet e tyre teorike që nuk i luan as topi dhe, pavarësisht se në kohë të tjera e në realitetin tonë ato gjejnë forma e shprehje të ndryshme, burimi është një. Pra Marks dhe Lenin duhet absolutisht t'i studiosh, t'i mbash dhe nën jastëkun e kokës, t'i konsultosh vazhdimisht e vazhdëmisht, që edhe ata të të ndihmojnë.

Po a e bëjnë si duhet një gjë të tillë sekretarët tanë të komiteteve të Partisë të rretheve? Jo, s'e bëjnë

si duhet e sa duhet. Po e kanë mundësinë ta bëjnë? E kanë, se ata kanë mbaruar shkolla të larta partie, ata kanë plot bashkëpunëtorë.

Po ç'do të thotë të nxjerrësh përgjithësime teorike nga realiteti ynë? Do të thotë të bësh me të vërtetë atë që Partia kërkon nga ne, punonjësit e saj. Me këtë punë serioze tonën ne duhet të edukojmë Partinë, të ngremë nivelin ideologjik të komunistëve dhe të mësive, t'i ndihmojmë të kuptojnë teorikisht domethënien e problemeve të ndryshme, të zbulojmë burimin e të këqijave dhe të përcaktojmë masat efikase për zgjidhjen e tyre dhe jo ta trajtojmë çështjen përciptazi, t'u themi disa këshilla praktike, disa «duhet» dhe të marrim disa masa administrative.

Kur nuk bëhen përgjithësime, masat që merren janë të çala, diskutimet në plenume nuk janë të thella. Po ajo që është më e keqja, mendohet se me mbledhjen e plenomit çdo gjë merr fund «me sukses», anëtarët e plenomit ose pjesëtarët e aktivit shkojnë në bazë ku i shtrojnë çështjet pa marrë masa shumë serioze.

Shumë rrallë shohim ne sekretarë të parë të komiteteve të Partisë të rretheve që të përgatitin referate teorike për edukimin e kuadrove të rrethit në seminare të veçanta. Flas për sekretarët e parë në radhë të parë, po edhe për të tjerët. Përse nuk e bëjnë ata këtë gjë, gjersa shkollë dhe eksperiencë kanë dhe as autoriteti nuk u mungon? Më në fund duhet thënë se kjo është një nga detyrat e tyre kryesore të Partisë, pse për fabrikën Partia ka ngarkuar të tjerë komunistë ta ndërtojnë dhe një ose me dhjetëra komunistë të tjerë që ta drejtojnë.

Referatet ideologjike pritet të dërgohen vetëm nga lart. Kjo nuk është e drejtë. Përgjithësimi teorik i punës së Partisë nuk bëhet vetëm në qendër. Ajo do të ishte disi *eks katedra* në rast se rrathi, në rast se baza lidhin duart. Rrethet duhet ta kenë mirë parasysh këtë, pse në rast se presin t'u japë të hanë fraza «teoricieni i zyrës», kur janë vetë në gjendje dhe më të kualifikuarit të ndihmojnë veten dhe qendrën, atëherë edukimi ideologjik i Partisë nuk do të ecë me ato ritme dhe me atë kualifikim që kërkojnë Partia dhe Komiteun Qendror.

Aktualisht Partia po e thellon me sukses revolucionarizimin e saj dhe të masave, vetëm se ky thellim duhet të jetë me të vërtetë thellim, dua të them me baza; i sqaruar më gjerë politikisht dhe nga ana teorike.

Ne zbulojmë shumë fenomene të këqija shoqërore dhe me të drejtë i demaskojmë ato. Ne indinjohemi, revoltohemi dhe hamë veten, kur mendojmë që i kemi lënë ato gjer tan pa i luftuar. Unë mendoj se ato ne i kemi luftuar, po jo sa duhet dhe, sidomos, si duhet.

Nuk mjafton vetëm të themi «ta shesësh vajzën, ta fejosh vajzën ose djalin të mitur është një gjë e poshtë», «këto janë zakone barbare» etj., shprehje këto që ne i përdorim shpesh si konkluzion logjik të aktit, dhe këtë konkluzion shumë herë e konsiderejmë të mjaftueshmë, filozofiko-teorik, pse nuk bëjmë përpjekje t'u futemi më thellë çështjeve. Çështjet shoqërore, sipas mendimit tim, nuk janë aq të thjeshta, ato kanë ligjet e tyre të shkruara dhe të pashkruara dhe

më të shumtën e herës ligjet e pashkruara janë më të rrezikshmet, më kryeneçet, që i rezistojnë zhdukjes. Këto ligje të pashkruara janë zakonet. Ka zakone të mira, ka edhe zakone të këqija; edhe zakonet e mira kanë anët e tyre pozitive, po kanë edhe anët negative. Zakonet nuk qëndrojnë përgjithmonë të pandryshuara. Edhe ato, me zhvillimin e kushteve shoqërore që i kanë krijuar, pësojnë evolucionin e tyre. Zakonet janë ligje të pashkruara, që pësojnë ndryshime si edhe ligjet e shkruara, por me periudha vazhdimësie më të gjata.

Zakonet, pra, janë disa ligje që drejojnë jetën shoqërore dhe i shërbejnë asaj. Me zakonet lidhen çështje ekonomike, politike, ideologjike, fetare, organizative, shëndetësore, të familjes, të fisisit, të bajrakut, të monarkisë dhe, më përpara akoma, të feudalizmit e deri të periudhës së fillimit të jetesës së njeriut në shoqëri. Pra, zakonet, ashtu si dhe ligjet, kanë bazën e tyre të lindjes: ekonomike, politike, ideologjike, etike, organizative etj.

Ne flasim për t'i luftuar dhe për t'i zhdukur zakonet tona prapanike, por për ta bërë këtë duhet të zbulojmë burimin e tyre, të demaskojmë prejardhjen e tyre filozofike, idealiste, fetare, pse bazën ekonomike ne tani e kemi ndryshuar. Por, shikoni karakteristikën e zakonit: megjithëse baza ekonomike e kohës kur ai është vendosur ka ndryshuar krejt, zakoni vazhdon akoma të shfaqet, të veprojë, bile nën hundën tonë.

Të marrim Kanunin e Lekë Dukagjinit. Ky Kanun është një përbledhje dokesh e zakonesh mesjetare të vendit tonë. Doket dhe zakonet, që kanë marrë

emrin e Lekë Dukagjinit, qeverisnin shoqërinë shqiptare, sidomos në Veri, në mënyrë të hekurt, saqë edhe sot ndihet zgjedha e tij barbare, antishoqërore, mesjetare. Shqipëria e Mesme dhe e Jugut, në qoftë se nuk kishin një ligj të koncentruar si Kanuni i Lekë Dukagjinit, për shkak të zhvillimit të tyre më të përparuar, edhe këto drejtoheshin nga disa ligje të pashkruara, që s'janë gjë tjetër veçse zakonet për të cilat po flasim, të cilat rregullonin dhe drejtonin edhe ato, në mënyrë barbare, jetën e njerëzve, të familjeve, të fiseve etj.

Të shikuara me syrin e sotëm dhe në epokën tonë të socializmit, këto zakone janë barbare dhe ne duhet të luftojmë që t'i zhdukim, po historikisht ato janë produkti logjik i epokave të caktuara, i zhvillimit ekonomiko-shoqëror të tyre. E meta jonë në këtë çështje është ajo që, edhe kur studiojmë historinë e lashtë të popullit tonë, theksin e vëmë më shumë në zhvillimin historik dhe faktet e ndodhitë luftarake i shohim në mënyrë romantike, duke lënë në errësirë gjoja për mungesë dokumentesh, faktorët ekonomikë dhe shoqërorë të zhvillimit të shoqërisë në epoka të ndryshme.

Ne themi se nuk kemi të dhëna dokumentare për studimin e këtyre anëve themelore të zhvillimit të shoqërisë, por në kohët tona, në socializëm, përsë nuk kemi studiuar dhe vazhdojmë të mos studiojmë në mënyrë shkencore sesa thellë vepron Kanuni i Lekë Dukagjinit në Veri ose zakonet e familjes, të fejesave, të fiseve dhe të fesë në popullin tonë? A na lejohet neve që një mëngjes të konstatojmë me habi se organizatat e

Partisë në Veri jo vetëm nuk reagojnë, ose reagojnë dobët kundër zakoneve të kanunit, jo vetëm nuk i shpjegojnë, ose i shpjegojnë shumë dobët, po edhe i përdorin ato si pa gjë të keqe?

Po të mos ia zbulojmë rrënjet e vërteta shoqërore zakonit të keq, është e vështirë ta zhdukësh atë. Kësh-  
tu ai mund të rrojë në shekuj. Po ju jap një shembull:  
Kur isha kalama, në Gjirokastër, në lagjen time rronte  
një plakë që quhej teto Merzo. Ajo vente derë më  
derë, duke mbajtur në xhepin e çitjaneve një kafkë  
qeni që ishte bërë si fildish nga përdorimi dhe me të  
«shëronte» njerëzit nga çdo sëmundje, të cilat ajo i  
përmblidhët në një sëmundje të vetme «ka marrë  
sysh». Kokën e qenit ajo ia shkonte të sëmurit në  
fytyrë, gogësintë tërë kohën dhe pas çdo gogësime  
pështynte lehtë «pf, pf». Përse jua them këtë rit ma-  
gjistar të rëndomtë? Jua them vetëm për të treguar  
që ky rit origjinën e vet e ka të paktën 6 000-vjeçare.  
Në një libër që lexoja kohët e fundit mbi «Shkencën  
dhe magjinë» bëhet fjalë për të njëjtin rit me kokë  
qeni ose me kokë çakalli, që përdorej në kohën e farao-  
nëve dhe para faraonëve aleksandrinë. Edhe fallxhinjtë  
ose magjistarët egjiptianë bënин tē njëjtat tē pështy-  
tura «pf, pf» si të teto Merzos.

Te nuskat e hoxhallarëve, të dervishlerëve dhe të  
klerikëve të tjerë, që vazhdojnë të bëjnë edhe sot, ne  
shohim vetëm anën e spekulimit monetar nga këta  
matrapazë dhe harrojmë të shohim spekulimin filozo-  
fiko-klerikal-idealit të tyre, fillin e të cilit e gjejmë  
edhe në shumë zakone të tjera prapanike.

Ne me të drejtë indinjohemi kur mësojmë se filani

shet vajzën ose fejon vajzën apo djalin që në mituri, po nuk thellohem i shumë për të gjetur arsyet shoqërore e filozofike të tyre, të zbulojmë që në këtë mes nuk ndërhyr vetëm faktori ekonomik i shumës së marrë, njëloj si për një kafshë, por nëpërmjet martesave e krushqive mbështetej edhe forcimi i pushtetit të familjes dhe të fiseve, i sigurimit të tyre nga goditjet e jashtme. Për prindërit, për familjet, ruajtja e «unitetit» të familjes, e mbrojtjes së saj, e krijimit të aleancave, qëndronte më lart se interesit individual ose humanitar.

Në epoka të caktuara, kur këto zakone lindnin, zhvilloheshin, përhapeshin, mbisundonte fuqia e kryetarit të familjes, të fisit, që ishte i vetmi në gjendje dhe i autorizuar të lidhte aleancat dhe t'i zgjidhë ato. E njëjta gjë ndodhë dhe me martesat, edhe me vdekjet. Ana ekonomike i linte vend çështjes së përfitimit politik dhe forcimit të pushtetit të familjes dhe të aleancave të saj nëpërmjet ndodhive të gëzuara dhe hidhërimeve. Në të gjitha këto dhe në të tjera fenomene të këtij lloji pleksej, natyrishët, edhe feja, superstruktura ideologjike, me një fjalë.

Nga e gjitha kjo, unë mendoj se Partisë i vihet detyra të punojë akoma më seriozisht e më thellë për këto probleme, të cilat janë probleme shoqërore e që e kanë edhe anën e tyre të rëndësishme ideologjike. Përsëri them që kjo nuk mund të jetë çështje vetëm e një grapi specialistësh (ata duhet ta planifikojnë e ta organizojnë shumë më mirë e më thellë punën e tyre), por është çështje e të gjithë kuadrove të Partisë e, në radhë të parë, e komiteteve dhe e sekretarëve.

A është e drejtë që, krahës indinjatës sonë për

veprën jo të mirë të një komunisti që, nga një anë ka sakrifikuar dhe është gati të sakrifikojë edhe jetën e tij për Partinë, por, nga ana tjetër, fejon vajzën e tij në moshë të vogël, ose nuk ndikon nga ana e tij që t'u prishë agjërimin pleqve të tij, të mos ndiejmë edhe ne përgjegjësinë tonë të madhe e të pyesim: «A kemi bërë ne sa duhet për ngritjen e tij ideologjike?».

Një material të pasur ka aktualisht në dorë Partia për problemet e ndryshme shoqërore. Ne do t'i sillnim një dëm serioz punës sonë, në qoftë se këto do t'i regjiströn vetëm si fakte. Ne duhet të organizojmë studimin e imët, të thellë e serioz të tyre, të bëjmë përgjithësime të shumanshme teorike, politike, edukative. Të sistemojmë mbi këtë bazë luftën parimore dhe në përshtatje me praktikën e këtyre zakoneve prapanike, pse njerëzit nuk janë të qartë. Komunistët janë të bindur për drejtësinë e direktivave të Partisë dhe në ballë të luftës për të zbatuar këto direktiva jetëdhënëse, por, pasi i pranojnë, u lindin paqartësi. Në seminaret e Beratit me kuadrot, siç më raportuan, para se të mbyllej mbledhja, kur u pyetën pjesëmarrësit mbi problemet politike të kohës, ata drejtuan lart nga 100 pyetje.

Ç'karakter kishin këto pyetje? Të gjitha në dukje kishin karakter praktik. Për shembull: «Të bëj dasmë kur të martoj djalin apo jo?», «Të pres në shtëpi urime ose ngushëllime?», «Sa të gjerë ta bëj dasmën?» etj., etj. Por këto pyetje, që duken praktike, tregojnë se ideologjikisht të këta kuadro nuk ka akoma qartësi as për dasmën, as për fejesën, as për vdekjen. Populli këto i ngre se zakoni është i rrënjosur dhe baza e tyre

nuk është vetëm ekonomike, por edhe filozofike, humanitare, materialiste apo idealiste. Partia nuk mund t'i rekomandojë tjetrit edhe shumën e të hollave që duhet të shpenzojë për dasmën e vajzës, ose ta lejojë apo jo atë që të presë miqtë e tij që venë ta ngushëllojnë kur i vdes i ati. Gëzimet dhe hidhërimet janë fenomene shoqërore, kanë të bëjnë me ndjenjat e njerëzve, me dashurinë dhe solidaritetin midis tyre. Si këto, ash tu edhe të tjera si këto, janë anët e mira të zakoneve. Partia e ka për detyrë t'i forcojë këto anë pozitive shoqërore, por ajo e ka njëkohësisht për detyrë që t'i shpjegojë e t'i interpretojë drejt edhe zakonet e këqija që janë pleksur me zakonet e mira. Në qoftë se këtë e bëjmë si duhet, as komunisti, askush nga populli nuk ka atëherë përsë të pyesë për gjëra që teorikisht dhe politikisht u janë bërë të qarta.

Prandaj thellimi në këto probleme nuk konsiston vetëm në bërjen e një plenumi ose referati. Kjo punë, duke qenë orientuese, nuk do të ishte as e mjaftueshme, as e plotë. Me të duhet të merret, ta studiojë dhe ta realizojë propaganda e Partisë dhe e shtetit. Konkluzionet teorike marksiste-leniniste për edukimin e Partisë dhe të popullit duhet të materializohen në të gjitha format e mundshme. Për këtë qëllim duhet të vihen në lëvizje të madhe shtypi, radioja, njerëzit e teatrit, të muzikës, të estradës, të baletit, të kinemasë, shkrimitarë dhe artistë, të afirmuar dhe diletantë. Të gjithë këta duhet të drejtohen, të fryshtëzojen, të ndihmohen fuqimisht nga Partia dhe nga shteti, të fryshtëzojen ideologjikisht dhe të ndihmohen konkretisht. Çdo vepër, çdo shkrim, çdo dramë, çdo pjesë muzikore

duhet tē frysmezohet jo pēr ta nxirē punēn, por duke luftuar atē qē duhet luftuar, tē vērē nē dukje anēt pozitive tē mrekullueshme tē njerēzve tanē. Pēr çdo gjē e nē çdo gjē tē dilet kurdoherē me konkluzione tē drejta dhe me perspektiva tē qarta dhe revolucionare.

Tē metat ne i kemi shikuar dhe do t'i shikojmē kurdoherē nē sy, pa frikē. Ne s'kemi pse tē jemi aspak pesimistē nē luftēn kundēr kētyre tē metave, pse Partia jonē ështē e fortē, marksiste-leniniste dhe populli ynē ështē njē popull i mrekullueshēm e pērparimtar.

Duke njobur historinē e popullit tonē, zhvillimin e tij tē gjithanshēm gjatē historisē, deri nē ditēn e sotme, dhe duke studiuar mjaft probleme tē tilla shoqërore si kēto qē na preokupojnē ne, nē popuj e shtete tē tjera, qē quhen shtete dhe popuj tē qytetēruar, si Franca, Shtetet e Bashkuara tē Amerikës, Italia, Anglia etj., mund tē dalim me konkluzionin se populli ynē, si njē popull pērparimtar, ështē shumē mē pērpara nē kēto drejtime, pavarësisht se shkalla e industrializimit, e niveli teknik te ne nuk janē nē niveli e tyre.

Revolucioni ynē ështē njē revolucion i thellē proletar. Reformat tona nuk janē tē thjeshta, ato janē njē pērbysje me tē vërtetē revolucionare, e bërë nga njē popull revolucionar, qē udhëhiqet nga njē parti revolucionare, tē cilēn e frysmezon njē teori revolucionare, pēr tē pērbysur nga themelet botēn e vjetēr dhe pēr tē ndërtuar socializmin dhe komunizmin. Partia jonē çan shtigje e rrugë tē reja nē ndërtimin e so-

cializmit dhe thellon në mënyrë revolucionare e pa ndërprerje revolucionin proletar.

Le të marrim revolucionin demokratiko-borgjez turk të Mustafa Qemalit, të cilin duan ta quajnë antifetar. Ç'bëri ky revolucion? Mustafa Qemali, me revolucionin qemalist, rrëzoi absolutizmin, sulltanatin dhe teokracinë; Kalifatin, dhe krijoi Republikën Turke. Ai vazhdoi të bënte edhe një sërë reformash shoqërore, deri diku edhe ekonomike, të cilat, me gjithë format e përparuara në krahasim me të kaluarën, nuk dolën nga korniza e një revolucioni borgjez, që u bë nën parullën «të ndjekim rrujan e evropianizimit të Turqisë». Rruga e «evropianizimit» të Turqisë nuk mund ta thellonte revolucionin qemalist, po do ta pengonte, ashtu siç e pengoi. Natyrisht, as Mustafa Qemali, as shokët e tij nuk ishin për reforma radikale ekonomike në favor të klasave të shtypura. Ata rrëzuan Kalifatin, zëvendësuan festen me kasketën, ndanë fenë nga shteti, po filozofia e tyre nuk ishte një filozofi materialiste, ajo ishte dhe qëndroi idealiste, fetare, në formë më të atenuara<sup>1</sup>, por prapë idealiste borgjeze.

Kur e barazon, pra, revolucionin qenialist me revolucionin tonë proletar, revolucioni ynë është me shekuj përpara jo vetëm me atë qemalist, por me të gjithë të ashtuquajturin «përparim evropian», amerikan ose revisionist; revolucioni ynë është me shekuj përpara nga pikëpamja e marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore (pavarësisht se forcat prodhuuese janë akoma relativisht prapa nga ana teknike), nga baza ideologjike, politike

---

<sup>1</sup> Nga frëngjishtja — më të zbutura:

dhe organizative e Partisë dhe e shtetit tonë, nga baza e arsimit dhe e kulturës masive progresive.

Revolucioni ynë, pra, është një revolucion i ndritur socialist, të cilin ne çdo ditë po e thellojmë në luftë me mbeturinat obskurantiste të së kaluarës dhe me format obskurantiste, dekadente, reaksionare, borgjeze që cilësohen si «përparim modern».

Pra, me thellimin e revolucionit tonë në dy drejtimet që përmenda më lart, ne duhet të kuptojmë thellë, të interpretojmë drejt, ideologjikisht dhe politikisht, fenomenet dhe ndodhitë që nxjerr në të gjitha fushat revolucioni ynë proletar.

Të mos harrojmë kurrë se ndryshimet e mëdha ekonomike në vçndin tonë, revolucionarizimi i çdo gjëje te ne, ndeshin në të vjetrën regresive, ndeshin edhe në presionin e reaksionit të jashtëm, në ndikimin e mënyrës së jetesës, gjoja moderne, që përfaqësohet në shitjet, në kulturë, në art, në veshje etj., etj.

Kur themi revolucionarizim i mëtejshëm i vendit tonë, i ndërgjegjes së njerëzve tanë, duhet të kuptojmë përblysjen e shumë zakoneve, mënyrave, normave të jetesës dhe zëvendësimin e tyre me zakone, mënyra e norma të reja jetese. Prandaj 100 pyetjet e shokëve të Beratit, që i përmenda më lart dhe një mijë e dhjetëra mijëra pyetje të tjera që do të na bëhen, nuk duhet t'i quajmë as të rastit, as të bëra me frymë opozicionale, kundër revolucionarizmit. Jo, ato janë kërkesa të gjetjes së normave të reja të jetesës për të zëvendësuar të vjetrat që po shkallmojmë. Ky është një problem i ri i madh shoqëror që duhet të shoqërojë materializmin e idesë revolucionare të Partisë. Këto pyetje

janë pozitive, janë në rendin e ditës. Prandaj t'u përgjigjesh atyre, ka rëndësi të jashtëzakonshme, pse neve na vihet detyrë serioze të zhvillojmë zakonet e mira, të luftojmë të këqijat dhe të vendosim zakone të reja socialiste, mënyrën socialiste të jetesës.

Ligjet socialiste, me të cilat nc rregullojmë jetën materiale dhe shpirtërore të popullit, gjatë zbatimit të tyre kthehen në shprehi, në jetë, bëhen zakone. Përveç këtyre, në marrëdhëniet e njerëzve, në familje, në shoqëri, lindin zakone të reja, lindin norma të reja jetese. Këto zakone pleksen dhe zhvillohen në rrugë të drejtë, kur ideologjikisht dhe politikisht punohet mirë dhe intensivisht nga ana e Partisë dhe, përkundrazi, ato marrin rrugë të shtrembër, kur Partia nuk punon si duhet.

Të marrim disa shembuj konkretë nga realiteti ynë. Partia kurdoherë ka rekomanduar të bëhet luftë kundër fesë, por në këtë drejtim është bërë pak. Çfarë ndodhte? Ndërsa ekonomia socialiste forcohej dhe ngrihej mirëqenia e njerëzve, kishat dhe xhamitë vazhdonin të frekuentohen. Përse ngjiste kjo dhe në një kohë që prona socialiste po forcohej? Sepse Partia, në fakt, nuk punonte gati fare në këtë drejtim kryesor të luftës.

Mund të biem prapë në gabime, po të mendojmë se tani xhamitë dhe kishat i prishëm, hoxhallarët dhe priftërinjtë rruan mjekrat dhe kjo punë mori fund. Po të mendojmë kështu dhe të kënaqemi vetëm pse zhdukëm mjetet, harrojmë që kjo që bëmë është vetëm alfa. Përpara është akoma më e madhja për të bërë, është për t'u bërë lufta shkencore kundër dogmës fetare,

luftha kundër fesë, e pleksur kjo me praktikën e ndodhiva në jetë.

Të marrim një fenomen shumë të hollë shoqëror, çështjen e gruas. Në këtë çështje ne po bëjmë përparrime. Gruaja në shoqërinë tonë socialiste gjithë tē gjitha tē drejtat, ajo ka fituar liritë demokratike, është çliruar dhe vazhdimisht po çlirohet ekonomikisht, ka fituar tē drejtën e divorcit etj., ctj.

Po ç'ngjet në jetë? Në përgjithësi gruaja paraqitet më e lidhur me burrin, por kur e reja martohet, me gjithëse i gjzon tē gjitha tē drejtat dhe liritë, vëmë re se ajo tregohet shumë më toleruese ndaj burrit sesa ky ndaj gruas. Këtu ne japim tē gjitha arsyet përsë ndodh një gjë e tillë, por harrojmë një arsy, një zakon, një traditë, atë që gruaja ka frikë nga divorce edhe për arsy se, po e ndau burri, ajo hyn automatisht në atë kategori grash që me zor gjejnë burrë përt'u rimartuar, osc nuk gjejnë dot fare, kurse burri gjen grua më lehtë, bile ai synon nö tē reja. Kjo është një nga arsyet e shumta, por tē rëndësishme, që gruaja, pa e ditur, pa e ndier, pa e arsyetuar, i nënshtrohet kësaj peshe që nuk është e shkruar gjékund, por që është shumë e zorshme përt ta zhdukur dhe për këtë duhet punuar.

Si këto ka shumë probleme shoqërore, shokë. Këto janë probleme serioze, tē cilat nuk na lejohet jo vetëm t'i lëmë pas dore, por as edhe t'i trajtojmë përciptas dhe lehtë. Neve çdo ditë e çdo orë na vihet përpara detyra t'i zgjidhim këto probleme tē jetës dhe ka shumë rëndësi çfarë zgjidhje do t'u japim. Nga një zgjdhje e drejtë vendoset sigurisht një zakon, një normë

e drejtë socialiste, kurse nga një zgjidhje e gabuar vendoset një zakon dhe një normë e gabuar.

Prandaj, shokë, duhet të bëjmë përpjekje për t'u ngritur vetë ideologjikisht që të mundim të ngremë pastaj Partinë dhe popullin dhe që revolucioni ynë të përparojë e të mos dalë kurrë nga binarët e marksizëm-lenismit. Ne duhet, gjithashtu, t'i vëmë rëndësi të madhe forcimit organizativ të Partisë.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1967-1968»,  
f. 81*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë  
nga procesverbali i mbledhjes  
së Sekretariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# ORGANIZIMI DHE ZBATIMI I PUNËS ME NORMA KOLEKTIVE SIGUROHET KRAHAS NGRITJES SË NDËRGJEGJES SË PUNONJËSVE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

22 prill 1967

Për zbatimin e këtyre formave të reja të normimit të punës mendoj se duhet ecur me kujdes të madh. Ashtu siç u tha edhe këtu, për këtë çështje të vendosim mbi bazën e një studimi të gjith-anshëm. Parimet t'i ruajmë, por edhe të mos shpejtohem i të mos vendosim për këtë problem pa u konsultuar mirë me punëtorët. Pasi lexova një material, që më pat dërguar para ca kohësh shoku Spiro<sup>2</sup>, më lindën disa pyetje. Organizimi i punës duhej t'i shërbëjë interesit të përgjithshëm të shoqërisë sonë sociale, në radhë të parë realizimit të planeve dhe të rendimentit në prodhim. Ai luan një rol të madh ven-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi disa probleme të organizimit socialist të punës dhe të pagave».

2 Spiro Koleka, në atë kohë kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit.

dimtar në këtë drejtim, prandaj të gjitha këto forma organizimi për të cilat diskutojmë, duhet të sjellin si përfundim ngritjen e rendimentit.

Me vënien në zbatim të masave që propozohen, ne mund të pranojmë që rendimenti, përkohësisht, në disa sektorë të ulet pak, po pas një periudhe është e domosdoshme që ai të ngrihet patjetër në një nivel më të lartë, se ndryshe masat që marrim nuk kanë asnjë kuptim. Duke pranuar dhe duke vënë në zbatim këto forma, në asnjë mënyrë mos ta taprojmë apo ta zvogëlojmë domosdoshmérinë e punës politike për ngritjen e ndërgjegjes së njerëzve, e cila nuk arrihet në një vit, po kërkon një veprimitari të madhe e të vazhdueshme. Te ne vihet re disa herë një zakon i keq: me t'u vendosur një formë e re pune, mendohet se gjithçka mbaron, zgjidhet, pra, priten vetëm rezultate dhe puna politike që duhet bërë vazhdimisht, bëhet dobët ose harrohet. Kështu, kur diskutohet çështja e formave të normimit, thuhet se nga zbatimi i tyre rendimenti do të ngrihet, por në fakt ndodh që, për mungesë të organizimit të mirë të punës politike, rendimenti, në vend që të rritet, vazhdon të ulet dhe prodhimi të mos realizohet ose të dalë me cilësi të dobët.

Është e rëndësishme të kuptohet që norma individuale qëndron në bazë të të gjithë procesit të normimit. Kjo normë është një rregulator për të gjitha llojet e normave që po diskutojmë dhe nuk i ka kaluar koha, siç mendohet nga ndonjë shok dhe siç thuhet edhe në material. Kur themi që norma individuale ekziston dhe shërben njëkohësisht si rregulator, kjo do

të thotë se edhe normat kolektive, atje ku mund të zbatohen, duhet të bazohen në ato individuale dhe të mbajnë parasysh nivelin e kualifikimit të secilit. Gjithashtu në këto raste kërkohet edhe një organizim sa më i mirë e i përsosur i punës.

Kjo çështje, me sa duket, nuk është kuptuar drejt edhe nga të gjithë punonjësit, përderisa në hyrjen e dokumentit të parë thuhet se normave individuale u paska kaluar koha. Vendosja e normave kolektive, organizimi e zbatimi i tyre varet nga proceset konkrete të punës. Gjithashtu, vendosja dhe zbatimi i normave kolektive është e lidhur ngushtë me ngritjen e ndërgjegjes së punonjësve. Prandaj edhe puna politike, ideologjike etj. duhet të perfektionohen, ashtu siç kërkohet të perfektionohet edhe puna teknike profesionale.

Lidhur me normat, është edhe çështja e shpërblijinit sipas vendit ose kategorisë së punës. Unë jam dakord që kjo të studohet. Një vend pune që kërkon kualifikim më të lartë, duhet ta shtyjë punëtorin të kualifikohet për t'u ngritur në kategorinë që ka vendi i tij i punës. Sot kur ka mungesë punëtorësh të kualifikuar, një punëtor i kategorisë së tretë, fjala vjen, mund të hajë bukë edhe në një vend të kategorisë së shtatë, po nesër, po të mos bëjë përpjekje të ngrihet do të vijë një tjetër me kategori më të lartë që do t'ia zërë vendin. Pra, një punëtor i tillë ta ketë të qartë se atë vend që ka sot, nuk e ka përfjetë, pse, pa dhënë provën e kualifikimit, nesër mund të hiqet andej.

Për kategorizimin e punëtorëve të mbështetemi, në radhë të parë, në llojin dhe cilësinë e prodhimeve

të nxjerra prej tyre. Kjo do të thotë që, kur një punëtor e bën një artikull në mënyrë të perfeksionuar, ai e meriton të ketë kategorinë që i përket këtij niveli kualifikimi dhe nxjerrja nga ana e tij e prodhimit të cilësisë që kërkon kategoria eshtë provimi më i mirë që dëshmon se ai e meriton të ketë atë kategori. Në qoftë se nuk veprohet kështu dhe një punëtori të tillë nuk i jepet kategoria përkatëse, kjo tregon se në këtë rast provimi eshtë zhvilluar në mënyrë burokratike. Provimi ka qëllim t'i nxitë njerëzit të kualifikohen, të ngrihen teorikisht dhe të fitojnë aftësi në punë. Në qoftë se punëtori nuk bën përpjekje dhe nuk përgatitet të japë provimin, ai do të qëndrojë atje ku eshtë, bile mund të zgresë edhe më poshtë. Por kur bën përpara dhe e rrit cilësinë e prodhimit, kjo do të thotë se eshtë kualifikuar, pra, meriton të ngrihet edhe në kategori.

Shpërblimin e punës mund të vazhdojmë ta bëjmë mbi bazën e kategorisë personale, po mund edhe të mos e bëjmë, po të kemi parasysh që edhe cilësia eshtë kualifikim. Po ta bëjmë kontrollin e cilësisë si gjer tani, duhet t'i mbajmë të dyja, por unë mendoj që kontrolli i cilësisë të bëhet me rreptësi të jashtë-zakonshme. Kur përfundon puna, për shembull, për prodhimin e një detali, që të vlerësohet mirë cilësia e punës, duhet të dihet punëtori që e ka prodhuar atë, se ndodh që dy punëtorë të kategorive të ndryshme të punojnë në një vend pune. Në qoftë se njëri nga këta, fjala vjen, ka kategorinë e shtatë dhe tjetri të tretën dhe i pari e nxjerr prodhimin të cilësisë më të mirë, gjë që duhet të dihet nga ndërmarrja, atëherë

do parë që puna e bërë këtij t'i paguhet më shumë, kurse të dytit t'i ulet paga. Ndryshe ç'kuptim ka që ngulim këmbë në çështjen e kualifikimit të punëtorëve dhe në organizimin e kontrollit të cilësisë? Është e qartë se punëtori i kategorisë së shtatë bën punë ose nxjerr prodhim të cilësisë më të mirë nga të atij që është i kategorisë së tretë dhe punon në vendin që kërkon punëtor të kategorisë së shtatë. Si rrjedhim, është e domosdoshme që puna e cilësisë më të lartë të shpërblehet më mirë. Kjo është në interes të prodhimit, prandaj gjatë ndarjes së shpërblimeve, krahas sasisë, e cila gjithashtu duhet llogaritur me kujdes, të mbahet parasysh edhe cilësia.

Cdo ndërmarrje e ka për detyrë të përpinqet t'i kualifikojë punëtorët e kategorive më të ulëta dhe sidomos ata që punojnë në vende që kërkojnë kualifikim më të lartë, për t'i ngritur në nivelin e kualifikimit të kategorive më të larta dhe njëkohësisht t'i edukojë, t'i sqarojë, t'u tërheqë vëmendjen, t'i kritikojë etj., pra t'i ngrejë politikisht dhe ideologjikisht, se këto punë janë të lidhura me njëra-tjetrën. Norma kolektive, atje ku mund të zbatohet, të çojë në rritjen e prodhimit në sasi dhe në cilësi, duke pasur kurdoherë parasysh si bazë normën individuale në prizmin e nxitjes individuale. Për këtë qëllim, në fund, në ndarjen e të ardhurave nga brigada, duhen mbajtur mirë parasysh diferençat e çdo punëtori në kualifikimin e tyre, në sasinë dhe cilësinë e punës. Kjo të bëhet me kujdes dhe të mos ngatérrohet me gjendjen shëndetësore të punëtorit, me numrin e fëmijëve që ka në ngarkim etj. Të jemi të rreptë në llogaritjen e punës së secilit

dhe të mos bëjmë lëshime, duke i justifikuar me gjithfarë arsyetimesh. Shpërblimi të bëhet sipas sasisë dhe cilësisë së punës, ndryshe, po u shkel ky parim, do të na krijohet te punëtorët një pasiguri që është shumë e dëmshme. Shpërblimi për punën llogaritet matematikisht në bazë të rregullave socialiste të përcaktuara që duhen zbatuar pa bërë lëshime. Është tjetër punë çfarë mund të bëjë Partia jashtë shpërblimit të punës për t'i ardhur njërit ose tjetrit në ndihmë, se është i sëmurë ose i ka dalë diçka e papritur. Këto janë çështje me rëndësi që nuk duhen konfonduar. Të kemi shumë kujdes kur konsultohemi me njerëzit dhe marrim të tilla vendime, se në këto raste mund të ngrihet në mbledhje një element dhe të lëshon si «bombë» një propozim «të guximshëm» ose «tepër të avancuar», atë e mbështet një tjetër dhe një i tretë dhe kështu propozimi i papeshuar mirë bëhet vendim.

T'i mësojmë njerëzit të mos kenë frikë të shfaqin mendime, të diskutojnë lirisht rrëth problemeve. Këtë ta inkurajojmë se nuk ndodh gjithmonë kështu. Në një shkollë u bë një mbledhje rinie për një vajzë, anëtarë e udhëheqjes së organizatës, që kishte kopjuar. Disa propozonin të përjashtohej nga komiteti i rinisë, disa e kundërshtonin këtë propozim. Udhëheqja e organizatës, për shkak se u elektrizua gjendja, u tremb, i mbylli diskutimet për atë ditë dhe e shtyu mbledhjen për më vonë. Po ç'të keqe pati që u shfaqën atje mendime të kundërtë? Ne duam që mbledhjet të elektrizohen, mendimet në to të rrihen mbarë e prapë dhe të mos vendoset gjoja me unanimitet vetëm se thotë njëri e tjetri.

Për stimujt që propozohen, në përgjithësi jam dakord. Disa propozime që u bënë, mendoj që, pasi t'i shqyrtojmë, t'ia lëmë Qeverisë në kompetencë të vendosë konkretisht.

Jam dakord me propozimin për shkurtimin e pagave të punonjësve të administratës dhe që shkurtimet që bëhen nga rrogat 1 200 lekë e lart.

Tani këto masa duhen shpjeguar nga Partia politikisht dhe ideologjikisht, që të gjithë punonjësit t'i kuptojnë mirë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## PUNA E PARTISË DUKET KONKRETISHT NË REZULTATET

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

22 prill 1967

Qëllimi, për të cilin i caktuam ekipit të Komitetit Qendror të na raportonte si punon organizata e Partisë në ushtri, më duket është arritur. Raporti na e plotësoi mendimin që kishim.

Mendoj se në ushtri eksperiencia e punës së komiteteve të Partisë është akoma e paktë. Vetëm një vit kanë organizatat-bazë dhe sidomos komitetet e Partisë në ushtri që po luftojnë për zbatimin e detyrave që caktoi Plenumi i 16-të i KQ<sup>2</sup> për punën politike e ideologjike të Partisë, në ushtri. Prandaj, është e na-

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit për disa probleme të punës së Partisë në dy njësi ushtarake.

2 Plenumi i 16-të i KQ të PPSH që u mbajt më 4 mars 1966 diskutoi e mori vendime edhe për disa çështje të forcimit e të kalitjes së mëtejshme të Ushtrisë Popullore. Në këtë plenum u vendosën heqja e gradave dhe rivendosja e funksionit të komisarit politik në ushtri.

tyrshme që në punën e tyre ka akoma dhe përsëri do të ketë të meta, ashtu siç ka edhe në komitetet e Partisë të terrenit, që kanë një eksperiencë më të madhe nga komitetet e Partisë në ushtri.

Raporti që na u paraqit ishte i mirë, objektiv dhe instruktiv, si për ne dhe për ushtrinë dhe, në mënyrë të posaçme, për të dy repartet e mëdha ku shkoi ekipi. S'ka dyshim se shokët e ekipit kanë bashkëpunuar me shokët drejtues të Partisë në ushtri, të cilët morën një mësim të mirë, që i armatosi jo vetëm për të na informuar ne, po do t'u vlejë edhe për punën.

Niveli i raportit na tregon se bashkëpunimi i ngushtë midis shokëve të ekipit dhe atyre të ushtrisë ka dhënë fryte të mira, ashtu sikurse mund dhe duhet të japë vazhdimit puna që bëjnë shokët instruktorë të Komitetit Qendror. Ata, kur venë në rrethe, edhe pa pasur rekomandime të veçanta, nuk duhet të lënë pa parë një repart ose një komitet partie, një njësi ose repart, pa vajtur nö ndonjë organizatë-bazë partie, pa biseduar me shokët e ushtrisë, me të cilët bashkërisht të shikojnë si venë punët dhe të diskutojnë për ecjen e tyre më përpara. Edhe këtë detyrë ne duhet t'ua ngarkojmë shokëve instruktorë.

Konkluzionet që ka nxjerrë ekipi dhe diskutimet e shokëve mendoj t'i jepen ushtrisë në formën e një vendimi për ta pasur si udhëheqje për punë. Ky vendim të formulohet në mënyrë që të jetë orientues për punën e organizatave të Partisë në ushtri, të cilat do të punojnë në bazë të tij. Gjithashtu të kihet kujdes që në vendim të mos ketë «receta» e shprehje kategorike.

Kam besim se vendimi që po marrim, do ta ndihmojë organizatën e Partisë në ushtri. Të gjithë jemi të një mendimi që në ushtri kemi pasur rezultate, të cilat, natyrisht, do të ishin më të mëdha pas gjithë këtyre masave që morëm një vit më parë dhe hovit të madh revolucionar që ka shpërthyer në të gjithë vendin. Në sukseset e arritura gjatë këtij viti në ushtri, ne shohim konkretisht rezultatet e punës politike të gjallë, revolucionare të Partisë.

Me gjithë shembujt pozitivë, shumë shokë ish-ushtarakë, që tani janë kthyer në punëtorë politikë, gjejnë akoma vështirësi në punë. Por, me një punë më të organizuar, këta shokë, brenda një kohe të shkurtër, mund të bëhen komisarë politikë të përsosur, prandaj duhet punuar me kujdes në këtë drejtim. Megjithatë, vështirësitë kryesore edhe këta shokë i kanë kapërcyer.

Të kemi parasysh që, në të ardhmen, shumë nga oficerët e rinj t'i drejtojmë në rrugën e punëtorit politik, të shohim pastaj se ç'mund të bëjmë edhe me ata që do të dalin oficerë nga Shkolla e Bashkuar dhe që mendojmë t'i destinojmë për komisarë. Këta, them unë, ose t'i dërgojmë në Shkollën e Partisë, ose t'u bëjmë ndonjë kurs të veçantë politik që t'i përgatitim për këtë punë, ose të përdorim ndonjë formë tjetër që do të gjykohet më e përshtatshme.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## C'TREGOI MBLEDHJA E RENEGATEVE NË KARLOVI-VARI

*Artikull i botuar në gazeten «Zëri i popullit»*

5 maj 1967

Në artikullin që gazeta jonë botoi më 13 prill në lidhje me mbledhjen e Karlovi-Varit të partive revizioniste të Evropës<sup>1</sup>, theksohej se një nga objektivat kryesorë që ajo i ka caktuar vetes është mobilitimi politik e ideologjik i popujve të Evropës, për të braktisur luftën revolucionare kundër kapitalizmit evropian dhe botëror, për të braktisur luftën kundër imperializmit amerikan, për të konsoliduar politikisht dhe ekonomikisht borgjezinë e vjetër e të re evropiane, për t'i hequr kësaj frikën nga revolucioni, për të konsoliduar pajtimin klasor, bashkekzistencën paqësore, politikën ekonomike e ideologjike borgjeze. Vlerësimet dhe parashikimet e PPSH u vërtetuan plotësisht.

Dokumenti «Për paqe dhe sigurim në Evropë», që aprovuan revizionistët në përfundim të mbledhjes

---

1 Shih në këtë vëllim f. 243.

së tyre tradhtare, është një thirrje e dëshpëruar përlëmoshë drejtuar imperialistëve amerikanë dhe borgjezisë reaksionare evropiane. Ai zbulon hapur përrapa gjithë opinionit publik botëror degjenerimin dhe kapitullimin e plotë të revisionistëve hrushovianë përrapa borgjezisë dhe forcave të tjera reaksionare, shndërrimin e tyre përfundimtar në një grumbullim socialreformist, që është vënë kokë e këmbë në shërbim të sistemit kapitalist dhe të kundërrevolucionit. Me lot në sy dhe me një pérulje prej skllavi, ata u luten borgjezisë së madhe evropiane, monopoleve të plotfuqishme dhe dinjitarëve të lartë të kishave, kreëreve socialdemokratë dhe të sindikatave të verdha, sundimtarëve të Evropës Perëndimore e reaksionit të pranojnë thirrjen e tyre për integrim dhe t'i pranojnë «delet e humbura» revisioniste në gjirin e tyre.

«Paqe me çdo kusht» midis socializmit dhe kapitalizmit, midis të shtypurve dhe shtypësve, midis revolucionit dhe kundërrevolucionit, midis kolonive dhe metropoleve, midis viktimate dhe agresionit imperialist — ja cili është lajtmotivi që përshkon dokumentin përfundimtar të mbledhjes së Karlovi-Varit dhe fjalimet që udhëheqësit revisionistë mbajtën aty. Nën këtë thirrje revisioniste nuk do ta kishin shumë vështirë të vinin nënshkrimin e tyre kardinalët e Vatikanit, partizanët e Evropës së kombeve dhe integralistët fanatikë të Jozef Shtrausit, parlamentarët e Strasburgut dhe shoqatat e reja monopoliste të Tregut të Përbashkët.

Dëshirën e tyre të papërbajtur për t'u integruar

në koncertin kapitalist evropian revizionistët deshën ta maskojnë me parullën bajate të «sigurimit evropian». Por kësaj manovre tanimë i ka dalë boja dhe nuk bind dot njeri. Nga kush kërkojnë ta sigurojnë Evropën revizionistët evropianë? Në mënyrë mjaft demagogjike e banale ata bëjnë shumë zhurmë dhe flasin për rrezikun e militarizmit dhe të revanshizmit gjerman. Por, ndërsa daullet e propagandës së tyre po shqyhen, ne shohim se udhëheqësit revizionistë janë vënë në një garë të ethshme kush të lidhë më parë marrëdhënie të gjithashme me Bonin, kush të marrë më shumë kredi, të rivendosë miqësitë e prishura dhe të harrojë të kaluarën. Vetë Brezhnev, gjatë fjalimit të tij në Karlovi-Vari, tha: «Nga ana jonë, ne e kemi deklaruar jo një herë dhe e deklarojmë përsëri: Bashkimi Sovjetik nuk është kundër përmirësimit të marrëdhënieve me Republikën Federale Gjermane dhe është gati të bëjë për këtë gjithçka është e nevojshme». E vetmja pengesë në këtë rrugë të re, tani për tani, është nxitimi i koalicionit të madh Kissinger-Brand, që nuk ka durim të presë evolucionin e plotë revizionist, por kërkon të kalojë sa më parë në portat e Brandenburgut në Berlin dhe të dalë menjëherë matanë brigjeve të Oder-Najses.

Udhëheqësit revizionistë në Karlovi-Vari kërkuant unitet me të gjithë borgjezinë evropiane e botërore gjoja kundër politikës militariste e revanshiste të Republikës Federale Gjermane. Por bëhet pyetja: Mos vallë vetëm RFGJ e kërcënoka paqen dhe borgjezia reaksionare botërore nuk e kërcënoka atë? Por e tillë është «logjika» e revizionistëve, e tillë është

tradhtia e tyre e përbindshme. Ata janë larguar jo vetëm nga pozitat klasore të marksizëm-leninizmit, që e kanë tradhtuar, por atyre u ka humbur edhe ai «dinjitet» i borgjezisë kapitaliste, që jeton me ligjin e xhunglës. Revisionistët blegërijnë, si berrat në kopjenë e ujqve. «Lufta» e revisionistëve kundër Republikës Federale Gjermane është fund e krye një blof, që kërkon të térheqë vëmendjen nga tradhtia dhe kursi i vërtetë i politikës së tyre të jashtme, që është vija e baškëpunimit me imperializmin amerikan dhe borgjezinë reaksionare të të gjithë botës, kundër klassës punëtore, lëvizjes komuniste dhe luftës çlirimtare të popujve.

Në deklaratën e tyre revisionistët flasin për shqetësimin që gjoja u shkakton «depërtimi gjithmonë e më i madh i kapitalit amerikan në Evropë». Sa qesharakë! Revisionistët hrushovianë vetë po i hapin dyert e tyre për hyrjen e kapitalit amerikan. Monopoli i evropiane, që po investojnë tani kapitalet e tyre në Bashkimin Sovjetik, finançoohen me autorizimin e qeverisë së SHBA-së drejtpërsëdrejti nga bankat e mëdha amerikane. Dihet, për shembull, se shuma prej disa qindra milionë dollarësh që «Fiat» italian do të përdorë për ndërtimin e uzinës së automobilave në Bashkimin Sovjetik, do të mbulohet nga kredia që atij i ka çelur banka amerikane e «Eksport-Importit». Edhe monopoli e tjera evropiane, që drejtojnë kapitalet e tyre në vendet revisioniste, janë të lidhura shumë ngushtë me ato amerikane, në mos qofshin, në shumicën e rasteve, filiale të tyre. Kapitalet e monopoleve perëndimore, që po hyjnë tani në Bashkimin

Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste, mund të jenë në lireta apo në franga, në sterlina apo në marka, por të gjitha paguhen në Nju-Jork në bankat e Uoll Stritit.

Aleanca me imperializmin amerikan, vija e bashkëpunimit amerikano-sovjetik përbëjnë sot gurin themeltar të politikës së jashtme të revizionistëve hrushovianë. Kohët e fundit, Bashkimi Sovjetik ka përfunduar një varg marrëveshjesh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe tani janë duke i dhënë fund së bashku në Gjenevë hartimit të projekttraktatit mbi mospërhapjen e armëve bërthamore. Ndërkaq, me një përzemërsi të madhe, përfaqësuesit e të dyja palëve po bisedojnë në Moskë mbi ndalimin e prodhimit të raketave antiraketa të mbrojtjes. Xhonsoni po kërkon me këmbëngulje nga Senati i tij që të heqë çdo kufizim në tregtinë me Bashkimin Sovjetik dhe revizionistët hrushovianë po u bëjnë elozhe të mëdha marrëdhënieve të përzemërtë sovjeto-amerikane.

Për sa i përket NATO-s, revizionistët deklarojnë se ajo ka pësuar «ndryshime», se nuk përbën më ndonjë rrezik etj. Si dëshmi të kësaj bindjeje, ata përpiken të likuidojnë Traktatin e Varshavës dhe u luten partnerëve të Blokut të Atlantikut të ndjekin shembullin e tyre.

Ata me fjalë thonë «Evropa për evropianët», parullë kjo antisocialiste dhe antiinternacionaliste, por, në fakt, duan dhe punojnë që Amerika të ketë rrjetin e vet të merimangës në Evropë. Me fjalë ata thonë se «Shtetet e Bashkuara të Amerikës formojnë një rrezik», por në realitet ata janë alcati i tyre, siç është

Republika Federale Gjermane, që gjoja e marrin në shenjë, por me të cilën kanë lidhje dhe paskëtaj do t'i kenë akoma më të ngushta, pavarësisht nga deklarata e Karlovi-Varit.

Por «kritika» ndaj penetrimit të kapitalit amerikan në Evropë synon gjetiu. Me këtë parullë revisionistët kërkojnë ta largojnë vëmendjen dhe t'u fshehin popujve të tyre depërtimin e kapitalit evropian në vendet revisioniste, të minimizojnë rrezikshmërinë e këtij të fundit.

Deklarata e Karlovi-Varit u thotë kapitalistëve evropianë, «atyre grupeve borgjeze, që mbajnë një qëndrim realist ndaj realitetit të sotëm», domethënë ndaj faktit real të restaurimit të kapitalizmit në BS dhe në vendet e tjera të Lindjes, se integrimi i ekonomisë revisioniste me Perëndimin do të bëhet mbi baza realiste, nënshtuese, në kushtet që do të duan në Londër, Paris apo Bon. Me një fjalë, revisionistët hrushovianë po u thonë atyre hapur se «ne po ju heqim çdo frikë që mund t'ju ketë mbetur, çdo dyshimi në lidhje me vendosmërinë tonë për restaurimin e kapitalizmit dhe integrimin e socializmit në kapitalizëm». Zaten qëllimi i vërtetë i deklaratës konsiston në atë që ta bindë kapitalizmin botëror se revisionistët modernë nuk janë më komunistë. Këtë vërtetim e jep deklarata dhe kjo, në gjuhën e tyre, është një kambial i firmuar nga tradhtarët e marksizëm-leninizmit, të socializmit e të revolucionit, që u mblodhën në Karlovi-Vari.

Në të vërtetë, çështja e «sigurimit evropian», ashtu siç e konceptojnë dhe po mundohen ta reali-

zojnë revisionistët hruščovianë, është një tjetër kaptullim i tyre, një tjetër komplot revizionisto-imperialist, i cili ka për qëllim zhdukjen nga faqja e dheut të socializmit e të komunizmit, ruajtjen dhe garantimin e sistemit kapitalist. Nuk është e rastit që propaganda dhe diplomacia revizioniste i intensifikuan përpjekjet e tyre për «sigurimin evropian» pikërisht në këtë kohë kur po realizohen reformat ekonomike në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të Evropës Lindore. «Sigurimi evropian» dhe «bashkëpunimi evropian» janë parulla të zgjedhura me kujdes nga revisionistët, si mjet për të justifikuar e për të nxitur si restaurimin e kapitalizmit në vendin e tyre, ashtu edhe pasojën e tij të pashmangshme, integrimin në ekonominë e vjetër borgjeze të Evropës.

Këtë politikë tradhtare, udhëheqësit revizionistë të Bashkimit Sovjetik e të vendeve të tjera u munduan ta bekijnë e ta miratojnë edhe me vulën e një mbledhjeje «komuniste» ndërkombëtare. «Likuidimi i pengesave të krijuara artificialisht në marrëdhëniet ekonomike midis vendeve socialiste dhe kapitaliste të Evropës, — thuhet në dokumentin e Karlovi-Varit, — do të favorizonte vendosjen e bashkëpunimit të fryshtëshmë, që do të përfshinte marrëveshje të gjera në fushën e prodhimit dhe të kërkimeve shkencore».

Çertifikatën e morën, tani mund të vrapijnë përpara. Dhe me të vërtetë, kur ato që i ndajnë vendet revizioniste nga vendet kapitaliste janë të gjitha artificiale, kur midis tyre nuk ka mbetur më asnje dallim esencial, klasor, parimor, kur vijat e demarkacionit janë zhdukur prej kohësh, ç'mund ta pengojë inte-

grimin e socializmit revizionist në kapitalizëm, aq shumë të propaganduar nga Titoja dhe aq shumë të dëshiruar nga Hrushovi? Klika Brezhnjev-Kosigin etj. u tregua plotësisht nxënëse e denjë e tyre. Ajo po e realizon hapur integrimin, që vetëm përpara pak vjetëve ishte paraqitur si një shpresë e largët e revolucionistëve më ekstremistë.

Shumë karakteristik është fakti që deklarata e Karlovi-Varit s'ka asnjë thirrje, qoftë edhe demagogjike, për luftë revolucionare të punonjësve kundër zgjedhës dhe shfrytëzimit kapitalist, për të drejtat dhe liritë e tyre demokratike. Edhe atëherë kur autorët e deklaratës u drejtohen punonjësve, ajo kufizohet në kërkesa të zakonshme ekonomike, reformiste të karakterit socialdemokrat «për ruajtjen e paqes dhe kryerjen e transformimeve shoqërore demokratike», «për një Evropë paqësore», «për paqe e drejtësi shoqërore», «për liri dhe përparim», «për miqësinë e popujve» etj. Asgjë për rezistencë, por vetëm nënshtrim ndaj zgjedhës e monopoleve borgjeze, bashkëpunim dhe nënshtrim klasor, bindje ndaj rendit kapitalist dhe «paqe me të gjithë». Çdo gjë lutje. Lutje «partive socialistë dhe socialdemokrate, që kanë një ndikim të gjerë në klasën punëtore evropiane dhe marrin pjesë në qeveritë e disa shteteve të Evropës», lutje «forcave kristiane, katolikëve dhe protestantëve, besimtarëve të të gjitha feve», lutje «grupeve borgjeze». Kot nuk e lëshoi papa Pavli i 6-të enciklikën e vet të fundit, të cilën shumë oratorë në Karlovi-Vari e ngriten në qiell dhe i bënë homazhe të zjarrta. Deklarata e revisionistëve hrushovianë ishte një

kopje besnike e enciklikës papale. E njëjta kambanë po bie: «Kapitalizmi është në rrezik, duhet të bashkohemi që ta shpëtojmë, t'ia zgjatim jetën».

Në mënyrë kaq të paturpshme, kaq hapur dhe me kaq cinizëin, siç po bëjnë revisionistët hrushovianë, nuk patën folur as socialshovinistët e Internacionales së Dytë, që i luftoi Lenini. Tani ata kërkojnë t'u mbushin mendjen të tjerëve se në botën e sotme ekziston vetëm Evropa, se problemet e saj janë çështjet më të mëdha e më të rënda të marrëdhënieve të sotme ndërkombëtare, se fatet e gjithë popujve vendosen e zgjidhen këtu. Për sa u përket Shteteve të Bashkuara të Amerikës, atyre u lihet dorë e lirë të veprojnë si të duan në të gjitha zonat e tjera. Duke hedhur në tryezat e bisedimeve dhe të pazarllëqeve ndërkombëtare «çështjen evropiane», revisionistët hrushovianë synojnë në një objektiv mjaft të qartë dhe të përcaktuar mirë. Ata kërkojnë t'u sigurojnë imperialistëve amerikanë qetësinë në Evropë, me shpresë se kështu do të ndërtojnë një bazë tjetër për zbatimin praktik të bashkëpunimit sovjeto-amerikan për ndarjen e sferave të influencës midis dy fuqive të mëdha dhe të krijojnë mundësi të reja për ta drejtuar sulmine potencialit të tyre ushtarak e politik drejt Azisë. Shtypi perëndimor ka mjaft kohë që vazhdon të njoftojë se mjaft divizione ushtarake amerikane të vendosura në Evropë, po nisen njëri pas tjetrit për në Azi. Dhe sado zhurmë që të bëjnë revisionistët për Vietnamin, një gjë duket fare qartë: profkat e tyre për sigurimin evropian kanë një qëllim, të largojnë vëmendjen e botës nga lufta e Vietnamit

dhe nga lufta antiimperialiste revolucionare e popujve të tjerë.

Deklarata hipokrite, që mbledhja e Karlovi-Varit adoptoi në lidhje me Vietnamin, nuk vlen më asnë grosh. Karta e Vietnamit, me të cilën kërkonin të luanin revisionistët, tanimë është djegur.

U provua me fakte të pakundërshtueshme se udhëheqësit sovjetikë mundohen ta futin zgjidhjen e problemit vietnamez në kuadrin e bashkëpunimit sovjeto-amerikan, ta përdorin atë si një mjet në fushatën e tyre antikineze. Moska tani është bërë strofka kryesore, ku imperialistët, revisionistët dhe reaksionarë të ndryshëm nga të gjitha vendet thurin komplete kundër Vietnamit, hartojnë plane si ta mashtrojnë atë, si ta largojnë nga rruga e drejtë e luftës popullore kundër agresorit. Bile udhëheqësit sovjetikë dhe revisionistët e tjerë ndodhen në një pozitë shumë më të djathtë nga mjast senatorë amerikanë, të cilët kërkojnë nga qeveria e tyre t'i japë fund luftës në Vietnam dhe t'i tërheqë menjëherë që andej ushtarët amerikanë.

Shkallëzimi i agresionit amerikan, me dashjen ose pa dashjen e tyre, po i tërheq revisionistët në pozita më të hapura antivietnameze dhe në qëndrime më të hapura proamerikane. Prandaj, përdorimi i mëtejshëm i parullave demagogjike mbi «solidaritetin për të ndihmuar popullin e Vietnamit», mbi «unitetin e veprimit» etj. jo vetëm që nuk mund ta mbulojë dot tradhtinë e tyre ndaj popullit të Vietnamit, por do ta zbulojë atë edhe më tepër. Deri kur ose deri në çfarë grade të shkallëzimit të agresionit amerikan

udhëheqja sovjetike do të përkrahë SHBA-në dhe, nga ana tjetër, do të hiqet sikur ndihmon Vietnamin? Vjen një kohë që maskat nuk mbahen dot. Pikërisht, në këtë fazë të vajtueshme ndodhen revisionistët hru-shovianë.

Një konferencë ndërkombëtare kaq e ulët, kaq bajate, kaq monotone, kaq false, kaq e përgjithshme e pa rezultat se ajo që mbajtën revisionistët në Karlovi-Vari, as që është parë kurrë. Krerët e revizionizmit evropian, me Leonid Brezhnjevin në krye, u ngjitet njëri pas tjetrit në tribunë dhe të gjithë përsëritën të njëjtat gjëra, të ngjashme dhe pa kurrfarë shpirtoje. Dukej qartë se asnjeri nuk u besonte atyre që thuhen. Fjalimet e tyre ishin një mizanskenë për të fshehur ato që nuk i thonë dot hapur. Në tribunën e ishpallatit perandorak të Karlovi-Varit krerët revisionistë vërtet flisnin por mendjen e kishin gjetkë. Atje ata formulonin pikat bajate të deklaratës së përbashkët, por planet e vërteta secili i mbante në xhep. Sa për sy e faqe, me fjalë dhe nö kartë, dukej sikur gjoja kishte unitet, por ata ishin në luftë, në grindje dhe me lesh në bark për njëri-tjetrin. Me të vërtetë u mbars mali e polli një mi. Deklarata e tyre s'ka as gjë të re, ajo është një kompilim fjalësh për t'u bërë qejfin të gjitha grupimeve revisioniste, për të ruajtur aparençat dhe për të mos cenuar interesat ose planet e ndonjërit nga pjesëmarrësit.

Mbledhja e Karlovi-Varit nuk mundi t'i mbyllte të çarat e frontit revisionist, të forconte pozitat hegemoniste sovjetike në këtë front dhe të konsolidonte radhët e shthurura të aleatëve hrushovianë. Kontra-

diktat midis vendeve dhe partive, ku janë në fuqi revizionistët, kanë rrënë të thella, të cilat vijnë duke u thelluar gjithnjë e më shumë. Ato janë pasoja të pashmangshme të politikës shoviniste të shtetit të madh, që ndjek udhëheqja sovjetike në marrëdhëniet me vendet e tjera, nga njëra anë, dhe të vetë procesit të restaurimit të kapitalizmit në vendet socialiste të Evropës, nga ana tjetër. Udhëheqja sovjetike, natyrisht, kërkon t'i mbajë ata në fre dhe të ruajë rolin e hegemonit, por pikërisht ky «kujdes» përbën një nga faktorët që i nxit ata të kërkojnë aleanca të reja për t'u shpëtuar ndërhyrjeve sovjetike, për të pasur më tepër liri manovrimi. Udhëheqjet në fuqi në vendet ish-socialiste nuk duan më që politikën e madhe të jashtme ta bëjë Bashkimi Sovjetik dhe ata të jenë vetëm pasues të thjeshtë të tij. Me një fjalë, midis tyre janë krijuar e po krijohen tanë raporte marrëdhënie shëtë tipit krejtësisht borgjez, të ndryshueshme sipas koniunkturës së ditës dhe sipas interesave kom-bëtare të veçanta, të cilat asnë mbledhje dhe asnë operacion nuk mund t'i zgjidhë.

Në luftën kundër marksizëm-leninizmit udhëheqjet, sigurisht, janë të bashkuara, por edhe në këtë luftë secila ka interesat e saj partikulariste, secila kërkon të arrijë ata objektiva që i interesojnë vetëm asaj, të fitojë epërsi, influencë, të bëjë pazarllëqe etj. Në këtë shportë karavidhesh udhëheqja sovjetike e ka shumë të vështirë të vërë rregull, të krijojë pikëpamje e qëndrime unike, e aq më tepër që ato të jenë në përputhje të plotë me interesat dhe qëllimet e saj.

Për qëllime propagandistike dhe për të mos dalë

me duar bosh, udhëheqësit sovjetikë iu lutën pjesë-marrësve të tjerë të mbledhjes t'u adresojnë atyre ndonjë homazh e bashkë me të edhe komplimente me rastin e 50-vjetorit të Revolucionit të Totorit. Por spekulimet me lavdinë e Revolucionit të Madh Socialist dhe të shtetit të parë socialist nuk zënë më vend. Revisionistët hruščovianë e kanë tradhtuar Leninin dhe ata që 50 vjet më parë përmbyssën carizmin dhe ngritën sovjetët, kanë tradhtuar gjakun që derdhën 20 milionë sovjetikë për mbrojtjen e atdheut të tyre dhe për çlirimin e Evropës nga murtaja fashiste. S'ka asnjë dyshim se retë e zeza që kanë mbuluar sot atdheun e Revolucionit Socialist të Totorit do të shpërndahen një ditë. Idetë e mëdha e të pavdekshme të Leninit e të Stalinit, që trojnë në zemrat e njerëzve të thjeshtë sovjetikë e që janë shkruar në flamurët e betejave revolucionare të komunistëve të vërtetë të Bashkimit Sovjetik, do të triumfojnë me siguri mbi revisionizmin, që ka usurpuar me forcë udhëheqjen e partisë e të shtetit.

Mbledhjen e tyre të Karlovi-Varit revisionistët hruščovianë shpresojnë ta shfrytëzojnë për demagogji dhe mashtrime të reja. Por tanimë marksistë-leninistët dhe popujt revolucionarë i njojin mirë taktikat revisioniste dhe dinë t'i analizojnë drejt situatat dhe të bëjnë konkluzionet e nevojshme. Ata do të dinë me siguri që përpara komploteve të reja, që përgatiin revisionistët, të bashkojnë akoma më shumë radhët e tyre dhe të luftojnë akoma më me fuqi për demaskimin e revisionizmit.

Detyra e marksistë-leninistëve, e gjithë revolucion-

narëve të vërtetë, është të vendosin një vijë të qartë demarkacioni me renegatët revizionistë, të cilët, me tradhtinë dhe komplotet e tyre, e kanë vënë veten jashtë frontit antiimperialist, jashtë lëvizjes komuniste ndërkontinentare.

Forcat e sotme revolucionare, në Evropën e mbarësur me revizionizëm, të afta për të udhëhequr luftën klasore kundër imperializmit, borgjezisë dhe oportunitimit, janë marksistë-leninistët. Atyre u përket e ardhmja. Në emër të saj, të revolucionit e të socialistët, ato duhet të bashkohen dhe të luftojnë me vendosmëri kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij, revizionistëve hrushovianë.

Në pragun e Revolucionit të Madh Socialist të Tectorit Lenini u nda me guxim nga socialoportunistët russë e Internacionalja e Dytë tradhtare dhe luftoi kundër tyre me vendosmëri të madhe. Kjo masë e rëndësishme revolucionare ishte një nga kushtet themelore dhe garancitë që fitoi revolucioni. Këtë mësim të madh të historisë duhet ta mbajmë kurdoherë parasysh.

Prandaj, që të fitojë revolucioni, duhet të luftojmë me të gjitha forcat e deri në fund, me vendosmëri dhe pa asnjë ngurrim kundër revizionizmit modern, i cili përbën rrrezikun kryesor për lëvizjen komuniste ndërkontinentare.

*Botuar për herë të parë në  
gazeten «Zeri i popullit»,  
nr. 108 (5833), 5 maj 1967*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## LUFTA KUNDER IMPERIALIZMIT E REVIZIONIZMIT KËRKON FORCIMIN E UNITETIT TË MARKSISTË-LENINISTËVE

*Nga biseda me delegacionin kulturor, delegacionin e Federatës Pankineze të Bashkimeve Profesionale, si dhe me delegacionin e fotoreporterëve kinezë*

**6 maj 1967**

*Porsa mysafirët zunë vend, shoku Enver i pyeti atu se si e kaluan në vendin tonë, ç'qytete dhe objekte vizituan, nëse morën takim me masat e gjera të popullit dhe, pasi dëgjoi përshtypjet e tyre, vazhdoi:*

Ju faleminderit për fjalët e mira që thoni për Partinë dhe popullin tonë. Ardhja juaj në Shqipëri shënon një hap të rëndësishëm në kalitjen e miqësisë midis popullit shqiptar dhe popullit vëlla kinez, në mes dy partive tona. Kontaktet në mes shokëve kinezë dhe shqiptarë ndikojnë në luftën e madhe kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe kundër revizionizmit modern, me tradhtarët sovjetikë në krye. Këto kontakte kanë një rëndësi të madhe edhe për shkëmbimin e eksperiencës midis njëri-tjetrit për ndërtimin e socializmit.

Ju e patë dhe e theksuat vetë dashurinë dhe miqësinë që ushqen populli shqiptar për popullin tuaj, e patë vetë këtë realitet në vendin tonë. Kështu, të bashkuar në një miqësi të singertë, dy popujt tanë do të bëjnë që revolucioni ynë të ecë gjithnjë përparrë, duke kapërcyer të gjitha vështirësitë e zhvillimit dhe të rritjes.

Borgjezia imperialiste dhe revizioniste në formimin e aleancave të saj i vë një rëndësi të madhe akteve të nënshkruara zyrtare, nën maskën e të cilave ajo fsheh ndjenjat e egra të xhunglës. Ndërsa marksistë-leninistët nuk kanë nevojë për të tilla akte ose traktate, për arsyet se çdo gjë midis tyre brumoset, lidhet e kalitet në bazë të marksizëm-leninizmit dhe të dashurisë së madhe, të pastër e reciproke, të ndershmërisë marksiste-leniniste midis njëri-tjetrit. Në ines shteteve tona nuk ekziston ndonjë aleancë e nënshkruar zyrtarisht, megjithatë aleanca dhe miqësia jonë janë të mbështetura te popujt tanë të cilët kanë si qëllim të përbashkët ndërtimin e socializmit, në bazë të parimeve marksiste-leniniste. Një aleancë e tillë nuk ka nevojë për akte dhe traktate të nënshkruara. Diplomatët e dy shteteve tona në bisedimet midis tyre nuk bëjnë diplomaci, por ua lënë vendin bisedimeve në fryshtë marksiste-leniniste.

Partia jonë i jep një rëndësi të madhe kësaj çështjeje, sepse në marrëdhëni tona, në çdo veprim tonin ajo sheh anën kombëtare, por edhe atë ndërkombëtare. Ajo niset nga fakti se revolucioni i vërtetë proletar, në çdo vend që të kryhet, udhëhiqet nga të njëjtat ligje dhe merr kurdoherë parasysh pasojat në

të gjithë globin, si dhe nga fakti që çdo veprim yni lë gjurmën e vet edhe në luftën që bëjnë elementët revolucionarë në botë, të cilët i çmojnë veprimet tonë dhe i marrin ato si shembull. Nga ana tjetër, edhe ne, në luftën e tyre gjejmë mbështetje e përkrahje përluftën tonë, sepse ajo që bëjnë ata ndihmon çështjen tonë të përbashkët. Është për këtë arsyе që aleanca e miqësia, të ndërtuara në baza marksiste-leniniste, kanë një rëndësi të jashtëzakonshme jo vetëm për ne, por për të gjithë popujt e tjerë revolucionarë.

Imperializmi botëror dhe revizionistët modernë janë ngritur dhe me thikë në gojë po përpinqen, si bishti i gjarpërit, për të na luftuar të gjithë ne, përtë luftuar unitetin e marksistë-leninistëve dhe përtë mbajtur gjallë akoma regjimet e tyre të kalbura, që kërcënohen nga revolucioni botëror. Kjo tregon dobësinë e madhe të imperializmit e të revizionizmit modern. Është fakt se armiqtë tanë nuk mund të jenë në pozitat e trimërisë, të vendosmërisë e të guximit, siç janë marksistë-leninistët. Armiqtë tanë janë në pozita frike, pasi e ndiejnë veten të dobët, të kalbur dhe e shohin se ideologjia e tyre është diçka që povdes. Pra, ata në çdo drejtim e ndiejnë dobësinë e tyre, sepse e dinë që janë vetëm klika dhe mbajnë në zgjedhë popujt, të cilët, sot ose nesër, do të revoltohen, do të ngrenë krye dhe do të ndjekin, me siguri, rrugën revolucionare.

Veprimtaria e imperialistëve, e revizionistëve dhe e gjithë reaksionarëve është një punë e ndyrë komplotesh. Por dihet se komplotet nuk kanë jetë të gjatë. Kështu nuk pati jetë as te ju komploti i Liu

Shao Çisë me shokë, pavarësisht se puna e tyre armiqësore krijoi një numër të madh vështirësish e ka bërë dëm të madh në mjaft kuadro që kanë gabuar.

Edhe Partia jonë ka vuajtur nga veprime të shumta të elementeve antiparti, trockistë, revizionistë e të tjerë, të cilët kanë dashur ta dëmtojnë Partinë, të dëmtojnë ndërtimin e socializmit në Shqipëri etj., por ata janë demaskuar, janë skartuar e likuiduar. Disa prej tyre kanë kaluar në gjyqe dhe kanë marrë dënimin e merituar, kurse të gabuarve u është dhënë dora, shumë prej të cilëve janë ndrequr.

Rëndësi ka që këta njerëz të njojin gabimet, ndryshe ata do t'i përsëritin. Ja, për shembull, Liu Shao Çia nuk ka gabuar vetëm një herë, ai ka gabuar shumë herë dhe faktet treguan se ai është një element i pandreqshëm, prandaj dhe duhej goditur. Kur sheh se njerëz si Liu Shao Çia e mbushin kupën, kur sheh rrezikshmërinë e këtyre njerëzve që kanë uzurpuar pushtetin, patjetër që duhet të ngrihesh prapë në revolucion për të marrë pushtetin. Fitorja e revolucionit në vendin tuaj do të ishte një inkurajim i madh për popujt e botës, një inkurajim i madh për të gjithë, duke përfshirë edhe vendet ku sundojnë revizionistët, sepse revolucioni u tregon atyre rrugën që duhet të ndjekin për të rrëzuar nga pushteti klikat tradhtare revizioniste.

Ka dy-tri ditë që Mao Ce Duni na njoftoi se Kina po kalon vështirësi, por ato do të kapërcehen. Momentet, pra, janë revolucionare, shumë të favorshme për ne, prandaj kërkohet që partia juaj dhe populli kinez të çelikosin unitetin dhe të ashpërsojnë luftën

kundër imperializmit amerikan e revizionizmit modern dhe të pastrojnë brenda vendit të gjitha barërat e këqija.

Partia jonë mendon se forcimi i luftës kundër imperializmit e revizionizmit modern kërkon që të kaliten uniteti i partisë dhe i popullit, uniteti midis marksistë-leninistëve dhe gjithë revolucionarëve e popujve të botës, pasi kështu, të bashkuar, do t'i bëjmë ballë me sukses rrebeshit të egër të imperializmit e të revizionizmit modern, të cilët po komplotojnë kundër nesh dhe revolucionit botëror.

Sikurse e patë edhe vetë, kudo në Shqipëri, politika e drejtë e Partisë sonë ka bërë që revolucioni ynë proletar të ketë sukses. Ky revolucion po thellohet çdo ditë e më shumë, materialisht dhe ideologjikisht. Sikurse jeni në dijeni, ai ka bërë që gjendja e vendit tonë, në krahasim me të kaluarën, të ndryshojë krejtësisht. Prona e përbashkët socialiste tanë është një realitet konkret, ndërsa prona private me gjithë superstrukturën e saj është shkallmuar. Te njerëzit tanë po rrënjoset një psikologji e re socialiste, që po shkatërron ligjet dhe zakonet e bazuara në filozofinë idealiste, e cila ka akoma rrënje dhe reminishenca në ndërgjegjen e njerëzve.

Ajo që patë në Shqipëri, në lidhje me luftën kundër fesë, ka një rëndësi të jashtëzakonshme për vendin tonë, por edhe për të tjerët, sepse feja mbështetet në filozofinë idealiste, përkrah pronën private, kapitaliste, ndihmon klasat sunduese për të paralizuar dhe për të shtypur revolucionin e popujt dhe është për shfrytëzimin e njerëzve. Prandaj ne, në vendin

tonë, u kemi shpallur luftë deri në fund fesë, zakoneve dhe traditave fetare, të cilat lidhen me kushitet e jetës, duke synuar që ato të zhduken jo vetëm materialisht, por ç'është e rëndësishme, edhe ideologjikisht, pra, që të çrrënjoset filozofia e tyre idealiste, të çrrënjoset dogmat fetare nga ndërgjegjja e njerëzve. Kjo është edhe ana më e vështirë e luftës sonë. Ne jemi të ndërgjegjshëm se, për t'i arritur plotësisht me sukses këta objektiva, duhet një kohë e gjatë, por kemi besim se do t'ia arrijmë patjetër, mbasi jemi në rrugë të drejtë.

Edhe lufta për çlirimin e plotë të gruas është një nga detyrat kryesore të revolucionit proletar. Gruaja, siç thotë Engelsi, për arsyen e pronësisë private, është skllavja e parë në historinë e njerëzimit. Atë e çliron vetëm revolucioni proletar. Ky revolucion i krijoj gruas shqiptare mundësitet që të emancipohet plotësisht, i krijoj dy kushtet e domosdoshme për këtë emancipim: zhdukjen e shfrytëzimit kapitalist dhe pjesëmarrjen e saj në prodhimin shoqëror. Si rrjedhim, gruaja shqiptare i ka fituar me ligje të gjitha të drejtat, mirëpo këto të drejta duhen thelluar akoma, sepse, me gjithë përparimet e arritura, ekziston i fortë mentaliteti i vjetër i sundimit të burrit ndaj gruas, që shfaqet në forma të ndryshme. Te ne është bërë një revolucion i madh në këtë drejtim, por akoma në mendjen e burrave ekziston pikëpamja e inferioritetit të gruas, pikëpamje e papranueshme për ideologjinë tonë proletare. Prandaj na bie detyra ta thellojmë më tej këtë revolucion, me qëllim që gruaja të ngrihet në të njëjtin nivel me burrin, që ajo të fitojë në fakt

dhe jo vetëm në letër të gjitha të drejtat, gjë që do të thotë të shtyhet akoma më me vrull përpara revolucioni ynë, të ndërtohet socializmi me hapa më të shpejtë. Partia jonë këto çështje i gjykon si probleme të dorës së parë për socializmin.

Ne po i vëmë një rëndësi të madhe edukimit të rinisë, të ardhmes së vendit, që ajo jo vetëm të rritet si revolucionare, me frymë marksiste-leniniste, të formohet e të brumoset me botëkuptimin e ri revolucionar, por edhe të mund të ndikojë në brezat e kaluar, te nënrat e baballarët.

Pra, revolucioni ynë është një revolucion kompleks, që synon të shtrihet e të fitojë në të gjitha drejtimet, që të gjitha ato të ecin njëkohësisht, sepse ndihmojnë njëra-tjetrën në përparimin e vendit dhe në çlirimin e mendjes së njerëzve për të rrënjosur tek ata botëkuptimin marksist-leninist, për të futur kudo traditat e reja, mënyrën marksiste-leniniste të jetesës, që të luftohen botëkuptimet e mentalitetet e vjetra borgjeze e mikroborgjeze. E gjithë kjo luftë bazohet në fitoren e madhe materiale që krijoj revolucioni ynë.

Kolektivizimi në vendin tonë përfundoi. Revolucioni proletar ka krijuar në fshat një psikologji të re të atillë që fshatarësia jonë, me vullnetin e vet, po e zvogëlon pronësinë e oborrit kooperativist. Ky është një revolucion i madh në mendjen e fshatarëve tanë, të cilët po e kuptojnë se përparimi i bujqësisë arrihet me punë, me dituri e me mësim. Në vendin tonë janë zhdukur tashmë mbeturinat që ekzistonin disa vjet më parë dhe që i pengonin fshatarët të dërgonin rregu-

llisht djemtë dhe vajzat në shkollë. Me punën e Partisë u zhduk, sidomos, mentaliteti i mosbesimit në forcë e veta, sipas të cilët punëtorët tanë nuk qenkan në gjendje t'i drejtojnë dot vetë fabrikat e uzinat. Partia u ka hapur horizonte të mëdha njerëzve, duke i frymëzuar me besim se, me përpjekje në punë dhe në mësim, ata mund të drejtojnë çdo objekt dhe të bëjnë kështu të shtohen prodhimet. Ju keni parë vetë, gjatë vizitave që bëtë, se njerëzit tanë kanë përvetësuar shpejt makineritë e veprave të reja. Kjo, në të vërtetë, është një inkurajim i madh për ne. Ndërtimi i këtyre objekteve është vepër e Partisë sonë, e cila, nëpërmjet revolucionit proletar dhe thellimit të tij të pandërrerë, ka krijuar mundësi që populli, në radhë të parë, të edukohet në masë ideologjikisht, politikisht, por edhe teknikisht. Me këtë hov të madh shpirtëror, që po rrit Partia, ne po prodrojmë më shumë të mira materiale, po e forcojmë materialisht e shpirtërisht ndërtimin e jetës së re socialiste në vendin tonë.

Faktet tregojnë se ne po i kapërcejjmë vështirësitë në përmirësimin e jetës së popullit, kurse revisionistëve vështirësitë po u shtohen. Ata po e ulin nga dita në ditë nivelin e jetesës së masave punonjëse. Te ne shtohen vazhdimisht prodhimet, ndërsa tek ata pakësohen. Te ne ulen çmimet, tek ata ngrihen.

Duhet njobur se në vendet ku sunojnë revizionistët janë trashëguar pasuri të mëdha nga borgjezia, e, megjithatë, në Bashkimin Sovjetik, në Bullgari, në Çekoslovakia, në Hungari etj., ka vështirësi të mëdha jetese për punonjësit.

Te ne gjendja është shumë e shëndoshë, sepse

udhëhiqemi nga idetë marksiste-leniniste, prej të cilave kanë frikë imperialistët dhe revizionistët, sepse ato do t'ua hanë kokën. Ndërsa ne ecim me plan, dhe po ecim përpara në ndërtimin e socializmit, revizionistët ecin në tym e në anarki dhe po rivendosin kapitalizmin. Ne, bashkë me popujt e tjerë, kemi për detyrë t'i luftojmë ata si edhe imperialistët, që të mund të fitojë kështu revolucioni në të gjithë botën.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP*

**SA MË REVOLUCIONARE DHE E PASTER  
TË JETË RINIA, AQ MË E FORTE  
DO TË BËHET PARTIA**

*Nga biseda me një delegacion të Partisë  
marksiste-leniniste të Austrisë*

**10 maj 1967**

Në emër të Partisë dhe të popullit tonë ju uroj mirëscardhjen, ju shpreh gjëzimin e madh që ata ndiejnë për krijimin e partisë suaj marksiste-leniniste, dhe ju uroj nga zemra për këtë ngjarje të madhe historike për popullin austriak. Ne kemi bindjen se partia juaj, me gjithëse akoma e re, do të vijë vazhdimisht duke u forcuar. Sigurisht, si parti e re, ajo do të ndeshë shumë vështirësi në rrugën e saj, por kjo është një gjë e mirë, pse vështirësi do të thotë luftë dhe me luftë e në luftë partia rritet, kalitet, forcohet e pastrohet nga elementët e padenjë. Gjatë rrugës revolucionare radhët e saj do të mbushen përherë e më shumë me njerëz të tjerë të mirë, të shëndoshë e besnikë, veçanërisht nga radhët e rinisë, që është e ardhmja e partisë, e ardhmja e atdheut. Prandaj kjo ka röndësi të dorës së parë.

Partia jonë i ka kushtuar vazhdimisht një kujdes të veçantë këtij problemi. Ajo na ka mësuar që sa më revolucionare, luftarake dhe e pastër të jetë rinia, aq më e fortë dhe e çeliktë do të jetë vetë Partia, aq më e sigurt do të jetë e ardhmja e saj dhe e atdheut, për arsyse nga radhët e të rinxve më të mirë e revolucionarë do të mbushet Partia me gjak të ri e të pastër.

Ne, të moshuarit, kemi vuajtur më shumë në jetë, se kemi jetuar për një periudhë kohe në një shoqëri tjetër, dhe ajo na ushqeu me normat e saj të vjetra, prandaj trashëguam mjaft anë jo të mira. Kështu që, bashkë me përmbysjen e pushtetit të shoqërisë së vjetër, na u desh të punonim për të bërë një përmbysjë edhe në ndërgjegjen e njerëzve tanë. Në këtë drejtim Partisë sonë i është dashur të kapërcejë shumë vështirësi, dhe pikërisht këto e kanë armatosur atë me një përvojë të madhe, e kanë mësuar të kujdeset që sidomos rininë ta mbajë kurdoherë të pastër.

Ju, shokë austriakë, nuk duhet të dëshpëroheni përfaktin se rininë hëpërhë nuk e keni në shkallën e rinisë sonë. Për të arritur deri këtu, Partisë sonë i është dashur punë kolosalë. Veç kësaj, ju e keni parasysh edhe arsyen tjetër — kushtet e ndryshme objektive e subjektive të vendeve tona, të cilat s'janë të njëllojta. Kur brezi ynë e filloj luftën, ishte vetë në moshë të re. Një faktor tjetër i favorshëm për Partinë tonë qe se ajo gjeti në Shqipëri një rini, jo vetëm të varfër e të shtypur politikisht e ideologjikisht, por edhe djerr, të pamolepsur, si të thuash, nga ideologjia

borgjeze. Ideologjia borgjeze dhe degjenerimi i ambientit, siç ekzistojnë në vendet kapitaliste, nuk kishin penetruar aq thellë në vendin tonë. Kjo rridhte ngaqë në Shqipëri nuk kishte kapitalizëm të zhvilluar. Ne na ndihmoi dhe momenti nacional — lufta kundër pushtuesve. Prandaj themi se terreni për ta bërë me vete më shpejt rininë ishte më i përshtatshëm. Meritë e Partisë sonë është se ajo diti të përfitonte nga këto kushte, t'i shfrytëzonte ato.

Sigurisht rrethanat në të cilat ndodheni ju, e vështirësojnë punën e partisë, prandaj ajo do të ketë pengesa e vështirësi në luftën për ta bërë me vete sa më parë të gjithë rininë. Por pikërisht këtu qëndron zotësia e partisë për të gjetur momentet e përshtatshme, për t'i studiuar ato dhe për të nxjerrë mësime për punçn e luftën që duhet të bëjë.

Partia jonë, bile edhe sot, në situatat kaq të favorshme që ekzistojnë për të rintjtë dhe të rejat e vendit tonë, vazhdimisht studion etapat në të cilat kemi kaluar e do të kalojmë, i analizon me kujdes këto etapa, nxjerr mësime nga e kaluara dhe bën piketime për të ardhmen. Në kryerjen e këtyre studimeve ne jemi bazuar e bazohemi kurdoherë në zhvillimin objektiv të shoqërisë sonë, në kushtet konkrete të vendit tonë. Për shembull, në lidhje me luftën kundër paragjykimeve të vjetra e besimeve fetare, janë marrë masa të përshtatshme sipas momenteve, pse për çdo etapë qëndrojnë vështirësi të natyrave të ndryshme, në bazë të të cilave Partia vendos metodën e veprimtarisë së vet politike, ideologjike e organizative. Vetëm kështu mund të realizohet zhvi-

llimi në mënyrë revolucionare, mund të thyhen më lehtë pengesat dhe të kapërcehen vështirësitë.

Ju e patë rininë e vendit tonë dhe besoj që keni krijuar një ide të përgjithshme për të. Ajo, kështu si tani, ka qenë kurdoherë, revolucionare. Një situatë të tillë sot, natyrisht, ju nuk mund ta krijoni dot menjëherë me rininë e vendit tuaj, sepse kushtet atje, siç thamë, janë të ndryshme. Rinia e vendit tonë rron në socializëm, di përsë punon e lufton. Ajo ka pjekuri të lartë politike e ideologjike dhe është aq shumë e lidhur ngushtë me Partinë, saqë, sa herë që Partia lëshon një direktivë, rinia jonë hidhet menjëherë në aksion me mish e me shpirt për zbatimin plotësisht të saj.

Edhe gjendja e gruas e tillë është te ne. Zhvillimi i saj ka bërë dhe përbën një problem të madh shoqëror. Edhe gruaja e vendit tonë është e lidhur ngushtë me Partinë. Marksizëm-leninizmi na mëson se partia e klasës punëtore duhet ta bëjë masën e grave me vete, se kjo përbën gjysmën e shoqërisë. Gruaja te ne luan një rol të jashtëzakonshëm në ndërtimin e socializmit. Kush nuk e kupton këtë rol, nuk do ta ndërtojë dot socializmin. Problemi i gruas nuk mund të kuptohet në bazë të teorisë reaksionare të Niçes apo të etërve të kishës, por vetëm në rrugën marksiste-leniniste. Marksizëm-leninizmi na mëson se po të bëhet gruaja e ndërgjegjshme që të kuptojë se lufta e partisë ka si objektiv t'i japë asaj të gjitha të drejtat, ta vërë pra në një radhë plotësisht të barabartë me burrin, po të punohet për të krijuar tek ajo besimin në forcat e veta fizike, morale e shpirtërore,

atëherë rezultatet në këtë drejtim do të qindfishohen. Te ne, në momentet aktuale, gruaja është një faktor kryesor i revolucionarizimit të Partisë dhe i gjithë jetës së vendit.

Në qoftë se gruaja arrin të kuptojë që feja dhe zakonet prapanike janë kundër saj, në qoftë se kupton drejt ç'janë dashuria, familja, shoqëria socialiste, atdheu socialist, atëherë ajo do të bëhet një forcë kolosale dhe do ta mbështetë Partinë. Në qoftë se gruaja gjithashtu bëhet e ndërgjegjshme dhe e kupton si duhet pjesëmarrjen e saj në luftë e në prodhim (që në vendet kapitaliste është në masë të kufizuar dhe përbën një objekt tjetër shfrytëzimi kapitalist), atëherë ajo do të juajë një rol akoma më të madh në shoqëri dhe me siguri revolucioni do të ecë edhe më me vrull përpara.

Këto probleme, në parim, qëndrojnë njëlloj, si për partinë tuaj, ashtu edhe për Partinë tonë, me të vetmin ndryshim se kushtet në vendet ku militon secila parti nuk janë të barabarta. Pikërisht këtu qëndron mprehtësia e çdo partie që parimet t'i zbatojë në mënyrë krijuese në kushtet e veta, jo të kopjojë verbërisht, pse një gjë e tillë nuk do të sillte asnje dobi përvçëse dëme. Puna është që hovin revolucionar të rinisë e të gruas të dish ta shfrytëzosh e ta vësh në shërbim të tyre.

Ky predispozion gjendet kudo, në çfarëdo kush-tesh të ndodhen rinia e gruaja. Ja, për shembull, shoqja austriake e entuziazmoi shumë Kongresin e 6-të të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë me përshëndetjen e saj të zjarrtë e me përmbytje të drejtë re-

volucionare. Delegatët e Kongresit e kujtojnë atë nga herë dhe flasin me simpati se ajo mbajti një fjalim shumë të mirë. A nuk flet ky fakt për atë që rinia kudo është e flaktë? Po, por duhet që partia marksiste-leniniste ta udhëheqë në rrugën revolucionare.

E ardhmja u përket partive tona, shokë, pse çdo gjë shkon në favorin tonë. Kur them këtë, nuk dua të zvogëloj vështirësitë e mëdha që kemi përpara, të cilat në koniunkturat aktuale, veçanërisht, janë kolosale, por e kam fjalën për atë që ne po shikojmë me sytë tanë se çështja e revolucionit po ecën përpëra. Krijimi i partive komuniste marksiste-leniniste në Evropën Perëndimore, në Azi dhe në Amerikën Latine si dhe lufta e tyre parimore dhe në praktikë flasin qartë për një situatë në favorin tonë. Kjo i shqetëson shumë armiqtë revizionistë, ashtu sikurse shqetëson edhe imperialistët; vetëm se këta të fundit janë tani në një periudhë euforie, për arsyen se në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera ish-socialiste të Evropës është restauruar kapitalizmi.

Krijimi i partive të reja marksiste-leniniste që nga imperialistët shpesh nënveftësohet, revizionistët përkundrazi i shqetëson shumë, pse këta ua kanë shumë frikën atyre, bile kohët e fundit revizionistët e maskuar e shfaqën haptazi këtë frikë. Nuk di nëse keni pasur rast ose jo të lexoni këto ditë një artikull të gjatë teorik të shkruar nga sekretari i parë i komitetit qendror të një partie plotësisht revizioniste, por e maskuar. Në këtë artikull ai shtron pikërisht një parim oportunist, revizionist, antimarksist e anti-internacionalist. Ai i quan «fraksione» partitë e reja

marksiste-leniniste, dhe, sipas tij, me partitë e vjetra, domethënë me partitë revizioniste, u dashkan mbajtur lidhje miqësore! Artikullshkruesi thotë se ndryshimet e pikëpamjeve që ekzistojnë midis partive nuk na qenkan parimore! Këto s'janë tjetër veçse teza revizioniste. «Komunistë» të tillë e heqin veten sikur zbatojnë marksizëm-leninizmin në mënyrë krijuese në përputhje gjoja me kushtet e vendit të tyre. Me këtë artikull, oportunistët, revizionistët e maskuar e shprehën haptazi frikën që kanë nga partitë e reja marksiste-leniniste, kundër të cilave revizionistët, tashmë të njohur publikisht si të tillë, zhvillojnë një luftë të ashpër e frontale.

Megjithëse situatat janë të favorshme për ne, atoprapë janë të vështira. Lëvizja jonë marksiste-leniniste që po rritet, ua vështirëson dhe akoma më shumë do t'uva vështirësojë në të ardhmen gjendjen armiqvetanë. Kontradiktat midis revizionistëve dhe imperialistëve jo vetëm do të acarohen, por rruga që ndjekin ata do të acarojë më tej vetë luftën e klasave në vendet ku sundojnë. Ne mendojmë se në vendet revizioniste do të bëhet dezintegrimi shkallëzor brenda partive të tyre. Në këto parti edhe sot ka njerëz që shkëputen, por midis tyre ka që shkëputen me direktivë të vetë revizionistëve, me qëllim që t'i përdorin si «kalin e Trojës», të futen në partitë revolucionare për t'i minuar e për t'i shkatërruar ato nga brenda. Ndaj këtyre elementëve ne duhet të jemi prudentë e shumë vigjilentë. Por të ruhem i edhe nga sektarizmi, se në këto parti ka edhe njerëz të ndershëm që, me zhvillimin e situatave, fillojnë të kuptojnë se udhë-

heqjet po i çojnë në tradhti dhe kërkojnë rrugët nëpër të cilat duhet të ecin. Njerëzit e ndershëm, që me siguri të tillë do të gjemë shumë gjatë rrugës, do ta kuptojnë se rrugëdalja do të jetë braktisja e partisë revizioniste, revolta, kryengritja. Të tjerët, ndoshta të paktë, do të ndjekin rrugën e shërbëtorëve të imperializmit, dhe këta do të jenë provokatorë. Kështu do të bëhet, dhe në fakt kështu po zhvillohet edhe sot ky proces. Situata nuk mund të qëndrojë në një vend dhe ne jemi plotësisht të bindur se në të ardhmen do të krijojen situata akoma më të vështira për armiqtë tanë, kurse për ne përherë e më të mira. Procesi i shpartallimit të partive revizioniste ka kohë që ka fillouar, ai po thellohet vazhdimisht.

Formimi i partisë suaj, sipas mendimit tonë, do të ndihmojë që ky proces të zhvillohet më shpejt edhe në Austri. Gjatë këtij procesi gradualisht do të kalitet edhe partia juaj, do të shtohen e do të forcohen pa ndërprerje radhët e ndikimi i saj.

Për partitë tona marksiste-leniniste nuk ka shumë rëndësi numri i anëtarëve, po cilësia e përbërjes së tyre. Sipas përvjoes së Partisë sonë, kur ajo u krijuar, nuk qe e mundur që të kishte qysh në fillim një numër të madh anëtarësh, bile në ditën e themelimit të saj ajo kishte rrëth 200 veta. Por, kur vija politike, ideologjike dhe ajo organizative e një partie është e drejtë, ajo rritet me shpejtësi. Kjo përbën çështjen më kryesore. Është plotësisht e drejtë ajo që ju jeni preokupuar qysh në fillim për forcimin e partisë dhe përsëri vazhdoni të preokupoheni, pse fillimi ka kurdoherë rëndësi. Por, në radhë të parë, krahas

kësaj, medoemos, duhet të pastrohet partia nga të ligjtë. Në radhët e partisë s'duhet të zënë vend armiq, as të lëkundurit dhe veçanërisht elementë të kamufluar, të cilët janë më të rrezikshmit.

Duke njojur mirë gjendjen e Austrisë, zhvillimin e saj mbi bazën e materializmit historik, gjendjen e forcave e të klasave në vend, pikat e dobëta të armikut dhe anët e favorshme të lëvizjes komuniste atje, s'ka dyshim se, me përpjekje të mëdha dhe me luftë të papërkulur, ju çdo ditë e më shumë do të fitoni terren.

Kështu ka vepruar edhe Partia jonë që në formimin e saj dhe gjatë kalitjes së saj të parë, ajo ndihmohej nga momenti i madh i favorshëm, ai nacional. Por megjithatë problemet e Partisë në atë kohë ishin të shumta, pse kishe të bëje me një gjendje të rëndë. Vendin e sundonin bajonetat e të huajve. Megjithëse në kushte të rënda, me u përpoqëm të kapeshim nga problemet themelore që preokuponin popullin, që pasqyronin dëshirat e tij më të afërta, si çlirimin kombëtar etj. Partia këtë u përpoq ta zgjidhte sa më parë, kurse çështjet e tjera, që duhen zgjidhur në një periudhë më të largët, i la në plan të dytë. Këtë e bënë me qëllim që forcat t'i grumbullonim, t'i përqendronim e t'i përdornim për të sulmuar në frontin kryesor.

Ideologja jonë ka baza materialiste, prandaj kur e kapim problemin konkretisht, atëherë gjejmë edhe rrugën e drejtë të zgjidhjes së tij, kur është nevoja në favor të revolucionit deri edhe me kompromis, natyrisht, bazuar në marksizëm-leninizmin dhe pa pre-

kur parimet. Mund të ketë njerëz që kompromiset e lejueshme, siç porosit Lenini, të mos i kuptojnë. Për të fituar rininë, fjala vjen, gjë që ka një rëndësi shumë të madhe për çështjen e partisë dhe të ardhmen e popullit, pa i shkelur parimet, na lejohet të bëjmë edhe ndonjë zigzag të përkohshëm, kompromis.

Këtu s'është fjala për ato kompromise që bëjnë revizionistët. Me kompromiset që bëjnë revizionistët, thyejnë parimet. Ne jemi kundër kompromiseve të tilla, ato janë të rrezikshme për revolucionin, se të çojnë në oportunizëm. Të bësh kompromise me përfitim për çështjen e partisë, nuk është e lehtë. Kjo kërkon njoħuri të thella marksiste-leniniste dhe një eksperiencë të madhe lufte revolucionare. Vetëm këto të ndihmojnë të dallosh, kur, ku dhe me kë duhet bërë kompromisi. Kjo duhet pasur mirë parasysh, ndryshe, siç na mëson Lenini, nuk është kompromis mbi baza të shëndosha. Një kompromis që shkel parimet, të çon në terrenin oportunist. Komprimeset që nuk thyejnë parimet, partia duhet t'i kuptojë mirë, që pastaj të mund t'i mbështetë, ajo duhet të shikojnë to qëllimet që duhen arritur dhe drejtësinë e tak-tikës.

Partitë ndjekin edhe taktika, po edhe në këto kurdoherë duhet të ruhen parimet. Ka parti që veprimet e tyre oportuniste i quajnë taktika, por të tilla taktika çojnë drejt një strategjie antimarksiste. Në qoftë se shikojmë që një taktikë nuk jep, ose jep diçka të dyshimtë, për arsyen se rrëthanat nuk janë të përshtatshme ose zbatimi i saj nuk është i drejtë, duhet tërhequr menjëherë dhe jo të shkohet nga mendimi:

se kështu i bie autoriteti Partisë. Kjo do të ishte e gabuar dhe do të thotë që ta lësh sëmundjen të rritet, të të kapë krahun e pastaj të të rrëmbejë trupin, jetën.

Unë mendoj që ju jeni në gjendje t'i dalloni këto dhe kemi besim se situatën e Austrisë e njihni, prandaj patjetër do ta forconi partinë.

Një nga mjetet kryesore që shërben për forcimin e partisë revolucionare është shfrytëzimi i shtypit marksist-leninist, veçanërisht i organit të saj, natyrisht, kur ky arrin të bëhet me të vërtetë tribunë e vegjëlisë.

Shokët më thanë se ju revistën tuaj «Rote fane» do ta bëni të përvjavshme. Shumë mirë. Shtypi ka rëndësi të madhe. Bashkë me propagandimin e parimeve, të qëndrimeve tona solidare internacionale, rëndësi të madhe ka edhe lufta për të lidhur partinë me masat, që, midis të tjera sh, bëhet edhe me anën e shtypit. Masat në fillim mund të mos binden për ato që shkruan gazeta, por ne, komunistët, duhet të përpinqemi që me shtypin tonë të qëllojmë kurdoherë në shenjë, sot, nesër dhe vazhdimesh. Duke vepruar në këtë mënyrë, do të krijohet medoemos dhe gradualisht te lexuesi besimi mbi çështjet që trajton gazeta. Teoria jonë është e tillë që, duke i analizuar drejt dhe objektivisht problemet, ndihmon që këtyre t'u gjendet edhe zgjidhja e drejtë, të bëhen edhe parashikime të drejta. Kështu, kur nesër-pasnesër lexuesi të shohë se ajo që ka shkruar «Rote fane» po vërtetohet në jetë, atij do t'i kujtohet se këtë ajo e ka pasë parashikuar prej kohësh, ndërsa tani u vërtetua. Në këtë mënyrë do t'i

shtohet besimi dhe do të afrohet më shumë me gazeten. Kështu do të rritet numri i simpatizantëve.

Partia juaj, me sa kuptova, po punon tani me intensitet të shtojë radhët e simpatizantëve, duke i organizuar ata në grupe. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe. Edhe ne, pas krijimit të Partisë, i vumë qysh në fillim një rëndësi të madhe punës së simpatizantëve, nga radhët e të cilëve u bënë shumë anëtarë partie, megjithëse, kur i afronim, nuk mendon si ne. Është e vërtetë që ata u bashkuan me ne se ishte faktori i çlirimit kombëtar. Megjithatë mendoj se edhe te ju aktualisht ka çështje për të cilat mund të bashkohen shumë njerëz rrëth partisë suaj, siç është, për shembull, lufta kundër imperializmit ose shfrytëzimit kapitalist. Natyrisht, bazën e simpatizantëve tuaj duhet ta përbëjnë ata elementë që politikisht dhe ekonomikisht janë në luftë me armiqëtë e klasës. Ata mund të mos janë plotësisht dakord me gjithë vijën tuaj, dhe pikërisht për këtë edhe quhen vetëm simpatizantë, ose mund të janë dakord vetëm për disa çështje me ju, por që kanë shumë rëndësi e që i bëjnë ata t'ju simpatizojnë. Nga çështjet e përbashkëta duhet të nisemi ne për t'i futur ata në rrugën që dëshirojmë, në rrugën e revolucionit, i cili vetë do t'i bindë edhe për ato çështje që në fillim janë të paqartë ose që s'janë dakord.

*Pasi foli edhe miku austriak, shoku Enver Hoxha në fund tha:*

Ju faleminderit shumë për vlerësimin që i bëni Partisë sonë. Kjo ne na inkurajon, por njëkohësisht na i shton më shumë detyrat. Partia jonë, pa pasur as-

pretendimin më të vogël, i ka të qarta detyrat. I vemi «pretendim» i saj është të luftojë në të gjitha kushtet dhe kundër të gjitha vështirësive pa u lëkundur. Forcat tona të përbashkëta, forcat e marksizëm-lennizmit në botë janë të mëdha, prandaj ne do të fitojmë!

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha. «Kun-  
dër revizionizmit modern  
1965-1967», f. 497*

*Botohet sipas shënimave të  
mbajtura në këtë takir  
çë gjenden në AQP*

## ATJE KU ËSHTË PUNA, ATJE DUHET KËRKUAR EDHE DITURIA

*Nga biseda me bariun Lezan Pisli*

22 maj 1967

*Shoku Enver Hoxha e priti bariun e dalluar Lezan Pisli në selinë e KQ të PPSH dhe zhvilloi me të një bisedë të përzemërt:*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Jam gëzuar shumë nga letra që më dërgove dhe, me qëllim që nga eksperiencia jote të përfitonin të gjithë blegtoret e vendit tonë, atë e botuam në gazetat qendrore<sup>1</sup>.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Unë nuk kam shumë shkollë dhe nuk di si t'i mësoj të tjerët. Përpara Çlirimt, megjithëse fare i vogël, si fukara që isha, hyra hyzmeqar, se familja, me 8 kalamaj për të rritur, ishte pa kurrfarë ndihme dhe kishte nevoja të mëdha. Po të mos ishte çliruar vendi dhe të mos kishim ndihmën e menjëherëshme të Partisë, ne do të mbaronim.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Partia duhet të kujdeset që edhe të të mësojë, prandaj shokët e rrëthit dhe

---

<sup>1</sup> Shih: «Zëri i popullit», 29 prill 1967.

të kooperativës të interesohen të të japin edhe libra. Njerëzve si ti u duhet dhënë dituri. Nuk është e udhës që dituria në vendin tonë të shërbejë si një stoli vetëm për disa. Partia lufton që ajo të përhapet të të gjithë, të bëhet pronë e njerëzve të thjeshtë, ndryshtë Shqipëria nuk ecën dot si duhet përpara.

Mirë thoshe ti në letrën që më dërgove se specialistët duhet të mësojnë nga punonjësit e prodhimit. Kështu është, ata duhet të mësojnë nga njerëz si ju. Njerëzit e mëdhenj, si Marks, Engels, Lenini e Stalini, mësimet e të cilëve na udhëheqin në rrugën tonë, dituritë e tyre të mëdha i kanë marrë nga populli. Ata rronin shumë afër me popullin, ndiqnin me kujdes të madh krijimet dhe mençurinë e tij, vërenin si luftonte dhe si e ndryshonte ai botën dhe, duke u bazuar në këto, zbulonin ligjet e zhvillimit të shoqërisë. Rëndësi ka, pra, që njerëzve të mësuar, atyre që Partia u ka dhënë shkollë, të mos u rritet mendja, po syrin dhe zemrën ta kenë te populli, se atje është dituria. Populli që punon është si një pus i thellë diturish dhe pikërisht atje ku është puna, atje duhet kërkuar edhe dituria. Ku nuk ka punë, ka dembellëk dhe padituri. Ti, shoku Lezan, je një njeri që e di mirë zanatin.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Dituria nuk ka fund. Unë do të përpinqem ta shtoj tufën e dhive gjer në atë masë sa të jetë në gjendje kooperativa ta mbajë me kullotë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kooperativa juaj është e bashkuar?

**SHOKU LEZAN PISLI:** Po, përbëhet nga katër

katunde. Në kooperativën tonë janë shtatë barinj, të gjithë djem të rinj, përveç meje.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Më thanë se nesër, në Burrel, do të bëhet një mbledhje me barinj nga rrethet e Veriut, ku do të japësh edhe ti eksperiencën tënde. Mos u përpiq t'u flasësh shokëve me fjalë të mëdha, por me gjuhën tënde të thjeshtë të zanatit. Ata nuk vijnë te ti që t'u thuash fraza, po për të mësuar nga eksperiencia jote e mirë, me qëllim që ato që do t'u thuash, t'i zbatojnë në kooperativën e tyre.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Ai që ruan bagëtitë, mbi çdo gjë, duhet të ketë dashuri të madhe për kafshët.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Drejt e thua ti, po e deshe bagëtinë, ajo ta shpërbolen. Unë kam lexuar se dashuria ndaj kafshëve luan një rol të madh në shtimin e prodhimtarisë së tyre. Është pikërisht kjo dashuri që të bën ty t'i njohësh si duhet të gjitha shijet, zakonet, dëshirat dhe nevojat e dhive. Mungesa e dashurisë së bariut për bagëtitë që i janë besuar të ruajë, ndihet shumë prej tyre, prandaj duhet shumë kujdes. Një njeri që i lë ato të shkojnë në satin e tyre, të kullasin ku të duan e sa të duan, pa qumësht le të japid sa të japid, nuk mund të jetë kurrë bari.

Me leshin e dhisë ne bëjmë disa gjëra të kufizuarë dhe jo shumë të vlefshme, por gjetkë endin një stof që e quajnë kashmir, emër që e ka marrë nga një vend pranë Indisë. Në Kashmir ka shumë dhi të mira, me leshin e të cilave bëhet ky stof, shumë i preferuar nga të pasurit. Dhia pastaj ka rëndësi edhe

për qumështin e saj. Ti ke arritur rendimente të larta nga tufa jote.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Megjithatë; them se është akoma pak, sepse ka mundësi që dhitë e kooperativës sonë të na jepin edhe më shumë. Gjer tanë nga çdo dhi kam marrë 124 kilogramë në vit, po shpresoj se do të arrij të marr edhe 135, bile 140 kilogramë, nga 120 kilogramë për dhi që jam zotuar të marr nga e gjithë tufa. Edhe me dhitë që kemi blerë tanë së fundi kam besin se do ta tejkalojmë planin.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kam kënduar një libër të shkruar nga një shkencëtar yni, doktor Myslim Selenica, që ti e njeh, dhe po më kujtohet tanë se shumë gjëra që shkruhen atje, puqen me ato që ke treguar ti, shoku Lezan. Ky shkencëtar flet në këtë libër për cilësitë që duhet të ketë çobani. Bariu i mirë, thotë ai, duhet t'i dojë shumë bagëtitë, ai nuk duhet t'i trembë kurrë delet që ruan.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Ai ka të drejtë, ndryshe u ikën qumështi nga frika.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Edhe fyelli, thotë ai, ka një rëndësi të madhe për tufën, pse qetëson kafshët, qoftë kur kullozin, qoftë kur venë të pinë ujë etj. Çobani e di se ç'melodie duhet t'i bjerë me fyell në çdo rast të veçantë. Në libër thuhet, gjithashtu, se çobani i mëson edhe qentë që të mos e frikësojnë asnjëherë tufën, të mos futen kurrë përmes saj, po anash, dhe, vetëm kur u jep shenjë bariu, mund të lehin.

Autori i librit flet edhe për stallat dhe tregon se bagëtitë nuk duhet të rrinë vazhdimisht brenda, ato

duhen nxjerrë edhe në ajër të pastër. Pastaj jep këshilla që kullotat të mos shfrytëzohen pa rregull.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Ju, shoku Enver, ditkeni gjithë këto gjëra për bagëtinë, kurse kryetari i kooperativës që ka përgjegjësi për to, nuk i di.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në këtë libër jepen edhe disa këshilla të tjera. Kur bariu mjel delet, duhet të veprojë me kujdes të madh. Më në fund, kur sheh se gjiri nuk ka më qumësht, duhet tundur me dorë, se atje brenda ka disa xhepa të vegjël, ku grumbullohet më shumë gjalpi. Kur çobani e tund me dorë gjirin, delja lëshon yndyrën e grumbulluar në këto xhepa.

Shumë nga këto që po të tregoj, unë i këndova edhe në shkrimin që kishte bërë gazetari ynë pas takimit që pati me ty. Aty mësova sa mirë punon ti dhe kjo tregon që, pavarësisht se nuk je në Parti, ti je një komunist i vërtetë, pse e kupton drejt se me punën që bën, u shërben kooperativës, popullit dhe atdheut. Do të vijë koha që të bëhesh anëtar partie<sup>1</sup>. Megjithatë, edhe tani, me punën tënde të mirë, je njëlloj si të gjithë anëtarët e Partisë.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Unë jam me zemër me Partinë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Partia na ka dhënë mundësi të mëdha të punojmë e të mësojmë. Ju, matjanët, jeni njerëz të fortë e të zgjuar. Më kanë raportuar shokët se në Mat po dallohen brigadat e rendimenteve të larta në misër dhe fasule. Vitet e ardh-

---

<sup>1</sup> Lezan Pisli u pranua në Parti më 16 nëntor 1970.

shme, nën shembullin e tyre, të gjitha brigadat në kooperativat e rrethit tuaj duhet të marrin rendimente të larta. Ky është një shembull tjetër shumë i mirë për të gjitha rrethet e vendit tonë. Ne duhet të arrijmë që në çdo kooperativë brigadat të bëhen të rendimenteve të larta për të gjitha kulturat. Në këtë rru-gë të ecim, si kudo, edhe në blegtori, siç ndodh me tufën tënde, ku ti merr 120-130 kilogramë qumësht për çdo dhi, ndërsa gjetkë marrin vetëm 60 kilogramë për kokë. Duke ecur kështu, ne do t'i ngjitim shkallët gjithnjë e më lart edhe në malësi. Atje fshatarësia duhet ta kuptojë që bujqësinë ta lidhë ngushtë me blegtordinë, sepse pa këtë nuk ka si përparon fshati.

Në Jug, si në Labëri, por edhe në veri të Shqipërisë, në Tropojë, në Kukës e gjetkë, ka disa mendime të vjetra, sipas të cilave fshatarët i vënë rëndësi të madhe vetëm blegtorisë. Kjo ndodhje përpara, sepse toka nuk ishte e fshatarit dhe ato pak prodhime bujqësore që ai realizonte, ia merrte më shumë beu ose agai, kurse ato pak dhi ose dele që mbante, populli i varfër i kishte të tijat. Fshatari mund ta shiste ndonjë kur sëmurej ose kur i mbarohej buka, prandaj i vinte kujdes të madh blegtorisë, kurse bujqësisë jo sa duhej. Tani, në socializëm, kërkohet të ecim paralel në të dyja këto drejtime të rëndësishme.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Të dyjave u ka dhënë rëndësi Partia.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po të ecim mirë në drejtim të bujqësisë, përparon më shpejt edhe blegtoria. Ti nuk ke shkuar ndonjëherë nga Fieri dhe

Vlora. Mbasi t'i rregullosh punët që ke, i thuaj shokut Muç Pajenga<sup>1</sup> të të çojë të shikosh Myzeqenë, se atje duket më mirë ç'përparime të mëdha ka bërë bujqësia jonë. Kur të shkosh atje, shko të vizitosh edhe Uzinën e Plehrave Azotike në Fier.

E vërteta është se kudo po ecim përpara, bujqësia jonë po përparon shpejt, kudo po hapen toka të reja në sipërfaqe të mëdha. Tani kemi vënë detyrë që edhe në malësi të hapim toka, pavarësisht se disa kanë frikë se mos u ngushtohen kullotat për blegtoria. Me hapjen e tokave të reja ne do të krijojmë në malësi ferma të mëdha dhe, krahas tyre, në kooperativat bujqësore, pa i hequr dhitë, do të rritim edhe lopë. Partia mendon se kështu do të bëhet më mirë, me zhvillimin intensiv të bujqësisë do të sigurohen më shumë ushqime si për njerëzit, ashtu edhe për kafshët.

*SHOKU LEZAN PISLI:* Edhe më përpara do të shkojë blegtoria kur ne të kemi një bujqësi më të fortë. Te ne në Mat ka akoma njerëz që nuk e kuptojnë rëndësinë që ka sigurimi i ushqimit për blegtorianë. Edhe blegtoria e ndihmon shumë bujqësinë. Unë e kuptoj që sa më shumë të shtohen dhitë, delet, lopët, aq më tepër kanë për t'u shtuar edhe prodhimet e bujqësisë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Lopa është një kafshë që jep qumësht e mish, por edhe pleh më shumë nga çdo bagëti tjetër.

*SHOKU LEZAN PISLI:* Veç bagëtitë duan shër-

---

<sup>1</sup> Mustafa Pajenga, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Matit.

bim të mirë. Unë ua pastroj çdo ditë vendin ku flenë dhive dhe plehun që japid e fus në gropë. Kështu, nga 300 dhi siguroj 600 kuintalë pleh në vit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Më kanë thënë se plehu më i mirë për duhanin është ai i dhisë.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Ashtu është, duhani që rritet në tokat ku përdoret pleh dhi, ka një krisje të lehtë, të këndshme kur e pi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** U trego barinjve të tjerë që të njohin barërat që helmojnë dhitë. U trego, gjithashtu, se cilat janë gjethet më të mira për ushqimin e tyre.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Po të vërejë me kujdes ku drejtohet vetë dhia për të ngrënë, bariu e mëson lehtë se cila gjethë është më e mirë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Thuhet se dhia i prish shumë pyjet, por mund edhe të mos i prishë, po të ketë kujdes njeriu.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Nuk e prish dhia pyllin, jemi vetë ne, njerëzit, që e prishim atë nga pakujdësia e padhimbsuria. Në një mal te ne, në Dardhë, siç e quajmë, beu na kishte thënë të ngrinim një stallë për bagëtitë e tij. Atij i bëheshin 400 krerë dhi, për sigurimin e të cilave kishte ndër mend të conte buqjt e vet për ta zaptuar malin, po nuk ia arriti dot qëllimit. Edhe sot ky mal është shumë i përshtatshëm për dhitë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po sikur në atë vend t'i ngremë ne stallat që donte të bënte ai?

**SHOKU LEZAN PISLI:** Ka leverdi. Gjethja e këtij mali është e trashë dhe e shëndosh shumë dhinë,

po fshatarët tanë gjethen e presin pa kujdes, prandaj prishet pylli. Unë kam njoftuar zyrën e pyjeve të ketë kujdes për këtë mal, prandaj qysh vjet, kur ajo e ndaloi prerjen e gjetheve, po shihet se shkurret rrithen mirë, sa, vende-vende, po të hysh brenda, vetëm qielli duket. Këto vende pëlqen dhia. Ajo ka shumë qejf kur kullot në mes të pyllit dhe nuk sheh gjë tjetër vec qiellit. Po të rriten edhe ca pemët në këtë mal, nuk ka rrezik të prishen më.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jetojnë fshatarët tuaj?

**SHOKU LEZAN PISLI:** Shumë mirë. Përpara, në fshatin tonë, njerëzit rrinin natën me pishë në shtëpi, kurse tani të gjithë janë rregulluar bukur fort. Edhe gratë janë gjallëruar te ne, ato e kanë kuptuar ç'bën Partia për to, prandaj e kanë ndryshuar veshjen e rëndë dhe zakonet e vjetra dalngadalë po i lënë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duhet të bëhet një luftë e madhe për zhdukjen e zakoneve të këqija.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Vëllai im, deri tre vjet më parë, falej dhe agjéronte, por e pa se nuk ka nxjerrë gjë, prandaj tani e ka lënë këtë zakon. Plaka ime, deri para ca kohe, mbante ca të holla që ia jepte hoxhës «për atë dynja». Tash as ajo nuk po i beson më hoxhës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Prapë ajo beson diçka, se nuk ikin lehtë këto mbeturina, shoku Lezan. Prandaj duhet punuar vazhdimisht, gjersa t'i shkulim nga rrënjet këto zakone të këqija, pse kështu do të përparojmë më shumë e më shpejt.

U gëzova shumë që u takova me ty. Kur të vij në Mat, do të përpinqem të vizitoj edhe kooperativën tuaj.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Mirë se të vini, do t'ju presim sipas zakonit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Zakonet e mira do t'i ruajmë. Partia ka një respekt të madh për matjanët, se janë njerëz besnikë të Partisë, trima, punëtorë e të zgjuar. Partia do të jetë kurdoherë afër jush dhe, këtej e tutje, do t'ju ndihmojë edhe më shumë. Te ju bëhen mollët, qershítë, bile më kanë thënë, dhe vetë e kam parë kur kam qenë në rrëthim tuaj, se te ju bëhet një lloj qershie kokërrmadhe, jashtëzakonisht e bukur, pale sa e shijshme. Ne duhet ta përhapim këtë lloj qershie në të gjitha rrëthet tona malore.

Kudo në Mat dhe në të gjitha zonat malore të vendit tonë ka mundësi të zhvillohen misri, patatja, fasulja. Jo shumë, po brenda dy-tre vjetëve, me një punë të tillë, si kjo që ka filluar, malësitë tona do të ndryshojnë, lëre pastaj si do të bëhen ato në pesëvjeçarin tjetër. Prandaj, si kurdoherë, me besim të patundur te Partia, të hidhemi pa u lodhur në punë.

**SHOKU LEZAN PISLI:** Nuk do të lëmë kusur në punë. Megjithatë kemi akoma disa njerëz që nuk na duan, po ne do t'u bëjmë ballë atyre dhe armiqve.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Armiqtë janë të shumtë rrëth e rrotull vendit tonë, por asgjë nuk i bëjnë dot Shqipërisë. Ne kemi edhe miq të fortë, me ne janë gjithë popujt e botës. Popujt nuk janë as me imperialistët, as me revizionistët, kushdo qofshin këta. Po t'i ngjasë gjë sot Shqipërisë, ata do të ngrihen të gjithë në këmbë.

Të uroj shëndet dhe suksese në punë, në zanatin shumë të lavdërueshëm që ke e ku po shquhesh dhe

do të të lutem që eksperiencën tënde t'ua japësh edhe të tjerëve.

*SHOKU LEZAN PISLI:* Me aq sa di, do të përpinqem me të gjitha forcat.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Duhet të kesh parasysh se mund të të dalin përpara njerëz që të të pen gojnë me qëllim në rrugën e Partisë. Këtyre Partia do t'u tregojë vendin. Po do të ketë edhe nga ata që nuk e kuptojnë atë që po bën ti për të mirën e përgjithshme. Këta të fundit kanë për ta kuptuar me kohë, prandaj duhet punuar me durim me ta gjersa të binden. Unë mendoj se në rrugën e mirë që ke hapur ti për rritjen e dhive, duhet të ecin të gjithë blektorët e vendit tonë, se është e drejtë. Asgjë nuk i reziston dot rrugës së mirë dhe të drejtë, prandaj edhe ndonjë që do të përpigjet të të thyejë, do të dështojë, sepse ti je njeri me vullnet të forta, punon për interesin e popullit tënd dhe ke besim të madh te Partia.

*Botohet për herë të parë si pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**PËR PRANIMET NË PARTI TË NISEMI NGA  
NEVOJA E FORCIMIT TË PARTISË DHE E  
SHTIRIRJES SË DREJTË TË FORCAVE  
TË SAJ**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**26 maj 1967**

Është fakt se puna e Partisë për dhënie llogari e zgjedhje ka pasur përmirësime, të cilat shokët i vunë në dukje. Tani çështja është që eksperiencia e fituar në këtë drejtim të na shërbejë për ta pasuruar atë akoma më shumë. Shokët e Fierit kanë punuar dhe janë përpjekur për t'i zbatuar orientimet që janë dhënë lidhur me studimin e terrenit ku veprojnë organizatat-bazë, për të shikuar mbi bazën e këtij studimi çështjen e pranimeve, përtëritjen dhe gjallërimin e Partisë. Nuk e di sa po i zbatojnë këto orientime të Komitetit Qendror shokët e komiteteve të

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit informativ «Mbi përfundimin e mbledhjeve për dhënie llogari e zgjedhje në organizatat-bazë të Partisë».

Partisë të rretheve të tjera, por, edhe një herë, dëshiroj të theksoj se ky problem nuk duhet lënë pas dore. Ne mund të flasim shumë për pranimet në Parti, ato mund t'i bëjmë të mira, po edhe jo të mira, mund të flasim për shfaqjet e farefisnisë nëpër organizatat e Partisë dhe mund të luftojmë për zhdukjen e tyre, por ato mund të na shfaqen përsëri, mund, pra, të ringjallan, në rast se e flemë mendjen. Studimi mbi punën e bërë dhe masat që duhen marrë nga organizata-bazë dhe komitetet për forcimin e përbërjes së Partisë, për shtrirjen dhe gjallërimin e jetës së saj të brendshme, që Komiteti Qendror ka rekomanuar të bëhen, dhe që në Fier i kanë në mbarim e sipër, do të na japë rezultate të mira për çështjen e forcimit të Partisë. Partia ka një eksperiencë të madhe në këtë çështje dhe mbi këtë temë ne kemi folur shumë herë, por ka akoma disa gjëra që duhet t'i shikojmë në mënyrë më të studiuar.

Kur themi «Të futim gjak të ri në Parti», me këtë të kuuptojmë se pranime duhen bërë sidomos atje ku nuk kemi nga ky gjak i ri. Kërkesa «Të sjellim gjak të ri» është për Partinë një domosdoshmëri, vetëm se këto pranime t'i bëjmë atje ku e kërkojnë situatat e brendshme të Partisë, ku e kërkojnë terreni, gjendja dhe nevojat e rritjes së prodhimit, dhe jo të pranojmë për të thënë që pranuam. Çdo gjë ta lidhim, pra, me situatat konkrete të çdo organizate-bazë.

Të futim gjak të ri në Parti, nuk do të thotë që të priremi për të pranuar djem e vajza 18-vjeçare, duke u nisur vetëm nga fakti se janë të rinj në mo-

shë. Nga radhët e të rinxve e të të rejave të kësaj moshe mund të na dalin shumë elementë me aftësi të jashtëzakonshme, por në organizatën e rinisë kemi edhe të rinx e të reja me mosha deri 26 vjeç, të cilët, duke pasur edhe eksperiencë më shumë në punë dhe në jetë, i plotësojnë më mirë kushtet për t'u pranuar në Parti. Për pranimet të kemi shumë kujdes, në radhë të parë, që të ruajmë kërkesat e Statutit.

Kemi edhe njerëz të moshave më të rritura, 27, 30 e 35 vjeç, të cilët, kur i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e Statutit, janë, gjithashtu, gjak i ri për Partinë. Por gjak i ri për Partinë mund të jetë edhe një grua ose një burrë akoma më i rritur, të cilin organizata, kur zbulon se tek ai ka vrull revolucionar dhe pikëpamje të drejta partie, pra është i vlefshëm për Partinë, megjithëse nuk është futur gjer tanë në të, e pranon ashtu siç pranon edhe një më të ri.

Prandaj, duhet ta kuptojmë drejt kërkesën «Të sjellim gjak të ri në Parti», jo vetëm thjesht nga ana e moshës, por në tërësinë e saj, duke pasur parasysh sidomos botëkuptimin, formimin dhe qëndrimet revolucionare marksiste-leniniste, ndërgjegjen dhe hovin në punë të elementit të ri që pranojmë. Natyrisht, po ta krahasojmë një të rritur, që e pranojmë të ri në Parti, me një të moshës së re, do të shohim se: i pari ka disa minuse nga pikëpamja fizike, ashtu siç mund të ketë i dyti minuse nga ana ideologjike, e eksperiencës etj., por Partia do të punojë që këta të kaliten kurdoherë, të gjallërohen e t'i japin sa më tepër asaj.

Të marrim tanë çështjen tjetër, atë të normave

që duhen zbatuar për pranimet në Parti. Komiteti Qendror ka theksuar kurdoherë që pranimet të bëhen në bazë të nevojave. Në qoftë se madhësia e territorit, rëndësia e problemeve dhe çështjet që kërkojnë të drejtohen e të organizohen nga Partia janë të shumta, atëherë është e nevojshme që ne t'i shpërndajmë mirë forcat e Partisë, domethënë të kemi organizatë-bazë partie në të gjitha vendet kyç dhe një numër të mjaftueshëm komunistësh, në mënyrë që çdo organizatë-bazë të kryejë si duhet detyrat e saj. Kur këta janë të pamjaftueshëm në krahasim me nevojat, atëherë ne duhet ta rritim efektivin e Partisë.

E kemi thënë edhe herë të tjera se në fshat kemi shumë probleme, kurse anëtarë partie kemi akoma pak. Sa komunistë kemi sot atje dhe sa duhet të pranojmë? Edhe shifra mund të nxjerrim, edhe numrin e përgjithshëm të popullsisë fshatare mund ta nxjerrim, por në bazë të kësaj që thamë, do të ishte e drejtë që Partinë, qoftë në fshat, qoftë në qytet e kudo, ta kemi në të gjitha vendet kyç dhe aq të madhe sa e lypin detyrat dhe territori i ndërmarrjes ose i kooperativës bujqësore. Njohjen e këtyre kërkesave do të na e plotësojë studimi që rrtheve u është rekomanduar ta bëjnë në bazë të konkluzioneve të Byrosë Politike për problemet organizative të Partisë. Pra, komiteti i Partisë për çështjet e forcimit, të shtrirjes, të futjes së gjakut të ri në Parti, për këto probleme kaq jetike për Partinë, nuk do të mund të ecë në baza shkencore marksiste-leniniste në qoftë se nuk do të njohë forcat, nevojat, problemet e terrenit. Çështja që kanë studiuar dhe do të marrin në

shqyrtim shokët e Fierit, ka rëndësi edhe për aparatin e Komitetit Qendror, sepse do të njihet me eksperiencën e një rrithi, si e ka shtruar dhe si e ka zbërthyer këtë direktivë, si kanë punuar shokët që janë ngarkuar me këtë punë, ç'konkluzione kanë nxjerrë ata për të gjitha organizatat-bazë ku kanë shkuar, ç'orientime mendojnë të jepen për forcimin e mëtejshëm të Partisë etj.

Natyrisht, në drejtim të këtyre studimeve nuk mund të arrijmë gjithçka në mënyrë të përsosur. Çështja është që ne t'i zgjidhim problemet në bazë të studimeve të thella, sipas parimeve që duhet të na udhëheqin kurdoherë. Kështu, duke bërë studimin mbi përbërjen dhe mbi detyrat që dalin për forcimin e Partisë, atëherë mund të arrijmë në konkluzionin nëse pranimet në organizatat-bazë të Partisë në fshat janë të bazuara apo jo, nëse janë të mjaftueshme apo të pakta.

Ne duhet të kuptojmë mirë kriterin e pranimeve në Parti, atje ku kemi më shumë nevojë dhe këtë ta përdorim si duhet dhe në interes të Partisë. Por, në qoftë se do t'u qëndrojmë skllevër çështjeve të origjinës dhe të gjendjes shoqërore të elementeve të rinj, ne ose mund ta frenojmë zgjerimin e Partisë me forca të reja, duke u treguar sektarë, ose, në të kundërtën, mund të tregohemi dorëlëshuar, t'i hapim dyert e Partisë për cilindo, duke u bazuar vetëm në origjinën dhe gjendjen shoqërore.

Nuk është e drejtë të mos bëjmë fare pranime kur na duhet të kemi komunistë në një sektor ose në një fshat, duke pasur frikë se mos na ulet përqindja

e elementëve nga klasa punëtore, se mos prishen proporcionet etj. Këto mund të qëllojë që edhe të na prishen, po vetëm një gjë nuk prishet në këtë mes, ajo që Partia jonë është parti e klasës punëtore, që udhëhiqet nga ideologjia e saj, që ndërtohet në bazë të parimeve ideologjike dhe organizative marksiste-léniniste dhe që i ndjek ato kurdoherë me besnikëri. Forcimi i Partisë me elementë të klasës punëtore ose me fshatarë, kur Partia ka nevojë për ta dhe kur këta janë të denjë për të, kur ata i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kërkasat e Statutit, është një çështje jetike për Partinë.

Ne kemi bërë hapa të mëdhenj përpara, si në çdo fushë, edhe në forcimin e përbërjes së Partisë. Të gjithë ne këtu jemi anëtarë të kësaj Partie, që u themelua kur në vendin tonë kishte një klasë punëtore akoma shumë të vogël, kur populli ynë, në shumicën dërrmuese, përbëhej nga fshatarësia. Në këto kushte ishte e natyrshme që, në fazën fillestare të mëdërtimit të Partisë sonë, në radhët e saj të kishte më shumë fshatarë e nëpunës dhe pak punëtorë. Megjithatë, Partia jonë nuk devijoi, ajo nuk u bë një parti fshatare, po ishte dhe ka mbetur parti e klasës punëtore, pse u ka qëndruar dhe u qëndron vazhdimisht besnikë parimeve ideologjike dhe organizative të partisë së kësaj klase. Kurse sot, në krahasim me periudhën e formimit të saj, Partia jonë i ka zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme radhët e veta me punëtorë, ka përmirësuar përbërjen e saj klasore.

Edhe në të ardhmen ne do të vazhdojmë dhe duhet të vazhdojmë të ecim në rrugën që kemi ndje-

kur, duke u qëndruar besnikë parimeve, domethënë duke futur në Parti edhe më shumë elementë nga radhët e klasës punëtore. Por, në kushtet e përbërjes së popullsisë së vendit tonë, duhet të jemi të matur, të mendojmë me kujdes për këtë problem, të mos harrojmë kriteret që thashë më parë. Mund të na ndodhë, për shembull, që një punëtor ka vetëm dy vjet që ka ardhur nga fshati në një uzinë mekanike. Vëtëm përfaktin se ai quhet «punëtor», të futet në Parti më parë nga i vëllai që ka mbetur në fshat, i cili është vërtet fshatar, por që gjatë 10 vjetëve ka shkrirë atje të gjitha forcat përforcimin e kooperativës dhe në të gjitha pikëpamjet dhe qëndrimet e tij tregohet revolucionar, lufton mirë në çdo drejtim përzbatimin e politikës së Partisë në fshat. Po t'i gjykojmë si duhet parimet, po të kemi parasysh qëllimin e forcimit të Partisë, ne duhet të futim më përparrë në radhët e saj këtë element që ka 10 vjet që shkrihet në punë revolucionare dhe vazhdon të qëndrojë në fshat, sesa atë që ka vetëm dy vjet që punon në uzinën mekanike, pavarësisht se tani është me gjendje punëtore. Këtë problem, pra, ne nuk duhet ta shohim formalisht, po të zbatojmë si duhet kërkesat e Statutit, të mbajmë parasysh qëndrimet dhe formimin individual të secilit, vendosmërinë e tij, të zgjedhim për në Parti, në radhë të parë, atë që është element më i devotshëm dhe përfshin cilin ajo ka nevojë dhe të mos nisemi nga përqindjet.

Mund të na paraqitet rasti që në një ndërmarrje mekanike, fjala vjen, të kemi vetëm 10 anëtarë partie, kurse nevojat e ndërmarrjes e lypin që atje të

kemi 20. Atëherë këtë boshllëk ne duhet ta mbushim dhe, natyrisht, këtë do ta bëjmë nga radhët e kolektivit të kësaj ndërmarrjeje, pa marrë parasysh nëse elementët e këtij kolektivi janë punëtorë me tradita apo kanë ardhur nga fshati. Zgjedhjen e elementeve për në Parti ne duhet ta bëjmë në bazë të kërkesave të Statutit, duke pasur parasysh frymën, qëndrimet revolucionare dhe vendosmërinë e elementit dhe, kur secili nga këta të dhjetë i plotëson këto kushte, atëherë i futim në Parti, edhe pse mund të mos kenë shumë kohë që kanë ardhur nga fshati në ndërmarrje.

Por ne edhe në fshat nuk duhet të hezitojmë për të futur në Parti njerëz të rinj, në qoftë se na duhet ta forcojmë apo ta zgjerojmë organizatën-bazë. Vetëm të kemi parasysh që këtë punë, edhe atje, ta bëjmë me njerëzit më të mirë.

Do të jetë vallë në Partinë tonë përqindja e fshatarësisë më e lartë nga ajo e punëtorëve? Sigurisht. Në kushtet e tanishme ajo mund të jetë edhe për ca kohë më e lartë, por, po e përsëris edhe një herë, në qoftë se ne i zbatojmë drejt kriteret, futja e elementeve fshatarë në Parti, kur këta na duhen dhe organizata ka nevojë për ta, nuk është aspak humbje, përkundrazi, do të ishte shablonizëm po të kapeshim vetëm nga përqindjet.

Kemi pastaj një çështje akoma më delikate, pranimin në Parti të nëpunësve dhe të intelektualëve. Në rast se i zbatojmë kriteret në mënyrë sektare dhe shabllone, duke u bazuar vetëm në përqindjet, atëherë për një kohë të gjatë do ta dobësonim drejtimin e punës së Partisë në sektorët ku punojnë nëpunësit dhe

intelektualët. Një praktikë e tillë nuk do të ishte e drejtë, bille do të ishte në dëm të forcimit të Partisë. Sigurisht, edhe në pranimin e nepunësve dhe të intelektualëve duhet observuar që të zbatohen me kujdes dhe rreptësi kërkesat e Statutit, por nuk duhet t'u qëndrojmë skllevër përqindjeve, ndryshe nuk do të vepronim në interes të Partisë.

Le të marrim si shembull sektorin e ushtrisë. Atje, në shumicën dërrmuese, nuk kemi përveçse nepunës, e kam fjalën sidomos për oficerët, dhe vetëm një përqindje fare e vogël e efektivit janë punëtorë, por këta punojnë në repartet ndihmëse, siç janë oficinat dhe punishtet e ndryshme të ushtrisë. Atëherë, në qoftë se do t'u mbetemi skllevër përqindjeve, ne do t'i kufizonim pranimet në Parti nga ushtria vetëm përfaktin se kemi të bëjmë me nepunës dhe nuk do të pranonim në organizatat e Partisë në ushtri shokë nga më të mirët e më të vendosurit.

Atëherë si duhet të veprojmë, konkretisht, lidhur me çështjen e pranimeve në ushtri? Të ndjekim kriteret që përmenda më sipër, të kemi parasysh rëndësinë e një reparti ose të një tjetri, shpërndarjen e komunistëve, nevojat që ka reparti qoftë në sektorët teknikë, qoftë rië ato politikë etj. Në këtë mënyrë t'i bëjmë llogaritë dhe të nxjerrim se për sa komunistë ka nevojë akoma kjo organizatë-bazë ose grup-organizatë partie mbi numrin e atyre që janë. Duke e kuptuar kështu këtë çështje, atje duhet, domosdo, të pranojmë elementë të rinj, po nga më të mirët dhe të mos shqetësohemi se sa do të na dalë përqindja. Kjo nuk duhet të na pengojë. Ne të nisemi, në radhë

të parë, nga nevoja e forcimit të Partisë dhe e shtrirjes së drejtë të forcave të saj.

Çështja e pranimeve në Parti duhet të kuptohet mirë edhe për arsimtarët ose për punonjësit e tjerë të frontit të kulturës. Komitetete të Partisë ne duhet t'u tërheqim vëmendjen në këtë drejtim, me qëllim që kjo të kuptohet drejt dhe çdo gjë të bëhet në mësën e duhur, se ky problem mund të jetë si thika me dy presa. Por, në rastet kur numri i inteligjencies në një vend është mjaft i madh dhe nga radhët e saj nuk kemi elementë në Parti, atëherë, të ngurrosh të bësh pranime do të ishte një qëndrim i gabuar, sektar. Prandaj, edhe në këtë sektor, për forcimin dhe zgjerimin e Partisë, ta hedhim çapin sipas nevojave, të mos i pengojmë ata elementë që i përbushin kushtet dhe kërkesat e Statutit, kur ne kemi nevojë dhe na duhet të pranojmë në Parti edhe nga këto shtresa.

Por Partia në asnjë mënyrë nuk duhet të harrojë që, në gjithë këtë punë, theksin kurdoherë ta vërë, në radhë të parë, në pranimin e elementeve që vijnë nga klasa punëtore, pastaj nga fshatarësia punonjëse, natyrisht, pa lënë në harresë edhe intelektualët. Direktivat e Partisë të shihen kurdoherë në këtë pri-zëm. Natyrisht, këto punë nuk bëhen me fushata dhe pa studime të vazhdueshme. Edhe shokët e Fierit, studimin që kanë filluar për këtë problem duhet ta konsiderojnë vetëm si një hap që po bëjnë, vetëm si një shkallë që po ngjitin, sepse përpëra kanë akoma shumë detyra të tjera, për zbatimin e të cilave duhet të punojnë. Dua të them se puna që po bëjnë shokët e Fierit, sipas rekondimeve të Komitetit Qendror,

nuk do t'i zgjidhë të tëra këto çështje, po ajo është e do të jetë një ndihmë që do të na shërbejë të gjithëve për të ecur si duhet në drejtim të forcimit të Partisë, për zgjerimin e radhëve të saj etj.

Në raportin që na është paraqitur thuhet se organizatat-bazë nuk kanë shumë iniciativë në zërthimin e direktivave të Partisë. Kjo është e vërtetë dhe të gjithë e dimë këtë dobësi, por çështja është që duhen gjetur mënyrat dhe metodat për t'i bërë ato që të kenë iniciativë. Lidhur me këtë, mendoj se shembullin duhet t'ua japim ne, sepse shembulli i dhënë nga komitetet e Partisë dhe nga Komiteti Qendror ka rëndësi të madhe. Por, në lidhje me zërthimin e direktivave, dobësi kemi edhe ne në aparatin e Komitetit Qendror, megjithëse ne nuk jemi në stadin e organizatave-bazë.

Aktualisht, kur bëhet ndonjë plenum, shokëve u dërgohen tezat, të përmbledhura në 5-6 pika, mbi të cilat do të mbahet raporti dhe u rekomandohet të përgatiten për diskutimet që do të bëhen. Shokët e plenumit i marrin tezat, mendojnë mbi to dhe shkojnë në mbledhje, ku në fillim dëgjojnë raportin. Mua më duket se këtë praktikë nuk e kemi të mirë. Nuk është nevoja, mendoj, t'u dërgojmë shokëve tezat, mund të ishte më mirë t'u jepej vetëm çështja që do të trajtohet dhe anëtarët e plenumit të vrasin vetë mendjen për problemet që dalin rrëth saj. Por edhe kjo, ndoshta, nuk është e mjaftueshme. Shoku Manush<sup>1</sup> na thotë se në organizatën e Tiranës men-

---

<sup>1</sup> Shoku Manush Myftiu, në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës.

dojnë të zbatojnë një eksperiencë, që, më duket, e kanë të drejtë dhe mund të zbatohet edhe nga ne, edhe nga komitetet e Partisë të rretheve të tjera. Ata kanë menduar të mos ua japin tezat shokëve, po, në vend të tyre, t'u dërgojnë projektvendimin që është, në fakt, zbërthimi i direktivave të raportit që do t'i paraqitet plenumit. Anëtarit të plenumit, i kërkohet jo vetëm të mendojë rreth problemit, por, gjithashtu, përpara se të vijë në mbledhje, të marrë për projektvendimin e dërguar edhe mendimin e organizatës-bazë ku bën pjesë. Duke vepruar kështu, do të nxitet mendimi krijues i secilit për probleme të caktuara.

Plenumi bëhet, natyrisht, për të hedhur disa mendime, të cilat, pasi të diskutohen, duhet të vendosen dhe të bëhen përpjekje që të realizohen në jetë. Praktika e dërgimit të projektvendimit anëtarëve të plenumit e nxit mendimin e komunistëve dhe kam besim se ajo do të ndihmojë. Kjo është një formë, por Partia në bazë mund të gjejë forma të tjera të shumta që do të lindin nga puna e madhe që po bëhet kudo.

Po ne pse kemi ndjekur rrugën e dërgimit të tezave? Se kjo është një punë shumë më e lehtë, bile, tezat përgatiteshin edhe më parë se të përgatitej vetë raporti. Ne mund ta zbatojmë eksperiencën e organizatës së Tiranës, por të mendojmë për të gjetur edhe forma të tjera që t'i nxitim më mirë organizatat-bazë që të kenë iniciativë dhe, në këtë drejtim, siç thashë, shembullin duhet ta japim ne. Kur baza të shohë si punojmë ne, kur ne t'ua japim praktikisht eksperiencën dhe shembullin tonë, atëherë, pas disa muajsh, edhe organizatat-bazë do të dinë çfarë detyrash u

dalin dhe si të punojnë për t'i kryer ato. Kësaj pune ne duhet t'i futemi që pas plenumit të ardhshëm të Komitetit Qendror.

Kam edhe një rekomandim për problemin e gruas. Ngritja e grave në përgjegjësi ose futja e tyre në Parti është vetëm njëra anë e problemit të madh që kemi shtruar në lidhje me gruan dhe, bile, më e lehta. Ne do ta bëjmë këtë për të gjitha ato arsyet që kemi thënë dhe, sigurisht, kur vetë gratë e meritojnë të pranohen në Parti ose të vihen në udhëheqje, dhe në këtë drejtim më duket se nuk është filluar keq. Mirëpo, sa e bëjmë këtë punë, e quajmë sikur e kryem detyrën, më pas gratë e pranuara në Parti ose ato që i ngremë në përgjegjësi i lëmë pas dore, nuk kujdesemi më për to. Po të veprohet kështu, duhet ta dimë që tani se nuk kemi bërë gjë. Këtë e them se ne e kemi shtruar edhe herë të tjera këtë çështje. Edhe më parë shumë gra i kemi ngritur në përgjegjësi, duke i vënë kryetare kooperativash bujqësore, brigadiere etj., por, pas dy-tre vjetësh, ato janë hequr përsëri, sepse askush nuk është kujdesur t'i ndihmojë, t'i udhëzojë, t'i inkurajojë e t'u forcojë besimin në punë. Kjo nuk tregon tjetër përveç dobësisë së punës sonë me njerëzit e rindj, sidomos me gratë. Kjo dobësi, përveç të tjerave, vjen edhe nga mentaliteti i vjetër i njerëzve, se gruaja është një krijësë e dobët, prandaj besim ka më shumë te burrat, se gjoja vetëm ata janë të fortë dhe të aftë për çdo punë. Këto mendime prapanike të masës ndikojnë edhe mbi ne komunistët, prandaj edhe i lëmë pas dore ato gra që ngremë në përgjegjësi, të cilat, nga

mungesa e ndihmës dhe nga gjithë ky presion që bëhet mbi to, bien në punë, nuk kanë rezultate. Përveç kësaj, atyre u qepen edhe plot gjëra të tjera për t'i diskredituar, për t'i luftuar, duke përhapur mendimin sikur nuk qenkan të zonjat, po sidomos se «nuk janë të ndershme», «janë imorale» etj. Para ca kohësh shokut Hysni [Kapo] i kishte ardhur një letër nga një grua, e cila ankohej se trajtohej keq jo vetëm nga fshati, por edhe nga organet në rreth, nuk i përfillnin ankesat e saj, pse kjo grua qenkej «imorale». Shoku Hysni, në këtë rast, me shumë të drejtë, u tha shokëve të rrethit: «Pse të vihet në shenjë kjo grua dhe të mbahet një qëndrim i tillë ndaj saj? Ju thoni se qenka «imorale», mirëpo kjo grua këtë imoralitet e ka bërë me burra, a nuk është kështu? Nëse po, atëherë përsë nuk merren masa edhe kundër këtyre burrave imoralë që i janë qepur pas kësaj gruaje, po vetëm kundër saj? Pse nuk keni mbledhur gjithë fshatin, ku të jetë edhe gruaja në fjalë, dhe t'i kërkohet të tregojë me gisht këta burra?». Pra, edhe sikur të ndodhë një rast si ky, nuk është e keqe vetëm kjo grua, por janë edhe burrat që i venë pas asaj, mirëpo shokët në bazë e gjejnë më kollaj të marrin masa vetëm kundër gruas që ka bërë një gabim, kurse për burrat, që në këtë rast janë shkaktarë të vërtetë të këtij imoraliteti, nuk merret asnjë masë.

Si ky shembull në jetë ka edhe shumë të tjerë. Prandaj Partia duhet t'u qëndrojë mbi kokë të gjitha gjérave. Nuk është e thënë që të gjitha gratë që ngremë në përgjegjësi të jenë flutura, të jenë plotësisht të zonjat. Ka edhe të pazonja midis gjithë kësaj mase

grash, po më parë se të mendojmë për t'i hequr, duhet t'u japim dorën, t'i ndihmojmë, të shohim nga afër ku i kanë pengesat dhe dobësitë, ku nuk e bëjnë dot punën, t'i udhëzojmë dhe t'i mësojmë si të punojnë. Nuk ka lindur njeri i ditur. Kur ndonjëra duket se, edhe pas gjithë kësaj ndihme që i është dhënë, nuk e kryen dot detyrën e ngarkuar, atëherë, kuptohet, s'kemi si e mbajmë, do ta heqim, pse nuk mund të mbajmë në atë vend pune një grua vetëm se është grua, kur shihet se ajo s'e bën dot. Por, në fillim, kur gjen vështirësi, një herë, dy, duhet dhe e kemi për detyrë ta ndihmojmë. Me këtë dua të them që vërtet t'i ngremë gratë në vende drejtuese, po të mos harrojmë që duhet edhe t'i ndihmojmë me qëllim që të fitojnë aftësi dhe besim në veten e tyre.

Një çështje tjetër që dua të prek është ajo e forcimit të rolit të organizatave-bazë të Partisë në kooperativat bujqësore.

Mua më duket se e kemi më të përcaktuar çësh-tjen e së drejtës së kontrollit të organizatave-bazë të Partisë mbi ndërmarrjet ekonomike, kurse kontrollin e organizatave-bazë mbi kooperativat bujqësore nuk e kemi, si duhet, të përcaktuar. Kompetencat e organizatave-bazë në përgjithësi i kemi, po mendoj se do të ishte mirë sikur këto t'i studionim edhe një herë, sidomos për kooperativat bujqësore.

Duke marrë parasysh karakterin e kooperativave bujqësore, si organizata ekonomike, ne mund t'i përcaktojmë edhe më mirë kompetencat e organizatave-bazë. Natyrisht, këto kompetenca, mendoj unë, nuk

mund të jenë njëlloj si në industri. Shokët e komiteve të Partisë mund ta gjykojnë më mirë se deri ku duhet të arrijnë këto kompetenca. Nëpërmjet një studimi të tillë duhen svaruar një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organizatës-bazë dhe me ushtrimin nga ana e saj të kontrollit mbi jetën ekonomike, politike e ideologjike të kooperativës. Duhet të dalin vështirësítë që hasen lidhur me kompetencat e organizatës-bazë dhe të kryesisë, ku bien ato në kontradiktë, për të përcaktuar nëse këto apo ato çështje praktike të punës i përkasin organizatës apo kryesisë etj. Me një fjalë, ndihet nevoja që të svarohet më mirë si duhet kontrolluar, ndihmuar e drejtuar kooperativa nga ana e organizatës-bazë të Partisë. Në qoftë se përcaktimet i kemi mirë, atëherë s'ka arsyе përsë të insistojmë që ato të rishikohen edhe një herë, përndryshe ky studim duhet bërë. Por Partisë i intereson të dijë nëse ndihet udhëheqja e organizatës-bazë në kooperativë dhe sa e si ndihet kjo. Mua më duket se këtë rol atje ne duhet ta forcjmë akoma. Mundet që ndihet, disi, autoriteti i sekretarit të organizatës, kur ai i thotë kryesisë çfarë duhet bërë, çfarë masash duhen marië për të mbjellë etj., por çështja është se sa dëgjohet fjala e tij për të gjitha problemet, sa zbatohen orientimet e organizatës-bazë, e cila i shtron çështjet edhe në kryesi, edhe në asamble. Me një fjalë, organizata-bazë e Partisë, që udhëheq gjithë jetën ekonomiko-shoqërore dhe politiko-ideologjike në kooperativë, i ka vallë të dyja këmbët në tokë apo jo? Në ndërmarrjet industriale, veç organizatës-bazë, kemi edhe bashkimet pro-

fesionale, edhe mbledhjet e prodhimit, atje kemi edhe forma të tjera nëpërmjet të cilave organizata e Partisë udhëheq, kurse në kooperativa nuk kemi, bile edhe komisionet për të cilat kemi folur, nuk punojnë dhe janë lënë në harresë.

Shoku Hysni u rekomandoi përsëri shokëve të rritheve që fondi i tokës, që u krijua nga zvogëlimi i oborreve kooperativiste, të planifikohet në mënyrë që prodhimi që do të dalë andej, t'u ndahet të gjithë anëtarëve sipas ditëve të punës. Edhe prodhimet bleg-torale, që do të merren nga bagëtitë e grumbulluara, nga zvogëlimi i numrit të krerëve të çdo oborri koo-perativist, të trajtohen në mënyrë që një pjesë ose, po të jetë nevoja, i tërë prodhimi, t'u shpërndahet familjeve kooperativiste. Ne u detyruam ta përsëritim edhe një herë këtë, sepse konstatuam që mbas 6-7 ditësh si u dhanë orientimet në qendër, këto nuk kishin shkuar akoma as në kryesitë e kooperativave bujqësore, lëre pastaj që ato t'u ishin svaruar masave kooperativiste. Po pse ngjet kjo? Sepse partia në bazë nuk vihet menjëherë në dijeni për këto orientime, me vonesë vihen në dijeni edhe kryesitë e kooperativave, bile këto pak i vë në dijeni kryetari për ato që merr nga rrathi, dhe kështu punët mbeten zvarrë, kriohen vështirësi dhe atje poshtë mendohet se për çdo gjë duhet të interesohet, në radhë të parë, shteti. Kjo nuk është e drejtë. Partia dhe Qeveria kanë dhënë porosi të qarta që fondi i tokës, i shkurtuar nga obo-rret kooperativiste, si dhe bagëtitë e grumbulluara po prej tyre, duhet të shfrytëzohen përsëri në interesin e kooperativës, por në mënyrë më të organizuar dhe

të drejtuar nga ajo, sepse një gjë e tillë, për kushtet e tanishme është e domosdoshme. Të tëra këto prodhime duhet të jenë të anëtarëve të kooperativave, për të plotësuar nevojat e tyre, kurse ka disa kryetarë kooperativash që thonë të shihet vetëm interes i shtetit, prandaj, oburra, mbillni në këto toka çdo gjë, pa menduar aspak për nevojat e anëtarëve. Ata gabojnë rëndë kur mendojnë dhe veprojnë kështu, prandaj duhet të preokupohen seriozisht për nevojat e anëtarëve të kooperativës.

Sikur të funksiononin si duhet komisionet që kemi në kooperativa, kryetari i kooperativës, që ka marrë udhëzime të freskëta në rrëth, sa të shkonte në fshat do të mblidhte me radhë të gjithë kryetarët e komisioneve, do t'u tregonte çfarë direktivash i dhanë në komitetin ekzekutiv, kulturat që duhen mbjellë, për nevojat e anëtarëve, në tokat e siguruara nga shkurtimi i oborreve dhe do t'i porosiste ata që të mblidhnin menjëherë anëtarët e komisioneve, të bisodonin bashkë me ta për të parë çfarë dëshirojnë anëtarët të mbillet në to dhe, në përgjithësi, si të merrnin mendimin e shumicës, të planifikonin çfarë duhej bërë. Po kështu për çështjen e qumështit, komisionit që merret me problemin e blegtorisë kryetari i jep porosi që, brenda një muaji, disa të ngrenë stailën, një pjesë të interesohen për bazën ushqimore, të tjerë për përgatitjen e punishteve për nxjerrjen e bulmetit për anëtarët etj. Kështu aktivizohet një numër i madh kooperativistësh. Por një gjë e tillë nuk bëhet. Komisionet janë lënë në harresë, nuk aktivizohen, megjithëse për këtë është folur shumë herë.

Kështu, që tani kryetari duhet të mendojë edhe përkazanët, edhe për stallat, edhe për bazën ushqimore, përlëndën e drurit, përgozhdët etj., etj. Mirëpo, duke ia lënë të gjitha gjërat mbi kurriz një njeriu, zbatimi i detyrave zvarritet dhe këto mbeten të realizohen në kalendat greke. Një metodë e tillë pune nuk është e drejtë dhe, në këtë mënyrë, punët në kooperativë nuk ka si të shkojnë mirë.

Të gjitha këto që vënië në dukje, siç janë funksionimi i komisioneve, eksperienca e nxjerrë nga mbledhjet e organizatave-bazë të Partisë për dhënie llogari e zgjedhjet etj., të mos mbeten në letër, por të shfrytëzohen për të mirën e përparimin e punës. Iniciativat e mëdha që kanë lindur duhet të mbahen gjallë vazhdimisht nga ana jonë. Prandaj, mendoj se është e domosdoshme që të studiohet si t'i ndihmojmë ca më shumë dhe t'i vëmë më në lëvizje organizata-bazë të Partisë në kooperativat bujqësore.

Kam edhe një çështje tjeter që mendoj se duhet parë: puna me instruktorët e Partisë. Tani që do të krijojmë komitetet e Partisë në një sërë zonash të thella, mendoj që sekretarë partie në këto komitete të dërgohen shokë që tani punojnë si instruktorë të komiteteve të Partisë të rrtheve. Kjo do të jetë një gjë shumë e mirë, pasi instruktorët janë shokë me eksperiencë në punën e Partisë. Por duhet njojur se puna jonë me instruktorët është akoma e dobët, as vetë ata nuk e ndiejnë përgjegjësinë e plotë që kanë përparrë komiteteve të Partisë. Kuptohet sikur përgjegjësia e tyre qëndron vetëm në vajtjen në bazë dhe, kur kthehen në rrëth, në dhënen e raportit ose të

informacionit për punën e bërë gjatë muajit. Dhe këto raporte e informacione ose kanë shumë fjalë, ose e paraqesin situatën fare të zezë. Sipas tyre, gabimin apo fajin për këtë gjendje e kanë, sigurisht, shokët në bazë. Me të tilla materiale kënaqen edhe sekretarët e Partisë që, bile, i lavdërojnë instruktorët për këtë punë. Ka pastaj disa instruktorë të tjerë që gjendjen në bazë e zbukurojnë dhe as që thellohen të shikojnë problemet konkrete, nëse u korr ose nuk u korr misri apo bari etj. Ata, kur vjen puna për këtë, fajin ua hedhin gjithashtu njerëzve në bazë dhe vetë justifikohen me atë se mendimet e tyre ia kanë dhënë komitetit të Partisë. Me këto veprime lënë përshtypjen sikur janë njerëz të zhdërvjellët dhe nuk u kërkohet asnjë përgjegjësi si instruktorë për zonat ose organizatat që kanë në ngarkim. Prandaj, unë mendoj se do të jetë më mirë sikur një pjesë e instruktorëve të dërgohen të punojnë në zonat e thella, t'u qepen organizatave-bazë dhe të marrin përgjegjësi të plotë për tërë punën, të përgjigjen për gjithçka, domethënë edhe pse nuk janë mbjellë gruri, misri, duhani etj., etj.

Pra, kështu si po gjykojmë, instruktori mund të dërgohet në zonë si përgjegjës për disa organizata-bazë, që të lidhet më ngushtë me to. Për këtë eshtë e rekomandueshme që ai të marrë me vete edhe familjen, që të punojë dhe të jetojë pranë organizatave-bazë. Mua më duket se kjo do ta shpëtonte komitetin e Partisë nga kënaqësia që ka tanë. kur dërgon në bazë njeriun e vet, të cilin e pret në fund të muajit që të vijë t'i raportojë. Shokët e komiteteve të Partisë mund të thonë se, duke vepruar kështu, do të mbeten

pa instruktorë. Unë mendoj që jo, sepse komitetit të Partisë, kur t'i duhet një instruktor, e thërret në aparat ose, sipas rastit, mund të shkojë sekretari i komitetit të Partisë ta takojë instruktorin në vend.

Natyrisht, në aparat do të duhet të qëndrojnë disa instruktorë për të përgatitur materiale dhe për çështje të tjera, por puna është që ta bënim një studim të tillë dhe të përpinqemi të gjejmë disa forma të ndërmjetme për t'i lidhur më mirë instruktorët me bazën, që komitetet e Partisë të kenë mundësi dhe të jenë në gjendje t'i aktivizojnë si duhet të gjithë këta shokë me eksperiencë, në mënyrë që ata të japin kontributin maksimal për të ndihmuar komitetet e Partisë dhe bazën. Si e qysh mund të bëhet kjo gjë, ju, shokët e rretheve, mund të na jepni mendime më të mira dhe eksperiencën tuaj për këtë çështje.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## ÇESHTJET E EDUKIMIT PËRBËJNË NJË KOMPLEKS TË TERË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

26 maj 1967

Mendoj që sekretarët e organizatave-bazë të dalin nga radhët e komunistëve të kooperativës dhe të mos dërgohen nga gjetkë. Në parim, shokët e Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës e kanë më drejt nga shokët e Elbasanit. Megjithatë, kur e duan kush-tet, si në rastet që solli shoku Jashar Menzelxhiu<sup>2</sup>, mund dhe do të dërgojmë në fshat edhe sekretarë të organizatave-bazë, po më mirë është të zgjidhen sekretarë shokë vendës, komunistë nga të kooperativës, për të gjitha arsyet që tha shoku Mihallaq Ziçishti<sup>3</sup>.

---

1 Kjo mbledhje mori në analizë raportin «Mbi gjendien dhe punën për edukimin e sekretarëve të organizatave-bazë të Partisë».

2 Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit.

3 Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës.

tisë, sidomos në seminaret njëditore, mund të reduktohen në gjysmë ore. Ato janë më shumë udhëzime, kurse rëndësi ka të dihet çfarë i preokupon vetë organizatat-bazë dhe pikërisht këto qështje ne mund t'i trajtojmë në seminaret triditore, që bëhen dy herë në vit. Prandaj, nuk është e drejtë të caktohet nga lart, nga komiteti i Partisë, çdo temë që do të bëhet në seminar. Natyrisht, do të zhvillohen edhe tema të caktuara nga komiteti i Partisë, si, për shembull, tema mbi imperializmin, revizionizmin etj., por këto shpesh mund t'u jepen pjesëmarrësve edhe nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve që do të bëjë baza. Në këtë mënyrë vëmë në lëvizje të gjithë Partinë dhe luftojmë shablonizmin.

Kjo punë ka edhe një të mirë tjetër. Po të veprojmë kështu, ne bëjmë, njëkohësisht, edhe edukimin e sekretarëve të komiteteve të Partisë, sepse ata, para se të venë në seminar, do të detyrohen të mendojnë dhe të përgatiten si duhet për pyetjet e shumta që organizatat-bazë do t'u bëjnë komiteteve të Partisë. Kjo do t'i nxitë sekretarët e komiteteve të Partisë të vrasin mendjen dhe të venë në seminar të përgatitur mirë. Puna që do t'u duhet të bëjnë për këtë qëllim, do të jetë, pra, një edukim për vetë sekretarët e komiteteve të Partisë.

Kur të zhvillohen kështu seminaret, do të zgjidhet edhe problemi që kemi ngritur, se shumica e sekretarëve të organizatave tona bazë akoma nuk dinë të mbajnë shënimë. Mirëpo, kur këta t'i kërkojnë komitetit të Partisë sqarime për një ose dy qështje dhe kur sekretari i komitetit të Partisë t'ua shpjegojë ato, atë-

herë sekretarët e organizatave-bazë do të mbajnë shënimë për çështjet që u interesojnë. Kështu, ata, gradualisht, do të mësohen të mbajnë pastaj shënimë edhe për gjëra të tjera.

Nëpërmjet kësaj pune duhen gjetur mënyrat edhe për t'u plotësuar shokëve disa boshllëqe që kanë. Çështjet që shtrohen në seminar, qofshin ato për të cilat mendon vetë komiteti i Partisë me iniciativën e tij, qofshin ato që trajtohen në bazë të kërkesave që bëjnë organizatat-bazë, mund të jenë politike, ideologjike ose organizative, por ato mund të jenë edhe çështje teknike. Për shembull, një organizatë-bazë mund t'i kërkojë komitetit të Partisë shpjegime, për ç'arsye bëhet ndërzimi artificial i deleve, të cilat nuk kanë vlera zooteknike, dhe komiteti i Partisë duhet t'i përgjigjet organizatës-bazë për këtë problem, pavarësisht se ka karakter teknik. Në këtë mënyrë do të dalin një mori problemesh e temash që do të vënë vazhdimisht në lëvizje organizatat-bazë dhe komitetet e Partisë.

Mendoj, përvëç të tjerave, se nga një punë e tillë do të dalin edhe temat për edukimin e instruktörëve dhe të të gjithë punonjësve të tjerë të aparateve të komiteteve të Partisë, që shpesh kufizohen në çështje fare të thjeshta. Temat e edukimit me instrukturët dhe punonjësit e aparateve të Partisë duhet të zhvillohen në një nivel më të lartë sesa seminaret me sekretarët e organizatave-bazë. Këta parashtrojnë një mori pyetjesh, të cilat klasifikohen dhe përgjigjet përgatiten në një nivel të tillë teorik që ata të jenë në gjendje t'i kuptojnë, kurse për in-

struktorët dhe punonjësit e aparateve të Partisë, që janë shokë më të ngritur, temat duhet të kenë një nivel më të lartë.

Siq shihet, pra, kjo punë nxjerr nevojën që temat të trajtohen në dy nivele, në nivelin e bazës në seminaret që thamë dhe në nivelin e punonjësve të aparateve të Partisë. Kjo është një punë konkrete parë, shumë e dobishme për ngritjen e komunistëve.

Mua më duket që çështjet e edukimit duhet t'i lidhim me kujdes me njëra-tjetren. U përmendën këtu të gjitha anët mbi këtë çështje, me përjashtim të njërites. U fol për çështjen e seminareve njëditore dhe për ato që bëhen dy herë në vit, u bënë propozime të ndryshme për seminaret që mund të zhvillohen për një kohë më të gjatë ose për kurse, po, përveç këtyre, me shumë rëndësi, mendoj, çshtë edhe çështja e vetedukimit, çështja e studimit individual. Më duket se të gjitha këto çështje nuk duhen marrë të shkëputura, sepse të gjitha së bashku përbëjnë një kompleks të tërë, lidhen ngushtë me njëra-tjetren dhe në qoftë se do t'i marrim të shkëputura, nuk do t'ia arrijmë dot qëllimit.

Jam me mendimin e shokut Jorgji Sota<sup>1</sup> që të mos i kodifikojmë gjërat, por as të mos ecim në tym, të mos i bëjmë sa për të shkuar radhën. Duhen koordinuar seminaret njëditore me ato që bëhen dy herë në vit, me studimin individual dhe me kurset e Partisë. Të kemi, pra, parasysh çfarë bëhet në një formë dhe

---

<sup>1</sup> Në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Durrësit.

çfarë duhet bërë në një tjetër; ato që do të shpjegojmë në seminarin njëditor që bëhet çdo muaj, të mos i përsëritim në seminaret që bëhen dy herë në vit. Pastaj, do të ketë çështje që do t'ua ngarkojmë sekretarëve të organizatave-bazë t'i lexojnë vetë dhe organizata-bazë ta kontrollojë me kujdes këtë punë. Për shembull, Statutin e Partisë ose ndonjë material tjetër të rëndësishëm, duhet ta lexojë dhe ta studiojë vetë sekretari i organizatës-bazë në shtëpi, qoftë edhe shumë herë, sepse, nga një përpjekje e tillë, diçka do t'i mbetet në kokë. Kjo punë do të jetë një plotësues i asaj që do të bëjë ai për edukimin e tij ideologjik dhe politik. Bile, edhe leximi me kujdes i gazetës është gjithashtu një edukim për të.

Dukë pasur parasysh të gjitha këto, ne mund të hartojmë një plan të madh edukimi për të gjithë vitin, tek i cili pjesën më të madhe duhet ta zënë përpjekjet për vetedukim. Këtë plan dhe kontrollin e punës së vetedukimit nuk duhet t'i harrojmë. T'i vihen këmbët në një këpucë për këtë çështje çdo komunisti, të përcaktohen konkretisht materialet që duhet të studiojë secili dhe të kontrollohet herë pas here nga organizata-bazë. Ne duhet të insistojmë shumë në këtë punë, sepse kjo do të na lehtësojë për realizimin e detyrave. Po të mos e bëjmë këtë me sekretarët e organizatave-bazë, ata nuk kanë si të jetojnë me direktivat e Partisë, të Komitetit Qendror ose me çështjet që trajton çdo ditë shtypi i Partisë. Këtë detyrë në asnjë mënyrë nuk duhet ta lëmë pas dore. Të mos justifikohemi me punët që kemi, pse situatat kanë ndryshuar, shokët e Partisë tashmë nuk janë analfabetë; çështjet e vijës

së Partisë, çështjet thjesht ideologjike ata, në përgjithësi, i dinë, i kanë kuptuar në parim, vetëm duhet t'u thellojmë. Të gjithë komunistët tani, edhe në fshat, kanë bërë nga një shkollë, kush pesë, kush shtatë ose më shumë klasë, domethënë janë në gjendje ta lexojnë shtypin dhe t'i kuptojnë deri diku mirë direktivat e Komitetit Qendror. Të gjitha këto çështje duhen marrë në kompleks, jo të shkëputura. Gjithashtu, të gjithë sekretarëve të organizatave-bazë duhet t'u bëhet e ditur detyra që kemi vënë, e cila qëndron gjithnjë në fuqi, që ata të bëjnë përpjekje që të mbarojnë shkollat tetëvjeçare.

Kisha edhe një vërejtje për aparatet e komiteteve të Partisë. Konstatojmë se sekretarët e organizatave-bazë thirren shumë nëpër mbledhje. Ju, shokë sekretarë të komiteteve të Partisë, kini parasysh që ata të thirren në komitetin e Partisë vetëm kur duhet dhe jo për çdo gjë, sepse ka raste që lajmërohen të vijnë edhe për një fjalë apo komunikim të thjeshtë. Në raste të tilla sekretari i organizatës-bazë mund të dërgojë edhe një njeri tjeter, prandaj jo kushdo, që i teket në aparatin e komitetit të Partisë, duhet të ketë të drejtën të thërrasë sekretarët e organizatave-bazë. Po të veprohet kështu, siç po ndodh në disa raste, ata do të humbin kohë, nuk do të merren me punë konkrete për të ndjekur zbatimin e vendimeve dhe të detyrave, kështu që nuk kemi pse t'i kritikojmë pastaj që nuk japid shembullin personal.

Sekretarët e organizatave-bazë të lihen të kryejnë funksionet e tyre si të tillë, prandaj duhet menduar mirë se kur është koha që të njoftohen për të ardhur

në komitetin e Partisë dhe kjo të bëhet vetëm për probleme të rëndësishme. Komitetet e Partisë duhet të kujdesen dhe të mos lejojnë që ata të thërriten kohë e pa kohë në çfarëdolloj mbledhjesh ose takimesh në aparatin e Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## TË MENDOJMË THELLË PËR MODERNIZIMIN E BUJQËSISE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

27 maj 1967

Nuk do të futem në detaje mbi çështjet që shtruan shokët, me të cilët jam dakord, por dëshiroj të theksoj:

Së pari, çështjet e bujqësisë, t'i shikojmë më realisht dhe të mos pandehim se ato janë plotësisht të njohura nga ne.

Së dyti, mendoj se ne duhet ta analizojmë metodën tonë të punës në bujqësi, qoftë në drejtim të punës politiko-ideologjike, qoftë në drejtim të zbatimit në praktikë të direktivave.

Së treti, mendoj, gjithashtu, që problemet e bujqësisë nuk duhet t'i marrim të shkëputura nga njëratjetra. Çdo veprim në bujqësi kërkohet ta koordi-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u morën në analizë raportet e paraqitura nga komitetet e Partisë të rretheve Skrapar, Tepelenë dhe Gramsh «Mbi masat për zbatimin e detyrës së caktuar nga Kongresi i 5-të i PPSH për sigurimin e bukës në vend».

nojmë me të gjitha veprimet e tjera, sepse, me gjithë sukseset që kemi, na vihet detyrë që, mbi bazën e tyre, në të ardhmen të ecim edhe më përpara, por me ritme e metoda më të përparuara dhe me një organizim më të mirë. Veprimet tona në këtë drejtim duhet të janë të tilla që frytet e punës që po bëjmë të janë më rentabël, si në sasi e cilësi, ashtu edhe në kohë.

Ne kemi 23 vjet që po punojmë dhe kemi pasur suksese në bujqësi, por niveli i tyre ka qenë i kushtëzuar nga disa rrethana. Tani, që na janë krijuar mundësi të shumta, na vihet detyrë dhe kemi besim që, me një punë më të organizuar dhe duke i kupltuar drejt problemet, bujqësinë do ta modernizojmë me plot kuptimin e fjalës.

Kam përshtypjen se ministri i Bujqësisë<sup>1</sup> nuk është si duhet në krye të drejimit të punëve në bujqësi. Për këtë mendoj se atij i bie një përgjegjësi e madhe. Kështu do të ndodhë edhe në të ardhmen, në rast se edhe këtej e tutje nuk do të vihet si duhet në krye të punëve të dikasterit që drejton. Prandaj, ose do ta futim Ministrinë e Bujqësisë në këto koncepte pune, mendimi e zbatimi në praktikë, ose do të mbetemi në vend numëro dhe do të çalojmë në këtë fushë me rëndësi jetike për vendin tonë.

Atëherë, duhet ta shtrojmë kështu problemin: për ta modernizuar bujqësinë, për ta transformuar e për ta pastruar atë nga mentalitetet dhe traditat e gabuara që ekzistojnë, Ministria e Bujqësisë duhet, në radhë të parë, t'i ketë mirë parasysh të gjitha këto

---

<sup>1</sup> Pirro Dodbiba.

çështje të rëndësishme. Kur them se ju, punonjësit e ministrisë, nuk jeni interesuar për problemet e maliësisë, çështja nuk duhet kuptuar vetëm me vajtjen në vend. Çështja është që ministri i Bujqësisë, kur të vejë në një rrëth malor, ta zëmë në Tepelenë, të shتروhet mirë, në mënyrë që të gjitha problemet kyç që e preokupojnë këtë rrëth për sektorin e bujqësisë, t'i zgjidhë gjer në fund, të paktën në parim.

Është fakt se bujqësia jonë ka ecur përpara dhe kemi bindje se ajo do të përparojë edhe në të ardhmen. Është, gjithashtu, fakt që shokët e Ministrisë së Bujqësisë, natyrisht, nuk rrinë duarlidhur, ata punojnë dhe drejtojnë, por pas 23 vjetësh çlirim nuk mund të pranojmë më që në disa rrethe të marrim edhe tani nga 5 kuintalë grurë për hektar, kur janë krijuar mundësitë që të marrim nga 25. Një gjendje e tillë duhet të na preokupojë seriozisht të gjithëve dhe të punojmë si duhet që kjo situatë të ndryshohet medoemos. Kjo do të thotë të modernizosh bujqësinë, gjë që do të bëhet kur ne të vihemë në rrugën e ecjes përpara në këtë fushë me ritme e metoda më të përparuara dhe në mënyrë më të organizuar. Në rast se Ministria e Bujqësisë, në radhë të parë, do të vihet vetë në këtë rrugë, në shembullin dhe drejtimin e mirë të saj do të punojnë më shumë edhe rrëthet e kooperativat bujqësore dhe atëherë ne do t'i arrijmë me siguri objektivat e parashikuar.

Ministria e Bujqësisë nuk duhet të ecë në bisht të situatës. Ajo nuk duhet të qëndrojë pasive nën saçin e thënieve të njërit dhe të tjeterit dhe në rast se sot ngjet një gjë e tillë, kjo vjen sepse ministria

nuk po i kryen si duhet detyrat, nuk është si duhet në krye të punëve. Prandaj bëhen herë pas here ndërhyrje për probleme të bujqësisë për të marrë këtë ose atë masë, sepse duken defekte, të cilat pengojnë zhvillimin e saj si duhet, në mënyrë të harmonizuar dhe të balancuar në të gjitha drejtimet. Ne vetë i themi ministrit t'i japë, fjala vjen, kaq traktorë Skraparit, më vonë i themi të bëhet kjo ose ajo vepër ujitjeje etj. Këto janë disa vendime që ne i marrim qoftë kolegialisht, qoftë individualisht, se shohim që Ministria e Bujqësisë akoma nuk ka një plan të studiuar mirë që ta zbatojë me një disiplinë të rreptë.

Çështja tjetër që desha të ngrija është ajo e zhvillimit të bujqësisë në zonat malore. Të tri komitetet e Partisë të rretheve që kemi thirrur në raport dhe të gjitha komitetet e Partisë në rrethet e tjera malore të vendit tonë, duhet të bëjnë një punë të dendur politike për t'u kuptuar si duhet problemet e bujqësisë, pastaj duhet të mendojmë e të punojmë për të dhënë edhe orientime.

Mua më duket se kryesorja, që shokët e kanë kuptuar, por nuk e kanë reflektuar sa duhet si të keqen më të madhe në malësitë tona, është çështja e disbalancimit të madh që ekziston në zbatimin e kooperimit në bujqësi dhe në blegtori. Këtë kooperim të zbatuar drejt, si në bujqësi ashtu edhe në blegtori, Partia dhe Ministria e Bujqësisë duhet ta kenë parasysh, pse është një nga faktorët kryesorë që do të na sigurojë realizimin e modernizimit të bujqësisë sotë në malësi.

Në bujqësinë tonë sot zbatohet një renditje më

e studiuar dhe më e organizuar e kulturave, gjë që në të kaluarën bëhej në mënyrë spontane. Por kjo renditje akoma nuk është e studiuar thellë dhe e organizuar në mënyrë moderne. Tani na mbetet shumë për të bërë për harmonizimin e të gjitha degëve të ekonomive bujqësore me një perspektivë të qartë dhe të balancuar, duke filluar që nga toka, kafshët, nga puna e njerëzve, me qëllim që të gjitha masat që marrim të na ndihmojnë për të arritur rendimente të larta në çdo drejtim. Kjo është një punë shumë e rëndësishme dhe parimore, që nuk mund të zbatohet në asnjë mënyrë me forma spontane ose duke u mjaftuar vetëm me propagandë, sa për t'ia bërë të qartë këto çështje fshatarësisë, pa vendosur, njëkohësisht, kudo në bujqësi edhe një disiplinë të hekurt për pjesëmarrje të plotë dhe efektive në punë, për ruajtjen dhe shfrytëzimin si duhet të plehut, të farrërave, të stallave etj., etj. Pa një disiplinë të fortë, pra, nuk mund të ecet drejt modernizimit në bujqësi. Këtë duhet ta kuptojmë mirë, sepse bile në vetë gjirin e klasës punëtore, ku kemi një organizim e disiplinë të mirë, ne kemi akoma të meta serioze në këtë drejtim.

Le të marrim tani problemin e proporcioneve në mes llojeve të kafshëve. Në malësi nuk kuptohet rëndësia e madhe ekonomike e lopës. Atje lopa shërben sa për të marië një viç dhe kaq, por kësaj nuk i thonë bujqësi. Me një mentalitet të tillë nuk ka si ecet përpëra drejt modernizimit të saj, prandaj duhet të luftohet për të rrënjosur një koncept të drejtë edhe përllopën. Mund të flasim teorikisht për këtë problem, por, në rast se nuk e shoqërojmë zgjidhjen e tij me të gjitha

masat e duhura, brenda mundësive tona dhe të çdo kooperative, atëherë nuk mund të ecim përpara. Ne, si shtet, duhet të studiojmë, të llogaritim, t'u bëjmë të qartë kooperativave shembullin e ushtrisë në këtë çështje dhe të punojmë që, me mundësitë që kemi, të bëjmë një shpërndarje më të mirë të lopëve, me qëllim që këto të futen edhe në malësi, por baza e përmirësimit racor të gjedhit dhe e shtimit të lopës në malësi janë lopët që kanë vetë kooperativat malore. Çështja është që nga ana e organeve shtetërore të bujqësisë dhe e ministrisë të ndihmohet me damazë dhe me specialistë, që të bëhet një punë serioze për përmirësimin racor të lopës së vendit. Kësh-  
tu do të zhduken konceptet e vjetra dhe do të forco-  
hen konceptet e reja për këtë kafshë me leverdi të madhe.

Është fakt se traditat që trashëgojnë nga e ka-  
luara malësitë tona, nuk zhduken vetëm me propa-  
gandë prej një, dy, ose qoftë edhe më shumë vjetësh. Prandaj propaganda duhet të shoqërohet njëkohësisht  
edhe me masa organizative e teknike. Të gjithë e dimë  
se malësitë tona në të kaluarën kanë jetuar, në radhë  
të parë, me blegtori, kurse ne tani luftojmë, me të  
drejtë, që atje të bëhet një kthesë 180 gradë, në drej-  
tim të modernizimit të bujqësisë. Por, që të realizohet  
kjo, duhet medoemos të harmonizojmë mirë dy drej-  
timet kryesore, që janë baza e zhvillimit të bujqësisë,  
të vendosim raportet e drejta në mes bujqësisë dhe  
blegtorisë. Sigurisht, ka pastaj vend për harmonizim  
edhe në mes llojeve të bagëtive, ka raporte që duhen  
vendosur mbi baza të drejta edhe ndërmjet llojeve të

ndryshme të kafshëve, gjë që bëhet në bazë të terrenit, të perspektivës dhe të situatave.

Kur shokëve në rrethet malore u japim direktivën që të hapin toka të reja, kjo do të thotë që atje ndërrohen raportet ekzistuese bujqësi-blegtori. Në sipërfaqet e përfituar nga hapja e tokave të reja, është e vërtetë që misri ose gruri janë e do të janë kulturat bazë kryesore, pastaj, me radhë, kulturat e tjera, frutat, zarzavatet etj., por, njëkohësisht, bashkë me to, ne ngremë me forcë edhe çështjen e zhvillimit të mëtejshëm të blegorisë, të lopës, të deles, të dhisë, të shtimit të sasisë së qumështit të tyre etj., pa lënë pas dore sigurimin e bazës ushqimore për to. Kur themi të balancojmë dy shtyllat kryesore, të ketë zhvillim të harmonizuar të bujqësisë me blegtorinë në malësi, me këtë duhet kuptuar që të mos ecim siç është ecur, por të bëjmë një kthesë të madhe, sidomos në mendjet e njerëzve.

Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se nuk është e lehtë të bindësh lebërit, që krahas deleve e dhive të mbajnë edhe lopë. Kjo është një punë shumë e vësh-tirë. Në Labëri është shumë më lehtë t'i ngresh njerëzit të shkojnë në luftë për mbrojtjen e atdheut me t'i rënë borisë, sesa t'u thuash të zëvendësojnë delen me lopën, sepse këtu kemi të bëjmë me një traditë të rrënjosur në shekuj. Prandaj, Partisë i duhet të bëjë një luftë të madhe për t'i bindur ata që të kuptojnë rëndësinë e çështjes për të cilën punon Partia. Edhe në mendjen e malësorëve të zonave të tjera të vendit tonë është i rrënjosur, gjithashtu, fort, një koncept i tillë për bagëtitë e imëta.

Po të marrim çështjen e deles dhe të dhisë në Kurvelesh, e dimë sa shumë i do kurveleshasi ato, por ne duhet të punojmë që t'i çrrënjosim konceptet dhe praktikat si i ushqejnë dhe si prodhojnë delet dhe dhitë në këtë krahinë e të rrënjosim koncepte të reja e të drejta ekonomike dhe perspektive. Natyrisht, kjo punë nuk bëhet as në një ditë dhe as në një vit. Ne jemi të qartë që nuk është i drejtë koncepti se Kurveleshi nuk bën dot pa delen dhe pa dhinë, por neve, parmisht dhe praktikisht, nuk na lejohet të biem në pozitat e koncepteve të vjetra e të prapambetura. Kurveleshasit nuk i mbushet mendja kollaj që disa nga delet t'i zëvendësojë me lopën, sepse interesin e tij personal ai nuk e kuption të kombinuar dhe në harmoni me atë të përgjithshmin, nuk i kuption masat për vendosjen e një raporti të drejtë midis bagëtive të imëta dhe lopës, ashtu sikurse nuk kuption dot edhe përfitimet e mëdha që do të ketë nga kooperimi i blektorisë me bujqësinë.

Atëherë si do ta bëjmë ne luftën kundër këtyre koncepteve që kanë zënë rrënje tradicionalisht? Folu sa të duash tepelenasve për këtë çështje, vetëm me propagandë nuk nxjerr gjë. Natyrisht, nga një propagandë e vazhdueshme njerëzve diçka do t'u mbetet në mendje, por ne nuk duam të ecim përpara pak nga pak, por brenda një kohe të shkurtër duam të realizojmë transformime të rëndësishme, të ecim, pra, në mënyrë revolucionare. Atëherë, si do t'i bëjmë këto transformime?

Në radhë të parë, duke luftuar konceptet e njërzëzve. Është e drejtë ajo që thanë shokët për luftën

që duhet bërë kundër koncepteve, po lidhur me këtë unë dua të shtoj edhe atë që anëtari i kooperativës i qepet sot oborrit kooperativist edhe për shkak të mentalitetit të vjetër të rrënjosur në mendjen e tij, sikur vetëm blegtoria është ajo që e mban dhe i siguron më shumë të ardhura. Sipas këtij mentaliteti, nuk prish punë sikur edhe më pak bukë të bëjë fshatari, sepse drithin që i duhet për bukë, ai vete e blen edhe gjetkë, në pazar. Të tilla pikëpamje tanë na pengojnë në punën tonë dhe duhet mbajtur parasysh se ato nuk zhduken automatikisht, mbasi kanë zënë vend thellë, brez pas brezi, në ndërgjegjen e njerezve.

Edhe ngurrimi që konstatohet në shumë raste për hapjen e tokave të reja në malësi, burimin e ka, gjithashtu, te koncepti i vjetër i fshatarëve të këtyre zonave, të cilët hapjen e tokave që i përdorin për kullota, e konsiderojnë si varfërim të bazës ushqimore të blegtorisë dhe, pra, si varfërim të tyre. Prandaj, na vihet detyrë që të punojmë pa u lëkundur për t'i zhdukur këto koncepte dhe kjo nuk bëhet vetëm me fjalë, por, krahas propagandës, duhen hedhur njerëzit në aksion, duhen mobilizuar masat e popullit të hapin toka të reja, edhe nga ato që gjer sot i përdorin si kullota. Vetëm kështu do të thyhet koncepti i vjetër që ekziston tek ata dhe i pengon të ecin përpresa. Mbasi të ngushtohen kullotat, kur të shohin fshatarët se, vërtet, ato u pakësuan, por tokat e hapura që u mbollën, prodhuan më shumë jo vetëm për njerëzit, por edhe për kafshët, të cilat, të ushqyera tanë më mirë, po u japid fshatarëve më shumë prodhime e të ardhura, atëherë do të

binden për drejtësinë e vijës së Partisë. Pra, këto koncepte, që pengojnë modernizimin e bujqësisë, ne do t'i thyejmë me punë ideopolitike dhe me aksione konkrete.

Gjithë këto punë, duke përfshirë edhe hapjen e tokave të reja, duhet t'i vëmë në rrugë me plan, pse nuk bëhen dot në një vit, prandaj të vazhdojmë të punojmë në mënyrë rreptësisht të disiplinuar dhe sistematike. Por hapja e tokave të reja në zonat malore nxjerr problemin e kufizimit medoemos të numrit të deleve ose të përmirësimit të tyre, çështjen e dhive atje ku rriten ato, zëvendësimin e bagëtive të imëta me lopë etj. Të gjitha këto duhet të bëhen në mënyrë të harmonishme, me plan dhe të studiuara në mënyrë shkencore, ndryshe fshatarët do të humbisnin besimin në masat që janë duke u marrë. Bile, qysh tani, ka disa fshatarë që u thonë shokëve tanë sikur po i lëmë pa bukë, kurse toka buke kudo ka plot, po i duan të gatshme, nuk hidhen t'i hapin, për shkak të dembellëkut të disa fshatarëve.

Planin ne vazhdimisht duhet të përpinqemi ta zbatojmë, po edhe ta rishikojmë e ta plotësojmë me një perspektivë më të qartë për zhvillimin sa më të harmonishëm të të dy drejtimeve kryesore, bujqësisë dhe blektorisë.

Çështjet që kemi në plan duhen studiuar, pra, nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, më thellë, të koordinuara me njëra tjetrën dhe në mënyrë të organizuar. Nuk duhet të lejohet më spontaneitet ose njëanshmëri në këto zhvillime. Ne jemi marksistë, edhe eksperiencë kemi tani, prandaj, për ato që parashikohen në plan, të

punohet me të gjitha forcat që të arrihen, të zbatohen dhe të kihet parasysh që të ecet paralel në të gjitha problemet. Në këtë mënyrë është e mundshme të parashikohen dhe të evitohen më mirë rreziqet, pse një pakujdesi ose një punë jo e matur mirë, që nuk mban parasysh rrjedhimet që do t'i shkaktojë një sektori tjetër, sjell pasoja. Gabime do të bëhen, ato janë të paevitueshme, puna është të bëhen sa më pak, në mënyrë që të hedhim si duhet bazat e bujqësisë sonë moderne dhe të forcojmë te fshatarësia jonë besimin e palëkundur në vijën e drejtë të Partisë për zhvillimin e bujqësisë.

Popullin e kemi të mirë, por ne nuk duhet të sakrifikojmë vijën e drejtë të Partisë, se i mbetet qejfi një pjese njerëzish që, edhe ata, nesër, do ta kuptojnë se këto masa që merr Partia janë për të mirën e të gjithëve. Ne nuk duhet të na pengojë ç'thotë njëri dhe tjetri, popullin ta bindim me fjalë dhe me prova, ashtu sikurse kemi vepruar gjer tani; t'ia bëjmë, si kurdoherë, të qartë se ato që bën Partia, janë vetëm në interes të tij, për mirëqenien dhe jo për varfërimin e tij.

Çështja qëndron, pra, jo vetëm te konceptet që ekzistojnë, të cilat po nuk i luftuam, punët nuk do të na ecin, por edhe te masat që duhet të marrim, në rrugë normale dhe brenda mundësive tonë, për të vënë në jetë ato që duam të arrijmë, po këto, mendoj, të jenë më të studiuara se gjer tani nga ana e Ministrisë së Bujqësisë.

Ministria e Bujqësisë të ketë kujdes që edhe orientimet dhe shpërndarjen e mjeteve që ka, t'i bëjë gjithashtu me një plan të studiuar e të përcaktuar mi-

rë. Duke pasur të qartë këtë dhe duke pasur në dorë këto mjete, Partia të bëjë llogari për rezultatet që do të arrihen, sepse, po nuk i bëri këto llogari, nuk mund të udhëheqë me perspektivë. Ne nuk kërkojmë të bëhet më shumë nga sa mund të bëhet, por shohim që, me gjithëse kudo po bëhet shumë, prapë ka rezerva, sepse, për shembull, fshatarësia mund të bëjë vetë hauze, kanale etj. dhe në asnje rast të mos lejohet të na ndodhë si në Kalivaç, ku hauzi ka 10 vjet që është ndërtuar, kurse fshatarët nuk po bëjnë akoma kanalet e dyta dhe të treta, vepra rri pa u shfrytëzuar dhe prej disa vjetësh ekonomia nuk realizon të ardhura të konsiderueshme. Si atje ka shumë probleme të tilla që Partia duhet t'i zgjidhë me fshatarësinë.

Rëndësi të madhe ka zbatimi i orientimeve. Partia duhet të mobilizohet totalisht për realizimin e tyre në jetë. Prandaj, në të gjitha këto probleme, qoftë për formimin e koncepteve të reja në bujqësi e në blegtori, qoftë për renditjen e kulturave bujqësore etj., duhen bërë studime. Unë lexova edhe materialin për çështjet e kodit agroteknik që mori në shqyrtim Qeveria. Duket qartë që ne kemi bërë përparime në drejtim të farërave dhe në zgjidhjen e disa problemeve të tjera. Kjo që është arritur gjer tanë përbën një bazë të mirë, po ne duhet të luftojmë me të gjitha forcat që të mos mbetemi në atë stad sa të kënaqemi duke marrë nga 5 kuintalë drithë për hektar. Në asnje mënyrë dhe në asnjë rrëth nuk duhet të lejojmë të merrin jo më 5, po as 10 kuintalë grurë për hektar. Ministria e Bujqësisë, siç thashë në fillim, duhet të mendojë thellë për rrugën e modernizimit të bujqësisë.

Të gjitha këto probleme, si rritja e rendimenteve të misrit, të grurit, përmirësimi dhe zhvillimi i blegtorisë etj., të marra në kompleks, kërkojnë studime. Çdo komitet partie në rrethe këto studime duhet t'i bëjë shumë më me hollësi sesa Ministria e Bujqësisë. Por konstatojmë se komitetet e Partisë nuk i lidhin me njëra-tjetrën këto çështje, ato interesohen vetëm të prodhohet grurë dhe misër. Kështu bujqësia nuk mund të ecë përpara. Të gjithë jemi dakord të bëjmë grurë dhe misër, por duhet të shihen me kujdes edhe interesat e atij që i prodhon, domethënë të fshatarit, të shihen me kujdes të gjitha nevojat e jetës së tij, duke menduar për të gjer te maja e gjilpërës. Shokët në bazë, në shumë raste, nuk i shohin këto çështje me syrin e një planoviku marksist. Për të siguruar të holla për kooperativistët duhen prodhuar edhe drithë, edhe duhan, por nuk duhet harruar se janë edhe bletët, pulat, zogjtë, derrat e shumë aktivitete të tjera, nga të cilat mund të nxirren të ardhura të konsiderueshme nga kooperativat bujqësore, kurse na flitet vazhdimisht vetëm për bukën, dhentë e dhitë, pa u parë të gjitha këto çështje në kompleks. Kjo tregon se ato janë lënë gjer tanë të ndiqen në mënyrë spontane. Ne duhet të vëmë disiplinë në fshat dhe kjo vihet jo me kopaçe, por me punë, me zhvillim politik, me një punë të atillë që ta kuptojë e ta mbështetë populli dhe me marrjen e masave të rrepta për zbatimin e planeve, sepse vetëm kështu do të kemi më shumë rezultate.

Me çështjet e tjera jam dakord. Ne kemi besim se edhe në sektorin e bujqësisë do të ecim akoma më përpara. Për këtë jemi të gjithë shumë optimistë. Të

dhënat e Partisë dhe të Ministrisë së Bujqësisë janë që në bazë po punohet, por ekzistojnë akoma një sërë të metash, të cilat do të ndreqen, natyrisht, jo në një ditë, vetëm se për këtë qëllim duhet të punohet me kujdes dhe me sistem.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# **REVIZIONISTËT SOVJETIKË — TRADHTARE TË ÇËSHTJES SË POPUJVE ARABË**

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**8 qershor 1967**

Ndërsa mbi popujt e Republikës Arabe të Bashkuar, të Republikës Arabe të Sirisë dhe të Jordanisë po ushtrohet një agresion barbar imperialisto-izraelit, Këshilli i Sigurimit, dje, adoptoi njëzëri një rezolutë, me të cilën u bëhet thirrje qeverive të interesuara të marrin të gjitha masat «për pushimin e menjëherëshëm të zjarrit dhe të ndalojnë të gjitha veprimet ushtarake». Rezoluta e Këshillit të Sigurimit është një thikë në shpinën e popujeve arabë. Ajo është fryt i kombinacioneve, i pazarllëqeve dhe i prapaskenave amerikano-sovjetike. Autorët e këtij dokumenti të turpshëm janë krerët e imperializmit amerikan dhe klika Brezhnev-Kosigin. Ajo shpreh pajtimin e plotë të pikëpamjeve të tyre politike, përputhjen e interesave të përbashkëta hegemoniste sovjeto-amerikane për sundimin e botës.

Revisionistët sovjetikë, duke redaktuar dhe aprovar, bashkë me imperialistët amerikanë, rezolutën e djeshme të Këshillit të Sigurimit, treguan fytyrën e

tyre të vërtetë si tradhtarë të çështjes së drejtë të popujve arabë, si armiq të tyre dhe miq të agresorëve imperialisto-izraelitë. Në fakt, rezoluta e formuluar dhe e aprovuar prej tyre nuk i vë gishtin Izraelit si agresor, si rrjedhim, nuk e dënon atë, por, përkundrazi, si agresorin, ashtu edhe viktimin e agresionit i vë në një plan të barabartë. Veç kësaj, me rezolutën e tyre, revizionistët sovjetikë nuk mbrojnë aspak, përkundrazi, injorojnë interesat jetike të popullit palestinez, ata heshtin fare për të drejtat sovrane të Republikës Arabe të Bashkuar në gjirin e Akabasë dhe në ngushticat e Tiranit. Më në fund, revizionistët sovjetikë jo vetëm nuk mbështetin faktin e vërtetuar plotësisht nga qeveria e Republikës Arabe të Bashkuar dhe qeveritë e tjera të vendeve të pavarura arabe se imperialistët amerikano-anglezë po marrin pjesë aktive e të gjith-anshme në agresion përkrah Izraelit, por, me heshtjen e tyre, tregojnë se e aprovojnë këtë pjesëmarrje në agresion kundër popujve arabë.

Dokumenti i aprovuar nga Këshilli i Sigurimit demaskon bashkëpunimin e hapur kriminal të udhëheqjes revizioniste sovjetike me armiq të e betuar të arabëve dhe të të gjithë popujve liridashës të botës — imperialistët amerikanë dhe agresorët izraelitë. Ky është një akt i ulët, që sanksionon jo vetëm tradhtinë e revizionistëve sovjetikë ndaj çështjes arabe, por edhe kapitullimin e tyre ndaj dhunës e agresionit.

Në fakt, ky edhe ka qenë qëllimi i parë e kryesor i këtij dokumenti përbindësh: të lidhen këmbë e duar popujt arabë, viktima të agresionit izraelito-imperialist, dhe t'i nënshtrohen diktatit sovjeto-amerikan,

duke pranuar faktin e kryer, dorëzimin dhe kapitullimin para agresorëve.

Qëndrimi i hapur tradhtar i grupit Brezhnjev-Kosigin është pasojë e politikës kapitulluese, proimperialiste, që ndjek prej kohësh udhëheqja revizioniste sovjetike, në kundërshtim me interesat jetësore të popullit sovjetik, të çështjes së çlirimit dhe përparimit të popujve. Qëndrimi tradhtar i udhëheqjes sovjetike ndaj çështjes së drejtë të popujve arabë është një shprehje tjetër konkrete e kësaj politike thallisht oportuniste e kundërrrevolucionare. Revisionistët modernë sovjetikë, duke zbatuar në mënyrë konsekuente këtë kurs politik tradhtar, janë bërë armiq të lirisë e të pavarësisë së popujve arabë, duke u identifikuar në këtë mënyrë plotësisht me imperialistët amerikanë. Bashkëpunimi i revisionistëve sovjetikë me agresorët imperialistë amerikanë, në hartimin e rezolutës antiarabe e proizraelite, zbulon edhe një herë rolin e tyre të urryer si zjarrfikës të luftërave antiimperialiste, demaskon falsitetin dhe hipokrizinë e tyre mbi gjoja «miqësinë» për popujt arabë. Ai provon se çdo deklaratë e revisionistëve sovjetikë, gjoja në përkrahje të arabëve, është një tingull fals, i bërë për qëllime mashtrimi.

Ky qëndrim nuk është i rastit. Nuk është e para herë për revisionistët sovjetikë që sakrifikojnë në altarin e bashkëpunimit sovjeto-amerikan interesat jetësore të popujve të tjerë. Në emër të këtij bashkëpunimi, në emër të miqësisë dhe të afrimit gjithnjë e më të madh me Uashingtonin, në emër të ndërtimit të gjithanshëm të «urave» me të, klika Brezhnjev-Kosigin

jo vetëm që ka shkermuar fitoret historiko-botërore të Totorit të madh, jo vetëm ka thyer e ka hedhur në baltë flamurin e kuq të Leninit, por ajo ka tradhtuar interesat jetike të vetë popullit sovjetik, ka lejuar dhe po ndihmon në restaurimin sistematik të kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik. Prandaj, kësaj klike renegatësh e tradhtarësh nuk i kushton asgjë të marrë nëpër këmbë e të shkelmojë, me po aq lehtësi, edhe interesat e popujve të tjerë. Këtë revizionistët sovjetikë e kanë bërë dhe po vazhdojnë ta bëjnë në Vietnam. Ndërsa populli vietnamez, me një heroizëm legjendar, po lan me gjak çdo pëllëmbë të tokës së vet, revizionistët sovjetikë, prej vitesh me radhë, përpiken me çdo kusht ta detyrojnë atë të kapitulojë ndaj agresorëve, t'i nënshtronhet skllavërisë imperialiste, duke e futur, kështu, çështjen vietnameze në orbitën e bashkëpunimit sovjeto-amerikan. Ndërkaq, ata bëjnë zhurmë antiimperialiste me ndihmat e skaduara për popullin vietnamez.

Të njëjtën taktikë dinake po ndjekin dhe të njëjtin qëndrim të pabesë po mbajnë revizionistët sovjetikë edhe ndaj popujve arabë. Duke u hequr si miq të tyre, në të vërtetë, revizionistët sovjetikë kanë qënë bashkëpunëtorë në krimin e agresionit anti-arab, përndryshe nuk do të vazhdonin të mbanin dhe të forconin marrëdhëniet e gjithanshme politike, ekonomike, tregtare e kulturore me Izraelin, përkrahje kjo, që e ka frymëzuar dhe e ka nxitur oreksin e tij agresiv.

Mburjet plot zhurmë të revizionistëve, për gjoja «ndihmën» që u jepin vendeve arabe,jeta dhe prakti-

ka i kanë demaskuar. Ato janë ndihma të pavlera, materiale të vjetra dhe të skaduara; dhënia e tyre, kryesisht, ndjek qëllime djallëzore politike.

Qëllimet djallëzore dhe synimet tradhtare dhe armiqësore të revizionistëve sovjetikë, të Hrushovit, të Brezhnjevit, të Kosiginit dhe të gjithë klikës udhëheqëse sovjetike, populli shqiptar i ka njojur prej kohësh në qëndrimet që këta kanë mbajtur dhe në veprimet që kanë bërë kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe popullit shqiptar. Revizionistët sovjetikë kanë komplotuar me armiq të tjerë të vendit tonë për likuidimin e pushtetit popullore. Ata organizuan blokadën ekonomike, politike c ushtarake për të mbytur Republikën Popullore të Shqipërisë, u përpoqën me çdo mjet të sabotojnë ndërtimin socialist të vendit tonë. Ata u treguan njëloj të egër dhe armiq si imperialistët anglo-amerikanë. Por populli shqiptar u tregoi vendin këtyre tradhtarëve, demaskoi veprimet e tyre armiqësore, u dha përgjigjen e merituar dhe të vendsur dhe forcoi gjithnjë e më shumë vigjilencën.

Ditët e fundit, që nga fillimi i agresionit të hapur ushtarak imperialisto-izraelit kundër Republikës Arabe të Bashkuar dhe popujve të tjerë arabë, treguan qartë se kush janë miqtë e vërtetë dhe kush janë armiq të këtyre popujve. Pikërisht, në këto ngjarje dolën sheshit hipokrizia dhe tradhtia e revizionistëve sovjetikë ndaj çështjes së madhe arabe. Ky është një mësim i rëndësishëm, që pa dyshim do të ndihmojë për të rritur vigjilencën e popujve arabë, do të bëjë që ata të ruhen nga komplotet dhe intrigat, që do të thurin edhe në të ardhmen revizionistët sovjetikë, bashkë me

imperialistët amerikanë, kundër lirisë dhe sovranitetit të popujve arabë.

Populli shqiptar është i bindur se popujt arabë, që po luftojnë me trimëri dhe në mënyrë të vendo-sur për të mbrojtur dinjitetin kombëtar dhe interesat e tyre jetike, do të dalin fitimtarë, si mbi agresorët imperialisto-izraelitë, ashtu edhe mbi intrigat e tradh-tinë e revizionistëve e të shërbëtorëve të tyre.

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit»,  
nr. 137 (5862), 8 qershor 1967*

*Botohet sipas librit: «E vërteta  
marksiste-leniniste do të tri-  
umfojë mbi revizionizmin»,  
vëll. 7, f. 84*

# **MINISTRIA E BUJQËSISE T'U PËRGJIGJET MË MIRË DETYRAVE QË I JANE NGARKUAR**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**10 qershor 1967**

Jam dakord me raportin dhe me vërejtjet që bënë shokët, po rreth tij kisha edhe unë disa vërejtje, të cilat Ministria e Bujqësisë mendoj t'i ketë parasysh.

Propagandimi i përvojës së përparuar është një mjet i rëndësishëm nxitës, por, për ta çuar përpara prodhimin, duhet organizuar më mirë puna edhe përzbatimin e kësaj përvoje, se, më duket, sikur kjo gjë lihet në fatin e vet, i lihet spontaneitetit. Në qoftë se dikush njihet me një përvøjë të përparuar dhe merr iniciativën ta zbatojë atë sipas mendimit dhe kuptimit të tij, bëhet diçka, ndryshtë asgjë e organizuar nuk bëhet për përhapjen e kësaj përvoje nga ana e Ministrisë së Bujqësisë. Na thuhet se për këtë çështje

---

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit «Mbi përfundimet e arritura dhe masat që duhen marrë për përhapjen e eksperiencës së përparuar dhe të eksperimentimit shkencor në bujqësi», që do t'i paraqitej Plenumit të 2-të të Komitetit Qendror.

bëhen disa seminare, po prapë edhe kjo është një punë e pamjaftueshme.

Pikërisht për këtë problem do t'i bëj një vërejtje ministrit të Bujqësisë, Pirro Dodbibës. Ministria e Bujqësisë do të punojë si duhet edhe për përhapjen e përvojës së përparuar, në qoftë se heq dorë nga punët e tepërtë administrative. Ajo ka nën administrim të drejtpërdrejtë një pjesë të bujqësisë, atë të ndërmarrjeve bujqësore, kurse pjesa më e madhe e bujqësisë së vendit administrohet drejtpërsëdrejti nga vetë kooperativat bujqësore. Por edhe pranë çdo ndërmarrjeje bujqësore ekziston një administratë e veçantë, e cila është në gjendje dhe ka përgjegjësi për drejtimin si duhet të ndërmarrjes, gjë që ministrisë ia lehtëson punën në këtë drejtim.

Ministria e Bujqësisë ka një sërë detyrash të mëdha; një nga më të rëndësishmet, siç thashë, është ajo e përhapjes sistematike dhe të organizuar të metodave dhic të eksperimenteve të reja, të kontrolluara e të provuara në dhënen e rezultateve të mira. Detyrë e rëndësishme e saj është, gjithashtu, ndjekja e zbatimit në jetë të këtyre metodave e eksperimenteve dhe nxjerra e vazhdueshme e përvojës së re që duhet përhapur.

Ekziston një traditë sipas së cilës nëpër raporte na numërohen vazhdimisht plot shembuj. Edhe raporti i paraqitur numëron shumë gjëra. Mundet që disa nga këto janë bërë ose po bëhen, por nuk na thuhet asgjë se në ç'rrugë janë bërë. Për shembull, nuk tregohet si u rrit rendimenti i drithërave ose i qumështit të lopëve në ndërmarrjet bujqësore, sa ndihmuan në këtë

drejtim kërkimet shkencore dhe si është organizuar puna për shtrirjen dhe zbatimin e kësaj përvoje të mirë në kooperativat bujqësore. Unë kam përshtypjen se për këtë të fundit nuk do të jetë punuar mirë, përderisa në shumë zona, qoftë rendimenti i drithë-rave, qoftë ai i qumështit, është shumë i ulët.

Ne flasim vazhdimisht për sigurimin e bazës ushqimore për lopët, bëjmë propagandë për konvejerin e gjelbër, për silazhin etj., etj. Rezultatet e arritura në të gjitha këto drejtime nuk mund t'i mohojmë, me gjithatë, po të kufizohemi vetëm në propagandë dhe të mos punojmë si duhet për zbatimin e përvojës së përparuar, këto rezultate nuk do të jenë akoma në nivelin e kërkuar. Në këtë drejtim Ministrisë së Bujqësisë i takon të luajë një rol qendror.

Një çështje tjetër për të cilën flitet, por që nuk bëhet si duhet, është përgjithësimi i kërkimeve shkencore të gjertanishme për të përcaktuar lidhjen e kulturave të ndryshme bujqësore me kushtet konkrete tokësore dhe klimatike të vendit tonë. Para Çlirimt nuk është bërë asgjë për të studiuar rolin e kushteve klimatike, pedologjike etj. në zhvillimin e kulturave bujqësore, kurse tani, me përvojen e fituar gjatë 23 vjetëve, duhet dhe mund të ishin bërë disa përgjithësime ekzakte në këtë drejtim nga Ministria e Bujqësisë. Por kjo mund të bëjë përgjithësime në qoftë se e organizon mirë punën, se, që të dilet me disa konkluzione të sakta, duhen zotëruar çështjet e tokës dhe të klimës, duhet pasur në dorë harta pedologjike e studiuar dhe e vërtetuar gjatë një periudhe kohe etj. Duke bërë vrojtime dhe studime të vëmendshme gjatë

disa vjetëve, atëherë mund të thuhet që në Lushnjë, fjala vjen, të mbillen këto ose ato kultura, sepse le-verdinë e mbjelljes së tyre atje e kemi vërtetuar për kaq vjet me radhë me një vëzhgim shkencor serioz mbi rendimentet që jep secila prej tyre për çdo vit.

Në raport flitet se për përmirësimin e tokave përdoret, përveç tarracimeve, edhe sistemimi i parcelave në formë kurriz peshku. Thuhet që ekziston një përvojë e popullit në këtë drejtim, por kjo përvojë më duket se duhet përpunuar më tej. E kam fjalën sidomos për hapjen e tokave të reja në zonat malore, që sot i kemi pyje të degraduara ose kullota. Ministria duhet dhe mund të bëjë një përgjithësim të përvojës së fituar për përgatitjen e veçantë të këtyre tokave, për anën strukturore të tyre, që përgatitjen e kësaj strukture ta bëjmë në varësi të kulturave bujqësore që do të destinojmë për t'u mbjellë atje. Po nga do ta nxjerrim këtë përvojë? Vetëm nga përvoja e fshatarëve? Jo, kjo është e kufizuar, nuk mjafton. Atëherë duhen shfrytëzuar, plus kësaj, edhe metodat e reja agroteknike, se, po e lamë formimin strukturor të tokave të ndryshme në mëshirën e fatit, ose po ta bëjmë vetëm në rrugën tradicionale primitive, do të harxhojmë shumë kohë dhe tokat nuk do t'i shfrytëzojmë dot mirë. Le të marrim shembull Ndërmarrjen Bujqësore të Maliqit. Sa kohë dhe sa shpenzime na u desh të bënim për të rregulluar strukturën e tokës së saj? Toka atje është speciale, mund të na thuhet. Po, ashtu është, po çdo tokë e veçantë, kur punohet si duhet për përmirësimin strukturor të saj, është speciale, prandaj përvoja e Maliqit është një përvojë e madhe.

Po a kanë menduar drejtuesit e Ministrisë së Bujqësisë dhe a kanë marrë masa organizative që kjo përvojë e madhe t'i vijë në ndihmë në mënyrë shkencore edhe fushës së Kavajës, e cila, me gjithë bonifikimet e mëdha që janë bërë, vazhdon të mbajë ujë? Kështu mund të thuhet edhe për Thumanën e për disa fusha të tjera.

Përgjithësimi shkencor, përhapja dhe zbatimi i organizuar i përvojës së përparuar nuk po bëhen si duhet. Në raport këto gjëra janë thënë të shkëputura, po do të ishte më mirë që atyre t'u kushtohet më shumë kujdes, sepse një punë e tillë do të shërbente përorientim. Në rast se për këto do të punohej mirë dhe sistematikisht, nga zhvillimi i bujqësisë do të nxirrej patjetër një përvojë e madhe e sintetizuar dhe e provuar. Po a zbatohet një metodë e tillë pune? Kooperativa e Zharrëzës, fjala vjen, ka një përvojë të mirë për një kulturë, një kooperativë më tutje mund të ketë për diçka tjetër, përvojë të mirë mund të ketë edhe në kooperativa të tjera, atëherë e gjithë kjo përvojë, e dalë nga jeta në zona të ndryshme, duhet mjuhur, studiuar dhe duhen nxjerrë detyra se si duhet vepruar në të ardhmen.

Ka rrëndësi të theksohet se zbatimi i atyre pak gjérave që janë bërë në këtë drejtim është prapa. Po të ndiqej më me kujdes zbatimi i përvojës së përparuar do të kishim më tepër suksese se gjer tanë, dhe do të vihej më mirë në jetë çdo eksperiment bujqësor. Pra, jo vetëm të thuhen shembujt pozitivë, po të nxirren llojet e eksperimenteve që bëhen dhe të ndiqet se si zbatohet përgjithësimi i përvojës së përparuar.

Në raport kritikohen me të drejtë Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive që nuk kanë punuuar sistematikisht dhe në mënyrë të organizuar për këto probleme. Përgjithësimi metodik i eksperimenteve do t'ju sqarojë më mirë ju drejtues të Ministrisë së Bujqësisë, për kritikën që ju bëhet, e cila vazhdon të jetë e përgjithshme. Unë mendoj që në raport këto çështje duhet të ishin paraqitur në mënyrë më të preçizuar dhe metodike, vetë Ministria e Bujqësisë duhet t'u jepte rretheve shembullin se si të bëhet konkretisht këtej e tutje një punë e mirë metodike.

Ne e kritikojmë vazhdimisht mospërhapjen si duhet të përvojës së përparuar brendapërbrenda çdo rrethi. Natyrisht, sado mirë të punojmë për këtë, prapë nuk do të arrijmë ta bëjmë në mënyrë të përsosur. Megjithatë ministria mund të nxjerrë të sintetizuar përvojën si në drejtimin pozitiv, ashtu edhe në atë negativ dhe të japë një orientim më të qartë për zbatimin e saj. Një përvojë mund të kritikohet, po tek ajo duhen vënë në dukje edhe anët e mira. Prandaj ka rëndësi të bëhet një sintezë e herëpashershme e përvojës së fituar pozitive dhe negative dhe kjo t'i jepet bazës, duke e orientuar ç'gjëra duhen marrë prej saj dhe cilat duhen hedhur poshtë. Kjo do të ishte një ndihmë e mirë për rrethet.

Flasim e do të flasim kurdoherë për ndikimin e kushteve tokësore e klimatike në prodhimin bujqësor. Këta janë faktorë objektivë që, kuptohet, nuk mund t'i lëmë në harresë, as t'i nënveftësojmë, ose t'i zhdukim. Por unë mendoj se vazhdon të ekzistojë një kuptim mistik idealist për ndikimin e klimës, i kundërt

me konceptin materialist marksist. Me gjithë përvojën e fituar, akoma nuk bëhet sa duhet një punë e pandërprerë sraquese e shkencore, që të kuptohet mirë gjer ku arrin ndikimi i këtyre faktorëve dhe njerëzit të bëhen të ndërgjegjshëm që t'i zotërojnë më mirë rrjedhimet e mira dhe të këqija të klimës dhe të terrenit nëpërmjet rrjetit të kullimit etj. Pra, nuk është e mjafueshme që Ministria e Bujqësisë të ndjekë vetëm realizimin e planit ose të rendimenteve, se ajo duhet të shohë edhe si rriten kulturat bujqësore në tokën dhe klimën e këtij ose të atij rrithi, të bëjë vërejtje dhe çdo vit ose çdo dy vjet të japë orientime të reja, të drejta për sistemimin e kulturave.

Duhet të kemi kurdoherë parasysh që të mund të zhdukim, sa të jetë e mundur më parë, konceptin mistik idealist për ndikimin e kushteve klimatike dhe tokësore në zhvillimin e kulturave bujqësore, sepse ky zhvillim nuk përcaktohet nga faktorët atmosferikë. Kuptimi i gabuar për ndikimin e këtyre faktorëve luftohet duke marrë masa që të zbatohen të gjitha ato që kemi thënë për shpërndarjen dhe sistemimin e kulturave bujqësore, përmirësimin e kushteve të tokës, përballimin e faktorëve atmosferikë: të thatësirës me anë të ujitjes ose të reshjeve të mëdha me anë të kullimit. Në qoftë se marrim të gjitha masat për t'i përballuar këta faktorë, atëherë ndjekim për një, dy ose tre vjet zhvillimin e kulturave, për të krijuar bindjen se cilat prej tyre janë të leverdishme dhe për ato që nuk janë të përshtatshme për atë klimë ose atë tokë, nuk duhet të insistojmë më për mbjelljen e tyre, po të propozojmë ndryshime.

Natyrisht, qoftë thatësira, qofshin reshjet ndikojnë, për mirë ose për keq, në zhvillimin e kulturave bujqësore, prandaj duhet t'i kemi parasysh kur planifikojmë që të mos nisemi vetëm nga nevojat, po këto t'i kombinojmë edhe me mundësitë e me kushtet reale të tokës, të 'klimës etj. Mjaft herë planifikimi bëhet sipas nevojave, përcaktohet se cilat kultura janë të nevojshme të mbillen në një rrëth, pavarësisht se një ose dy prej tyre nuk japid prodhim në atë tokë. Një praktikë e tillë nuk është e drejtë, ajo nuk është ekonomike. Çështja nuk duhet parë në mënyrë të njëanshme. Ne jemi shtet, prandaj këtë problem duhet ta shohim me kujdes, që të mund të marrim sa më shumë prodhim nga kultura që mbjellim në një tokë.

Këto vërejtje (të cilat mund të mos vihen në report), Ministria e Bujqësisë duhet t'i ketë parasysh. E përsëris, jo se nuk bëhen fare këto gjëra, po shokët drejtues të ministrisë duhet të jenë më aktivë. Tani këtij dikasteri ne i kemi dhënë kompetenca të mëdha, prandaj ministri duhet t'i mbajë më mirë mbi supe përgjegjësitë. Ministria e Bujqësisë është drejtuesja kryesore e bujqësisë së vendit tonë. Këtë ta kemi të qartë edhe ne këtu, edhe Partia në bazë, prandaj kjo ministri t'u përgjigjet më mirë detyrave që i janë ngarkuar.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verballi i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## **AGJENT I AMERIKANËVE DHE MIK I RREMË I POPUJVE ARABË**

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**13 qershor 1967**

Agresioni kriminal izraelit kundër popujve arabë, i fryshtuar, i përgatitur dhe i përkrahur aktivisht nga imperialistët amerikanë dhe aleatët e tyre, është prej disa ditësh në qendër të vëmendjes së opinionit ndërkombëtar. Kauza e drejtë e luftës së Republikës Arabe të Bashkuar dhe e vendeve të tjera arabe për mbrojtjen e lirisë, të pavarësisë dhe të sovranitetit kundër imperializmit amerikano-anglez dhe reaktionit, u përkrah fuqimisht nga popujt revolucionarë e liridashës, nga miqtë e vërtetë të popujve arabë.

Në këto ditë historike të luftës kundër agresorëve imperialisto-izraelitë, Republika Arabe e Bashkuar dhe vendet e tjera vëllezër arabë provuan edhe tradhtinë e revisionistëve sovjetikë. Gjithë bota ishte dëshmitare e frikës që mbërtheu revisionistët, e pjesë-marrjes së tyre bashkë me imperialistët amerikanë në komplotin e shëmtuar kundër popujve arabë. Por

ngjarjet e ditëve të fundit në Lindjen e Mesme demas-kuan edhe një tjetër mik fals të popujve arabë, nxo-rën në dritë të diellit, para gjithë botës, fytyrën e vërtetë të Titos si agjent i imperialistëve amerikanë, si mik i pabesë i Republikës Arabe të Bashkuar, i popujve arabë dhe i të gjithë popujve që luftojnë përliri e pavarësi.

Për vite me radhë klika titiste, kjo agjenturë kundërrevolucionare e imperializmit amerikan, nuk ka pushuar së trumbetuari me zhurmë të madhe, përmiqësinë e saj të pathyeshme» me vendet arabe. Por faktet e kohëve të fundit treguan se kjo «miqësi» e Beogradit ndaj popujve arabë, ishte një blof fund e krye, një blof me qëllime të caktuara. Në Lindjen e Mesme, në ditët e krizës, të shkaktuar nga agresioni imperialist izraelito-amerikan, Titoja i la në baltë miqtë. Dhe kjo duket fare qartë në deklaratën e tij zyrtare në lidhje me agresionin izraelit, prapa të cilat veprojnë haptazi SHBA dhe aleatët e tyre, në të cilën ai nuk thotë as gjysmë fjale për organizatorët e vërtetë të agresionit, për Xhonsonët e kompani.

Të dalësh në mbrojtje të agresorëve izraelitë dhe të padronëve të tyre amerikanë, ashtu siç bën klika revizioniste jugosllave, në një kohë kur vendet arabe presin marrëdhëniet diplomatike dhe çdo marrëdhënie tjetër me imperialistët amerikanë, do të thotë të vi-hesh sheshit krah për krah me armiqtë më të egër të popujve arabë. Kjo nuk është një taktkë e re në politikën tradhtare titiste në shërbim të imperializmit dhe as që ndodhi rastësisht.

Sic dihet, Titos i ishte ngarkuar nga Uashingtoni

misioni të krijonte të ashtuquajturën forcë të tretë dhe këtë ta vinte në shërbim të imperialistëve amerikanë. Për më se 20 vjet udhëheqja tradhtare jugosllave në politikën e saj të jashtme ndjek me besnikëri kursin e diplomacisë amerikane, për të sabotuar luftërat antiimperialiste çlirimtare të popujve.

Për të realizuar këto qëllime, Titoja, me bujë, ka organizuar njérën pas tjetrës konferenca e kongrese, ka bërë udhëtime e vizita të shumta, duke e hequr veten si «forcë asnjanëse», si «forcë paqësore», si partizan i «bashkekzistencës aktive paqësore», që gjoja qëndron jashtë blloqeve e konflikteve. Nën këto maska klika e Titos punoi intensivisht bashkë me renegatë të tjerë për të organizuar të ashtuquajturën forcë e tretë, ose, siç i pëlqente atij, shpeshherë, ta quante grupim «të vendeve të paangazhuara». «Forca e tretë» e Titos është brohoritur dhe përkrahur me të gjitha mjetet e propagandës nga imperializmi amerikan. Bile për këto shërbime revizionistët jugosllavë janë shpërblyer me miliarda dollarë nga Uashingtoni. «Blloku i tretë» i Titos, ashtu siç e kanë provuar shpesh ngjarjet e vitezave të fundit, nuk ka qenë asgjë tjetër vetëm se një metodë e tërthortë, një rrugë djallëzore për të futur këto vende nën kthetrat e sundimit amerikan.

Qëllimi i Titos dhe i amerikanëve ka qenë dhe mbetet që shtetet e lira, të pavarura e sovrane, që luftonin për konsolidimin e lirive të tyre të fituara me sakrifica e me gjak, t'i nënshtronte politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht te kolonialistët e rinj amerikanë. Jo më kot krerët e imperializmit amerikan e kanë quajtur Jugosllavinë titiste «aleate të besuesh-

me dhe të patundur për të çuar përpara qëllimet, për të cilat përkojnë interesat e të dyja palëve».

Me politikën e tij dyfaqëshe Titoja është hequr si mik i Nehrusë, i Sukarnos, i Nkrumës dhe i presidentit Naser. Gjatë gjithë kësaj kohe dhe nën këtë maskë tatonte pulset, kurdiste sabotazhe, nxiste fraksione me dy rrugë për t'ia arritur një qëllimi, o me tradhti dhe me iluzione t'i fuste këto shtete në suazën e amerikanëve ose me puçe e me kundërrevolucionare. Me të parën amerikanët arritën të futin Indinë nën diktatin e tyre. Me të dytën në Indonezi gjeneralë të bardhë rrëzuan Sukarnon. Në Gana, puçi i komplotistëve, nën drejtimin e amerikanëve, e rrëzoi Nkrumën. Roli i Titos në të gjitha këto ngjarje ishte ai i provokatorit, i organizatorit të puçeve në favor të amerikanëve.

Mbetej presidenti Naser dhe RAB-i. Këtu Titos dhe amerikanëve u hasi sharra në gozhdë. Planet e tyre nuk realizoheshin. Naserin ata nuk mundën dot as ta gënjenin, as ta futnin në kurth dhe as ta rrëzonin.

Titoja filloi të ftohet me Naserin dhe ky i fundit e kuptoi ç'plane thurte Titoja në kurriz të RAB-it dhe të popujve të tjerë. Amerikanët këtu nuk patën sukses si në Indonezi dhe në Ganë. Atëherë këta e janë përkohësisht kartën Tito dhe vunë në lëvizje kartën Moshe Dajan, kartën e Izraelit. RAB-i dhe popujt arabisë po bëheshin një rrezik për imperializmin amerikan dhe atë anglez, prandaj këta përdorën këtë herë jo diversionin titist, po sulmin e armatosur izraelit.

Faktet dhe historia vërtetuan edhe një herë atë

që dhjetëra vjet me radhë ka thënë Partia jonë, se titizmi nuk është veçse një agjenturë e amerikanëve, një përçarës i luftës antiimperialiste të popujve.

Në këto ditë gjithë popujt, dhe veçanërisht popujt arabë, e panë vetë ç'ishte Titoja për ta dhe ç'është titizmi, prandaj ata shqelmojnë me neveri miq të tillë të rrremë. Manovra e Titos, që mori rrugën e Moskës, për të marrë pjesë në mbledhjen e revisionistëve dhe për të vënë firmën mbi një dokument demagogjik, ku më shumë duket frika ndaj imperializmit sesa përkrahja për popujt arabë, siç është komunikata që bo-tuan revisionistët, nuk mashtron njeri.

Qëndrimi proamerikan i Titos në ngjarjet e fundit ishte një hap tjetër në vazhdën e gjatë të tradhtisë e të komplateve kundër popujve në favor të imperialistëve. Kongoja dhe Kuba, Koreja dhe Vietnam, Laosi dhe India, Hungaria dhe Lindja e Mesme etj. kanë provuar se Titoja, sa herë që imperialistët dhe reaksionarët janë vërsulur kundër popujve, ka mbajtur, në fakt, anën e agresorëve e të reaksionarëve.

E ashtuquajtura forcë e tretë e «vendeve të pangazhuara» tashmë është diskredituar dhe demaskuar keq. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me demagogjinë e parullës së «forcës së tretë», mundën të futin nën sundimin e tyre, në kthetrat e tyre disa vende. Por kundërshtimi i vendosur i popujve arabë kundër agresionit imperialist amerikano-izraelit ishte një fakt kuptimplotë në këtë drejtim, që bëri të dëshfojë demagogjinë e «forcës së tretë» në një zonë me rëndësi. Ai tregoi se popujt arabë nuk mund të mashtrohen nga parullat demagogjike të imperialistëve dhe të re-

vizonistëve sovjetikë e jugosllavë të «mosangazhimit», të «asnjanësisë» dhe të «bashkekzistencës paqësore me imperialistët» dhe nën maskën e tyre të sakrifikojnë interesat kombëtare, duke u radhitur përkrah imperialistëve.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, revizionizmin modern, me atë sovjetik në krye, si «forcë e dytë» e kanë futur në shërbim direkt të tyre dhe me të kanë marrë përsipër të robërojnë popujt, t'i gënjejnë ata dhe të bëjnë ligjin e dy fuqive në botë.

Mirëpo popujt janë ngritur në këmbë dhe luftojnë. Popujt arabë janë ngritur në këmbë kundër imperializmit amerikan dhe reaksionit.

Tani, Titoja dhe revizionistët e tjerë, pasi i tradhuan, dhe i lanë në baltë popujt arabë, kanë filluar nga përpjekjet për të mësuar se cilat do të jenë planet e mëtejshme të vendeve arabe në çështjen e kundërshtimit të agresionit imperialisto-izraelit, të bashkimit e unitetit arab, të qëndrimit ndaj revizionistëve etj. Klika e Beogradit ashtu si dhe ajo e Moskës duan të jenë të pranishëm, të ndërhyjnë dhe të influencojnë në proceset e reja të përcaktimit të politikës së ardhshme të vendeve arabe, për t'i dhënë asaj një drejtëm kundër luftës clirimtare antiimperialiste, e sidomos për të evitar e për të shuar urrejtjen kundër revizionizmit.

Por popujt arabë, të cilët në këto ditë të vështira i kuptuan dhe i njohën miqtë e rremë revizionistë, nuk mund të bien në kurthet e reja revizioniste dhe t'u besojnë këtyre planet dhe kartat, që ata do të luajnë në të ardhmen. T'i besosh Titos, do të thotë t'i

varësh ujkut mëlçitë në qafë, do të thotë t'u japësh mundësi imperializmit amerikan, Izraelit e të tjerve të jenë në dijeni të planeve dhe të qëllimeve të tua, t'u japësh atyre mundësi të të sulmojnë papritur dhe të të godasin rëndë. Vigjilanca ndaj «miqësisë» e «kë-shillave» të Titos, Brezhnevitet, Kosiginit e shokëve të tyre është një premisë dhe kusht për fitoren e popujve arabë mbi agresorët imperialisto-izraelitë, është një kusht për ruajtjen dhe forcimin e lirisë e të pavarësisë së tyre kombëtare.

Agresioni i huaj dhe tradhtia e revizionistëve u kanë shkaktuar dëme të rënda popujve arabë dhe çështjes së tyre të drejtë. Por situata e tanishme, sado e vështirë që të jetë, është e përkohshme. Fitorja përfundimtare e popujve arabë mbi armiqjtë e tij është e pashmangshme. Lufta e tyre kundër agresionit vazhdon dhe ajo nuk do të shuhet për asnjë çast, mbasi nuk mund të shuhën kurrë dëshira e tyre e zjarrtë për liri dhe pavarësi, vendosmëria për të zhdukur padrejtësitë e mëdha që u janë bërë, pse nuk ka forcë në botë që të ndalojë popujt arabë të çojnë në vend aspiratat e tyre shekullore.

*Botuar për herë të parë  
në gazeten «Zëri i popullit»,  
nr. 141 (5866), 13 qershori 1967*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha. «Kundër revi-  
zionizmit modern 1965-1967»,  
f. 507*

## **PALLAVRAT REVIZIONISTE NUK DO T'I MASHTROJNË POPUJT ARABË**

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**14 qershor 1967**

Krerët kryesorë të vendeve revizioniste të Evropës u mblodhën në Moskë më 9 qershor, «për të shqyrtuar gjendjen në Lindjen e Afërt». Në fund të takimit, ata, me përjashtim të udhëheqësve rumunë, që edhe në këtë rast ruajtën pozitën e tyre të veçantë, botuan një deklaratë, në të cilën shpallën përfundimet e bisedimeve.

Deklarata, pjesën më të madhe të së cilës e zënë emrat dhe titujt zyrtarë të udhëheqësve revizionistë, përbën një dokument tjetër që vërteton tradhtinë e tyre të rëndë ndaj popujve arabë, frikën dhe kapitullimin e tyre të paturpshëm përpara imperializmit dhe reaksionit.

Farsa revizioniste e mbledhjes së re të Moskës, dhe deklarata e saj bajate, ëmbushur me fjalë të përgjithshme, qëndrime propagandistike të papërcaktuara, solidaritet fals dhe premtimi boshe, janë një orvatje e dëshpëruar për t'i vënë ndonjë mballomë të.

vjetër prestigjit të Bashkimit Sovjetik, i cili u godit rëndë, si rezultat i tradhtisë dhe i goditjes pas shpine, që udhëheqësit e tij renegatë u bënë tanë popujve arabë.

Nga mënyra dhe koha kur e thirrën mbledhjen, kur shumica e shteteve arabe kishin pranuar armë-pushimin dhe Bashkimi Sovjetik e kishte shprehur plotësisht në OKB qëndrimin e tij kapitullues, duket qartë se krerët revizionistë nuk kishin aspak për qëllim t'u jepnin RAB-it, Sirisë ose vendeve të tjera arabe ndonjë ndihmë konkrete, për të kundërshtuar agresionin izraelit. Synimi i tyre ishte që, me anë të një demagogjie të re solidariteti, premtimi e krekosje boshe, të hiqnin sa të mundnin disa nga ndyrësítë, që u mbeten në duar e fytyrë, kur janë në baltë popujt arabë dhe u futën atyre thikën pas shpine. Këtij synimi i shërben edhe prerja, si kofini pas të vjeli, e marrëdhënieve diplomatike me Izraelin nga ana e qeverisë sovjetike dhe e disa pasuesve të saj.

Më 23 maj qeveria sovjetike lëshoi një deklaratë plot solemnitet e bombasticitet. Në të thuhej: «Asnjë nuk duhet të ketë dyshim se ai që do të guxonë të shpërthente një agresion në Lindjen e Afërt, do të ndeshet jo vetëm me forcën e bashkuar të vendeve arabe, por edhe me kundërshtimin e vendosur të Bashkimit Sovjetik dhe të të gjitha shteteve të tjera paqedashëse». Por ja që Izraeli dhe përkrahësit e tij anglo-amerikanë «guxuan» të shpërthenin agresionin në Lindjen e Mesme. Popujt e botës qenë këto ditë dëshmitarë të rezistencës heroike të popujve arabë. Por ç'u bë «kundërshtimi i vendosur i BS»? Jo vetëm që

«kundërshtimi» nuk u duk gjëkundi, por dolën në shesh tradhtia e turpshme revizioniste, bashkëpunimi dhe komploti i përbashkët sovjeto-amerikan në përkrahje të Izraelit, i cili u konkretizua në rezolutat e përbashkëta dhe në unanimitetin e tyre në Këshillin e Sigurimit.

Tani udhëheqësit revizionistë dalin përsëri e na thonë se «asnje nuk duhet të ketë dyshim» se «në qoftë se qeveria e Izraelit nuk largon trupat e saj brenda vijës së armëpushimit, shtetet socialiste, që kanë nënshkruar këtë deklaratë, do të bëjnë gjithçka të nevojshtme për të ndihmuar popujt e vendeve arabe t'i japin një përgjigje vendimtare agresorit» etj., etj.

Mjaft më me pallavra të tillë! Popujt arabë nuk kanë nevojë për ngushëllime, as për përkrahje e solidaritet të tillë fals. Puna është për masa konkrete, të shpejta, të përcaktuara, efektive, të cilat revizionistët nuk mund t'i marrin kurrë, pasi ata janë renegatë, kapitullantë, mashtrues.

Udhëheqësit sovjetikë mundohen tani të përvetësojnë kërkesën e drejtë për largimin e trupave izraelite nga tokat e pushtuara dhe tërheqjen e tyre në vijën e armëpushimit. Por kushdo e kupton se kjo kërkesë në gojën e revizionistëve është thjesht një spekulim, pasi ata nuk do të bëjnë asgjë për realimin e saj. Edhe kur të tërhiqen trupat izraelite, gjë që do të ndodhë patjetër, kjo do t'u detyrohet luftës, trimërisë dhe vendosmërisë së popujve arabë dhe askuqt tjetër.

Izraeli dhe partnerët e tij amerikanë, s'ka dyshim, do të bëjnë të gjitha përpjekjet që, nga pozitat

e forcës, t'u imponojnë vendeve arabe diktatin e tyre. Këtu synon manovra e Izraelit, i cili kërkon zgjidhjen e problemeve të vjetra e të atyre që lindën nga konflikti i tanishëm drejtpërdrejt me vendet arabe, duke llogaritur përkohësisht një betejë gjoja të fituar. Por një diktat i tillë, siç e mendojnë ata, do të jetë për imperialistët një disfatë e re, qoftë imediate, qoftë për të ardhmen. Gabohen rëndë ata që mendojnë se mund t'u imponojnë popujve arabë një diktat të tillë fashist.

Çështjet mund të fillojnë të zgjidhen vetëm atëherë kur Izraeli të ketë ndërprerë plotësisht agresionin dhe të jetë tërhequr në pozitat që mbante përparrë 4 qershorit. Çdo taktkë tjetër, qoftë e OKB-së ose c'vëtë agresorëve izraelitë, nuk do të ketë jetë të gjatë, sepse as Organizata e Kombeve të Bashkuara, as Izraeli nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë pa u tërhequr më parë trupat izraelite nga territorët e pushtuara, si rezultat i agresionit të tyre të tanishëm kundër vendeve arabe.

Duke dalë tani me një deklaratë të bujshme për Lindjen e Mesme, klika Brezhnev-Kosigin, dhe ata që i shkojnë pas, kërkojnë të ulin valën e urrejtjes anti-revisioniste, që ka shpërthyer në të gjitha vendet arabe e që po merr çdo ditë e më shumë përpjesëtime të gjera. Ata kërkojnë të hiqen si të pafajshëm, se në të ardhmen do të bëjnë diçka, se janë miq të vendeve arabe, se janë antiimperialistë etj.

Por kjo është një orvatje e dëshpëruar. Popujt arabë tanimë u bindën nga eksperienca e tyre e hidhur se sa vlejnë «miq» të tillë. Dhe kjo eksperiençë

nuk ka të bëjë vetëm me atë që ndodhi këto ditë, por edhe me qëndrimet dhe qëllimet e udhëheqjes revizioniste sovjetike në të ardhmen. Në deklaratën e tyre të 9 qershorit, krerët revizionistë shprehen qartë se do të mundohen ta futin zgjidhjen e konfliktit arabo-izraelit nëpër mekanizmat e OKB-së, domethënë ta vënë në tryezën e pazarllëqeve sovjeto-amerikane për ndarjen e zonave të influencës dhe sundimin botëror. Fakti që në mbledhjen e Moskës mori pjesë edhe Titoja, ky agjent i vjetër e i regjur i imperializmit amerikan, është mjaft sinjifikativ. Si vëzhgues gati zyrtar i SHBA-së, ai, sigurisht, është përpjekur, dhe faktet e tregojnë, që rezultatet e kësaj mbledhjeje të jenë në përshtatje me vijën amerikane. Nuk është e rastit, për shembull, që deklarata nuk e po-honi haptazi dhe nuk e dënon pjesëmarrjen konkrete të forcave ushtarake amerikane dhe anglezë në veprimet luftarake përkrah Izraelit.

Klika revizioniste sovjetike, në prag të agresionit imperialisto-izraelit, bëri çmos t'i demobilizonte popujt arabë, të ulte vigjilencën e tyre përpëra irrezikut imediat. Kur filloi agresioni, ajo komplotoi me SHBA-në për të shuar rezistencën e tyre dhe, me anë të rezolutave të Këshillit të Sigurimit, u mundua t'i krijojë Izraelit kushte të favorshme për të ndjekur politikën e tij nga pozitat e forcës. Tani ajo kërkon të përfitojë nga vuajtjet e popujve arabë për të forcuar bashkëpunimin midis dy fuqive të mëdha dhe të bëhet partnere, ose të kryesojë, në emër të popujve arabë, luftën e ardhshme diplomatike e politike për rregullimin e konfliktit arabo-izraelit. Por, sado për-

pjekje e manovrime që të bëjnë revizionistët, popujt arabë, siç deklaroi pardje presidenti i Algjerisë, Bumedien, nuk do të lejojnë kurrë një Munih të dytë.

Arabët, ashtu si gjithë njerëzit e ndershëm në botë, nuk mund të mos shohin se revizionistët hrušovianë kanë degjeneruar në politikanë të paparim, që marrin nëpër këmbë interesat jetike të popujve, që të shesin e të blejnë si çdo plaçkë të zakonshme tregu. Tradhtia e udhëheqësve sovjetikë për popujt arabë ka qenë e rëndë dhe u ka sjellë atyre dëme të mëdha. Por, nga ana tjetër, ajo ka sjellë edhe një shërbim të mirë: u ka treguar popujve se sa e gabuar dhe e rrezikshme është të mbështetësh qoftë edhe shpresën më të vogël te revizionistët. Ajo zbuloi dhe tregoi me fakte jo më ekzistencën e aleancës imperialisto-revisioniste, por edhe veprimin e saj konkret. Maska e grisur e revizionistëve, që hiqeshin si përkrahës të luftës çlirimtare të popujve, u çor edhe më tepër. Tani popujt kanë mundësi të shikojnë edhe më mirë fytyrën e vërtetë të revizionistëve si aleatë dhe bashkëpunëtorë të imperializmit amerikan, armiq të rrezikshëm të çlirimt, të lirisë dhe të pavarësisë së popujve.

Vështirësitë e tanishme të përkohshme, që erdhën si rezultat i agresionit të pabesë izraelit, u dhanë shteteve arabe një mësim të madh, nga i cili do të përfitojnë për të konsoliduar më mirë unitetin e tyre përpara armiqve imperialistë e izraelitë. Dhe nuk ka asnjë dyshim se nuk do të jetë e largët ditë kur imperialistët dhe izraelitët do të gjenden përpara një uniteti të çeliktë, që do t'i dënojë e do t'i shkatërrojë ata, kur as befasia dhc as intrigat e imperializmit e të

Izraelit, kur as tradhëia e demagogjia e revizionistëve nuk do të gjejnë terren të përshtatshëm për të dëmtuar lirinë e pavarësinë, të drejtat dhe aspiratat e pamohueshme të popujve arabë.

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit»,  
nr. 142 (5867), 14 qershor 1967*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha. «Kundër revi-  
zionizmit modern 1965-1967»,  
f. 513*



## L E N D A

PARATHIËNIE PËR VËLLIMIN E 35-TË ..... V-IX

1967

REVOLUCIONARIZIMI I MËTEJSHËM I PARTISË DHE I PUSHTETIT — Fjalim i mbajtur në mbledhjen e përbashkët të organizatave-bazë të Partisë të Mi- nierës së Qymyrgurit të Kërrabës, uzinës «Enver», kooperativës bujqësore «Vilhelm Pik», Repartit Ushtarak nr. 5009 dhe Universitetit të Tiranës (6 shkurt 1967) .....	1—55
VETËM KËSHTU MBROHEN REPUBLIKA DEMO- KRATIKE GJERMANE DHE KUFIJTË ODER-NAJSE — Artikull i botuar në gazeten «Zeri i popullit» (8 shkurt 1967) .....	56—63
POPULLI I KA ZGJEDHUR UDHEHEQËSIT PËR TË REALIZUAR VIJËN E PARTISË — Nga takimi me punonjës dhë kooperativistë të Shijakut (18 shkurt 1967) .....	64—76
PROBLEMET E ORGANeve TË PUNËVE TË BRENDSHME NUK QËNDROJNË JASHTË DREJTI- MIT E KONTROLLIT TË PARTISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 shkurt 1967) .....	77—88

TË PËRMIRESOJMË PUNËN ME KUADRIN DHE PRANIMET NË PARTI – Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (23 shkurt 1967) .....	89–95
DISA PROBLEME PËR KOOPERATIVAT BUJQE-SORE TË ZONAVE MALORE – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (24 shkurt 1967) .....	96–102
PRAKTIKAT FETARE T'I LUFTOJMË ME FRYMËN PATRIOTIKE DHE REVOLUCIONARE TË MASAVE – Letër e KQ të PPSH drejtuar komiteteve të Partisë të rrtheve mbi luftën kundër fesë, paragjykimeve e zakoneve fetare (27 shkurt 1967) .....	103–113
KOMUNISTËT TË UDHËHEQIN ME SHEMBULLIN, ME SAKRIFICAT, ME PUNËN E TYRE VETËMO-HUESE – Diskutim në organizatën e Partisë të sektorit të turnit «C» të uzinës «Enver» (2 mars 1967) .....	114–132
PARTIA ASGJË NUK MUND TË ZGJIDHË DREJT, JASHTË MASAVE DHE PA NDIHMËN E TYRE – Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (22 mars 1967) .....	133–151
SHTYPI KA NEVOJË PËR NDIHMËN E PARTISË – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (23 mars 1967) .....	152–158
PUNA NË PRODHIM U SHËRBEN KALITJES DHE EDUKIMIT – Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (23 mars 1967) .....	159–162
TË FORCOJMË MË TEJ KOOPERATIVAT BUJQE-SORE TË MALËSISE – Fjala e mbajtur në aktivin e Partisë të rrëthit të Krujës (24 mars 1967) .....	163–184
RRUGA E PARTISË ËSHTË E VETMJËA RRUGË E LUMTURISË SË POPULLIT – Fjala e mbajtur në takimin me kooperativistët e kooperativës bujqësore «Partizani» të Fushë-Krujës (25 mars 1967) .....	185–206

- POPULLSIA SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI NUK MASHTROHET DHE NUK MPOSHTET DOT NGA KLIKA TITISTE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (5 prill 1967) ..... 207–223
- NË LUFTËN KUNDER BESIMEVE FETARE KA VETËM NJË RRUGË — PUNË POLITIKE, IDEOLOGJIKË, BINDJE — Nga biseda me sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të Rrithit të Dibrës (7 prill 1967) ..... 224–329
- MIQËSI E VËRTETË ËSHTË VETËM AJO QË KARAKTERIZOHET NGA BESNIKËRIA NDAJ MARK-SIZËM-LENINIZMIT — Nga biseda në takimin me ambasadorin kinez në Tiranë (12 prill 1967) ..... 230–242
- MBLEDHJA E KARLOVI-VARIT — NJË MBLEDHJE TRADHTARËSH — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (13 prill 1967) ..... 243–257
- PA U KUPTUAR ROLI I GRUAS, TRANSFORMIMET REVOLUCIONARE NUK DO TË KRYHEN ME ATË VRULL QË DËSHIRON PARTIA — Bisedë me një grup grash e të rejash që morën pjesë në takimin kombëtar të luftëtareve të së resë (19 prill 1967) ..... 258–279
- SI TA FORCOJMË PARTINË ORGANIZATIVISHT DHE SI TA EDUKOJMË ATË IDEOLOGJIKISHT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (21 prill 1967) ..... 280–314
- ORGANIZIMI DHE ZBATIMI I PUNËS ME NORMA KOLEKTIVE SIGUROHET KRAHAS NGRITJES SË NDËRGJEGJES SË PUNONJËSVE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 prill 1967) ..... 315–321
- PUNA E PARTISË DUKET KONKRETISHT NË REZULTATET — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 prill 1967) ..... 322–324

Ç'TREGOI MBLEDHJA E RENEGATËVE NË KARLO-VI-VARI — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (5 maj 1967) .....	325—338
LUFTA KUNDER IMPERIALIZMIT E REVIZIONIZMIT KËRKON FORCIMIN E UNITETIT TË MARKSISTË-LENINISTËVE — Nga biseda me delegacionin kulturor, delegacionin e Federatës Pankineze të Bashkimeve Profesionale, si dhe me delegacionin e fotoreporterëve kinezë (6 maj 1967) .....	339—347
SA MË REVOLUCIONARE DHE E PASTËR TË JETË RINIA, AQ MË E FORTË DO TË BËHET PARTIA — Nga biseda me një delegacion të Partisë marksiste-leniniste të Austrisë (10 maj 1967) .....	348—360
ATJE KU ËSHTË PUNA, ATJE DUHET KËRKUAR EDHE DITURIA — Nga biseda me bariun Lezan Pisli (22 maj 1967) .....	361—371
PËR PRANIMET NË PARTI TË NISEMI NGA NEVOJA E FORCIMIT TË PARTISË DHE E SHTRIRJES SË DREJTË TË FORCAVE TË SAJ — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (26 maj 1967) .....	372—392
ÇËSHTJET E EDUKIMIT PËRBËJNË NJË KOMPLEKS TË TËRE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (26 maj 1967) .....	393—401
TË MENDOJMË THELLË PËR MODERNIZIMIN E BUQËSISË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (27 maj 1967) .....	402—415
REVIZIONISTËT SOVJETIKË — TRADHTARË TË ÇËSHTJES SË POPUJVE ARABË — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (8 qershor 1967)	416—421

---

MINISTRIA E BUJQÉSISE T'U PËRGJIGJET MË MIRË DETYRAVE QË I JANË NGARKUAR – Dis- kutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (10 qershori 1967) .....	422–429
AGJENT I AMERIKANËVE DHE MIK I RREMË I POPUJVE ARABË – Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (13 qershori 1967) .....	430–436
PALLAVRAT REVIZIONISTE NUK DO T'I MASH- TROJNË POPUJT ARABË – Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (14 qershori 1967) .....	437–443